



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I DREJTËSISË
DEPARTAMENTI PENAL**



DISERTACION

PËR MBROJTJEN E GRADËS SHKENCORE

DOKTOR

“AKUZAT E REJA NË PROCESIN PENAL”

PUNOI:

Klodian KURUSHI

UDHËHEQËS SHKENCOR:

Prof. Dr. Artan HOXHA

TIRANË , KORRIK 2017

PËRMBAJTJA

Mirënjohje.....	5
Shkurtime.....	6
Abstrakt.....	7
Abstract	7
METODOLOGJIA E PËRDORUR	8
KAPITULLI I.....	9
VËSHTRIMI HISTORIK I AKUZAVE TË REJA	9
1.1. Vështrim historik mbi akuzat e reja.....	9
1.2. Akuzat e reja sipas Kodit të Procedurës Penale të vitit 1953.....	11
1.2.1. Akuzat e reja në fazën e hetimeve.....	13
1.2.2. Akuzat e reja gjatë gjyqimit.....	15
1.2.3. Përfundimet mbi akuzat e reja në Kodin e Procedurës Penale të 1953-it.....	19
1.3. Akuzat e reja në kodin e procedurës penale të vitit 1979-ës	22
1.3.1. Akuzat e reja dhe ndryshimi i akuzës gjatë hetimeve	24
1.3.2. Akuzat e reja dhe ndryshimi i formulimit të akuzës në gjykim.....	25
1.3.3. Të drejtat e gjykatës mbi formulimin e akuzës gjatë gjyqimit	26
1.4. Përfundimet mbi akuzat e reja sipas kodit të procedurës penale të 1979-ës.....	28
KAPITULLI II	30
AKUZA NË FAZËN E HETIMEVE PARAPRAKE.....	30
2.1. Vlerësime të përgjithshme mbi akuzën në procesin penal	30
2.2. Akuza në fazën e hetimit në raport me akuzat e reja në procesin penal.....	33
2.2.1. Elementët e akuzës.....	34
2.2.2. Përkufizimi i akuzës	36
2.2.3. Koha e njoftimit të akuzës	40
2.2.4. Akuza dhe gjendja e arrestit.....	42

2.2.5. Akuza dhe arrestimi nga policia gjyqësore	47
2.3. Akuza dhe gjykimi i drejtpërdrejtë	49
2.3.1. Nevoja e gjykit të drejtpërdrejtë	51
2.3.2. Kërkesa për gjykim të drejtpërdrejtë dhe akti i njoftimit të akuzës	54
2.4. Akuza në gjykimin e drejtpërdrejtë dhe ndryshimet e reja në Kodin e Procedurës Penale.....	56
2.4.1. Refuzimi i kërkesës për gjykim të drejtpërdrejtë dhe pozita procedurale e personit të sjellë për gjykim	59
2.5. Kuptimi i ndryshimit dhe plotësimit të akuzës gjatë hetimeve paraprake.....	62
2.5.1. Ndryshimi i shkakut të akuzës	62
2.5.2. Ndryshimi i natyrës së akuzës.....	64
2.5.3. Ndryshimi i shkakut dhe i natyrës së akuzës në të njëjtën kohë.....	65
2.5.4. Plotësimi i akuzës gjatë hetimeve paraprake	66
2.5.5. Plotësimi i akuzës me rrethanën rënduese	66
2.5.6. Plotësimi i akuzës për një fakt të ri penal	68
KAPITULLI III.....	74
AKUZAT E REJA NË SEANCËN PARAPRAKE	74
3.1. Organizimi dhe funksionimi i prokurorisë në ndryshimet e reja kushtetuese ...	74
3.2. Seanca paraprake.....	77
3.3. Akuza dhe ndryshimi i saj në seancë paraprake	81
3.4. Ndryshimi i akuzës dhe njoftimi i akuzës për një vepër penale të re.....	82
3.4.1. Propozimi për ndryshimin e nenit 332/d paragrafi 1 të K.Pr.Penale	87
3.5. Njoftimi i akuzës për faktin e ri penal.....	87
3.7. Vlerësime të përgjithshme mbi ndryshimin e akuzës në seancë paraprake.....	92
3.8. Akuza gjenerike dhe vlerësimi i saj në seancë paraprake	93
3.9. Të drejtat e të pandehurit sipas nenit 34/a të Kodit të Procedurës Penale.....	101
KAPITULLI IV	103
AKUZAT E REJA NË PROCESIN PENAL	103
4.1. Konsiderata të përgjithshme mbi akuzat e reja.....	103

4.2.	Ndryshimi i akuzës dhe elementët e saj	108
4.2.1.	Faza e shqyrtimit gjyqësor.....	109
4.2.2.	Fakti del ndryshe nga ç'është përshkruar në kërkesën për gjykim.....	109
4.2.3.	Kompetenca e gjykatës për të shqyrtuar akuzën e ndryshuar.....	118
4.2.4.	Ndryshimi i akuzës si e drejtë ekskluzive e prokurorit.....	123
4.3.	Akuza për një vepër tjetër	127
4.3.1.	Lidhja e veprave penale	128
4.3.2.	Lidhja e veprës tjetër penale me atë që gjykohet sipas nenit 79/b të K.Pr.Penale.....	130
4.3.3.	Konkurrimi ideal i veprave penale dhe akuza ndaj një veprë tjetër penale	132
4.3.4.	Vepra penale vazhduese dhe akuza për një vepër tjetër penale	134
4.3.5.	Rrethana rënduese për veprën penale në gjykim	136
4.4.	Akuza për një fakt të ri.....	142
4.4.1.	Fakti i ri në gjykim	143
4.4.2.	Tërheqja e dosjes dhe vazhdimi i hetimit.....	145
4.4.3.	Marrëveshja për shqyrtimin e faktit të ri në të njëjtën seancë gjyqësore	146
4.5.	Të drejtat e mbrojtjes për të pandehurin në raport me akuzat e reja	152
4.5.1.	Të drejtat e të pandehurit në gjykimet alternative në raport me akuzat e reja.....	155
4.6.	Akuzat e reja dhe gjykimi në apel.....	157
4.7.	Tërheqja e akuzës prej prokurorit sipas nenit 377 të K.Pr.Penale	161
KAPITULLI V.....		165
NDRYSHIMI I CILËSIMIT JURIDIK		165
5.1.	Prezantimi i përgjithshëm i ndryshimit të cilësimit juridik.....	165
5.2.	Analiza e elementëve të ndryshimit të cilësimit juridik	167
5.2.1.	Gjykata dhe cilësimi juridik i veprës penale.....	167
5.2.2.	Fakti në cilësimin juridik mbetet i pandryshuar	169
5.2.3.	Cilësimi juridik dhe vendimi i gjykatës	172

5.2.4. Kompetenca lëndore dhe kompetenca funksionale	180
5.3. Cilësimi juridik i veprës penale sipas ndryshimeve në Kodin e Procedurës Penale.....	184
5.3.1. Ndryshimi i cilësimit juridik në gjykimin në apel	189
KAPITULLI VI.....	195
PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	195
6.1. Përfundime	195
6.2. Rekomandime	203
BIBLIOGRAFIA	195
LEGJISLACION.....	206
VENDIME TË GJYKATËS SË LARTË	207
VENDIME TË GJYKATËS KUSHTETUESE.....	207
VENDIME TË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË	208
VENDIME TË GJYKATËS SË APELIT	208
VENDIME TË GJYKATËS EVROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT	208
VENDIME TË GJYKATËS SË KASACIONIT TË ITALISË (Corte di Cassazione)..	209
VENDIME TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË ITALISË (Corte Costituzionale) ..	209

Mirënjohje

Në përfundim të këtij punimi gjej rastin të falenderoj të gjithë personat që më kanë ndihmuar si në aspektin profesional ashtu në atë moral pasi të gjithë së bashku më kanë krijuar mundësitë e duhura që unë të përfundoj disertacionin. Tema e përzgjedhur ishte një temë e vështirë në përgjithësi dhe ka kërkuar sakrifica për kohën që unë u merrja detyrimeve të tjera familjare, shoqërore dhe profesionale.

Akuzat e reja në procesin penal mbartin në përmbajtjen e tyre probleme të cilat vazhdojnë të jenë të diskutueshme si në doktrinë ashtu edhe në jurisprudencë. Kështu që një pjesë të këtyre problemeve juridike jam përpjekur ti paraqes në këtë punimi dhe në fund të jap mendimin tim mbi mënyrën dhe formën e zgjidhjes së tyre duke u mbështetur në përvojën e fituar për shkak të detyrës që ushtroj, por edhe në kontributin e madh që kam marrë prej kolegëve, miqëve dhe bashkëpunëtorëve të mi.

Në vijim duhet të shpreh falenderimet e mia për kolegë të talentuar të cilët më ka ndihmuar me materialet e duhuara për të realizuar këtë punim.

Duhet të shpreh falenderimet e mia të veçanta për Profesorin Z. Skënder Kaçupi dhe profesorët e tjerë në Departamentin e së Drejtës Penale në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti Tiranë të cilët me këshillat e tyre më kanë inkurajuar për të përfunduar disertacionin e përzgjedhur nga ana ime.

Dua të shpreh mirënjohjen e veçantë për Profesorin tim të së Drejtës së Procedurës Penale Z. Artan Hoxha pa ndihmën e pakursyer të të cilit unë nuk do të kisha nisur rrugëtimin tim në sferën akademike. Kjo punë e vështirë është realizuar falë bashkëpunimit shkencor me Profesorin tim që është njëkohësisht një prej hartuesve të Kodit të Procedurës Penale dhe të ndryshimeve pozitive që ka pësuar ai me ligjin 35/2017. Për këtë arsye e konsideroj veten me fat që Profesori është udhëheqësi im shkencor i këtij disertacioni.

E falenderoj në mënyrë të veçantë Profesor Artan Hoxha, jo vetëm për ndihmën, por edhe për kohën që ai më ka vënë në dispozicion duke më dhënë pjesë nga përvoja e tij e pasur si Profesor i së Drejtës së Procedurës Penale. Nuk mbaj mend ta kem falenderuar drejtpërdrejt, por në këtë rast është koha që me anë të këtij punimi shkencor të shpreh mirënjohjen dhe nderimin tim për gjithçka që ai ka bërë për mua.

Në mënyrë të veçantë dua të falenderoj prindërit e mi, bashkëshorten dhe vajzat e mia që janë familja ime. Ata së bashku janë përpjekur me mënyrat e tyre të më nxisin për të përfunduar disertacionin. Shpreh edhe një herë mirënjohjen për familjen time të cilës i kushtoj çdo sukses që kam arritur, pasi të gjithë së bashku kanë qenë përherë mbështetësit e mi në vështirësitë dhe gëzimet që kam ndeshur në jetë.

Shkurtime

KEDNJ Konventa Evropiane Për të Drejtat e Njeriut dhe Lirive Themelore

K.Pr.Penale Kodi i Proçedurës Penale

K. Penal Kodi Penal

GJEDNJ Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriutë

Abstrakt

Në këtë punim fillimisht ofrohet një panoramë doktrinale e gjyqësore të akuzave të reja në periudha të ndryshme historike pas vitit 1912 e deri në ditët e sotme, duke analizuar akuzën e ndërtuar në fazën e hetimeve paraprake si dhe modifikimin e saj gjatë shqyrtimit gjyqësor, përfshirë edhe rolin aktiv që gjykata kishte në drejtim të “ndryshimit të akuzës së kontestuar” nga ana e prokurorit apo hetuesit në fazën e hetimeve paraprake. Në punim trajtohet faza procedurale në të cilin kalon “akuza” penale, duke evidentuar dy karakteristikat themelore të saj, përkohshmëria në fazën e hetimeve paraprake dhe elasticiteti në fazën e shqyrtimit gjyqësor, pasi në momente të ndryshme procedurale mund të pësojë modifikime, mbi ndryshimin apo shtimin e faktit apo veprës penale. Në pjesën kryesore punimi analizon në mënyrë shteruese ndryshimet e reja në kodin e procedurës penale mbi seancën paraprake, gjyqtarin e seancës paraprake dhe transformimin që mund të pësojë akuzat në seancë paraprake. Do të analizohet fillesa e modifikimit të akuzës, apo njoftimin e akuzave të reja nga prokurori në seancën paraprake. Në punim analizohet dhe pozita që ka gjykata në drejtim të ndryshimit të akuzës, rolin e prokurorit, si dhe raportin që krijohet mes akuzës, gjykatës dhe prokurorit në gjykim. Më tej trajtohet ndryshimi i akuzës në raport me natyrën dhe llojin veprës penale dhe konstruktin e saj juridik, duke marrë për bazë natyrën e veprës penale, faktin penal si pjesë përbërëse e akuzës të sjellë për gjykim si dhe arsyet se përse në gjykim fakti rezulton të dalë ndryshe nga sa është paraqitur në kërkesën për gjykim. Trajtim të veçantë gjen dhe praktika e Gjykatës Kushtetuese të Italisë mbi institutet e ndryshimit të akuzës, akuzës për një vepër tjetër, akuzat për një fakt të ri. Në analizë do të merret dhe instituti i ndryshimit të cilësimit juridik me vendim përfundimtar, kufizimet e gjykatës në drejtim të ndryshimit të cilësimit juridik, raporti që krijohet midis ndryshimit të cilësimit juridik dhe kompetencës së gjykatës për gjykimin e asaj vepre penale. Në punim analizohen dhe ndryshimet e kodit të procedurës penale të kryera me me Ligjin nr. 35/2017. Punimi në përfundim do të paraqesë dhe rekomandimet e nevojshme në formën e propozimeve mbi përmirësimin e legjislacionit tonë procedural penal mbi akuzat e reja.

Abstract

This paper initially provides a doctrinal and judicial view of new charges at different historical periods after 1912 to the present day, analyzing the charge built into the preliminary investigation phase and its modification during the main trial, including the active role that the court had in terms of "changing the contested charge" by the prosecutor or investigator at the stage of the preliminary investigation. The paper deals with the procedural phase in which the criminal charges go through, identifying the two basic characteristics, the provisionality at the preliminary investigation phase and the elasticity at the judicial review phase, since at various procedural times it may be subject to modifications to the change or increase of the fact or the criminal offense. The main part of the paper exhaustively analyzes the new changes to the Code of Criminal Procedure on the Preliminary Session, the Judge of the Preliminary Session and the transformation that may be incurred in the preliminary hearing. The beginning of the modification of the indictment, or notification of new allegations by the prosecutor in the preliminary hearing will be analyzed. In addition, the paper analyzes the position of the court regarding the change of the charge, the role of the prosecutor, as well as the report created between the charge, the court and the prosecutor in the trial. It further deals with the change of the indictment in relation to the nature and type of offense and its legal construct, taking into account the nature of the offense, the criminal fact as an integral part of the charge brought for trial, and the reasons why in the trial the fact turns out to differ from what is presented in the request for trial. Even the practice of the Constitutional Court of the Italian Republic finds special treatment on the institutes of changing the charge, the charge for another offense, the charge of a new fact. The paper will also analyze the institute of change of legal qualification with a final decision, the court's limitations in terms of changing the legal qualification, the report that is created between the change of legal qualification and the jurisdiction of the court to adjudicate that criminal offense. The paper also analyzes the changes to the Code of Criminal Procedure carried out by Law no. 35/2017. The conclusions of the paper will present the necessary recommendations in the form of proposals on improving our criminal procedural legislation on new charges.

METODOLOGJIA E PËRDORUR

Realizimi i disertacionit me temë “Akuzat e reja në procesin penal”, në kuadër të marrjes së titullit Doktor në fushën e së drejtës procedurale penale është kryer në përputhje me metodat e kërkua shkencore dhe të pranura në rregulloren dhe aktet juridike përkatëse të Universitetit të Tiranës.

Metodologjia e përdorur në këtë punim fillon me përdorimin e metodës historike, përmes së cilës është mundësuar shfaqja e një panorame të gjerë mbi mënyrën sesi ka qenë dhe si ka evoluar më pas legjislacioni procedural penal në kuadër të akuzave të reja në procesin penal.

Krahas metodës historike në punim është përdorur dhe metoda krahasimore, e cila ka në vëmendje jo thjesht pasqyrimin e legjislacionit të huaj, por më tepër jurisprudencën e gjykatave të huaja kryesisht të Gjykatës Evropiane “Për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut” si dhe jurisprudencën e gjykatave italiane, për shkak të modelit të ngjashëm të sistemit procedural penal. Qëllimi i përdorimit të praktikës gjyqësore të Gjykatës së Kasacionit të italisë, por edhe të Gjykatës Kushtetuese, qëndron në faktin se në kuadër të akuzave të reja, kodi ynë i procedurës penale ka ngjashmëri dhe shpesh njëjlojshmëri me atë Italian.

Në fakt, metoda krahasimore, duke ju referuar praktikës së gjykatave italiane, tashmë përbën një realitet juridik në ambientin e jurisprudencës shqiptare, ku mund të përmendim Vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë mbi ndryshimin e cilësimit juridik të gjykimit të shkurtuar, vendim i cili i referohet jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese italiane. Ky vendim por dhe vendime të tjera të cilët prekin problematikën e cilësimit juridik të veprës penale do të jetë pjesë e analizës së këtij punimi.

Krahas metodave të mësipërme gjerësisht është përdorur edhe metoda e analizës së rasteve, njohur edhe si *case law*, përmes së cilës evidentohet mënyra sesi gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, veçanërisht Gjykata e Shkallës së Parë Për Krimet e Rënda, duke përfshirë edhe Gjykatën e Lartë, interpretojnë dhe zbatojnë në raste konkrete institutin e “Akuzave të reja në procesin penal”. Metoda e analizës është përdorur gjithashtu në evidentimin e elementeve përbërës të akuzës dhe mënyrës sesi ajo transformohet gjatë procesit gjyqësor.

Gjithashtu literatura e përdorur është e gjerë dhe e shumëllojshme. Burimet formale dhe materiale të shfrytëzuara janë legjislacioni shqiptar prej vitit 1928 e deri në ditët e sotme, komentare të jurisprudencës, me autor të brendshëm dhe të huaj si dhe jurisprudencë gjyqësore ndër vite.

KAPITULLI I

VËSHTRIMI HISTORIK I AKUZAVE TË REJA

1.1. Vështrim historik mbi akuzat e reja

Instituti i akuzave të reja gjendet i përfshirë në të gjitha kodet e procedurave penale në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Shqipëria fitoi pavarësinë prej pushtimit të gjatë të Perandorisë Otomane më 28 nëntor të vitit 1912. Në këtë kohë është krijuar edhe qeveria e parë shqiptare e cila u përpoq që kontrollonte të gjitha territoret shqiptare me qëllim ushtrimin e pushtetit të saj në emër të popullit shqiptar. Rrjedhimisht po t'i referohemi procedimit penal shqiptar do të ndalemi vetëm për periudhën pas Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë dhe formimit të Qeverisë së parë shqiptare.

Në periudhën e pushtimit osman zbatohet legjislacioni i Perandorisë Otomane, miratuar në vitin 1879 i bazuar në modelin e kodit të procedurës penale të Francës në kohën e Napoleonit të vitit 1808¹. Në kohën e formimit të shtetit të parë shqiptar pas Shpalljes së Pavarësisë për shkak të kushteve politike, gjendjes ekonomike të popullsisë si dhe rrethanave që lidhen me situatën ndërkombëtare të prag luftës së parë botërore, nuk u arrit të krijohet një legjislacion procedural penal i plotë e i përfshirë në një ligj të veçantë. Gjithsesi vlen të theksojmë përpjekjet e bëra në këtë kohë nga një grup juristësh të shquar shqiptarë të cilët krijuan një legjislacion fillestar të procedurës penale, i cili do t'i jepte mundësi gjykatave shqiptare të funksiononin si organe ligjore për të dhënë drejtësi.

Në këtë periudhë përmendim përpjekjet e bashkë firmëtarit të Deklaratës së Shpalljes së Pavarësisë, Petro Poga që në qeverinë e parë shqiptare pas Shpalljes së Pavarësisë u zgjodh Ministër i Drejtësisë, i cili së bashku me avokatët e shquar Dhimitër Tutulani dhe Fehim Mezhgorani kanë hartuar Statutin e Gjykatës që shkëputi Gjykatat Shqiptare nga juridiksioni i Perandorisë Osmane. Po kështu, ata së bashku kanë hartuar aktet ligjore që janë “Kanuni i Dëmeve” dhe “Kanuni i Zhurisë”, të cilat Ministri Petro Poga i ka paraqitur për diskutim dhe mbrojtur vetë gjatë miratimit të tyre. “Kanuni i Zhurisë”, ashtu sikurse edhe “Kanuni i Dëmeve”, u botua në disa numra të gazetës “Përlindja e Shqipërisë”, që mban datën e përfundimit si dokument të hartuar më 13 maj 1913. Gjatë kësaj kohe Ministria e Drejtësisë u shqua për rolin e saj aktiv në hartimin edhe dërgimin e urdhërësive e udhëzimeve në prefektura e nënprefektura për zbatimin e ligjshmërisë ndaj personave që kryejnë faje, madje duke këmbëngulur që ata “të shtien në dorë menjëherë”, duke vënë në veprim xhandarmërinë.

Më datë 10 maj 1913 në Shqipëri miratohet “Kanuni i Zhurisë”. Në këtë akt përcaktohet nocioni i fajit, organizimi, funksioni, juridiksioni dhe kompetencat e sistemit të gjykatave që do të trajtonin nga ana e tyre çështjet që do të paraqiteshin për gjykim me natyrë civile dhe penale. Me “Kanunin e Zhurisë” hiqeshin kadilerët si subjekte që jepnin vendimin gjyqësor në emër të Perandorisë Otomane. Për herë të parë në “Kanunin e Zhurisë” u parashikua procedura

¹ Dr. Gazeli Kosta, “Vështrim historik – krahasues për akuzat e reja në legjislacionin Procedural penal shqiptar”, Shkrim i botuar në Revistën shkencore “Justiniani i Parë”, botuar më 20 prill 2011, Tiranë

e gjykimit me juri për Krimet e Rënda. Kjo procedurë u zbatua vetëm një herë, për një rast që u gjykua në Gjykatën e Elbasanit. “Kanuni i Zhurisë” shënoi fillimet e zbatimit të politikave për krijimin e elementeve bazë të së drejtës së procedurës penale me orientim perëndimor.

Për këtë arsye data 10 maj është përcaktuar në ligjin “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” i cili është aktualisht në fuqi, si Dita e Drejtësisë për të përkujtuar dhe respektuar ditën në të cilën është miratuar “Kanuni i Zhurisë”.²

Periodha e Mbretërisë Shqiptare i ka fillimet e saj me miratimin prej Asamblesë së dytë Kushtetuese, të Statutit themeltar të Mbretërisë Shqiptare më datë 1 dhjetor 1928. Gjatë periudhës së Mbretërisë u arrit të realizohej një reformë moderne juridike e cila është mjaft e vlerësuar për kohën kur ajo është kryer. Përgjatë kësaj reforme juridike mund të evidentojmë miratimin e Kodit Civil dhe Kodit Penal të njohura si “Kodi Civil dhe Kodit Penal i Zogut” pasi i referohen kohës së miratimit të tyre gjatë Mbretërimit të Mbretit Zog i Parë në Shqipëri. Me gjithë punën e lavdërueshme të bërë në kohën e Mbretërisë, nuk u arrit në këtë kohë miratimi i legjislacionit të procedurës penale më vite.

Gjatë kohës së Mbretërisë procedimet penale janë bazuar në aktet ligjore të miratuara nga Qeveria e Vlorës e vitit 1912, të shoqëruara më pas edhe me akte të tjera ligjore që në përmbajtje të tyre kishin norma me natyrë procedurale penale. Në këtë kohë mund të përmendim miratimin e Ligjit “Për organizimin e drejtësisë” i vitit 1929, Ligji “Për Përmirësimin e Procedurave penale” i vitit 1937, Ligji “Për procedurat penale ushtarake në kohë paqe” që hyri në fuqi në vitin 1932. Gjatë kësaj kohe mund të themi se mungesa e Kodit të Procedurës Penale si ligj i pavarur procedural penal, i bëri të pamundura konstatimet dhe përfundimet për sa u përket institutit të akuzave të reja në procedimin penal.

Në periudhën e pas çlirimit të vendit nga pushtimi i huaj, me krijimin fillimisht të Republikës së Shqipërisë nga Asambleja Kushtetuese më datë 11 janar të vitit 1946 fillon një rrugë e re për legjislacionin në përgjithësi, si dhe për legjislacionin e procedurës penale në veçanti. Gjatë periudhës së pas çlirimit deri në fund të vitit 1990, Shqipëria kalon nën sundimin e një sistemi qeverisës komunist. Gjatë kësaj kohe është realizuar një reformë ligjore e mirëfilltë e cila pasqyron dhe mbron marrëdhëniet e reja socialiste të vendosura pas çlirimit të vendit më 29 nëntor 1944.

Referuar legjislacionit të procedurës penale, përmendim miratimin për herë të parë të Kodit të Procedurës Penale të vitit 1953. Kodi i parë i procedurës penale i 1953 ka qenë në fuqi deri në kohën e miratimit të kodit të ri të procedurës penale të vitit 1979. Ndërkohë që ky i fundit qëndroi në fuqi deri në vitin 1995. Më datë 1 gusht të vitit 1995 hyri në fuqi kodi i ri i procedurës penale i cili aktualisht është në fuqi. Në të tre kodet e procedurës penale të përmendur më lart parashikohet instituti i akuzave të reja.

Në këtë mënyrë për efekte të studimit të këtij instituti është përdorur metodologjia e përfshirjes së akuzave të reja në procesin penal në Kodet e Procedurave Penale të mëparshme për të evidentuar funksionin, strukturën, karakteristikat dhe ndryshimet që kanë pësuar akuzat

² Material i marrë nga konkursi i zhvilluar në ambientet e Gjykatës së shkallës së parë “Për Krimet e Rënda” Tiranë, organizuar nga Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, mbajtur më datë 10 maj 2013

e reja në Kodet e Procedurave Penale. Pra në funksion të një vështrimi të shkurtër historik do të ndalemi paraprakisht në prezantimin e akuzave të reja në kodet e procedurave penale të viteve 1953 dhe 1979.

1.2. Akuzat e reja sipas Kodit të Procedurës Penale të vitit 1953

Instituti procedural të akuzave të reja në procesin penal e gjejmë në Kodin e Procedurës Penale të vitit 1953, i cili gjeti zbatim deri në vitin 1980. Sipas këtij kodi, sistemi procedural penal i zgjedhur ishte ai inkuizitor, por me elementë dhe të sistemit akuzator. Për rrjedhojë, në këtë kod instituti procedural i akuzave të reja rregullohej në raport me funksionet, të drejtat dhe detyrat e subjekteve të procedimit penal gjatë procedimit penal, veçanërisht të gjykatës dhe prokurorit, të cilat përcaktoheshin nga sistemi procedural i cili ishte inkuizitor, modeli i tij, si dhe sistemi politik, që ishte vendosur në vendin tonë në atë kohë³.

Fillimisht kodi i vitit 1953 u miratua me Ligjin nr. 1650 datë 30 mars 1953. Gjatë kohëzgjatjes së tij, ky kod pësoi dy ndryshime, respektivisht me Ligjin nr. 1776 datë 3 dhjetor 1953 si dhe me Ligjin nr. 2805 datë 4 dhjetor 1958.

Kodi i Procedurës Penale i 1953-it, u mbështet në disa parime themelore të cilat pasqyrojnë rendin e ri shoqëror të krijuar pas çlirimit të vendit. Normat e kodit të procedurës penale kishin “për detyrë të mbronin shtetin demokratik popullor të punëtorëve, të fshatarëve punonjës dhe rendin e juridik socialist”⁴. Në këtë Kod gjejmë të sanksionuar edhe disa parime demokratike të rëndësishme të së drejtës procedurale penale siç janë mosgjykimi rishtas për të njëjtin krim për të cilin është gjykuar më parë me një vendim të formës së prerë “*ne bis in idem*” parashikuar në nenin 5 të këtij Kodi, parimi i gjykimit me dyer të hapura (zhvillimi i seancave publike) parashikuar nga neni 7, dhënia e vendimit duke u bazuar vetëm në provat e shqyrtuara në seancë gjyqësore (njëri prej aspekteve të zbatimit të parimit të ligjshmërisë) neni 8, sigurimi i së drejtës së mbrojtjes për të pandehurin në procesin gjyqësor parashikuar nga neni 12, prezumimi i pafajësisë për të pandehurin derisa fajësia e tij të provohet me një vendim gjyqësor të formës së prerë, të parashikuar nga neni 13 i këtij Kodi.

Sistemi procedural penal i zgjedhur nga ky kod siç e përmendëm më sipër ishte ai inkuizitor, ku prova formohej gjatë fazës së hetimit penal. Për rrjedhojë edhe akuza në hetim, si dhe instituti i akuzave të reja rregullohej në këtë kod në raport me funksionet, të drejtat dhe detyrat e subjekteve pjesëmarrës në procedimin penal. Vlen të përmendim faktin se në formulimin e akuzave të reja prokurori dhe gjykata kanë një rol të rëndësishëm, për shkak të sistemit inkuizitor që prezantonte kodi i procedurës penale si dhe për shkak të sistemit politik të vendosur në Shqipëri⁵.

Subjektet kryesore procedurale këtë Kod ishin gjykata, prokurori, hetuesia, organet e gjurmimit, si dhe i pandehuri.

³ Bani Erion, Dardha Luveta, Dervishi Marsela, Gjuzi Adelajda, Goxha Diamela, Hasani Dritan, Mihali Elona, Muçi Emona, “Ndryshimi i cilësimit juridik të veprës penale dhe e drejta për një proces të rregullt ligjor sipas KEDNJ”, Revista “Jeta Juridike” nr 2, qershor 2012

⁴ Neni 1/1 i Kodit të Procedurës Penale të vitit 1953

⁵ Dr. Gazeli Kosta, “Vështrim historik – krahasues për akuzat e reja në legjislacionin Procedural penal shqiptar”, Shkrim i botuar në Revistën shkencore “Justiniani i Parë” botuar në Tiranë më datë 20 prill 2011

Prokurori kishte për detyrë të fillonte ndjekjen penale për çdo vepër penale të dënueshme nga ligji dhe të mbronte akuzën përpara gjykatës. Përveç funksionit të dhënies së drejtësisë, gjyqtarët në bazë të këtij kodi kishin edhe funksione të tjera, si fillimin e çështjes penale kryesisht ose mbi bazën e një kallëzimi që ai mund ta merrte nga kallëzuesi i veprës penale. Për fillimin e çështjes penale gjyqtari dispononte me një vendim të arsyetuar⁶. Nëse kallëzimi nuk përmbante elementet e ndonjë krimi atëherë gjyqtari mund të jepte një vendim të arsyetuar për mos fillimin e hetimeve. Kundër këtij vendimi mund të lejohej ankim në gjykatën më të lartë. Kur e vlerësonte të nevojshme gjyqtari mund të dërgonte kallëzimin për hetim organeve të hetimit.

Kur çështja vinte për gjykim nga organi që kryente hetimet, gjyqtari i vetëm do t'i duhej fillimisht të aprovonte akt akuzën dhe të caktonte çështjen për gjykim kur konstatonte se hetimet janë të mjaftueshme për gjykim⁷. Kur çështja penale depozitohej në gjykim me një akt akuzë të aprovuar nga prokurori, gjyqtari i vetëm e dërgonte detyrimisht çështjen penale në seancë përgatitore.

Në seancën përgatitore gjyqtari shqyrtonte paraprakisht çështjet që lidheshin me kompetencën, themelin e akuzës dhe besueshmërinë e provave për dërgimin e çështjes në seancë gjyqësore, mbi cilësimin e drejtë të akuzës dhe veprës penale sipas dispozitave të kodit penal. Në përfundim të seancës gjyqësore gjyqtari vendoste dërgimin e çështjes për gjykim, aprovimin e akt akuzës ose ndryshimin e akt akuzës kur nuk ishte rasti i kthimit të çështjes penale prokurorisë për plotësimin e hetimeve apo për përpilimin e një aktakuzë të re që ka nevojë për plotësim hetimesh, pezullimin ose pushimin e çështjes penale në rastet e parashikuara shprehimisht në Kod⁸.

Vërehet ndër të tjera se gjyqtari në bazë të këtij kodi kishte të drejtën të kontrollonte akt akuzën përpara se çështja të shqyrtohej në seancë gjyqësore. Ndërkohë që hetimi kryhej nga hetuesia dhe organet e gjurmimit. Veprat penale për të cilat kryhej hetimi nga të dy këto organe ishin të përcaktuara qartësisht në këtë kod. Organi kryesor që merrej me hetimet ishte organi i hetuesisë. Organet e hetuesisë me marrjen dijeni për ndonjë ngjarje me natyrë kriminale ishin të detyruara të fillonin menjëherë hetimin me një vendim të arsyetuar dhe të njoftonin prokurorin për nisjen e hetimit. Organet e hetuesisë përveç hetimit kishin edhe funksione të tjera të rëndësishme si marrja e një personi me cilësinë e të pandehurit, të merrnin në pyetje të pandehurin, t'i jepnin mundësi të pandehurit që të merrte dijeni për materialin e hetimeve, të vendosnin për masat e sigurimit duke marrë pëlqimin në këtë rast të prokurorit, të përpilonin akt akuzën me aprovimin e prokurorit⁹.

Pas përfundimit të hetimeve, hetuesia përpilonte aktakuzën në të cilën tregoheshin shkurtimisht përmbajtja e çështjes, duke u përmendur rrethanat, si ato që ishin kundër, ashtu dhe ato në favor të të pandehurit, si dhe provat me të cilat vërtetoheshin këto rrethana. Në akt akuzë tregoheshin njoftime të hollësishme për personin që kishte kryer krimin, për vendin, kohën, mjetet dhe shkaqet e kryerjes së krimit, njoftime për dëmin e shkaktuar nga krimi dhe për të dëmtuarin, duke shënuar nenet e kodit penal që parashikonte krimin dhe, kur në akuzë

⁶ Neni 95 i kodit të procedurës penale të vitit 1953

⁷ Neni 213 i kodit të procedurës penale të vitit 1953

⁸ Neni 215 i kodit të procedurës penale të vitit 1953

⁹ Neni 118 i kodit të procedurës penale të vitit 1953

përmendeshin shumë krime, nenet që parashikonin secilin prej tyre¹⁰. Akt akuzën së bashku me aktet e hetimit hetuesi ja dërgonte prokurorit. Kundër veprimeve të hetuesit i pandehuri dhe palët e tjera mund të bënin ankim te prokurori, i cili ishte i detyruar të shqyrtonte ankimin brenda 3 ditëve nga paraqitja e tij.

Prokurori si subjekt procedural funksion kryesor të tij kishte kontrollin e hetimeve. Jo në të gjitha çështjet që shqyrtoheshin në gjykatë prania e prokurorit ishte e detyrueshme. Prokurori mund të kthente çështjen penale për plotësim, duke i bashkëngjitur vendimit udhëzimet e nevojshme që duhet të merreshin në konsideratë nga hetuesia. Prokurori aprovonte akt akuzën me shkrim kur ndante të njëjtin mendim me hetuesin. Kur prokurori nuk kishte të njëjtin mendim për akt akuzën e përpiluar më parë nga hetuesi, përpilonte një akt akuzë të re. Në këtë rast akt akuzë e parë e hartuar nga hetuesia ose organi i gjurmimit sipas rastit, hiqej nga aktet e dosjes penale dhe i kthehej përpiluesit të saj, duke i përmendur të metat¹¹. Akt akuzë së bashku me aktet e tjera i dërgoheshin gjykatës nga prokurori dhe nëse prokurori e vlerësonte të nevojshme pjesëmarrjen e tij në seancë gjyqësore, ia bënte të ditur gjykatës.¹²

Pra pjesëmarrja e prokurorit në seancë gjyqësore nuk ishte në të gjitha rastet e detyrueshme. Në mungesë të prokurorit debati gjyqësor zhvillohej midis të pandehurit dhe gjykatës.

1.2.1. Akuzat e reja në fazën e hetimeve

Kodi Procedurës Penale i vitit 1953 nuk përmbante dispozita mbi të cilat rregullohej “ndryshimi akuzës” në fazën e hetimeve paraprake. Si pasojë e kësaj zgjedhjeje ligjore, në terren zbatohesh një praktikë e njehsuar ndër vite, sipas së cilës, nëse pas marrjes së personit si i pandehur rezultonte se vepra penale e konsumuar ishte e ndryshme nga ajo e komunikuar me aktin e marrjes si i pandehur, prokurori i çështjes përpilonte një vendim të dytë i cili në pikëpamje të vlerave, revokonte vendimin e mëparshëm, e njëkohësisht i jepte një vlerë juridike të ndryshme procedimit penal të nisur, kjo në raport me autorin dhe veprën penale të konsumuar.

Siç e përmendëm edhe më lart, një person merrte cilësinë e të pandehurit me vendimin e hartuar nga hetuesi ose organi i gjurmimit. Cilësia e të pandehurit nuk lidhej domosdoshmërisht me përpilimin e akt akuzës. Vendimi për marrjen e një personi me cilësinë e të pandehurit dhe vendimi i përpilimit të akt akuzës ishin dy akte të ndryshme procedurale të cilat zakonisht hartoheshin në kohë të ndryshme të fazës së hetimit.

Gjatë hetimit një person merrte cilësinë e të pandehurit kur ndaj tij hetuesi kishte të dhëna të mjaftueshme për pjesëmarrjen e një personi në kryerjen e krimit. Në këtë rast organi i hetimit i njoftonte të pandehurit akuzën përkatëse. Pas marrjes së një personi me cilësinë e të pandehurit organet e hetimit procedonin me marrjen në pyetje të tij si të pandehur. Më tej organet e hetimit procedonin me marrjen e grumbullimit të provave të tjera të cilat në përfundim vlerësoheshin prej hetuesit në përpilimin e akt akuzës.

¹⁰ Neni 202 i kodit të procedurës penale të vitit 1953

¹¹ Neni 208 i kodit të procedurës penale të vitit 1958

¹² Neni 209 i kodit të procedurës penale të vitit 1958

Në përfundim të hetimeve, hetuesi i çështjes përpilonte aktakuzën në të cilën paraqiste konkluzionet që evidentoheshin nga uniteti i provave dhe akteve që ndodheshin në dosje, së cilës i bashkëlidhej dhe mbi të cilat mbështetej kërkesa për gjykim, kjo vetëm pas miratimit të saj nga prokurori. Në realizimin e këtij funksioni procedural hetuesi ishte i kushtëzuar për shkak se hartimi i aktit të akuzës nuk mund të formësohej me një përmbajtje të ndryshme nga akti i marrjes si i pandehur, veçse në rastin kur favorizohej pozita. Akt akuza përpilohej nga hetuesia ose organi i gjurmimit (pra organi që kishte kryer hetimin) pas përfundimit të hetimeve. Aktakuza e përpiluar duhej të kontrollohej nga prokurori në drejtim të hetimit si dhe në drejtim të dispozitës konkrete të kodit penal që e parashikonte si krim veprimin e kryer prej të pandehurit. Pra aktakuza ishte akti përfundimtar i cili i jepte fund hetimit dhe e dërgonte çështjen penale për gjykim.

Kodi i procedurës penale i 1953 nuk parashikonte shprehimisht mundësinë e ndryshimit të akuzës prej hetuesit nëse zbuloheshin fakte apo rrethana të tjera që ndikonin në ndryshimin e akuzës që i ishte bërë dhe njoftuar më parë të pandehurit. Mënyra e veprimit në këto raste ishte e përcaktuar nga doktrina juridike e kohës si dhe praktika gjyqësore.

Kështu në rast se gjatë zhvillimit të hetimeve fakti rezultonte ndryshe nga sa të pandehurit i ishte paraqitur akuza në njoftimin e vendimit për marrjen si të pandehur, hetuesi i çështjes duhej të përpilonte dhe t'i njoftonte të pandehurit një vendim të ri për marrjen si të pandehur, me një formulim të ri të akuzës ku të pasqyroheshin fakti ose rrethanat e reja pavarësisht nëse ato e ndryshonin ose jo cilësimin juridik të veprës penale. Në përpilimin e akt akuzës që hartohej prej hetuesit në përfundim të hetimit ai i referohej akuzës së parë që i kishte njoftuar të pandehurit në kohën që ai e kishte marrë me këtë cilësi një person të dyshuar për kryerjen e një krimi. Pra hetuesi në përgjithësi nuk mund të dilte jashtë kufijve të akuzës që ishte përmendur në vendimin për marrjen me cilësinë e të pandehurit të personit ndaj të cilit kishin nisur hetimet.

Aktakuza e përpiluar nga organet e hetimit kalonte në rastin më të mirë në dy filtra kontrolli, të cilat ishin fillimisht kontrolli i realizuar nga prokurori e më pas kontrolli i realizuar nga gjyqtari përpara se çështja penale të kalonte në seancë gjyqësore. Pra akt akuza e përpiluar nga hetuesi ose përfaqësuesi i organit të gjurmimit detyrimisht do të kontrollohej për saktësinë e saj. Ndërkohë akuza që lidhej me vendimin e organit të hetimit për të marrë një person me cilësinë e të pandehurit nuk parashikohej në këtë kod si akt procedural që duhej t'i nënshtrohej një kontrolli ashtu si kur ndodhte me aktakuzën.

Pas marrjes së akt akuzës, prokurori i çështjes nëse nuk ishte dakord me akuzën e ngritur, gëzonte të drejtën procedurale për shkak funksioni, të mund të ndryshonte akuzën pa qënë i detyruar t'ia kthente akt akuzën hetuesit. Megjithatë ushtrimi kësaj kompetence funksionale realizohej brenda një hapësire juridike e cila synonte të minimizonte mundësitë për arbitraritet të prokurorit dhe maksimalizonte garancitë procedurale të personit të marrë në cilësinë e të pandehurit.

Thënë më thjeshtë, pas marrjes së akt akuzës prokurori nëse nuk ishte dakord pa ja kthyer hetuesit mund të përpilonte një aktakuzë të re. Në përpilimin e akt akuzës prej prokurorit, akuza fillestare e njoftuar të pandehurit mund të ndryshohej. Prokurori mund të ndryshonte cilësimin e veprës penale që i ngarkohej të pandehurit, vetëm nëse ky ndryshim nuk e rëndonte akuzën

dhe nuk ndryshonte karakterin e krimit për të cilin ishte akuzuar i pandehuri nga ana e organit të hetimit.¹³

Kështu prokurori mund të ndryshonte cilësimin juridik të veprës që i ngarkohej të pandehurit, vetëm nëse ndryshimi i cilësimit juridik nuk e rëndonte pozitën e tij procedurale dhe nuk ndryshonte natyrën juridike të krimit për të cilin akuzohej i pandehuri.

Në eventualitet se gjykata do t'i kthente aktet prokurorisë për realizimin e hetimeve të mëtejshme ose plotësimin e aktit juridik të akt akuzës, shtrohej për diskutim çështja nëse akti i ri, i nxjerrë si rrjedhojë e detyrimeve të shprehura në vendimin gjyqësor do të konsiderohej si një akt akuzë e re apo plotësim i aktit të mëparshëm. Përcaktimi i një fakti të tillë juridik përfaqëson vlera jo vetëm teorike e formale, por praktike dhe substanciale me impakt të drejtpërdrejtë në afatet e hetimeve paraprake. Kësaj çështje, në mungesë të një norme juridike, i'u dha përgjigje përmes praktikës së Gjykatës së Kasacionit e cila përcaktoi qëndrimin sipas të cilit:

“Prokurori i çështjes duhet të paraqitet në gjykim me një aktakuzë të re, e cila duhet detyrimisht t'i komunikohet të pandehurit me qëllim për ti dhënë atij garancitë e nevojshme për t'u mbrojtur në proces”¹⁴.

1.2.2. Akuzat e reja gjatë gjyimit

Më sipër u prezantuan rastet kur akuza në fazën e hetimit dhe akt akuza pas përpilimit të saj prej përfaqësuesit të organit të hetimit mund të ndryshonte përpara fillimit të shqyrtimit gjyqësor të çështjes penale. Akt akuza - e cila konsistonte në aktin procedural përmbledhës të përfundimit të hetimeve si dhe të kërkesës që depozitohej në gjykatë për të proceduar më tej me çështjen penale - kontrollohej sipas rastit nga prokurori ose prej gjyqtarit të vetëm. Ky i fundit në seancë përgatitore kontrollonte akt akuzën e sjellë drejtpërdrejtë nga përfaqësuesi i organit të hetimit kur një veprimi i tillë ishte i përcaktuar nga kodi ose nga prokurori në rastin kur akt akuza duhej paraprakisht të kontrollohej nga prokurori. Në rastin e fundit, vendimi i gjyqtarit të vetëm për të dërguar çështjen penale në seancë përgatitore pas marrjes në dorëzim të akt akuzës nga prokurori përbënte vendim të detyrueshëm.

Pas kontrollit që i bëhej akt akuzës së përpiluar nga përfaqësuesi i organit të hetimit, si nga prokurori ashtu edhe nga gjyqtari në seancë përgatitore, kur nuk duhet të kryheshin veprime të tjera plotësuese në drejtim të hetimit apo cilësimit juridik të aktakuzës, çështja penale dërgohej për gjykim. Në gjykim prania e prokurorit nuk ka qenë e detyrueshme në varësi të rëndësisë së akt akuzave të sjella për gjykim. Rrjedhimisht debati gjyqësor në seancë gjyqësore zhvillohej midis të pandehurit dhe mbrojtësit të tij nga njëra anë dhe gjykatës nga ana tjetër.

Përveç gjyqtarit të seancës përgatitore i cili kishte të drejtë të ndryshonte akt akuzën e të pandehurit në seancë, pa shqyrtuar në themel të gjitha provat e grumbulluara në fazën e hetimit, një të drejtë të tillë për të ndryshuar akuzën në gjykim në seancë gjyqësore e kishte dhe gjykata.

¹³Dr. Gazeli Kosta, “Vështrim historik – krahasues për akuzat e reja në legjislacionin Procedural penal shqiptar”, Shkrim i botuar në Revistën shkencore “Justiniani i Parë” botuar në Tiranë më datë 20 prill 2011

¹⁴ Shiko vendimin nr. 204 datë 26.03.1954 i Gjykatës së Kasacionit

Kapitulli i njëmbëdhjetë i kodit të procedurës penale të 1953 titullohej “Ndryshimi i akuzës dhe marrja nën akuzë e personave të tjerë” përmbante katër dispozita procedurale të cilat rregullonin institutin procedural të ndryshimit të akuzës.

Në një vështrim të përgjithshëm të këtyre normave procedurale bie në sy roli aktiv i gjyqtarit, kjo pasi në kushtet kur realiteti procedural karakterizohej nga ekzistenca e sistemit inkuizitor, sipas të cilit gjyqtari është subjekt me një rëndësi të veçantë në procesin penal. Një figurë e tillë e gjyqtarit është e pranueshme në një sistem të tillë, në kushtet kur gjykata në përgjithësi dhe gjyqtari në veçanti, perceptoheshin (për shkak ligji) jo vetëm si subjekt i dhënies së drejtësisë, por dhe si subjekt me kompetenca fuqiplotë në fazën e hetimeve paraprake dhe në fazën e gjykimit të çështjes penale ardhur për shkak të kontrollit të cilësisë së hetimit e verifikimit të saktësisë së aktakuzës të formuluar nga prokurori përpara fillimit të shqyrtimit gjyqësor të procedimit penal.

Dispozitat procedurale kishin të bënin me nenet 273 deri 276 të kodit të procedurës penale të vitit 1953, ku më konkretisht parashikohej se:

Neni 273

“Gjykimi i çështjes në seancë gjyqësore bëhet vetëm për personat e dërguar në gjyq para çeljes së seancës gjyqësore dhe vetëm në lidhje me akuzën për të cilën janë marrë si të pandehur qysh më parë me përjashtim të rasteve të parashikuara nga nenet që vijojnë.”

Neni 274

“Kur nga të dhënat që kanë dalë nga gjykimi, shihet e nevojshme të ndryshohet formulimi i parë i akuzës, gjykata kryesisht ose me kërkesën e çdo pale, jep vendim në lidhje me këtë dhe u’ a njofton palëve.

Në qoftë se formulimi i ri i akuzës nuk sjell një dënim më të rëndë dhe rrethanat e çështjes mund të sqarohen plotësisht gjatë seancës gjyqësore, gjykata vazhdon gjykimin e çështjes.

Kur shihet e nevojshme që të merren prova të reja në lidhje me ndryshimin e formulimit të akuzës, gjykata kryesisht ose me kërkesën e çdo pale dërgon çështjen për plotësimin e hetimeve.

Në qoftë se formulimi i ri i akuzës sjell një dënim më të rëndë çështja duhet të dërgohet për plotësimin e hetimeve.

Neni 275

“Kur nga të dhënat e gjykimit, del se i pandehuri, përveç krimit për të cilin gjykohet ka kryer edhe një krim tjetër që nuk ka lidhje me të parin, gjykata vendos veçimin e çështjes ose krimit të ri, kur çmon se për krimin e fundit duhen bërë hetime nga ana e organeve të hetuesisë ose të gjurmimit ose kur për akuzën e re parashikohet një dënim me i rëndë nga ai i akuzës së parë.

Në rast se akuza e re ka lidhje të ngushtë me akuzën e parë dhe gjykata çmon se për akuzën e re duhen bërë hetime nga ana e organeve të hetuesisë ose të gjurmimit, pezullon gjykimin e çështjes sipas rregullave të përgjithshme dhe e dërgon këtë që të zhvillohen hetimet.

Në lidhje me çështjen e re gjykata mund të marrë masa sigurimi (neni 143 i këtij Kodi).

Neni 276

“Kur nga të dhënat e gjykimit del se është kryer një krim nga ana e një personi tjetër që nuk është dërguar në gjyq në lidhje me çështjen që gjykohet, gjykata jep vendim për fillimin

e ndjekjes penale kundër atij personi dhe këtë çështje e dërgon për hetim sipas rregullave të përgjithshme.

Në qoftë se çështja e re është e lidhur ngushtë me çështjen që gjykohet dhe gjykimi i tyre nuk mund të bëhet veç e veç, çështja që gjykohet duhet të pezullohet dhe të dërgohet bashkë me çështjen e re për t' u hetuar në tërësi.

Në lidhje me çështjen e re gjykata mund të marrë masa sigurimi (neni 143 i këtij Kodi).

Mbi këto dispozita bazuar në kërkimin studimor të kryer rreth praktikës së mundshme gjyqësore, ka rezultuar se praktika e asaj kohe kishte hasur vështirësi në lidhje me zbatimin e dispozitave procedurale që bënin fjalë për ndryshimin e akuzës gjatë zhvillimit të hetimeve.

Referuar asaj situate, Plenumi i Gjykatës së Lartë nxori udhëzimin me nr. 2 datë 14.03.1955 “Mbi ndryshimin e formulimit t’ akuzës gjatë gjykimit”¹⁵. Në bazë të këtij udhëzimi ka rezultuar se:

“Sipas nenit 274 kur nga të dhënat që kanë dalë nga gjykimi, shihet e nevojshme të ndryshohet formulimi i parë i akuzës, gjykata kryesisht ose me kërkesën e palëve jep vendim në lidhje me këtë dhe ua njofton palëve.

Në qoftë se formulimi i ri i akuzës nuk sjell një dënim më të rëndë dhe rrethanat e çështjes mund të sqarohen plotësisht gjatë seancës gjyqësore, gjykata vazhdon gjykimin e çështjes.

Kur shihet e nevojshme të merren prova të reja në lidhje me ndryshimin e formulimit t’ akuzës, gjykata kryesisht ose me kërkesën e palëve e dërgon çështjen për plotësim të hetimeve.

Në qoftë se formulimi i ri i akuzës sjell një dënim më të rëndë çështja duhet të dërgohet për plotësim hetimesh.

Paqartësitë më të mëdha në këtë drejtim kanë të bëjnë me paragrafin e II- të të këtij neni. Gjykatat nuk e kanë të qartë çfarë duhet kuptuar me fjalët “formulim i ri i akuzës, nuk sjell një dënim më të rëndë”. Disa gjykata e kanë trajtuar paragrafin e dytë të nenit 272 të K. Pr. Penale në mënyrë formale. Ato kanë shikuar vetëm masën e dënimit të nenit në bazë të të cilit ishte formuluar akuza e parë dhe masën e dënimit të nenit të ri.

Një qëndrim i tillë është i gabuar. Nuk mjafton të shihet vetëm masa e dënimit të nenit të mëparshëm dhe të nenit të ri t’ akuzës sepse një gjë e tillë në thelb shpesh herë mund ta keqësojë pozitën e të pandehurit. Përveç masës së dënimit është e nevojshme të shihet edhe karakteri i veprës për të cilën akuzohet në fillim i pandehuri si dhe karakteri veprës për të cilën ai akuzohet pas ndryshimit të formulimit t’ akuzës. Ka raste kur vepra të ndryshme nga ana e karakterit të tyre, sjellin si pasojë dënime të ndryshme dhe me gjithë këtë ndryshimi i akuzës do të keqësonte pozitën e të pandehurit megjithëse dënimi i nenit të ri është më i butë se ai i nenit të mëparshëm. Kështu për shembull neni 211 i K.Pen. parashikon një dënim më të rëndë se ai i nenit 86 të K. Pen, por me gjithë këtë ndryshimi i akuzës nga neni 211 në nenin 86 të K. P, rëndon pozitën e të pandehurit për shkak se karakteri i veprës së dytë është më i rëndë se ai i veprës së parë. Po

¹⁵Ky udhëzim është botuar në pikën 705 të Buletinit të Gjykatës së Lartë të vitit 1955

kështu keqësohet pozita kur ndryshohet akuza nga neni 86 në nenin 211 të K. P, për shkak se nenin 211 parashikon një dënim më të rëndë se ai i nenit 86.

Ndryshimi i akuzës nga një nen me dënim më të rëndë në një nen me dënim të barabartë ose më të butë mund të bëhet vetëm atëherë kur edhe karakteri i veprës së dytë nuk ndryshon ose kur është më i favorshëm për të pandehurin.

Kjo mund të ndodh në dy raste: 1) kur po të njëjtave rrethanave të çështjes u jepet një cilësim juridik më të butë p.sh një person është dërguar për në gjyq për plagosje të rëndë nga pakujdesia ndërsa gjatë gjykimit del se plagosja nuk ka qenë e rëndë por e lehtë duke mbetur të pandryshuara të gjitha rrethanat e tjera të ngjarjes; 2) kur bien disa rrethana të cilat më parë e bënin veprën më të kualifikuar dhe kur me zhdukjen e tyre vepra merr një karakter më të butë, p.sh personi është dërguar në gjyq për përvetësim të pasurisë socialiste dhe vepra ishte cilësuar sipas nenit 85 të K.P. Gjatë gjykimit rezulton se të hollat prej tij janë marrë në mënyrë të paligjshme por ai nuk ka dashur t'i përvetësojë por ka pasur për qëllim që t'i kthejë më vonë. Duke munguar qëllimi i përvetësimit ai nuk mund të përgjigjet sipas nenit 85 por sipas nenit 207 të K.Penal.

Në të dy këto raste të drejtat e të pandehurit janë të garantuara. Në rastin e parë çështja nga ana e faktit nuk ndryshon kështu që i pandehuri ka mundësi të vazhdojë mbrojtjen e tij pa pasur rrezik që të dëmtohet nga ndryshimi i akuzës. Po kështu ai ka mundësi të mbrohet edhe në rastin e dytë. Para se të ndryshohej akuza ai ishte përgatitur që të mbrohej kundër të gjithë rrethanave duke përfshirë këtu edhe rrethanat cilësuese. Pas ndryshimit të formulimit të akuzës ai do të mbrohet vetëm në lidhje me rrethanat e zakonshme të veprës për të cilën akuzohet por jo më kundër rrethanave cilësuese. Kuptohet se zhdukja e rrethanave cilësuese e lehtëson mbrojtjen e të pandehurit.

Në të tilla rrethana gjykata mund të bëjë ndryshimin e formulimit të akuzës dhe në rast se çështja mund të sqarohet plotësisht gjatë gjykimit, ajo duhet të vazhdojë atë. Në qoftë se pas formulimit të ri të akuzës ka nevojë për hetime të tjera gjykata duhet të pezullojë gjykimin dhe ta dërgojë çështjen për plotësim hetimesh.

Në rast se masa e dënimit të nenit të ri është më e madhe se ajo e nenit të mëparshëm ose në qoftë se masa e dëmit nuk ndryshon ose është më e butë por karakteri i veprës është më i rëndë gjykata pasi të marrë vendim mbi ndryshimin e akuzës dhe pasi t'ja njoftojë këtë palëve duhet të pezullojë medoemos gjykimin e çështjes dhe ta dërgojë atë për zhvillim hetimesh.

Edhe në rastin kur gjykata pas përfundimit të hetimeve gjyqësore dhe duke u ndodhur në dhomën e këshillimit arrijnë në përfundimin se duhet të ndryshohet formulimi i akuzës ajo duhet të marrë vendimin për riçeljen e hetimeve gjyqësore dhe mbi ndryshimin e formulimit të akuzës. Pas kësaj në qoftë se nuk ka nevojë për zgjerim hetimesh ose në qoftë se rrethanat e çështjes mund të sqarohen gjatë gjykimit, gjykata zhvillon hetime gjyqësore në mënyrë të zakonshme. Gjukata duhet të pyes përsëri të pandehurin (në rast nevojë edhe dëshmitarët dhe ekspertët) ti jap fjalën prokurorit mbrojtësit dhe fjalën e fundit të pandehurit. Pas kësaj gjykata tërhiqet përsëri në dhomën e këshillimit.

Në rast se pas ndryshimit të formulimit t' akuzës nevojiten hetime të reja ose akuza e re është më e rëndë për shkak të masës së dënimit ose për shkak të karakterit të veprës penale të re, gjykata pezullon gjykimin e çështjes dhe e dërgon atë për zgjerim hetimesh.

Kundër vendimit të ndryshimit të formulimit t' akuzës palët kanë të drejtë t' ankohen ose të protestojnë. Gjkata është e detyruar ti marrë në shqyrtim ato. Në rast se formulimi i ri i akuzës është më i favorshëm për të pandehurin dhe të gjitha rrethanat e çështjes mund të sqarohen gjatë hetimeve gjyqësore, gjykata me tu paraqitur ankimi apo protesta duhet të vendos nëse gjykimi do të vazhdohet ose jo. Në rast se gjykata vendos që gjykimi të vazhdojë palët ruajnë të drejtën që të paraqesin ankimin dhe protestën kundër vendimit të ndërmjetëm të gjykatës së bashku me ankimin dhe protestën që ato kanë të drejtë kundër vendimit përfundimtar.

Në rast se gjykata vendos pezullimin e gjyimit si dhe në rast se formulimi i ri i akuzës është më i rëndë për të pandehurin ose në rast se çështja ose në rast se çështja pas ndryshimit të formulimit t' akuzës ka nevojë për hetime të reja, atëherë ankimi dhe protesta shqyrtohen nga ana e gjykatës së shkallës së dytë pa prituri që gjykata e shkallës së parë të jap vendimin përfundimtar. Në të tilla raste paraqitja e ankimit dhe protestës bën që çështja të mos shkojë në prokurori për zgjerim hetimesh, por të dërgohet në gjykatën e shkallës së dytë, e cila e shqyrton themelësinë dhe ligjshmërinë e vendimit të gjykatës së shkallës së parë mbi ndryshimin e formulimit t' akuzës.

Në të tilla raste gjykata e shkallës së dytë ose e lënë në fuqi vendimin e ndërmjetëm të gjykatës së shkallës së parë dhe çështja pas kësaj i shkon prokurorisë për zgjerim hetimesh dhe për të riformuluar akuzën ose e prish vendimin e ndërmjetëm dhe çështjen ja dërgon për gjykim gjykatës së shkallës së parë.

Gjkata e shkallës së dytë ka të drejtë gjithashtu që të urdhërojë një formulim tjetër të ri t' akuzës dhe çështjen t'ja dërgojë prokurorisë kur formulimi i ri rëndon pozitën e të pandehurit ose kur është e nevojshme të zgjerohen hetimet.

Kur çështja dërgohet për zgjerim hetimesh organet e hetuesisë duhet të kryejnë të gjitha veprimet procedurale, që parashikohen nga Kodi i Procedurës Penale për marrjen e një personi si të pandehur dhe dërgimin e tij në gjyq...”.

1.2.3. Përfundimet mbi akuzat e reja në Kodin e Procedurës Penale të 1953-it

Referuar udhëzimit të përmendur më sipër të marrë në harmoni dhe me përmbajtjen e dispozitave të kodit të procedurës penale të vitit 1953 arrihet në përfundimet si më poshtë.

Në fazën e hetimit akuza formulohej nga hetuesi ose përfaqësuesi i organit të gjurmimit me anë të një vendimi, i cili më pas i njoftohej të pandehurit. Me hartimin e akuzës i pandehuri merrej në pyetje nga organi i hetimit. Njoftimi i akuzës në kohë realizohej përpara se të përfundonin hetimet.

Me përfundimin e hetimeve, hetuesi hartonte edhe akt akuzën e cila konsistonte në përmbledhjen e qëndrimit zyrtar e përfundimtar të organit të hetimit ndaj hetimeve të kryera. Akt akuza i dërgohej prokurorit, i cili nëse pajtohej me përmbajtjen e saj e dërgonte çështjen në

gjykatë. Nëse prokurori nuk pajtohej me akt akuzën e hartuar prej hetuesit e ndryshonte atë në qoftë se nuk kishte nevojë për hetime të mëtejshme dhe akt akuzën e parë të hartuar prej hetuesit i'a kthente atij së bashku me vërejtjet përkatëse. Nëse me ndryshimin e aktakuzës ishte e nevojshme kryerja e veprimeve të tjera hetimore, atëherë prokurori e dërgonte dhe një herë çështjen për plotësim hetimesh tek organi i ndjekjes penale. Prania e prokurorit në gjykatë nuk ishte e domosdoshme në të gjitha rastet. Bazuar në nenin 209 të kodit të procedurës penale të vitit 1953, pasi prokurori aprovon akt akuzën, ai e dërgon atë të aprovuar në gjykatë, së bashku me të gjitha aktet e tjera e nëse ai e quan të nevojshme pjesëmarrjen e tij në gjykim, ja bënte këtë fakt të ditur gjykatës.

Në seancë përgatitore gjyqtari i vetëm shqyrtonte çështjet të cilat vinin drejtpërdrejtë në gjykim nga organi i hetimit në rastet e përcaktuar në ligj, si dhe çështjet të cilat vinin për gjykim me akt akuzë të aprovuar më parë nga prokurori. Në rastin e fundit, gjyqtari i vetëm ishte i detyruar që çështjen penale t'a dërgonte për shqyrtim në seancë përgatitore.

Në seancë përgatitore gjyqtari i vetëm vendoste aprovimin e akt akuzës, ose ndryshimin e saj dhe dërgimin e çështjes penale për gjykim në seancë gjyqësore nëse ndryshimi i aktakuzës nuk përfshihej në rastin e dërgimit të çështjes penale për plotësim hetimesh. Në seancë përgatitore gjyqtari i vetëm mund të kthente çështjen për plotësim hetimesh kur ai konstatonte se hetimet nuk ishin të plota, kur mungonin veprime të tjera hetimore që do të sqaronin edhe rrethana të nevojshme për çështjen penale. Gjyqtari i vetëm mund të kthente çështjen penale për hetim dhe në rastet kur ai vlerësonte se akuzat e hartuar më parë në hetim, duhej të ndryshohej e një ndryshim i tillë kërkonte hetime plotësuese ose sillte një dënim më të rëndë se akuzat e parë që i ishte njoftuar të pandehurit.

Në seancë gjyqësore akt akuzat mund të ndryshohej gjatë gjykimit. I vetmi subjekt procedural i cili gëzonte autoritetin e vetëm ligjor për të ndryshuar aktakuzën në gjykim ishte gjykata. Kështu nëse gjatë gjykimit dilnin rrethana të reja, të cilat e bënin të detyrueshme ndryshimin e aktakuzës, gjykata kryesisht ose dhe mbi kërkesën e palëve merrte një vendim të ndërmjetëm për këtë ndryshim dhe vendimin e ri i'a njoftonte palëve në gjykim.

Nëse formulimi i ri i aktakuzës nuk sillte një dënim më të rëndë e kur karakteri i veprës së penale nuk është më i rëndë, gjykata pas vendimit për ndryshimin e formulimit të aktakuzës, vazhdonte gjykimin e çështjes penale nëse nuk kishte nevojë edhe për hetime të reja. Nëse nevojiteshin hetime të tjera të reja, çështja kryesisht ose me kërkesë të palëve pezullohej dhe dërgohej për zgjerim hetimesh.

Kur formulimi i aktakuzës sillte një dënim më të rëndë, ose kur formulimi i ri ishte i një karakteri më të rëndë të veprës penale, pavarësisht nga masa e dënimit e cila mund të ishte e barabartë ose më e butë, çështja në këtë rast pezullohej dhe dërgohej për hetim.

Kur nevoja e ndryshimit të aktakuzës i dilte gjykatës në dhomën e këshillimit në rastin e pritjes së dhënies së vendimit përfundimtar, gjykata, pasi dilte nga dhoma e këshillimit, merrte vendim për riçeljen e hetimit gjyqësor dhe për ndryshimin e formulimit të aktakuzës. Këtë vendim të marrë gjykata i'a njoftonte palëve në gjykim. Pas këtij veprimi gjykimin vazhdonte në mënyrë të zakonshme referuar dhe natyrës së aktakuzës së re, sipas rregullave të përmendura më sipër.

Kundër vendimit të gjykatës për ndryshimin e formulimit të akuzës mund të bëhej ankimi ose protestë në gjykatën më të lartë. Ankimi bëhej nga i pandehuri, ndërsa protesta nga prokurori. Gjykata e cila kishte vendosur ndryshimin e formulimit të akuzës në rastin kur përpara saj depozitohesh ankimi ose protesta, ishte e detyruar të vendoste në lidhje me vazhdimin ose jo të gjykimit të nisur prej saj.

Në rast se gjykata vendoste vazhdimin e gjykimit, ankimi dhe protesta për ndryshimin e formulimit të akuzës i bashkëngjiteshin ankimit dhe protestës kundër vendimit përfundimtar. Në rast se gjykata vendoste të mos vazhdonte gjykimin, pra ta pezullonte atë në bazë të kërkesës së palëve, si dhe kur çështja pas ndryshimit të formulimit të akuzës dërgohej prej gjykatës për zgjerim hetimesh, ankimi dhe protesta bëheshin kundër vendimit të ndryshimit të formulimit të akuzës që dërgohej për zgjerim hetimi, pa prituri që gjykata të jepte vendimin përfundimtar. Në këtë rast gjykata më e lartë shqyrtonte ankimin ose protestën e bërë, pa u dhënë vendimi përfundimtar i gjykatës më të ulët.

Kur çështja dërgohej nga gjykata për zgjerim hetimesh për shkak të ndryshimit të formulimit të akuzës, organet e hetuesisë duhet të kryenin të gjitha veprimet hetimore që parashikoheshin në këtë Kod, përfshirë këtu marrjen e personit si të pandehur dhe dërgimin e tij në gjyq. Kur gjykata dërgonte çështjen për plotësimin e hetimeve, organi i hetuesisë mbarte detyrimin ligjor të vijonte hetimin dhe të kryente me përpikmëri të gjitha detyrat e vendosura në dispozitiv nga gjykata, kjo në funksion të marrjes së personit si të pandehur. Në një tjetër vlerësim normativ, së paku nga ana formale konstatohet se kur gjykata bënte ndryshimin e akuzës, dispozitat e mësipërme procedurale nuk parashikonin dhënien e mundësisë së të pandehurit dhe mbrojtësit të tij për të përgatitur mbrojtjen, për më tepër këto dispozita nuk njihnin as të drejtën procedurale të të pandehurit të kërkonte një afat për këtë qëllim edhe pse ky ndryshim i akuzës parashikonte dënim më të favorshëm për të.

Me interes për këtë punim në funksion të përcaktimit të natyrës juridike të institutit të akuzave të reja dhe ndryshimeve që ka pësuar ky institut ndër vite, kam vlerësuar të ndalem shkurtimisht në nenin 276 të kodit të procedurës penale të vitit 1953, dispozitë e cila referon në situatën e njohur në doktrinën juridike si "*concorso di personae*" ose konkurim personash në kryerjen e veprës penale.

Sipas kësaj dispozite procedurale, në gjykim nëse nga të dhënat e përfuara dilte se ishte kryer një krim nga ana e një personi tjetër, i cili nuk ishte dërguar në gjykim, gjykata jepte vendim për fillimin e ndjekjes penale kundër atij personi dhe çështjen e re të zbuluar në gjykim, gjykata e dërgonte për hetim ndaj personit të ri, të evidentuar si autor të mundshëm të një krimi të konstatuar gjatë gjykimit. Nëse çështja e re e zbuluar në gjykim ishte e lidhur ngushtë me çështjen që gjykohej dhe gjykimi i tyre nuk mund të ndahej çështja që gjykohej pezullohej nga gjykata dhe dërgohej së bashku me çështjen e re për t'u hetuar në tërësi si një çështje e vetme.

Në vështrim të përmbajtjes së kësaj norme konstatojmë rolin aktiv të gjykatës si organ i ngarkuar me kompetenca funksionale në drejtim të fillimit të një procedimi penal, ndaj një personi konkret të vënë nën hetim nga gjykata. Në këtë kuptim, kur gjykata gjatë shqyrtimit gjyqësor arrinte në përfundimin se persona të tjerë ishin përfshirë në kryerjen e veprës penale ose që kanë kryer një vepër penale, qoftë edhe në mënyrë të mëvetëshme, merrte vendim për ushtrimin e ndjekjes penale duke e dërguar çështjen për hetim sipas rregullave të përgjithshme.

Pra kompetenca mbi ushtrimin e ndjekjes penale ndaj një fakti të ri të konstatuar në gjykim që në bazë të nenit 374 të kodit të procedurës penale aktualisht në fuqi i takon ekskluzivisht vetëm prokurorit të çështjes penale, në kodin e procedurës penale të 1953, kjo kompetencë i përkiste gjykatës. Pra në një krahasim të përgjithshëm vetëm për rolin e prokurorit në raport me faktin e ri penal apo personin e ri pjesëmarrës në krim të konstatuar në gjykimin e themelit, mund të themi se të drejtat e prokurorit në ushtrimin e ndjekjes penale në gjykim sipas kodit të vitit 1953 ishin të reduktuara në maksimum dhe këto të drejta ushtroheshin nga gjykata.

Në vijimësi të këtij parashikimi vihet re një dallim esencial në raport me legjislacionin procedural aktual në fuqi mbi rolin e gjykatës në raport me akuzën dhe vendimarrjen e saj mbi cilësimin juridik të veprës penale. Gjykata referuar kodit të vitit 1953 në institutin e akuzave të reja, nuk bënte ndryshim të cilësimit juridik të veprës penale, por bënte ndryshimin e akuzës, qoftë edhe kryesisht, pa qenë e nevojshme paraqitja e një kërkesë ose disponimi në seancë nga ana e prokurorit.

1.3. Akuzat e reja në kodin e procedurës penale të vitit 1979-ës

Siç u trajtua më sipër, instituti i akuzave të reja në procesin penal, të parashikuar në kodin e procedurës penale të vitit 1953 dhe në tërësi vetë ky kod, i shtriu efektet ligjore deri në muajin prill të vitit 1980, me hyrjen në fuqi të kodit të procedurës penale të miratuar në vitin 1979.

Në fakt, veçanërisht gjatë hetimeve paraprake por dhe gjatë gjykimit, mundësia e prokurorit për të ndryshuar akuzën u zvogëluar dhe më tepër se mundësia që prokurori kishte me kodin e procedurës penale të vitit 1953.

Me Dekretin Nr. 5139, datë 30.01.1974, “Mbi unifikimin e hetuesisë, heqjen e saj nga sistemi i prokurorisë dhe përqëndrimin e saj në sistemin e Ministrisë së Punëve të Brendshme” dhe më vonë, me Dekretin nr. 5265, datë 29.01.1975, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin e Procedurës Penale”, kjo e drejtë gjatë hetimeve paraprake i kaloi kryesisht hetuesisë si organ më vete, ndërsa prokurorit i’u la vetëm e drejta e miratimit të akt akuzës së hetuesisë vetëm për krimet e rënda.

Pra në një vlerësim të përgjithshëm mund të themi se kodi i procedurës penale i vitit 1979 dallohej për natyrën e tij inkuizitore.

Struktura e ndërtimit të këtij kodi i përngjante kodit të procedurës penale të vitit 1953 por nga ana tjetër në kodin e 1979-ës, shprehej vullneti i klasës punëtore dhe masave të tjera punonjëse si mjet i rëndësishëm i shtetit të diktaturës së proletariatit në luftën kundër vepra penale. Ky kod kishte për detyrë të mbronte shtetin socialist, të mbronte e ndihmonte ndërtimin e socializmit sipas parimit të mbështetjes në forcat e veta si dhe interesat e ligjshme të shtetasve.

Gjithashtu legjislacioni procedural penal kishte për detyrë të parandalonte kryerjen e veprave penale e të ndikonte në edukimin e shtetasve me frymën e respektimit të ligjshmërisë socialiste. Kodi evokonte hetimin dhe gjykimin e shpejtë e të drejtë të veprave penale në luftën kundër shfaqjeve burokratike e të liberalizmit.

Kodi i procedurës penale i 1979-ës bazohej në parimin e luftës klasore kundër veprave penale. Në bazë të tij gjykata dhe hetuesia (përfshijë prokuroria në këtë rast) zbatonte rregulla të njëjta dhe të barabarta për të gjithë në zhvillimin e hetimeve në mënyrë objektive të plotë e të gjithanshme me qëllim që asnjë fajtor të mos i shmangej përgjegjësisë dhe të sigurohej që çdo shtetas të shmangej nga ndjekja penale e dënimi i padrejtë.

Vlen të theksojmë se në këndvështrimin e sotëm mbi vlerësimin e normave procedurale në tërësi, kodi i procedurës penale i 1979-ës bëri një hap prapa krahasuar me kodin e procedurës penale të vitit 1953, përse i përket parimeve procedurale mbi të cilat duhet të mbështetej në tërësi procedimi penal.

Theksojmë se në kodin e procedurës penale të 1979-ës nuk përfshiheshin parimet e prezumimit të pafajësisë për të pandehurin dhe parimi i së drejtës së mbrojtjes, të cilat gjenin pasqyrim në kodin e procedurës penale të vitit 1953. Roli i prokurorit në kodin e procedurës të vitit 1979 është më i reduktuar dhe hetuesia ishte subjekti kryesor që ushtronte ndjekjen penale. Në këtë kod, prokuroria ishte organi i cili kontrollonte zbatimin e njëjtë të ligjeve në të gjithë veprimtarinë procedurale penale duke marrë masa që të mos veprohej në kundërshtim me to.

Ndërkohë hetuesia ishte organi i caktuar me ligj për zhvillimin e hetimeve dhe hetuesi vepronte me iniciativën e tij në drejtimin e hetimeve mbi zbulimin e veprës penale dhe të autorit të saj. Gjatë hetimit në kod përcaktohej ndalimi i përdorimit të dhunës fizike ose psikike, si dhe i masave të tjera të ngjashme prej hetuesit.

Gjykata ishte organi i cili realizonte procesin e dhënies së drejtësisë. Në dhënien e drejtësisë gjykata ishte e pavarur e vendoste vetëm në bazë të ligjit. Përveç këtij pozicioni natyral, gjykata kishte dhe disa funksione të tjera, të cilat në këndvështrimin e sotëm nuk duhet ti përkasin.

Më konkretisht gjykata kishte të drejtën të fillonte procedimin penal me një vendim të arsyetuar. Pra gjykata përfshijë në funksionin e saj, jo vetëm dhënien e drejtësisë por dhe fillimin e ndjekjes penale¹⁶. Gjithashtu gjyqtari kishte të drejtë të merrte një person me cilësinë e të pandehurit. Kur kishte të dhëna të mjaftueshme që tregonin se vepra penale është kryer nga një person i caktuar, gjyqtari i vetëm vendoste marrjen e këtij personi me cilësinë e të pandehurit. Vendimi për marrjen e një personi si të pandehur, i njoftohej këtij të fundit nga gjyqtari brenda 24 orëve nga përpilimi i vendimit me qëllim që ai të njihej mbi faktin për të cilin po procedohej.

I pandehuri ishte personi që merrej në përgjegjësi për kryerjen e një veprë penale. Ai quhej i tillë derisa vendimi i gjykatës të merrte formë të prerë ose çështja penale të pushohej. I pandehuri mund të mbrohej në gjykim me anë të këshilltarit ligjor, bashkëshortit, gjinisë ose krushqisë së afërt. Për të pandehurit nën moshën 18 vjeç, si dhe për të pandehurit që shfaqnin të meta fizike ose psikike të cilat e pengonin atë të realizonze vetë lirisht të drejtën e mbrojtjes, pjesëmarrja e këshilltarit ligjor ishte e detyrueshme.

¹⁶ Neni 63/1 i Kodit të Procedurës Penale të vitit 1979 parashikonte se: “Çështja penale fillon me vendim të arsyetuar të gjykatës, gjyqtarit të vetëm ose të hetuesit, kur ka të dhëna të mjaftueshme.”

1.3.1. Akuzat e reja dhe ndryshimi i akuzës gjatë hetimeve

Duhet thënë se edhe sistemi procedural i përcaktuar në këtë kod dallohej më shumë për karakterin e tij inkuizitor. Siç u përmend më sipër, procedimi penal fillonte me vendim të arsyetuar të gjykatës, gjyqtarit të vetëm dhe hetuesit. Pra gjykata kishte si funksion ligjor fillimin e ndjekjes apo të procedimit penal si dhe dhënien e drejtësisë, duke dobësuar ndjeshëm rolin e prokurorit si në fazën e hetimeve paraprake ashtu dhe në gjykim.

Hetimi i një çështjeje penale në bazë të kodit të procedurës penale të 1979-ës fillonte me një vendim i cili mund të merrej nga gjyqtari i vetëm ose nga hetuesi. Marrja e vendimit për fillimin e çështjes penale pasohej më pas me verifikimin dhe kryerjen e veprimeve hetimore në drejtim të zbulimit të veprës penale dhe autorit të mundshëm të saj.

Kallëzimet si akte procedurale që kishin për qëllim njoftimin mbi kryerjen e veprave penale mund të paraqiteshin nga shtetasit kallëzues pranë prokurorisë, hetuesisë, gjykatës, organeve të punëve të brendshme, organeve të pushtetit lokal si dhe pranë komandave të reparteve ushtarake. Kallëzimi mund të bëhej me gojë ose me shkrim. Në rast se kallëzimi bëhej me gojë, në këtë rast mbahej një procesverbal në të cilin do të pasqyrohej kallëzimi¹⁷.

Vetëm gjyqtari dhe hetuesi kishin të drejtë të merrnin vendim për refuzimin e fillimit të çështjes penale. Në këtë rast vendimi merrej me shkrim dhe ishte i arsyetuar. Vendimi për refuzimin e fillimit të çështjes penale u njoftohej menjëherë shtetasve, institucioneve, ndërmarrjeve, organizatave dhe prokurorisë, organe të cilat kishin të drejtë të bënin ankim ose protestë brenda pesë ditëve. Ankimi ose protesta kundër vendimi të hetuesit bëhej tek eprori i tij përkatës (përgjegjësi i sektorit të hetuesisë, drejtori i drejtorisë së hetuesisë dhe në fund te Ministri i Punëve të Brendshme), ndërsa kundër vendimit të gjykatës, ankimi ose protesta bëhej në gjykatën e shkallës së dytë.

Në fazën e hetimit, gjyqtari ose hetuesi mund të merrnin një person me cilësinë e të pandehurit nëpërmjet njoftimit të këtij të fundit me anë të një vendimi. Ky veprim kryhej nga gjyqtari ose hetuesi në bazë të provave të grumbulluara të cilat ishin të mjaftueshme për të treguar se vepra penale ishte kryer nga një person i caktuar. Vendimi për marrjen e një personi me cilësinë e të pandehurit i njoftohej këtij të fundit brenda 24 orëve nga marrja e vendimit. Më pas i pandehuri pasi njihej me akuzën ku gjendej fakti penal i përshkruar në të, merrej në pyetje nga hetuesi. Ky veprim hetimor realizohej brenda 24 orëve nga koha e njoftimit mbi marrjen e një personi me cilësinë e të pandehurit.

Nëse pyetja bëhej jashtë afatit të përmendur më lart, hetuesi mbante procesverbal tek i cili ai duhej të përshkruante arsyet e vonesës së marrjes në pyetje të të pandehurit. Pyetja e të pandehurit nga hetuesi pasqyrohej në një procesverbal që mbahej për këtë qëllim nga hetuesi në prani të pandehurit. Në procesverbal shënohej pyetja e hetuesit dhe përgjigja e të pandehurit. Pas përfundimit të pyetjes, të pandehurit i jepej procesverbali që ta lexonte. I pandehuri pas leximit, kishte të drejtë të kërkonte plotësimin ose korrigjimin e procesverbalit të pyetjes së tij.

¹⁷ Neni 64/2 i Kodit të Procedurës Penale të vitit 1979 parashikonte se: “Kallëzimi mund të bëhet me gojë ose me shkrim. Për kallëzim me gojë mbahej procesverbal.”

Në fazën e hetimit, kodi i procedurës penale i 1979-ës njihte dhe mundësinë e ndryshimit ose plotësimit të akuzës. Subjekti procedural që bënte ndryshimin ose plotësimin e akuzës ishte hetuesi. Ndryshimi apo plotësimi i akuzës në hetim ishte një nevojë që lidhej me të dhënat e përfutuara nga hetimi. Nëse gjatë hetimit dilnin të dhëna të reja të cilat e ndryshonin akuzën e paraqitur më parë kundrejt të pandehurit, ose e plotësonin atë me fakte të reja penale të panjohura më parë, hetuesi merrte vendim për ndryshimin ose plotësimin e akuzës dhe këtë vendim të ri i'a njoftonte të pandehurit. Për njoftimin e ndryshimit ose plotësimit të akuzës ndiqeshin të njëjtat rregulla si për njoftimin e akuzës së parë ndaj të pandehurit.

Me përfundimin e hetimeve kur kishte prova të plota ndaj të pandehurit për veprën penale të kryer, hetuesi përpilonte akt akuzën e cila së bashku me aktet e tjera hetimore i dërgoheshin gjykatës kompetente për gjykim. Një kopje e akt akuzës i dërgohej të pandehurit për t'u njohur me të, me qëllim që ai të përgatiste mbrojtjen e tij përpara gjykatës. Vërejmë se në ndryshim nga kodi i procedurës penale të vitit 1953, në kodin e procedurës penale të 1979-ës, përpilimin e akt akuzës për gjykim e bënte hetuesi dhe jo prokurori.

1.3.2. Akuzat e reja dhe ndryshimi i formulimit të akuzës në gjykim

Për shkak të ruajtjes së traditës në përzgjedhjen e sistemit inkuizitor kodi i procedurës penale i 1979-ës për sa u përket akuzave të reja gjatë gjyimit ruan pothuaj të njëjtat karakteristika në raport me kodin e vitit 1953.

Vlen të përmendim këtu se kontrolli i akt akuzës së hartuar nga hetuesi gjatë fazës së hetimit për të pandehurin realizohej në fazën e gjyimit. Fillimisht në fazën e parë pasi akt akuzë dërgohej për gjykim nga hetuesi, gjyqtari i vetëm paraprakisht verifikonte përmbajtjen e akteve të hetimit nëse ato ishin të plota e nuk kishin nevojë për plotësime të mëtejshme. Në rast se gjyqtari konstatonte se hetimi ndaj të pandehurit nuk ishte i plotë, apo akuzë që i ishte njoftuar atij nuk ishte e saktë, atëherë gjyqtari i vetëm e dërgonte çështjen për shqyrtim në seancë përgatitore për të shqyrtuar në prani edhe të dy ndihmës gjyqtarëve çështjet që lidheshin kryesisht me hetimin dhe formulimin e akuzës.

Të njëjtat të drejta gëzonte gjykata dhe gjatë fazës së shqyrtimit gjyqësor. Në fazën e dytë nëse gjatë gjyimit, gjykata konstatonte se hetimi nuk ishte i plotë dhe vetë gjykata nuk kishte mundësi për të plotësuar hetimin, ose akuzë e hartuar duhej të plotësohej në rëndim të pozitës së të pandehurit, ajo bënte përcaktimin e duhur përkatës dhe dërgonte çështjen për hetim të mëtejshëm.

Pasi çështja penale sillej për gjykim nga ana e hetuesit, gjyqtari i vetëm të cilit i jepej kjo çështje penale, kur çmonte se duhej të ndryshohej akuzë e ky ndryshim shoqërohej me rëndimin e pozitës së të pandehurit, merrte vendim për dërgimin e çështjes në seancë përgatitore. Në seancë përgatitore çështja shqyrtohej paraprakisht nga një gjyqtar e dy ndihmës gjyqtarë.

Në seancë përgatitore merrte pjesë dhe prokurori e për këtë qëllim ai njoftohej nga gjykata. Shqyrtimi i seancës përgatitore niste me parashtrimin që bëhej nga gjyqtari ose ndihmës gjyqtari. Pas këtij veprimi gjykata dëgjonte mendimin e prokurorit në lidhje me seancën përgatitore.

Në seancë përgatitore gjykata mund të merrte disa vendime të cilat përcaktonin ecurinë e gjithë procesit. Më konkretisht në këtë fazë, gjykata mund të vendoste dërgimin e çështjes për gjykim, kthimin e çështjes për hetim organit të hetuesisë ose pezullimin apo pushimin e çështjes kur ishin rastet e përcaktuara në ligj.

Gjykata kur çmonte se akuzat duhej të ndryshohej - e ky ndryshim nuk rëndonte pozitën e të pandehurit si dhe nuk shoqërohej me kryerjen e veprimeve komplekse hetimore, - merrte vendim për ndryshimin e akuzës e dërgimin e çështjes në gjykim me akuzën e ndryshuar. Vendimi për ndryshimin e akuzës i njoftohej të pandehurit përpara se të fillonte shqyrtimi i çështjes penale në seancë gjyqësore. Më tej seanca gjyqësore zhvillohej me gjykimin e të pandehurit me akuzën e ndryshuar në seancë përgatitore nga gjykata.

Në seancë përgatitore gjykata mund të kthente për hetim çështjen penale të sjellë për gjykim nga hetuesia. Kështu nëse në seancë përgatitore gjykata konstatonte se duhej të bëhej një formulim i ri i akuzës për të pandehurin, - formulim i cili shoqërohej me rëndim të pozitës së të pandehurit në funksion të rrezikshmërisë së veprës penale apo të karakterit të saj, - çështja i kthehej për hetim hetuesisë. Pra dërgimi i çështjes për hetim lidhej me plotësimin e hetimeve prej hetuesisë për shkak se ndryshimi i akuzës në rëndim të pozitës së të pandehurit prej gjykatës, detyrimisht duhej të shoqërohej me kryerjen e plotësimin e veprimeve të tjera hetimore.

Në seancë përgatitore gjykata mund të vendoste pezullimin ose pushimin e çështjes penale në rastet e parashikuara nga nenet 97 dhe 98 të Kodit Penal¹⁸.

1.3.3. Të drejtat e gjykatës mbi formulimin e akuzës gjatë gjykimit

Gjatë fazës së gjykimit, gjykata gëzonte të drejtën për të kontrolluar akuzën dhe hetimet që lidheshin me akuzën e formuluar nga hetuesia. Kuadri ligjor që rregullonte të drejtat e gjykatës për të ndërhyrë në kontrollin e hetimeve dhe formulimin e akuzës parashikohej nga nenet 144 – 146 dhe 153 të Kodit të Procedurës Penale të vitit 1953.

Gjykimi i çështjes penale sipas këtij kodi kufizohej për personat që janë dërguar për gjykim dhe akuzat përkatëse me të cilat këta persona janë marrë me cilësinë e të pandehurit. Nëse gjatë gjykimit të një të pandehuri në gjykim konstatohet se ai përveç veprës penale për të cilën ishte akuzuar e sjellë për gjykim, kishte kryer edhe një vepër tjetër penale të zbuluar në gjykim, në këtë rast gjykata procedonte me fillimin e hetimit për çështjen penale të re dhe dërgimin e saj

¹⁸ Neni 97 parashikonte se: “*Hetimi pezullohet kur: 1) i pandehuri vuan nga një sëmundje e rëndë që ndalon hetimin e mëtejshëm të çështjes 2) personi që ka kryer veprën penale nuk është zbuluar ose nuk është gjetur. Pezullimi i hetimeve bëhet me vendim të hetuesit, në të cilin tregohen shkaqet e pezullimit, pasi të jenë kryer të gjithë veprimet e mundshme.*

Neni 98 parashikonte se: “*Hetuesi pushon çështjen kur: 1) janë rastet e treguara në nenet 71 e 73 të këtij Kodi 2) nuk vërtetohet se vepra penale është kryer nga i pandehuri. Vendimi mbi pushimin e çështjes i njoftohet prokurorit, të pandehurit, të dëmtuarit, institucionit, ndërmarrjes, organizatës ose personit, me kallëzimin e të ëilëve ka filluar çështja. Kundër vendimit për pushimin e çështjes mund të bëhet ankim brenda pesë ditëve para përgjegjësit të sektorit të hetuesisë që kontrollojnë hetimin dhe protestë nga prokurori.*

për hetim hetuesisë kur vepra penale e re nuk kishte lidhje të natyrës procedurale me veprën penale që ai po gjykohej.

Nëse vepra penale e re kishte lidhje të natyrës procedurale me akuzën që i pandehuri po gjykohej, atëherë gjykata i njoftonte akuzën e re të pandehurit për veprën penale të konstatuar në gjykim dhe pas këtij veprimi gjykata dërgonte çështjen penale për hetim të mëtejshëm në organin e prokurorisë. Në këtë rast gjykata vepronte brenda kufijve që kodi kishte përcaktuar të drejtën e gjykatës për të konstatuar veprimtarinë kriminale të të pandehurit në lidhje me gjykimin e një akuze dhe zbulimin në gjykim të një vepre tjetër penale të kryer prej të pandehurit për të cilën duhej të zhvilloheshin hetimet e nevojshme.

Në gjykim gjykata mund të ndryshonte akuzën e të pandehurit për të cilën ai ishte sjellë për gjykim. Nëse gjatë gjykimit përftoheshin të dhëna të reja të cilat plotësonin akuzën e parë ose këto të dhëna ndryshonin formulimin e parë të akuzës, gjykata merrte vendim për plotësimin ose ndryshimin e formulimit të akuzës së parë. Në funksion të rëndimit ose jo të pozitës së të pandehurit për shkak të ndryshimit të akuzës ose plotësimit të saj, gjykata vendoste vazhdimin e gjykimit, në rastet kur ndryshimi apo plotësimi i akuzës nuk rëndonte pozitën e të pandehurit si dhe nuk rëndonte karakterin e rrethanat e veprës penale. Nëse këto ndryshime rëndonin pozitën e të pandehurit apo rëndonin karakterin dhe natyrën e veprës penale, gjykata në këtë rast ia dërgonte çështjen penale hetuesisë për hetime të mëtejshme.

Kur gjatë gjykimit dilnin të dhëna të cilat tregonin se është kryer një vepër penale nga një person tjetër, i cili nuk ishte sjellë për gjykim nga hetuesia, gjykata merrte vendim për fillimin e hetimeve për veprën penale të re të konstatuar në gjykim, vepër e cila mund të ishte kryer nga një person që nuk ishte sjellë për gjykim. Në vijim gjykata i dërgonte materialin gjyqësor hetuesisë, kur vepra penale e kryer nga personi tjetër nuk kishte lidhje të natyrës procedurale me veprën penale që po gjykohej i pandehuri. Nëse vepra penale e re e zbuluar në gjykim e kryer prej një personi të pa hetuar, kishte lidhje të natyrës procedurale me akuzën e sjellë për gjykim ndaj të pandehurit që gjykohej prej gjykatës, atëherë gjykata i njoftonte akuzën personit tjetër për veprën penale të re të zbuluar në gjykim e pas këtij veprimi çështjen penale e dërgonte për hetim.

Kodi i procedurës penale i 1979-ës i njihte të njëjta të drejta gjykatës për të vepruar si më sipër dhe në rastin kur gjykata kishte përfunduar hetimin gjyqësor dhe ishte tërhequr për vendim¹⁹.

¹⁹ Neni 153 i kodit të procedurës penale të 1979-ës në lidhje me rastin e marrjes së vendimit përfundimtar të gjykatës parashikonte se: “Gjykata vendos që çështja t’i kthehet hetuesisë për plotësim hetimesh kur: 1. çështja nuk është hetuar në mënyrë të plotë dhe të gjithanshme dhe hetimet nuk mund të plotësohen gjatë shqyrtimit të saj në seancë gjyqësore. 2. gjatë hetimit janë shkelur rregullat procedurale që garantojnë të drejtat e të pandehurit; 3. Çështja u përket rasteve të parashikuara nga nenet 144, 145, 146 të këtij Kodi. Gjykata, në raste të veçanta, vendos dërgimin e çështjes organit të hetuesisë për të zhvilluar hetime për vepra penale që gjykohej drejtpërdrejt ose që hiqen mbi ankim.

1.4. Përfundimet mbi akuzat e reja sipas kodit të procedurës penale të 1979-ës

Kodi i procedurës penale objekt referimi dallohej për përzgjedhjen e një sistemi inkuizitor procedural. Në bazë të këtij sistemi, kompetencat e prokurorit në drejtim të hetimit dhe përfaqësimit të akuzës në gjykim ishin të reduktuara. Hetimi kryhej nga hetuesia. Ky organ ishte përgjegjës për hetimin e veprave penale, hartimin e njoftimit të akuzës së të pandehurit, marrjen në pyetje të të pandehurit pas njoftimit të akuzës, hartimin e akt akuzës në mbyllje të hetimeve dhe dërgimin e çështjes në gjyq.

Gjykata nuk ishte organ i cili jepte vetëm drejtësi. Për shkak të sistemit procedural të zgjedhur, gjykata urdhëronte fillimin e hetimeve për rastet e përcaktuar në ligj, njoftonte akuzën për të pandehurin, si dhe dërgonte për hetim çështjen penale që ishte sjellë për gjykim nga hetuesia, kur hetimi nuk ishte i plotë e duhej të plotësohej me veprime të tjera hetimore. Pra gjykata ishte organi që jepte drejtësi, por njëkohësisht ushtronte dhe ndjekjen penale në gjykim, kur njoftonte një akuzë të re kundrejt të pandehurit por dhe urdhëronte hetuesinë të niste hetimet për akuzën e re të formuluar nga gjykata gjatë gjykimit të çështjes penale.

Në këtë kuptim, gjyqtari të cilit i kalonte çështja për gjykim, kur çmonte se ekzistonin elementë prove ose fakti, të cilat i jepnin (faktit) një veshje juridike të ndryshme nga ajo ekzistuese, gëzonte legjitimitetin procedural të nxirrte vendim të ndërmjetëm mbi ndryshimin e akuzës, me kusht që të mos rëndohej pozita procedurale e personit të marrë si i pandehur.

Ndërkohë në eventualitetin se elementët e provës ose faktit që sillnin ndryshimin e kualifikimit juridik *ipso lege* rëndonin pozitën procedurale të personit të marrë si i pandehur ose sillnin përfshirjen e personave të tjerë në kryerjen e veprës penale, qoftë në bashkëpunim, qoftë dhe në mënyrë të veçantë apo të shkëputur, gjykata kushtëzohej në vendimmarrje. Ky kushtëzim lidhej me pamundësinë juridike të gjykatës për të vazhduar më tej procesin, në kuptimin që obligohej për shkak ligji, që me vendim të ndërmjetëm të dërgonte aktet në hetuesi me qëllim vijimin e hetimeve.

Në lidhje me institutin e akuzave të reja vërejmë se në këtë kod gjykata kishte të drejta të zgjeruara për të verifikuar e kontrolluar hetimin dhe akuzën e ngritur nga hetuesi gjatë fazës së hetimit. Gjykata, kontrollin, ushtrimin e ndjekjes penale dhe verifikimin e akuzës e realizonte si në fazën e veprimeve përgatitore kur akt akuzës ishte sjellë për gjykim nga hetuesi, ashtu dhe në fazën e shqyrtimit të çështjes penale në gjykim. Madje gjykata ruante të drejtën për fillimin e ushtrimit të ndjekjes penale edhe pasi hetimi gjyqësor kishte përfunduar dhe gjykata ishte tërhequr në dhomën e këshillimit për të marrë vendimin përfundimtar që lidhej me çështjen²⁰.

Instituti i akuzave të reja sipas kodit të procedurës penale të 1979-ës, i jepte mundësinë gjykatës të ndërhynte në dy drejtime kryesore që lidheshin me hetimin e plotë të çështjes penale, hetim që duhej t'i bashkëngjitej edhe akuzës përkatëse si dhe në drejtim të plotësisht apo ndryshimit (modifikimit) të akuzës të sjellë për gjykim nga hetuesia.

Në lidhje me hetimin gjykata kishte të drejtë të ushtronte ndjekjen penale kur konstatonte se hetimi i bërë nga hetuesia nuk ishte i plotë. Nëse në gjykim, në bazë të të dhënave të

²⁰ Neni 153 i kodit të procedurës penale të 1979-ës

përftuara, gjykata konstatonte se i pandehuri kishte kryer edhe një vepër tjetër penale të pa hetuar ose të pushuar nga hetuesia, ajo vendoste fillimin e ndjekjes penale edhe për veprën e re. Nëse vepra e re kishte lidhje të natyrës procedurale me atë që po gjykohej, atëherë gjykata i njoftonte në gjykim të pandehurit akuzën mbi veprën e re penale dhe për hetim të mëtejshëm e dërgonte çështjen në organin hetimor.

Në të kundërt, kur vepra e re penale nuk kishte lidhje me atë që gjykata shqyrtonte ajo vendoste fillimin ose rifillimin e hetimit për veprën penale të re dhe urdhëronte hetuesinë që të niste ose riniste edhe një herë hetimet. Pra në gjykim, gjykata gëzonte të drejta të zgjeruara për të hetuar dhe konkluduar në akuzat të reja ndaj veprimtarisë kriminale të të pandehurit, të ndryshme nga ajo e sjellë për gjykim prej hetuesisë.

Gjykata jo vetëm kishte mundësi të hetonte veprimtarinë kriminale të të pandehurit edhe për vepra të tjera të mundshme penale të kryera prej tij por që nuk ishin sjellë për gjykim nga hetuesia, por ajo kishte mundësi dhe të hetonte përfshirjen e personave të tjerë në veprimtarinë kriminale që ajo po e shqyrtonte në gjykim. Në vijim të të së drejtës së saj, gjykata mund të ushtronte ndjekjen penale si dhe të njoftonte akuzat edhe ndaj personave të tjerë që nuk ishin sjellë për gjykim nga hetuesia.

Këtë veprim ajo e bënte kur nga shqyrtimi i çështjes së sjellë për gjykim, gjykata konstatonte ekzistencën e një vepre të re penale të kryer nga një person tjetër që nuk ishte sjellë për gjykim. Në këtë rast nëse vepra e re penale kishte lidhje me atë që shqyrtohej nga gjykata, kjo e fundit kishte të drejtën t'i njoftonte akuzën për veprën penale të re personit që nuk ishte sjellë për gjykim dhe materialet e çështjes penale i'a dërgonte hetuesisë. Në të kundërt nëse vepra penale e re nuk kishte lidhje me atë që gjykohej, gjykata vendoste fillimin e ndjekjes penale për personin e ri që nuk ishte sjellë në gjykim dhe çështjen e dërgonte për hetime të mëtejshme.

Në funksion të plotësimit e modifikimit të akuzës, gjykata sipas këtij kodi kishte një rol aktiv. Gjatë gjykimit ajo mund të procedonte me plotësimin e akuzës në bazë të të dhënave të reja të pranuar në gjykim, ose mund të ndryshonte (modifikonte) akuzën që ishte hartuar më parë nga hetuesi. Pas këtij veprimi gjykata mund të vazhdonte gjykimin me akuzën e modifikuar ose të plotësuar, kur çështja nuk ishte komplekse dhe pozitive e të pandehurit nuk rëndohej nga ndryshimi apo plotësimi i bërë prej gjykatës në gjykim. Nëse çështja ishte komplekse ose pozitive e të pandehurit rëndohej me ndryshimin apo plotësimin e kryer, çështja dërgohej për hetim.

Funksioni i gjykatës sipas kodit të procedurës penale të 1979-ës krahasuar me kushtet e sotme janë të zgjeruara. Gjykata nuk ishte vetëm organ i dhënies së drejtësisë, por ajo ishte dhe organ plotësues i ndjekjes penale. Në kushtet e sotme kur gjykata është organi i vetëm i dhënies së drejtësisë, do të ishte e pamundur të mendohej dhe ushtrimi i ndjekjes penale apo njoftimi i akuzës në gjykim për një vepër penale të re të zbuluar nga gjykata gjatë gjykimit. Veprime të tilla do të binin ndesh me parimin e pavarësisë dhe paanshmërisë së gjykatës.

KAPITULLI II

AKUZA NË FAZËN E HETIMEVE PARAPRAKE

2.1. Vlerësime të përgjithshme mbi akuzën në procesin penal

Sistemi ynë aktual procedural lejon ndërtimin e akuzës prej prokurorisë në fazën e hetimeve paraprake, duke mos përcaktuar me saktësi kohën se kur duhet të kryhet ky veprim procedural prej prokurorit.

Pavarësisht se kodi aktual i procedurës penale nuk përcakton kohën se kur hartohet dhe njoftohet akuzat kundrejt të pandehurit, në të përcaktohen kushtet e përgjithshme me plotësimin e të cilave prokurori i njofton akuzën të pandehurit. Më konkretisht kushti i përgjithshëm në fazën e hetimit paraprak lidhet me mbledhjen e të dhënave të mjaftueshme për të marrë një person në cilësinë e të pandehurit.

Në kodin aktual të procedurës penale nuk përcaktohen në detaje se cilat duhet të jenë të dhënat e mjaftueshme që të mund të lejojnë prokurorin për të hartuar akuzën mbi një hetim të nisur. Kjo logjike e ndjekur nga legjislatori besoj se është e kuptueshme, për shkak se asnjëherë hetimet e nisura nuk janë të njëjta pasi të njëjta nuk janë as veprat penale dhe as cilësitë e autorëve të veprave penale. Kështu që volumi i të dhënave të mjaftueshme që nxisin prokurorin për t'i njoftuar akuzën konkrete të pandehurit vlerësohet vetëm nga prokurori, si subjekt i ngarkuar prej ligjit për të ushtruar ndjekjen penale, pjesë e së cilës natyrisht është dhe njoftimi i akuzës të pandehurit.

Për sa kohë hartimi i akuzës dhe njoftimi i saj është një proces që lidhet me mjaftueshmërinë e të dhënave të mbledhura në fazën e hetimit paraprak, mund të themi se në vetvete akuzat e njoftuar prej prokurorit në bazë të nenit 34 të K.Pr.Penale është normalisht e përkohshme, pra nuk është e qëndrueshme në momentin e parë të njoftimit tek i pandehuri.

Përkohshmëria e akuzës si njoftim i parë që prokurori i bën të pandehurit, lidhet me një vlerësim relativ që prokurori ka mbi të dhënat e mjaftueshme që ai ka mbledhur në fazën e hetimeve paraprake. Them i se prokurori në njoftimin e parë të akuzës kundrejt të pandehurit, bazohet në një vlerësim relativ për shkak se hartimin fillestar të akuzës ai e bazon në të dhëna të grumbulluara deri në një moment të caktuar të hetimit.

Sigurisht që hetimi nuk përfundon me njoftimin e akuzës të pandehurit. Për këtë rast sistemi ynë procedural i ka dhënë një hapësirë të mjaftueshme prokurorit që t'i njoftojë akuzën të pandehurit në fillim, në vijim ose në fund të hetimit paraprak. Kjo hapësirë e mjaftueshme mbi njoftimin e akuzës lidhet me vlerësimin relativ të prokurorit për të dhënat e mjaftueshme që ai ka mbledhur përgjatë hetimit paraprak.

Gjithashtu prokurori nuk mbetet peng i akuzës së parë që ai i ka njoftuar të pandehurit gjatë hetimit. Nëse prokurori ka njoftuar akuzën kundrejt të pandehurit për kryerjen prej tij të një vepre penale e gjatë hetimit pa arritur në fundin e tij prokurori mbledh të dhëna të tjera shpesh

në funksion të hetimit, të cilat ndryshojnë situatën e parë të njoftimit të akuzës, prokurori ka të drejtë që duke u bazuar edhe në të dhënat e reja të mund të ndryshojë ose plotësojë akuzën, duke rënduar ose lehtësuar pozitën procedurale të të pandehurit, në varësi të natyrës së të dhënave të reja të grumbulluara gjatë hetimit.

E drejta për të ndryshuar ose plotësuar akuzën nga prokurori në varësi të të dhënave të reja të mbledhura pas njoftimit të akuzës së parë në hetim është e drejtë të cilën prokurori e ushtron duke u bazuar në nenin 34 paragrafi 1 të K.Pr.Penale²¹. Pra në mënyrë implicite, legjislacioni ynë procedural ka lejuar që akuza gjatë gjithë hetimit paraparak të jetë e përkohshme. Kur themi akuzë e përkohshme kemi parasysh natyrën e saj e cila në hetim, mund të ndryshojë ose të plotësohet në varësi të të dhënave të mbledhura prej prokurorit. Pra përkohshmëria ose paqëndrueshmëria e akuzës lidhet gjithmonë me sasinë e cilësinë e të dhënave të mbledhura përgjatë hetimit.

Kështu që mund të flasim për “akuzën provizore” që hartohet prej prokurorit përgjatë fazës së hetimit akuzë e cila është e paqartësuar plotësisht. Akuza është njëkohësisht dhe e ndryshueshme ose elastike, për shkak të varësisë së saj prej të dhënave që i shtohen hetimit të nisur prej prokurorit.

Mbi natyrën e akuzës dhe karakteristikat e saj në përgjithësi është shprehur Gjykata e Lartë në Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara²² ku trajtohet momenti se si avancon pozita procedurale e një personi ndaj të cilit ka nisur hetimi dhe sesi është e lidhur akuza me të dhënat e grumbulluara gjatë hetimit. Më konkretisht në atë vendim citohet shprehimisht se:

“...Duke permbledhur sa u tha me siper, arrihet ne perfundimin se figura procedurale e autorit te mundshem te vepres penale qe nga momenti i njoftimit te saj tek prokurori e deri ne momentin e perfundimit te hetimeve (neni 327) evoluon nga “person te cilit i atribuohet vepra penale” ne “person ndaj te cilit zhvillohen hetime” dhe se fundi ne “i pandehur”, pavaresisht se ceshtja pushohet (neni 328) apo dergohet per gjykim (neni 331). Si rregull statusi i te pandehurit merret ne perfundim te hetimeve perpara se te depozitohet fashikulli i gjykimit, por ky status mund te merret edhe me perpara. Kjo eshte ne cmimin e prokurorit. Dhe kete prokurori mund ta beje ne çdo faze te hetimit deri ne perfundimin e tyre. Kete veprim prokurori e kryen vetem pasi te kete siguruar te dhenat e mjaftueshme (neni 34/1 i K.Pr.Penale)...”

Një çështje tjetër që mund të sjellim në vëmendje nga vendimi i mësipërm ka të bëjë me natyrën e akuzës. Në një kuptim më të gjerë Gjykata e Lartë në vendimin e saj unifikues nr. 3/2002 nuk e lidh akuzën në kuptimin formal të saj me momentin kur në bazë të neni 34 të K.Pr.Penale prokurori i njofton të pandehurit zyrtarisht akuzën për veprën për të cilën ai merret nën përgjegjësi penale.

Pavarësisht se njoftimi i akuzës për të pandehurin realizohet në një moment të papërcaktuar në kohë gjatë hetimit, por gjithësesi ky moment është i përcaktueshëm nisur nga volumi i të dhënave

²¹ Neni 34 paragrafi 1 i K.Pr.Penale parashikon se: “Merr cilësinë e të pandehurit personi të cilit i atribuohet vepra penale me aktin e njoftimit të akuzës, në të cilin tregohen të dhënat e mjaftueshme për marrjen si të pandehur. Ky akt i njoftohet të pandehurit dhe mbrojtësit të tij. Kur pas marrjes së një personi si të pandehur dalin të dhëna të reja që ndryshojnë akuzën e paraqitur ose e plotësojnë atë, prokurori merr vendim, të cilin ia njofton të pandehurit.”

²² Vendim Unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 3 datë 27.09.2002

të mbedhura. Në kuptimin jo formal personi nën hetim, ndaj të cilit ka nisur një procedim penal është një person i akuzuar, megjithëse ndaj tij zyrtarisht prokuroria nuk ka njoftuar akuzën penale.

Në momentin e përballjes për herë të parë me prokurorin ose oficerin e policisë gjyqësore në veprimin hetimor të marrjes në pyetje, personi nën hetim ka të drejtën ligjore të informohet për faktin se ndaj tij është nisur një procedim penal prej prokurorisë. Procedimi penal i nisur bazohet në dyshimin se i hetuari ka kryer një veprim kriminal i parashikuar si vepër penale nga legjislativi penal material, duke treguar dhe veprën penale konkrete të parashikuar, burimet e provës ose aktet e tjera procedurale që kanë bërë të mundur regjistrimin e procedimit penal nëse ato nuk e dëmtojnë hetimin që mund të lidhen me kallëzimin e të dëmtuarit nga vepra penale ose dekarimet e dhëna nga persona që tregojnë rrethana të dobishme për hetimin, si dhe të drejtën që ka i hetuari për tu mbrojtur nëpërmjet mbrojtësit ligjor.

Këto të drejta të përmendura më lart që gëzon i hetuari në momentin e parë të marrjes në pyetje prej prokurorit ose oficerit të policisë gjyqësore, në varësi të rrethanave kur kryhet ky veprim hetimor, janë njëkohësisht dhe detyrime ligjore të cilat duhet të përmbushen dhe respektohen prej organit procedues në fazën e hetimit. Pra në momentin e parë të marrjes në pyetje në hetim, organi procedues ka detyrimin që përpara fillimit të pyetjeve t'i bëjë të ditur të hetuarit gjithë të drejtat me natyrë informuese të përmendur më sipër.

Në përmbajtje sipas vendimit të mësipër unifikues të Gjykatës së Lartë, të drejtat e mësipërme përbëjnë thelbin e akuzës, pavarësisht se zyrtarisht prokuroria nuk i ka njoftuar akuzën të pandehurit sipas nenit 34 të K.Pr.Penale.

Në lidhje me këtë moment Gjykata e Lartë në vendimin unifikues nr. 3/2002 shprehet se:

“...Nga shqyrtimi i akteve të dosjes del se V. O është njoftuar për thelbin e akuzës në ngarkim të tij, duke ju bërë e qartë:

- *se ndaj tij është filluar një procedim penal nga Prokuroria e rrethit Durrës*
- *se ai akuzohet për veprën penale të vjedhjes me anë mashtrimi parashikuar nga neni 143/1 të Kodit Penal*
- *se veprën penale e ka kryer në bashkëpunim me vjehrrën e tij*
- *se procedimi penal ka filluar mbi bazën e kallzimit të shtetasit T. C.*
- *se cila është përmbajtja në thelb e këtij kallzimi*
- *se ka të drejtë të mbrohet me një avokat*

Sa u thanë më sipër shtetasit V. O. i janë njoftuar më datë 4.10.2001 në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime...”.

Evidentimi i këtij momenti në vendimin e Gjykatës së Lartë, lidhet me sqarimin e fazës së njohjes me akuzën në përgjithësi dhe njoftimin e akuzës zyrtarisht të pandehurit.

Në pamje të parë duket sikur momenti i njohjes së personit nën hetim me thelbin e akuzës dhe momenti i njoftimit zyrtarisht të të pandehurit me akuzën, paraqesin të njëjtën situatë juridike, por në thelb nuk është e njëjta situatë. Midis këtyre dy momenteve ka dallime të cilat informojnë për natyrën e paqëndrueshme të akuzës.

Njohja me thelbin e akuzës përbën një veprim procedural, përmes të cilit personit që i atribuohet vepra penale (i cili sipas rrethanave të procedimit penal mund të jetë i lirë ose i ndaluar) i bëhen të ditura shkaqet dhe natyra e ndalimit ose e fillimit të procedimit penal, në respektim të parimit të ligjshmërisë.

Ndërkohë njoftimi i akuzës si veprim procedural kryhet në momentin kur prokurori çmon se të dhënat e mbledhura deri në atë fazë të procedimit tregojnë se vepra penale ka ndodhur e se është kryer nga personi nën hetim, fakte për të cilat prokurori njofton akuzën. Njoftimi akuzës në këtë çast sjell si efekt ndryshimin e statusit procedural të personit, duke kaluar nga person nën hetim, në të pandehur. Me veprimin e njoftimit të akuzës zyrtarisht personi nën hetim merr cilësinë e të pandehurit. Prej këtij momenti i pandehuri ka mundësinë reale që të organizojë mbrojtjen e tij efektive për akuzën e ngritur nga prokuroria.

2.2. Akuza në fazën e hetimit në raport me akuzat e reja në procesin penal

Punimi i këtij disertacioni edhe pse i referohet akuzave të reja në procesin penal dhe si rrjedhim është e kuptueshme që duhet të përqendrohet drejt tij, por kam vlerësuar si pjesë të rëndësishëm të këtij punimi dhe trajtimin e akuzës në fazën e hetimeve paraprake dhe elementeve thelbësorë të saj. Vlerësoj se në këtë punim duhet të trajtohet me hollësi dhe akuza për shkak se ky akt procedural është elementi bazë që gjendet në të gjitha dispozitat procedurale që përfshihen në kapitullin e akuzave të reja.

Mjafton të përmendim ndryshimin e akuzës në gjykim prej prokurorit (neni 372 i K.Pr.Penale), akuza për një vepër tjetër (neni 373 i K.Pr.Penale), akuza për një fakt të ri (neni 374 i K.Pr.Penale) për të kuptuar rëndësinë dhe praninë e akuzës fillestare që rezultojnë të jetë e përfshirë në mënyrë integrale në kapitullin e akuzave të reja në Kodin e Procedurës Penale.

Për të trajtuar me hollësi ndryshimin e akuzës që ndodh gjatë shqyrtimit gjyqësor të një çështje penale prej prokurorit, duhet paraprakisht të shpjegohet së çfarë është akuza si akt procedural i parashikuar në Kod, cilat janë elementët përbërës të saj dhe si transformohen këta elementë në gjykim që nxisin prokurorin në ndryshimin e akuzës fillestare për të cilën është sjellë në gjykim i pandehuri.

Për të trajtuar dispozitën procedurale që lidhet me akuzën për një vepër penale të re në gjykim duhet të sqarojmë se cilët janë elementet thelbësorë të akuzës fillestare që e lidhin këtë akuzë dhe me një vepër penale të re, të pa përmendur më parë prej prokurorit në kërkesën për gjykim, çfarë rrethanash duhet të ekzistojnë që prokurori në gjykim t'i njoftojë të pandehurit një akuzë të re që detyrimisht duhet të ketë lidhje me akuzën fillestare. Në vijim për të interpretuar dispozitën procedurale që lidhet me akuzën për një fakt të ri duhet të trajtohet kuptimi i faktit të ri. Gjithashtu për të vazhduar më tej duhet t'i japim përgjigje pyetjes se përse fakti i ri për të cilin prokuroria duhet të procedojë dhe me njoftimin e një akuzë nuk ka mundësi që të lidhet organikisht me elementet e akuzës së parë të sjellë në gjykim nga prokurori ndaj të pandehurit.

Në të gjithë shembujt e përmendur më lart gjendet gjithmonë e pranishme akuza bazë ose fillestare që prokurori ka sjellë në gjykim për të pandehurin e në gjitha rastet e përfshira në

institutin e akuzave të reja, akuza fillestare është pjesë integrale e ndryshimit që ndodh në gjykimin e akuzave të reja.

Për arsyet e përmendura më lart vlerësohet se trajtimi me hollësi i akuzës në fazën e hetimeve dhe elementeve përbërës të saj është i rëndësishëm për shkak se nëpërmjet trajtimit të elementeve të akuzës është më e lehtë e më e kuptueshme trajtimi në veçanti i të gjitha dispozitave procedurale që lidhen me institutin e akuzave të reja.

2.2.1. Elementët e akuzës

Akuza është akt procedural i përcaktuar si i tillë nga neni 34 paragrafi 1 i K.Pr.Penale. Nëpërmjet akuzës prokuroria i njofton të pandehurit veprën penale të dyshuar si të kryer prej tij si dhe karakteristikat ligjore të veprës penale të parashikuar si të tillë nga Kodi Penal. Pra për të arritur në përkufizimin e duhur se çfarë është akuza në fillim duhet të identifikojmë elementet përbërës të saj të cilat i gjejmë të përcaktuara në nenin 34 paragrafi 1 të K.Pr.Penale.

Në Kodin e Procedurës Penale nuk gjejmë asnjë dispozitë ligjore që të japë kuptimin e akuzës dhe elementeve përbërës të saj. Në nenin 34 të K.Pr.Penale parashikohet detyrimi i prokurorit që t'i njoftojë të pandehurit akuzën përkatëse në të cilën paraqiten të dhënat e mjaftueshme që përlligjin hartimin dhe njoftimin e akuzës. Më tej Kodi i Procedurës Penale nuk jep ndonjë përkufizim se cilat janë të dhënat e mjaftueshme të mbledhura në hetim që lejojnë prokurorin të hartojë dhe komunikojë akuzën. Për të kuptuar akuzën, të dhënat e mjaftueshme që përbëjnë elementet e saj duhet t'i referohemi jurisprudencës e më konkretisht jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka përshtuar në mënyrë narrative akuzën dhe elementët e saj si pjesë e procesit të rregullt ligjor që lidhet ngushtë me parimin e së drejtës së të pandehurit për t'u informuar për akuzën me qëllim përgatitjen e mbrojtjes së tij. Pra Gjykata Kushtetuese në fokusin e saj nuk ka pasur si qëllim që të përkufizojë akuzën si një akt procedural që prokurori duhet t'ja njoftojë të pandehurit, por duke elaboruar në jurisprudencën e saj parimin kushtetues të së drejtës për t'u informuar për akuzën parashikuar nga neni 31/a i Kushtetutës²³ dhe njëkohësisht nga neni 6/3/a i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut²⁴, ajo ka përcaktuar elementet konstituiv të akuzës, të cilat në gjitha rastet duhet t'i bëhen të ditur të pandehurit përpara se të fillojë procesi gjyqësor përpara gjykatës, me qëllim që ai të realizojë të drejtën e mbrojtjes. Në jurisprudencën e saj që lidhet me shtjellimin e parimit kushtetues të së drejtës për t'u informuar për akuzën, Gjykata Kushtetuese sigurisht i referohet jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Në vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 24/2012²⁵, paraqiten elementët thelbësorë të akuzës, të cilat në funksion të respektimit të parimit kushtetues të së drejtës për t'u informuar

²³ Neni 31/a i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon se: "Gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë: a) të vihet në dijeni menjëherë dhe hollësisht për akuzën që i bëhet, për të drejtat e tij, si dhe t'i krijohet mundësia për të njoftuar familjen ose të afërmit e tij;"

²⁴ Neni 6/3/a i Konventës parashikon se: "3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme: a) të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij;"

²⁵ Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 24 datë 30.04.2012

për akuzën duhet ti bëhen të ditur të pandehurit me qëllimin e vetëm që ai të përgatisë të drejtën e mbrojtjes së tij.

Më konkretisht Gjykata Kushtetuese mbi këtë aspekt shprehet se:

“...E drejta e individit për t’u vënë në dijeni menjëherë dhe në mënyrë të hollësishme mbi natyrën dhe shkakun e akuzës kundër tij, është sanksionuar nga neni 31/a i Kushtetutës dhe nga neni 6/3/a i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ). Ky parim kushtetues është trajtuar nga jurisprudenca shqiptare dhe ajo e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në funksion të realizimit të së drejtës së mbrojtjes të të akuzuarit si dhe të garantimit të parimit të barazisë së armëve ndërmjet palës akuzuese dhe mbrojtjes. Gjykata vëren se qëllimi i këtyre dispozitave është të krijojnë mundësinë për të akuzuarin të njihet paraprakisht me materialet, provat dhe rezultatet e hetimit, në mënyrë që të ushtrojë të drejtën e tij për të përgatitur një mbrojtje efektive, pra për të paraqitur argumentet në favor të tij dhe për të kundërshtuar akuzën e ngritur...”

Pra Gjykata Kushtetuese shprehet për dy elemente përbërës të akuzës, të cilat detyrimisht duhet t’i bëhen të ditur të pandehurit me qëllim që ai më pas të realizojë të drejtën e mbrojtjes. Këto elemente janë shkaku dhe natyra e akuzës. Siç edhe e përmendëm më lart Gjykata Kushtetuese në praktikën e saj i referohet jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut e cila në disa vendime i ka dhënë kuptimin e duhur elementve përbërës së akuzës që janë shkaku dhe natyra e saj.

Në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut kemi zgjedhur vendimin në lidhje me çështjen *Mattoccia vs Italy*²⁶.

Në këtë çështje GJEDNJ-ja në interpretimin e nenit 6 paragrafi 3 pika a) të KEDNJ-së që lidhet me parimin e informimit të të pandehurit me akuzën, shprehet ndër të tjera për rëndësinë që duhet të tregohet në njoftimin e akuzës kundrejt të pandehurit. I dyshuari duhet të njoftohet formalisht për faktin penal dhe bazën ligjore të akuzës së ngritur në ngarkim të tij. I pandehuri duhet të vihet në dijeni dhe të kuptojë njëkohësisht në detaje dhe menjëherë për shkakun e akuzës që përbëhet nga fakti penal kundër të cilit është bazuar dhe akuza e ngritur, si dhe për natyrën e akuzës që përbën cilësimin e drejtë ligjor të faktit penal. Sipas GJEDNJ-së, veprimi i dhënies në mënyrë të plotë e të detajuar të informacionit që lidhet me akuzën kundër të pandehurit është një kusht thelbësor që siguron një procedim të drejtë penal në funksion të respektimit të parimit të një procesi të rregullt ligjor.

Pra ajo se çfarë paraqet rëndësi për nevojat e këtij punimi është pjesa e vendimit të GJEDNJ-së e cila përcakton elementët thelbësorë të akuzës të cilat duhet t’i bëhen të ditur të pandehurit në çastin e njoftimit të akuzës. Këto elementë janë siç u theksua më sipër, shkaku dhe natyra e akuzës.

Në lidhje me akuzën dhe elementet e saj duhet t’i referohemi nenit 34 të K.Pr.Penale, ku sipas kësaj dispozite prokurori është subjekti procedural i cili harton akuzën penale. Akuza me vendim të prokurorit i njoftohet të pandehurit i cili e merr këtë cilësi në momentin e njoftimit

²⁶ Gjykata Evropiane Për të Drejtat e Njeriut – çështja *Mattoccia vs Italy* (2000)

të saj. Nëpërmjet akuzës i pandehuri duhet të njoftohet në mënyrë të qartë e të plotë mbi dy elementet thelbësorë të saj që janë shkak i akuzës dhe natyra e saj

Shkaku i akuzës është elementi që përcakton veprimin e dyshuar të kryer prej të pandehurit, mbi të cilin është mbështetur akuza e ngritur prej prokurorisë. Kur i referohemi veprimit, kemi parasysh të gjithë elementët materiale që përcaktojnë faktin penal që dyshohet se është realizuar nga i pandehuri. Pra shkaku i akuzës lidhet me veprimet ose mosveprimet konkrete të kryera prej të pandehurit, të cilat formojnë figurën konkrete të veprës penale të dyshuar si të kryer prej tij.

Natyra e akuzës është elementi që përcakton karakteristikat ligjore që i jepet veprimit të të pandehurit sipas dispozitës apo dispozitave konkrete në Kodin Penal. Pra natyra e akuzës lidhet me përcaktueshmërinë e veprimit ose mosveprimit konkret të të pandehurit si vepër penale të parashikuar si e tillë nga Kodi Penal ose nga ligje të tjera penale.

Sjellim në vëmendje faktin se baza e legjislacionit penal përbëhet nga Kodi Penal si dhe nga ligje të tjera që parashikojnë vepra penale²⁷.

2.2.2. Përkufizimi i akuzës

Pasi u evidentuan elementet thelbësore të akuzës, është më e thjeshtë për të dhënë dhe një përkufizim mbi akuzën, duke i dhënë në këtë mënyrë përgjigje pyetjes së çfarë është akuza si një akt procedural i parashikuar si i tillë nga neni 34 i K.Pr.Penale.

Duke ju referuar elementeve të përmendur më lart akuza mund të përkufizohet si në vijim:

“Akuza është akti procedural i hartuar nga prokurori me të cilin personin nën hetim merr cilësinë e të pandehurit dhe njoftohet për natyrën kriminale të veprimeve të dyshuara të kryera prej tij, si dhe për karakteristikat ligjore të veprës penale që i jepet veprimit kriminal sipas dispozitës konkrete në Kodin Penal apo Ligjin Penal shqiptar.”

Kodi i Procedurës Penale në tërësinë e dispozitave të tij i njeh të drejtën prokurorisë që në varësi të të dhënave të grumbulluara gjatë hetimit, të marrë në cilësinë e të pandehurit personin që dyshohet se mund të jetë autor i veprës penale të përcaktuar si të tillë nga Kodi Penal. Kur përmendim Kodin Penal i referohemi jo vetëm Kodit Penal që parashikon pjesën më të madhe të veprave konkrete penale por dhe Ligjeve të tjera të cilat në përmbajtjen e tyre mund të parashikojnë vepra penale të veçanta.

Në ushtrimin e së drejtës për të marrë një person si të pandehur, prokurori në çdo rast është i detyruar që të veprojë në përputhje me kërkesat që parashikohen në nenin 34 paragrafi 1 të K.Pr.Penale. Kjo do të thotë se një person e merr cilësinë e të pandehurit, vetëm atëherë kur ai njoftohet me akt të shkruar në formën e një vendimi nga prokurori ose oficeri i policisë gjyqësore, i autorizuar prej prokurorit për akuzën që i atribuohet. Në përmbajtjen e aktit të

²⁷ Neni 1/a i Kodit Penal parashikon se: “Kodi Penal bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në parimet e përgjithshme të së drejtës penale ndërkombëtare, si dhe në marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar. Legjislacioni penal përbëhet nga ky Kod dhe ligje të tjera që parashikojnë vepra penale.”

njoftimit të akuzës duhet të gjejnë pasqyrim gjithmonë elementët e akuzës që janë shkak dhe natyra e saj.

Elementet e akuzës i parashtrihen të pandehurit në aktin e njoftimit të saj nëpërmjet të dhënave të grumbulluara nga prokuroria deri në atë fazë të hetimit paraprak të cilat janë të vlerësuar, si të mjaftueshme për të arritur në përfundimin për natyrën e veprës penale dhe autorin e saj. Njoftimi i akuzës me akt të shkruar pasqyron përfundimin paraprak të arritur prej prokurorisë se vepra penale është kryer dhe se autori i saj është personi të cilit i bëhet ky njoftim.

Përpilimi i aktit për marrjen e personit në cilësinë e të pandehurit dhe njohja e tij detyrimisht e në mënyrë të hollësishme me shkakun dhe natyrën e akuzës që prokuroria ka arritur të grumbullojë kundër tij, ka lidhje me të drejtën e personit për t'u mbrojtur. Për këtë arsye veprimi i njoftimit të akuzës me akt të shkruar duke përfshirë në të, të gjitha elementët e akuzës për të pandehurin është i një rëndësie të veçantë. Mos respektimi i të gjitha këtyre kërkesave nga prokuroria, përbën shkak për cënimin e së drejtës së mbrojtjes për të pandehurin.

Raporti procedural midis prokurorit dhe të pandehurit i vendosur në momentin e hartimit dhe njoftimit të akuzës është i një rëndësie të madhe sepse ky raport lidhet drejtpërdrejt me respektimin e parimit të procesit të rregullt ligjor. Në këtë raport prokuroria përfaqëson subjektin procedural që ka si detyrë funksionale ushtrimin e ndjekjes penale dhe njoftimin e akuzës ndaj personit që dyshohet se ka kryer një vepër penale, ndërsa i pandehuri është personi, të cilit i garantohet e drejta e mbrojtjes ndaj akuzave të ngritura në emër të shtetit prej prokurorisë.

Pra një aspekt i procesit të rregullt ligjor është garancia që prokuroria duhet t'i ofrojë të pandehurit në formulimin dhe njoftimin e akuzës. Është e qartë tashmë se mbrojtja e të pandehurit është efikase vetëm në rastin kur ai e di se për çfarë akuzohet. Siç e përmendëm edhe më sipër, akuza është njoftimi zyrtar me akt të shkruar nga ana e prokurorisë, që i bëhet të pandehurit për faktin penal që lidhet me kryerjen e një vepre penale. Kështu që gjatë procesit të formulimit të akuzës si një akt zyrtar, prokuroria duhet të bëjë kujdes që në përmbajtjen e akuzës të pasqyrojë me hollësi e në detaje shkakun e ngritjes së akuzës që lidhet me faktin material mbi të cilin bazohet akuza si dhe natyrën e akuzës që lidhet me cilësimin e drejtë ligjor që prokuroria i bën fakteve të pasqyruara në akuzë.

Gjithashtu procesi i formulimit të akuzës duhet të shoqërohet edhe me procesin e njoftimit të saj. Akti i shkruar i akuzës në formën e një vendimi nga ana e prokurorisë duhet t'i njoftohet të pandehurit me konfirmimin e marrjes dijeni prej tij për akuzën e hartuar nga prokurori.

Formulimi i drejtë i akuzës dhe njoftimi i saj në kohën e duhur të pandehurit, përmbushin detyrimin ligjor për t'i garantuar këtij të fundit një mbrojtje efektive duke përmbushur kërkesat e procesit të rregullt ligjor.

Formulimi i drejtë i akuzës garanton ushtrimin e një mbrojtje efektive prej të pandehurit, pasi nëse në këtë formulim pasqyrohet me hollësi shkakun dhe natyrën e akuzës, i pandehuri jo vetëm informohet për akuzën e ngritur ndaj tij, por njëkohësisht është në gjendje të kuptojë e perceptojë përmbajtjen e saj. Vetëm në këtë mënyrë i pandehuri ka mundësi objektive që pasi të ketë kuptuar me saktësi akuzën e ngritur, të fillojë të përgatisë mbrojtjen e tij efektive në lidhje me akuzën.

Shprehja “tregohen të dhëna të mjaftueshme për të pandehurin” të përcaktuar në nenin 34 paragrafi 1 të K.Pr.Penale nënkupton qartësinë e elementëve të akuzës për të cilat duhet të njoftohet i pandehuri, si pjesë e garancisë që i ofrohet atij për të realizuar një mbrojtje sa më efektive.

Për arsyet e përmendura më lart vlerësojmë se njoftimi i akuzës të pandehurit, në detaje dhe me qartësi, duke i dhënë atij mundësinë të kuptojë shkaqet dhe natyrën e akuzës e ngritur është pjesë e rëndësishme e respektimit të së drejtës së mbrojtjes si garanci kushtetuese për të pandehurin dhe në këtë kuadër është edhe një garanci e procesit të rregullt ligjor.

Jo pa qëllim në shembullin e mësipërm të dhënë në çështjen *Mattoccia kundër Italisë*, GJEDNJ-ja ka theksuar rëndësinë e informimit të të pandehurit menjëherë dhe në detaje për akuzën e ngritur ndaj tij, si pjesë thelbësore e një procesi gjyqësor të drejtë e të paanshëm.

Gjykata Kushtetuese ka një praktikë solide në këtë drejtim, duke konfirmuar parimin e së drejtës që gëzon i pandehuri për t’u informuar për akuzën e ngritur ndaj tij, si pjesë e rëndësishme e realizimit të së drejtës së mbrojtjes.

Më konkretisht në vendimin nr. 4/2012²⁸, Gjykata Kushtetuese rikonfirmon praktikën e krijuar prej saj në përputhje edhe me jurisprudencën e GJEDNJ-së që lidhet me rëndësinë e njoftimit të të pandehurit në detaje që lidhet me akuzën dhe elementet thelbësore të saj. Në këtë vendim Gjykata Kushtetuese ndër të tjera shprehet se:

“...E drejta e individit për t’u vënë në dijeni menjëherë dhe në mënyrë të hollësishme mbi natyrën dhe shkakun e akuzës kundër tij, është sanksionuar nga neni 31/a i Kushtetutës dhe nga neni 6/3/a i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ). Ky parim kushtetues është trajtuar nga jurisprudenca shqiptare dhe ajo e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në funksion të realizimit të së drejtës së mbrojtjes të të akuzuarit si dhe të garantimit të parimit të barazisë së armëve ndërmjet palës akuzuese dhe mbrojtjes. Gjykata vëren se qëllimi i këtyre dispozitave është të krijojnë mundësinë për të akuzuarin të njihet paraprakisht me materialet, provat dhe rezultatet e hetimit, në mënyrë që të ushtrojë të drejtën e tij për të përgatitur një mbrojtje efektive, pra për të paraqitur argumentet në favor të tij dhe për të kundërshtuar akuzën e ngritur përpara gjykatës²⁹.”

Në lidhje me të drejtën e mbrojtjes Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj të konsoliduar ka theksuar se ajo duhet të jetë reale dhe efektive dhe jo vetëm teorike dhe se ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet, por përkundrazi, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet të marrin të gjitha masat ligjore që në funksion të procesit të drejtë t’i japin mundësinë individit të bëjë mbrojtje reale, duke respektuar parimin e barazisë së armëve. Në këtë këndvështrim Gjykata ka theksuar se veçanërisht në procesin penal, barazia e armëve, kontradiktoriteti i lidhur ngushtë me këto, realizimi i mbrojtjes së të pandehurit, i garantuar shprehimisht në nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, përbëjnë në vetvete elementët më thelbësorë të procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues.

Nisur sa më lart, informimi i plotë dhe i saktë për akuzat e ngritura, si dhe për kualifikimin juridik të veprës penale, duhet të konsiderohet si kusht themelor për besueshmërinë e procesit dhe për përgatitjen e duhur të një mbrojtjeje efektive, e cila është një nga garancitë themelore

²⁸ Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 4 datë 10.02.2012

²⁹ Vendim i Gjykatës Kushtetuese, po aty

për realizimin e të drejtës për një proces të rregull ligjor të sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe në nenin 6 të KEDNJ-së.

Sa më sipër vërehet se e gjithë procedura që lidhet me hartimin dhe njoftimin e akuzës të pandehurit, referuar hapësirës kohore lidhet ngushtësisht me elementet e shkakut dhe natyrës së akuzës. Në këtë kuptim mund të themi se akuza është e gatshme për t'ju njoftuar të pandehurit, vetëm kur nga të dhënat e mbledhura në fazën e hetimit, prokurori vlerëson se në mënyrë të mjaftueshme por jo përfundimtare janë qartësuar elementet e shkakut dhe të natyrës së akuzës.

Në vazhdim do të mund të konstatohet se zhvillimi i akuzës “në mënyrë dinamike” gjatë hetimit përbën një prej karakteristikave të sistemit tonë procedural. Hetimi për shkak të natyrës së tij të përcaktuar në ligj është objekt i shtimit të vazhdueshëm me elementë provash të dobishme për të përcaktuar në mënyrë më të plotë faktet që mund t'i ngarkohen personit nën hetim/të pandehurit, deri në momentin e gjykimit të tij nga organi procedues.

Në thelb ngritja e akuzës për kryerjen e një veprë penale, shpreh nevojën që personi subjekt ndaj të cilit adresohet akuza, të ketë mundësinë e një mbrojtjeje efektive, me afate kohore dhe kërkesë provash në përputhje me modifikimet e akuzës.

Situata më e mirë në të cilën do gjendej personi nën hetim do ishte ajo në të cilën ai do të njihet që nga fillimi përmbajtjen e akuzës, me kusht që e drejta e mbrojtjes t'i lejohet që nga momenti kur personi nën hetim të njihet me akuzën.

Kjo pritshmëri e ligjshme, në të vërtetë nuk përmbushet në praktiken e përditshme ku ndodh që ndryshime të vazhdueshme të akuzës të bëhen si nga pikëpamja formale ashtu dhe ajo substanciale. Jo rastësisht është miratuar një disiplinë juridike në lidhje me ndryshimin e titullit të akuzës. Është pikërisht kjo e cila përbën detyrim në rast nevojë për ndryshim të akuzës, për prokurorin në fazën e hetimeve paraprake dhe për gjyqtarin gjatë shqyrtimit gjyqësor, për t'i lejuar personit nën hetim/të pandehurit, një të drejtë për mbrojtje reale.

Shqyrtimi i vazhdueshëm mund të çojë në një rishikim konstant të akuzës, duke krijuar ekuilibra të vështirë midis objektivit të rendit juridik mbi ndjekjen penale të personave e nga ana tjetër të së drejtës së personit nën hetim/të pandehurit për të pasur mundësinë e mbrojtjes më të mirë të mundshme pa e detyruar atë që të përballet me vështirësi të krijuara ndonjëherë edhe në mënyrë artificiale e duke i sjellë pengesa në ndërtimin e një mbrojtje të përshtatshme në kohë të përshtatshme.

Për më tepër, mund të thuhet se modeli që aktualisht rregullon ndryshimin e akuzës është përballur me sfida të forta në nivelet e jurisprudencës. Mjafton të përmendim praktikën e ndryshme që kanë ndjekur gjykatat e zakonshme në sistemin tonë gjyqësor e ndonjë herë edhe praktika të ndryshme të ndjekura nga Gjykata e Lartë, për të kuptuar vështirësinë me të cilën është përballur modeli i akuzave të reja, vështirësi të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejt në pozitën procedurale në të cilën ndodhej i pandehuri.

Nisur nga sa u tha më sipër, mund të shtojmë se nevoja për ndryshime të vazhdueshme të akuzës ka lidhje me natyrën e procesit penal që zbatohet në vendin tonë. Sistemi ynë procedural është një sistem miks, në të cilin përfshihen elemente të modelit akuzator të gërshetuara me

elementë të theksuara inkuizitore. Në këtë sistem procedural të pranuar, mund të përftohen vazhdimisht elementë të reja prove, përfshirë dhe fazën e gjykimit në themel të çështjes së marrë në rishqyrtim.

Përderisa në sistemin tonë procedural është pranuar kjo zgjidhje që lidhet me marrjen e provave edhe në fazën e gjykimit të çështjes penale, rrjedhimisht kemi pranuar si zgjidhje edhe mundësinë që fakti penal i sjellë në gjykim nga prokuroria, të mund të pësojë ndryshime sa herë që të përftohen elementë integruar prove si dhe çdo herë kur prokurori apo gjyqtari të nxjerrin konkluzione të ndryshme nga ato të konstatuara më parë, pavarësisht se baza e elementëve të provës mund të ketë mbetur po e njëjta, siç ka rezultuar fillimisht nga aktet.

Kjo është dhe një nga karakteristikat që gëzon sistemi ynë procedural në lidhje me akuzën. Ajo mund të ndryshojë në varësi të të dhënave të mbledhura si gjatë fazës së hetimeve paraprake (rastet e zakonshme) ashtu edhe gjatë gjykimit që në përgjithësi mund të quhen raste të veçanta.

Në të gjitha situatat ndryshimi i vazhdueshëm i akuzës ndikon negativisht në realizimin efektiv të mbrojtjes prej të pandehurit. Që të shmangët një situatë e tillë e padëshirueshme për të pandehurin por edhe për procesin në tërësi, duhet që sistemi procedural të përfshijë brenda tij elemente garantues të cilat do t'i krijojnë të pandehurit lehtësirat e nevojshme që në kushtet e ndryshimit të situatës që lidhet me akuzën të mund të realizojë realisht të drejtën e mbrojtjes.

Sistemi ynë procedural i ka elementet garantues që lehtësojnë pozitën e të pandehurit dhe i japin mundësi atij që të realizojë të drejtën e mbrojtjes edhe në rastet e ndryshimit të akuzës fillestare.

2.2.3. Koha e njoftimit të akuzës

Akuza duhet t'i njoftohet të pandehurit në kohën e duhur, në mënyrë që atij t'i krijohen të gjitha mundësitë e duhura për t'u njohur e përgatitur mbrojtjen e tij në një kohë të arsyeshme. Njoftimi i akuzës nuk ka për qëllim vetëm që i pandehuri të informohet mbi shkakun dhe natyrën e ndjekjes penale të nisur prej prokurorisë, por njoftimi ka për qëllim gjithashtu t'i japë mundësinë të pandehurit që ai të përgatitet në kohën e duhur për të realizuar një mbrojtje efektive. Për të realizuar mbrojtjen efektive i pandehuri fillimisht duhet të marrë në dorëzim aktin e akuzës të njoftuar nga prokurori. Pra i pandehuri duhet të njihet drejtpërdrejtë duke pasur në zotërim aktin e akuzës prej të cilit, atij i lindin dhe të drejtat procedurale të realizimit të mbrojtjes.

Në këtë mënyrë mund të themi se respektohet parimi i pjesëmarrjes efektive të të pandehurit në procesin penal, parim i cili duhet të zbatohet në favor të çdo personi që gjendet në një situatë të disfavorshme, siç mund të jetë rasti i të miturve që akuzohen për kryerjen e një veprë penale.

Referuar legjislacionit tonë procedural penal, marrja e personit me cilësinë e të pandehurit nëpërmjet njoftimit të akuzës me akt të shkruar, mund të realizohet në çdo fazë të hetimit paraprak, duke përfshirë këtu edhe kohën përpara se personi të vendoset në masën e sigurimit "arrest në burg".

Në disa legjislacione (përfshirë këtu edhe legjislacionin italian i cili është marrë si model nga

legjislacioni ynë) akti i formulimit dhe njoftimit të akuzës bëhet në përfundim të hetimit paraprak pasi prokuroria ka arritur në konkluzionin se çështja penale duhet të dërgohet për gjykim. Deri në këtë çast personi të cilit i atribuohet vepra penale konsiderohet si person nën hetim. Në përfundim të hetimeve, të pandehurit i njoftohet akuza zyrtare e cila konfirmohet në kërkesën për gjykim përgjatë seancës së verifikimit të akuzës³⁰. Deri në momentin e zhvillimit të seancës së parë gjyqësore, të pandehurit i jepet koha e nevojshme për të përgatitur mbrojtjen e tij.

Thënë me fjalë të tjera, kërkesa për gjykim është e integruar në përmbajtjen e saj edhe me aktin e njoftimit të akuzës. Madje referuar drejtpërdrejt legjislacionit italian³¹, kërkesa për gjykim (dekreti që urdhëron gjykimin) në të cilin është njehsuar edhe akti i njoftimit të akuzës për të pandehurin, përpilohet nga gjyqtari i seancës paraprake.

Siç e përmendëm edhe më lart Kodi ynë i Procedurës Penale nuk ka vendosur kufizime mbi momentin e njoftimit të akuzës. Prokurori është i lirë të njoftojë akuzën të pandehurit, që në momentet e para të konstatimit të veprës penale apo të dyshimeve mbi personin që ka realizuar veprën penale. Gjithashtu mund të njoftohet akuza në vijim të procedimit penal të nisur, kur ndaj të hetuarit është caktuar edhe masa e sigurimit personal, por akuza mund të njoftohet edhe në fund të hetimit paraprak, kur prokuroria konkuldon se çështja penale duhet të dërgohet për gjykim.

Në të gjitha rastet akti i njoftimit të akuzës është i ndryshëm nga akti i kërkesës për gjykim që prokuroria paraqet në gjykatë kundër të pandehurit. Pavarësisht se në përmbajtje akti i njoftimit të akuzës dhe akti i kërkesës për gjykim mund të përmbajnë elementë të njëjta, përsëri këto akte në përgjithësi nuk janë të njëjta. E vëmë në dukje këtë ndryshim për shkak se akti i njoftimit të akuzës është ushtrimi i së drejtës kushtetuese të prokurorisë për t'i njoftuar të pandehurit akuzën me të dhëna të mjaftueshme, të cilat në tërësinë e tyre tregojnë elementët e veprës penale të kryer dhe autorësinë e të pandehurit në këtë vepër penale. Ndërkohë akti i kërkesës për gjykim konsiston në konkretizimin e ushtrimit të ndjekjes penale duke u lidhur në këtë mënyrë me funksion kushtetues të prokurorisë, atë të përfaqësimit të akuzës përpara gjykatës.

Në aktin e njoftimit të akuzës i pandehuri nuk është i detyruar të japë shpjegime apo të paraqesë prova të nevojshme përpara prokurorit për të qartësuar pozitën e tij procedurale në raport me akuzën e ngritur. Madje akti i njoftimit të akuzës prej prokurorisë është një veprim i njëanshëm i saj, i cili fillon me hartimin e akuzës dhe përfundon me njoftimin e saj tek i pandehuri. Referuar Kodit të Procedurës Penale, i pandehuri gjatë hetimit paraprak nuk ka mundësi konkrete të ankimojë më vete aktin e njoftimit të akuzës në gjykatë.

Gjithsesi me ndryshimet e reja të Kodit të Procedurës Penale të hyra në fuqi më datë 1 gusht 2017 është parashikuar seanca paraprake, ku në prani të gjyqtarit të kësaj seance i pandehuri ka mundësi reale për të kundërshtuar akuzën që prokurori i ka njoftuar atij përpara se çështja penale të dërgohet për gjykim në themel. Kujtojmë se seanca paraprake do të trajtohet më poshtë.

Kodi i Procedurës Penale përpara ndryshime të kryera me Ligjin nr. 35/2017 nuk i njihte mundësinë të pandehurit për të ankimuar akuzën e ngritur ndaj tij prej prokurorisë menjëherë pasi atij i ishte njoftuar akuza.

³⁰ Neni 60 paragrafi 1 i Kodit të Procedurës Penale të Italisë

³¹ Neni 424 paragrafi 1 në lidhje me nenin 429 të Kodit të Procedurës Penale të Italisë

Të drejtën për të kundërshtuar akuzën për të gjitha elementet përbërës të saj, i pandehuri mund ta ushtrojë jo vetëm në seancë paraprake por edhe gjatë gjykimit të çështjes së tij penale përpara gjykatës. Në gjykim në funksion të garantimit të një mbrojtje efektive i pandehuri mund të kundërshtojë akuzën e tij si përsa i përket shkakut ashtu dhe në lidhje me natyrën e akuzës.

Cilësia e të pandehurit ndjek disa rregulla procedurale që janë të parashikuara në paragrafët dy dhe tre të nenit 34 të Kodit të Procedurës Penale³². Cilësia e të pandehurit ruhet deri në përfundim të procedimit penal, që do të thotë deri në kohën kur vendimi i pushimit, vendimi i pafajësisë ose vendimi i dënimit të ketë marrë formë të prerë. Me dhënien e vendimit të pafajësisë apo të pushimit të çështjes penale, i pandehuri rifiton çdo të drejtë të humbur apo të kufizuar për shkak të procedimit penal të nisur, ndërsa me vendimin e dënimit ai konsiderohet i dënuar.

Nga ana tjetër, cilësia e të pandehurit rimerret në rastin kur prishet vendimi i pushimit ose kur vendoset rishqyrtimi i procesit nga Gjykata e Lartë.

2.2.4. Akuza dhe gjendja e arrestit

Kodi i Procedurës Penale parashikon dy raste të përgjithshme të kufizimit të lirisë vetjake të personit që lidhet me gjendjen e arrestit të tij. Rasti i parë është dhe rasti i zakonshëm i vendosjes së një personi në gjendje arresti mbi bazën e një vendimi gjyqësor i ndikuar nga kërkesa e paraqitur prej prokurorit për caktimin e masës së sigurimit arrest në burg/shtëpi.

Rasti i dytë lidhet me një situatë jo të zakonshme të kufizimit të lirisë vetjake të personit e diktuar nga disa rrethana që lidhen me urgjencën e kryerjes së këtij veprimi. Në këtë rast policia gjyqësore arreston në flagrancë ose ndalon mbi bazën e një urdhri të prokurorisë personin që dyshohet se ka kryer ose është në kryerje e sipër të një vepre penale.

Më poshtë do shtjellojmë lidhjen që ekziston ndërmjet veprimit të njoftimit të akuzës me gjendjen e arrestit të personit nën hetim, të përcaktuar me vendimin e gjykatës apo në rastet përjashtimor me veprimin e policisë gjyqësore.

Referuar rastit të parë një procedim penal fillon në përgjithësi me regjistrimin e veprës penale si dhe regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale në regjistrin e veprave penale që administron prokuroria. Gjatë fazës së hetimit bazuar në të dhënat e grumbulluara, nëse prokuroria arrin në përfundimin se ekziston dyshimi i arsyeshëm i mbështetur në prova se personi nën hetim duhet të vendoset nën një masë sigurimi për shkak të personalitetit të të hetuarit, për shkak të natyrës së hetimit në funksion të mbledhjes së provave atëherë prokuroria i paraqet gjykatës kërkesën për caktimin e masës së sigurimit ndaj të hetuarit.

Kërkesa e prokurorit për caktimin e masës së sigurimit zhvillohet vetëm me praninë e prokurorit. Masa e sigurimit arrest në burg ose arrest në shtëpi pas caktimit nga ana e gjykatës ekzekutohet nga oficeri i policisë gjyqësore. Brenda tri ditëve nga zbatimi i masës së sigurimit të

³² “2. Cilësia e të pandehurit ruhet në çdo gjendje dhe shkallë të procesit derisa të ketë marrë formë të prerë vendimi i pushimit, i pafajësisë ose i dënimit. 3. Cilësia e të pandehurit rimerret kur prishet vendimi i pushimit ose kur vendoset rishqyrtimi i procesit.”

arrestit në burg ose arrestit në shtëpi³³, gjykata merr në pyetje personin për të cilin ka vendosur këtë masë sigurimi.

Procedura e mësipërme pasqyron situatën e zakonshme procedurale në të cilin nis dhe vazhdon procedimi penal prej prokurorisë. Deri në këtë gjendje procedimi, personi në hetim ndaj të cilit është caktuar edhe një masë sigurimi me vendim gjykate ende nuk ka marrë cilësinë e të pandehurit, pasi siç e përmendëm edhe më lart cilësinë e të pandehurit personi nën hetim e merr vetëm nga prokuroria me njoftimin e akuzës. Vendimi i gjykatës për caktimin e masës së sigurimit në përmbajtjen e tij duhet të parashtrijë në mënyrë të përmbledhur rrethanat e faktit duke treguar edhe dispozitat e ligjit penal që gjykata i konsideron të shkelura prej personit nën hetim si dhe parashtrimin e shkaqeve të posaçme e të të dhënave që përlligjin masën e sigurimit.

Gjithsesi vendimi i gjykatës për caktimin e masës së sigurimit nuk zëvendëson aktin e njoftimi të akuzës. Me vendimin për caktimin e masës së sigurimit personi nën hetim vendoset nën një masë sigurimi në funksion të hetimit të nisur dhe me këtë vendim personi nën hetim nuk merr cilësinë e të pandehurit. Vendimi mbi caktimin e masës evidenton rrethanat e faktit në funksion të dyshimit të arsyeshëm dhe rëndësinë e masës së sigurimit për nevoja të hetimit. Në vendimin e masës nuk gjejnë pasqyrim elementët e akuzës të cilat i përmendëm më lart që janë një vlerësim i plotë i bërë nga prokuroria për veprimet kriminale të dyshuara të kryera nga i pandehuri dhe për dispozitat ligjore penale të cilat i përcaktojnë këto veprime kriminale si vepër penale.

Me këtë përfundim të arritur nuk duhet të themi se akti i njoftimit të akuzës nga prokurori është më i rëndësishëm se vendimi i gjykatës për caktimin e masës së sigurimit. Kur bëhet fjalë për lirinë vetjake të individit, vëmendja për garantimin e respektimin e kësaj të drejte është maksimale. Mjafton të vëmë në dukje faktin se Kodi i Procedurës Penale në fuqi, për herë të parë ka vendosur detyrimin se liria vetjake e individit mund të kufizohet vetëm me një vendim gjykate, duke u kuptuar rëndësia e madhe që i është kushtuar mbrojtjes së kësaj të drejte si një komponent i rëndësishëm i setit të lirive dhe të drejtave themelore të njeriut. Gjithsesi edhe në vendimin e gjykatës për caktimin e masës së sigurimit gjenden elementë fillestare të një akuze të cilat padyshim ndikojnë në hetimin e nisur e mund të jenë pjesë përbërëse e akuzës që prokurori do të hartojnë në vijim të hetimit.

Në ndryshim nga njoftimi i akuzës, kufizimi i lirisë së individit me një vendim gjyqësor shoqërohet me një proces gjyqësor me pjesëmarrjen e prokurorit dhe personit ndaj të cilit është kërkuar kufizimi i lirisë vetjake në prani të gjykatës që garanton ligjshmërinë e procesit gjyqësor. Pra vendimi i gjykatës për kufizimin e lirisë vetjake të individit që hartohet mbi bazën e një kërkesë të paraqitur më parë prej prokurorisë merr një rëndësi të madhe. Pa dashur të zbehim rëndësinë e vendimit të gjykatës për kufizimin e lirisë vetjake të individit, ky vendim nuk zëvendëson aktin e njoftimit të akuzës që prokurori i bën të pandehurit.

Pra mund të themi se sipas ligjit tonë procedural, akuza dhe vendimi për caktimin e masës së sigurimit ndaj një personi nën hetim nuk janë të ndërvarura nga njëra – tjetra përse i përket kohës

³³ Në ndryshimet e reja të Kodit të Procedurës Penale të tij hyrë në fuqi në datë 1 gusht 2017, në nenin 248/1 parashikohen rastet e marrjes në pyetje në gjykatë të personave të cilëve u është caktuar një masë sigurimi shtrenguese ose ndaluese e ndryshme nga ajo e arrestit. Afati marrjes në pyetje nga gjykata në këtë rast është pesë ditë.

së realizimit të tyre. Kjo do të thotë se akuza mund t'i njoftohet të pandehurit si përpara caktimit të masës së sigurimit personal ndaj tij, ashtu edhe pas caktimit të masës së sigurimit personal.

Deri tani kemi prezantuar rrugën e zakonshme që ndjek një procedim penal i regjistruar në regjistrin e veprave penale në prokurori kundër një personi dhe kërkesën që paraqet prokurori në gjykatë për kufizimin e lirisë vetjake të individit (kërkesa për caktimin e masës së sigurimit arrest në burg ose arrest në shtëpi). Kemi thënë gjithashtu se vendimi i gjykatës për caktimin e masës së sigurimit arrest në burg apo arrest në shtëpi nuk qëndron e lidhur me cilësinë e personit ndaj të cilit caktohet kjo masë siguri, nëse ai është i pandehur apo person nën hetim. Në këtë rast vendimi i gjykatës për caktimin e masës së sigurimit nuk zëvendëson aktin e njoftimit të akuzës.

Ajo se çfarë mund të vërë pak në dyshim konkluzionin e mësipërm është përcaktimi ligjor i shprehur në nenin 249 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale³⁴. Në bazë të kësaj dispozite brenda 10 ditëve nga zbatimi ose njoftimi i vendimit të gjykatës për masën e sigurimit, prokurori ose i pandehuri mund të bëjnë ankim në gjykatën më të lartë. Sipas këtij formulimi mund të arrihet në një përfundim paraprak, gjithsesi jo ai i duhuri, se për sa kohë neni 249 paragrafi 1 i K.Pr.Penale i njeh të drejtën vetëm të pandehurit (jo personit nën hetim) të ankimojë vendimin e gjykatës për caktimin e masës së sigurimit, do të thotë se masa e sigurimit nuk mund të caktohet përpara njoftimit të akuzës që prokurori duhet t'i bëjë të pandehurit.

E përmendëm edhe më lart që një përfundim i tillë nuk është i drejtë. Përdorimi i fjalës “i pandehur” në nenin 249 paragrafi 1 të K.Pr.Penale që bën fjalë për të drejtën e të arrestuarit për të ankimuar masën e sigurimit të vendosur nga gjykata e shkallës së parë, lidhet me faktin se ky person mund të jetë i tillë. Pra dhe ndaj të pandehurit kur atij zyrtarisht i është njoftuar më parë akuza prej prokurorisë mund të caktohet një masë siguri prej gjykatës dhe ky konstatim është i vërtetë pasi nuk ndalohet nga asnjë dispozitë procedurale, por nga ana tjetër e kundërta nuk mund të jetë e vërtetë³⁵.

Nuk ekziston asnjë dispozitë procedurale që të përcaktojë lidhjen me kushtin *sine qua non* të caktimit të masës së sigurimit nga gjykata vetëm me cilësinë të pandehurit që duhet të ketë personi ndaj të cilit caktohet masa e sigurimit. Madje nenet 245 paragrafi 1 pika a) dhe 246 paragrafi 1 të K.Pr.Penale³⁶, që parashikojnë në mënyrë specifike procedurën e caktimit të masës së siguri dhe zbatimit të masës së sigurimit i referohen si term procedural “personit ndaj të cilit është marrë masa e sigurimit” dhe jo termi “të pandehur”.

Nga përmbajtja e këtyre dispozitave të përmendura më lart, rezultojnë qartësisht i shprehur qëllimi dhe vullneti i ligjvënësit sipas të cilit masat e sigurimit mund të merren ndaj çdo personi

³⁴ “1. Brenda dhjetë ditëve nga zbatimi ose njoftimi i vendimit të gjykatës, në bazë të të cilit është marrë ose është refuzuar një masë siguri, prokurori, i pandehuri ose mbrojtësi i tij mund të bëjnë ankim në gjykatën më të lartë.”

³⁵ Vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 3 datë 27.09.2002.

³⁶ Neni 245 paragrafi 1 pika a) të K.Pr.Penale parashikon: “1. Vendimi që cakton masën e sigurimit përmban: a) gjeneralitetet e personit ndaj të cilit merret masa ose çdo gjë tjetër që vlen për t'a identifikuar atë dhe, kur është e mundur, tregimin e vendit ku ndodhet.”

Neni 246 paragrafi 1 i Kodit të Procedurës Penale parashikon: “1. Oficeri ose agjenti i policisë i ngarkuar me zbatimin e vendimit të arrestit i dorëzon personit ndaj të cilit është marrë masa, kopjen e vendimit dhe i bën të njohur të drejtën që të zgjedhë një mbrojtës, njofton menjëherë mbrojtjen e zgjedhur nga i pandehuri ose të caktuar kryesisht dhe mban procesverbal për të gjitha veprimet e kryera. Procesverbali i dërgohet gjykatës që ka dhënë vendimin dhe prokurorit.”

që plotëson kushtet për të qenë subjekt i një veprë penale. Nëse i përmbahemi vetëm terminologjisë të përdorur në nenin 249 paragrafi 1 të K.Pr.Penale, atëherë duhet t'i referohemi terminologjisë së përdorur në përgjithësi në Kodin e Procedurës Penale për subjektet e veprave penale.

Terminologjia e përdorur në Kod për subjektet e veprave penale ndryshon nga fillimi i çështjes penale e deri në dërgimin e saj për gjykim. Emërtimi i autorit të veprës penale fillon me termin “*person të cilit i atribuohet vepra penale*”, parashikuar nga neni 287 të K.Pr. Penale. Më pas gjejmë termin “*person ndaj të cilit zhvillohen hetimet*” respektivisht në nenet 293 paragrafi 1 të K.Pr.Penale, 295 paragrafi 1 të K.Pr.Penale, 296 paragrafët 1 e 2, nenin 302 të K.Pr.Penale, nenin 303 paragrafi 2 pika “b” dhe “d” të K.Pr.Penale , nenin 308 të K.Pr.Penale. Në Kod gjejmë edhe termin e zakonshëm “i pandehur” që e hasim në shumë dispozita ligjore.

Autori i mundshëm i veprës penale këto emërtime i merr në faza të ndryshme të procedimit penal, kjo në varësi të gjendjes dhe shkallës së procedimit penal. Këto emërtime nuk përfaqësojnë të njëjtën cilësi për autorin e veprës penale si dhe nuk kanë të njëjtin kuptim. Të gjitha emërtimet e përmendura më lart janë interpretuar nga Gjykata e Lartë në vendimin e saj unifikues nr. 3 datë 27.09.2002.

Shkurtimisht në përmbajtjen e këtij vendimi të rëndësishëm gjejmë përcaktimin e drejtë ligjor të termave “*person të cilit i atribuohet vepra penale*”, “*person ndaj të cilit zhvillohen hetimet*”, “*person i marrë me cilësinë e të pandehurit*”.

Sipas këtij vendimi termi “*person të cilit i atribuohet vepra penale*” i referohet momentit të parë kur prokuroria shënon në regjistrin e veprave penale emrin e personit për të cilin njoftohet se mund të ketë kryer veprën penale. Regjistrimi prej prokurorisë i emrit të personit që i atribuohet vepra penale mund të ndodh për shkak të njoftimit që mund të marrë prokuroria prej kallëzimit të depozituar nga kallëzuesi i veprës penale apo për shkak të njoftimeve që mund të marrë prokuroria prej burimeve të tjera ligjore që mund të jenë informacioni për referimin e veprës penale të sjellë nga policia gjyqësore që vepron në Drejtoritë e Policive të Qarqeve në vendin tonë, njoftimi që mund të marrë prokuroria nga media e shkruar ose ajo elektronike etj.

Termi “*person të cilit i atribuohet vepra penale*” lidhur me momentin procedural në të cilin ai përdoret, i përket fazës fillestare të procedimit penal të nisur nga prokuroria. Pra në fillesat e hetimit kur prokuroria ka regjistruar procedimin penal dhe për këtë procedim ajo ka një emër personi konkret, atëherë ky person merr cilësinë ligjore të “*personit të cilit i atribuohet vepra penale*”. Emri i personit të cilit i atribuohet vepra penale shënohet në regjistrin e veprave penale, vetëm në ato raste kur për veprën penale të kryer, prokuroria njoftohet nga burimet e ndryshme ligjore edhe për emrin e personit që mund të jetë i lidhur me kryerjen e kësaj veprë penale.

Kjo nuk do të thotë me siguri se personi të cilit i atribuohet vepra penale është vërtet autor i veprës penale të kryer. Për të arritur në një përfundim të drejtë mbi përfshirjen apo përjashtimin e personit të cilit i atribuohet vepra penale prokurorisë do t'i duhet të nis dhe të përfundojë një hetim të plotë e të gjithanshëm në përputhje me rregullat e parashikuara për këtë qëllim nga Kodi i Procedurës Penale.

Me fillimin e hetimeve nga prokuroria në drejtim të ekzistencës së veprës penale dhe të lidhjes së mundshme të personit të cilit i atribuohet vepra penale me veprën penale konkrete për të cilën ka nisur hetimi, kuptohet se e gjitha kjo sjell dhe ndryshimin e pozitës procedurale të autorit të mundshëm të veprës penale. Tashmë autori i mundshëm i veprës penale ndaj të cilit kanë nisur hetimet, merr pozitën e “*personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet*” ose thënë me thjeshtë, ai është “*person nën hetim*”. Personi ndaj të cilit zhvillohen hetimet është një figurë e përkohshme procedurale që qëndron ndërmjet asaj që Kodi i Procedurës Penale e quan “*person të cilit i atribuohet vepra penale*” dhe “*të pandehurit*”.

Personi ndaj të cilit zhvillohen hetimet është figura më e zakonshme e fazës së hetimit paraprak dhe ndoshta është figura me kohëzgjatjen më të madhe të kësaj gjendjeje përgjatë hetimit paraprak. Personi ndaj të cilit zhvillohen hetimet gëzon të gjitha të drejtat që ligji i njeh të pandehurit. Ai në çdo veprim procedural që mund të kryhet ndaj tij, mund të përfaqësohet nga mbrojtësi i zgjedhur e në pamundësi të tij, nga një mbrojtës të caktuar kryesisht prej organit procedurës. Ky person nuk është i detyruar të jap deklarime në fazën e hetimit paraprak, ka të drejtë të njihet me faktin penal për të cilin ka nisur procedimi dhe me burimet prej të cilave ka rrjedhur fakti penal nëse një gjë e tillë nuk i dëmton hetimet. Gjithashtu mund të paraqesë prova në hetim për të lehtësuar pozitën e tij procedurale në raport me veprën penale për të cilën po hetohet apo prova të cilat e përjashtojnë atë nga përgjegjësia penale.

Përveç të drejtave të përmendura më lart, personi ndaj të cilit zhvillohen hetimet mbart dhe disa detyrime, ku më i rëndësishmi është ai i caktimit të masës së sigurimit nëse ndaj tij ekzistojnë indicie të forta fajësie që e lidhin me veprën penale. Në ndryshim nga i pandehuri, personi ndaj të cilit zhvillohen hetimet nuk mund të jetë subjekt procedural gjatë shqyrtimit gjyqësor të një çështje penale themeli përpara gjykatës, pasi këtë të drejtë e ka vetëm i pandehuri.

Me dërgimin e çështjes penale të themelit në gjyq, personi ndaj të cilit zhvillohen hetimet e humbet këtë cilësi, pasi ai zëvendësohet me figurën e “*të pandehurit*” që është në një pozitë procedurale më të avancuar dhe më të qëndrueshme e pandryshueshme në gjendje dhe shkallë të procesit penal, deri sa të ketë marrë formë të prerë vendimi penal i pushimit, i pafajësisë apo i dënimit.

Duke përmbledhur sa u tha me lart, arrijmë në përfundimin se figura procedurale e autorit të mundshëm të veprës penale që nga momenti i njoftimit të saj tek prokurori e deri në momentin e përfundimit të hetimeve (neni 327 i K.Pr.Penale) evoluon nga “*person të cilit i atribuohet vepra penale*” në “*person ndaj të cilit zhvillohen hetime*” dhe së fundi në “*i pandehur*”, pavarësisht se çështja pushohet (neni 328 i K.Pr.Penale) apo dërgohet për gjykim (neni 331 i K.Pr.Penale).

Si rregull statusi i të pandehurit merret në përfundim të hetimeve përpara se të depozitohet fashikulli i gjykimit, por ky status mund të merret edhe me përpara. Ky vlerësim është në çmimin e prokurorit. Veprimin e njoftimit të akuzës prokurori mund ta bëjë në çdo fazë të hetimit deri në përfundimin e tyre. Këtë veprim prokurori e kryen vetëm pasi të ketë siguruar të dhënat e

mjaftueshme (neni 34 paragrafi 1 i K. Pr. Penale)³⁷, të cilat lidhen me elementët thelbësorë të akuzës që janë shkaku dhe natyra e saj.

2.2.5. Akuza dhe arrestimi nga policia gjyqësore

Rasti i dytë lidhet me një rrugë jo të zakonshme të kufizimit të lirisë vetjake të personit. Në një kapitull të veçantë të Kodit të Procedurës Penale janë bërë përcaktime të plota dhe të hollësishme për kufizimin e lirisë vetjake të individit në rastet urgjente (rastet e jashtëzakonshme) që janë arresti në flagrancë dhe ndalimi i personit. Në bazë të dispozitave të Kodit, që të kryhet arrestimi në flagrancë kërkohet të ekzistojnë kushtet e përgjithshme e të veçanta, të shoqëruara këto dhe me kriteret për caktimin e masave të sigurimit, të ekzistojë gjendja e flagrancës si dhe të jetë duke u kryer një vepër penale nga ato të parashikuara në neni 251 të K.Pr.Penale³⁸.

Pra në Kod janë parashikuar gjithsej dy raste të jashtëzakonshme të kufizimit të lirisë vetjake të individit.

Në nenin 252 të K.Pr.Penale është dhënë përkufizimi i flagrancës në të cilën është përcaktuar se *“është në gjendje flagrante ai që është kapur në kryeje e sipër të veprës penale ose ai që menjëherë pas kryerjes së veprës penale ndiqet nga policia gjyqësore, personi i dëmtuar ose persona të tjerë, ose që është kapur me sende apo prova materiale nga të cilat duket se e ka kryer veprën penale.”*

Në nenin 253 të K.Pr.Penale janë të përcaktuara kushtet që duhet të ekzistojnë mbi ndalimin e një personi që dyshohet se ka kryer një krim. Referuar kësaj dispozite prokurori mund të urdhërojë ndalimin e të dyshuarit për një vepër penale që dënohet me burgim jo më pak se katër vjet kur ka shkaqe të bazuara për të dyshuar se ka rrezik ikjeje, pra t’i fshihet hetimit.

Sipas këtyre dispozitave një personi mund t’i kufizohet liria e tij vetjake nga oficeri i policisë gjyqësore (jo nga gjykata) vetëm në rastet e përcaktuara shprehimisht në ligj. Kufizimi i lirisë vetjake nga policia gjyqësore në këtë rast shoqërohet edhe me disa garanci të tjera që favorizojnë personin e arrestuar.

Më konkretisht në bazë të nenit 256 të K.Pr.Penale, i arrestuari merret menjëherë në pyetje në prani të mbrojtësit të zgjedhur apo të caktuar kryesisht. Gjatë pyetjes i arrestuari ose i ndaluar i njoftohet për faktin për të cilin procedohet dhe mbi arsyet e marrjes në pyetje duke i treguar të dhënat e nevojshme në ngarkim të tij. Kur hetimeve nuk u shkaktohen dëme, të arrestuarit i tregohen edhe burimet prej nga rrjedhin edhe këto të dhëna. Të gjitha këto veprime për të cilat oficeri i policisë gjyqësore është i detyruar t’i kryejë përbëjnë elementet fillestare të një akuze.

Bazuar në nenin 258 të K.Pr.Penale brenda afatit prej 48 orëve nga arrestimi apo ndalimi, i arrestuari duhet të dërgohet përpara gjykates. Mos respektimi i këtij afati nga prokuroria bën që arrestimi apo ndalimi të humbasë fuqinë e tij dhe personi të lirohet nga gjendja e arrestit. Brenda 48 orëve nga paraqitja e kërkesës së prokurorit për vleftësimin e arrestit ose të ndalimit, gjykata

³⁷ Vendim unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 3 datë 27.09.2002

³⁸ Islami H., Hoxha A., Panda I., “Komentar i Kodit të Procedurës Penale” Tiranë 2010, ribotim, faqe 355

shqyrton në seancë gjyqësore në prani të prokurorit të të arrestuarit dhe mbrojtësit të tij, kërkesën për vleftësimin e arrestit apo ndalimit. Pra kufizimi i jashtëzakonshëm i lirisë vetjake të personit në kushtet e flagrancës apo ndalimit, i nënshtrohet një kontrolli gjyqësor ku të ndaluarit i ofrohet mundësia që në prani të mbrojtësit të tij të mund të deklarojë përpara gjykatës rrethanat e arrestimit të tij.

Edhe në këtë rast për zgjidhje mund të shtrohet pyetja: A është e detyrueshme marrja më parë me cilësinë e të pandehurit të personit që është arrestuar në flagrancë apo është ndaluar nga policia gjyqësore për shkak të një urdhri ndalimi të nxjerrë nga prokurori?

Pa asnjë mëdyshje mund të themi se kur personit i është kufizuar liria vetjake në formën e ndalimit apo arrestimit në flagrancë si edhe në rastin e përmendur më lart, kur ndaj tij është caktuar masa e sigurimit personal, prokuroria nuk është e detyruar ligjërisht që para vendosjes së këtyre masave t'i njoftojë personit të arrestuar akuzën duke e marrë atë me cilësinë e të pandehurit.

Siç e përmendëm më lart në rastin e flagrancës apo të ndalimit, bazuar në nenin 256 të K.Pr.Penale, prokurori duhet të marrë menjëherë në pyetje personin e arrestuar apo të ndaluar për t'i njoftuar ndër të tjera faktin penal për të cilin po procedohet si dhe arsyet e marrjes në pyetje, duke i treguar të dhënat në ngarkim të tij. Kryerja e këtij veprimi nga prokurori është e detyrueshme në çdo rast që personit i kufizohet liria vetjake për shkak flagrancë apo ndalimi.

Marrja në pyetje e personit të arrestuar apo të ndaluar nga prokurori nuk do të thotë se ai nëpërmjet këtij veprimi e ka marrë të arrestuarin me cilësinë e të pandehurit. Edhe në këtë rast marrja në pyetje e të arrestuarit apo ndaluarit prej prokurorit, nuk njehsohet dhe nuk zëvendëson veprimin procedural të njoftimit të akuzës që prokuroria e realizon në përputhje me nenin 34 të Kodit të Procedurës Penale. Veprimi që kryen prokurori me marrjen në pyetje të të arrestuarit nuk është i njëjtë me veprimin e njoftimit të akuzës. Madje marrja në pyetje e personit të arrestuar sipas nenit 256 të K.Pr.Penale realizohet pas ekzekutimit të urdhrin të ndalimit apo arrestimit në flagrancë.

Megjithatë në këtë rast elementët thelbësorë të akuzës i bëhen të ditur personit nën hetim nga prokurori gjatë marrjes në pyetje.

Kështu përpara marrjes në pyetje prokurori ka detyrimin ligjor që personit të arrestuar/ndaluar t'i njoftojë shkakun për të cilin atij i është kufizuar liria vetjake, duke treguar thelbin e akuzës (jo akuzën e plotë dhe zyrtare) që përbëhet nga njoftimi mbi faktin penal për të cilin ka nisur procedimi penal, të dhënat mbi të cilat ka lindur dyshimi i arsyeshëm i përfshirjes së të arrestuarit/ndaluarit me veprën penale si dhe të dhëna të tjera të grumbulluara deri në atë fazë hetimit kundër tij. Këto veprime prokurori duhet t'i pasqyrojë në një procesverbal si pjesë e dokumentimit të veprimit procedural.

Veprimet e mësipërme prokurori i kryen kundrejt personit ndaj të cilit kanë nisur hetimet duke i kufizuar në të njëjtën kohë edhe lirinë vetjake të tij. Gjithsesi këto veprime pavarësisht se janë veprime që pasqyrojnë edhe elementet fillestare të një akuze të ardhshme, ato nuk duhet të konfundojnë me veprimin e njoftimit të akuzës. Deri në këtë fazë të hetimit prokurori nuk i ka dhënë cilësinë e të pandehurit personit të arrestuar duke proceduar me marrjen në pyetje të tij.

Prokurori nuk përpilon aktin e veçantë në formën e vendimit për njoftimin e akuzës siç e parashikon neni 34 i K.Pr.Penale. Parashikimet e nenit 256 të K.Pr.Penale nuk e urdhërojnë

prokurorin që në këtë fazë të procedimit penal të realizojë të drejtën e tij për të marrë si të pandehur personin e arrestuar ose të ndaluar.

Njoftimi i personit të ndaluar apo të arrestuar në flagrancë nga prokurori për shkaqet dhe kushtet e arrestimit/ndalimit, si dhe njoftimi mbi të dhënat që prokuroria disponon për dyshimin se ai mund të jetë autor i veprës penale realizohet në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet. Njoftimi përmban të dhëna të rëndësishme për procedimin penal që duhet t'i bëhen të ditur personit të arrestuar dhe që lidhen kryesisht me këto elemente:

- se ndaj tij ka nisur një procedim penal nga prokuroria,
- se procedimi penal ka filluar mbi bazën e një kallëzimit ose kryesisht nga organi procedues,
- se cila është përmbajtja në thelb e këtij kallëzimi nëse procedimi penal ka nisur mbi bazën e kallëzimit,
- se ai po hetohet për faktin penal përkatës të parashikuar si vepër penale nga dispozita konkret penale,
- se ai dyshohet se veprën penale e ka kryer në rrethanën cilësuese përkatëse nëse ky fakt nuk dëmton hetimin e mëtejshëm të procedimit penal,
- se ka të drejte të mbrohet me një mbrojtës të zgjedhur dhe në pamundësi të tij me një mbrojtës të caktuar kryesisht nga organi procedues.

Të gjitha elementet e përmendura më lart që janë pjesë e njoftimi të personit të ndaluar/arrestuar, përmbajnë thelbin e akuzës por jo akuzën zyrtare. Në ndryshim nga njoftimi i prokurorit, personit të ndaluar/arrestuar për thelbin e akuzës, akuza zyrtare është një akt procedural i veçantë i parashikuar shprehimisht në ligj mbi bazën e të cilit personi nën hetim merr cilësinë e të pandehurit. Në aktin e njoftimit të akuzës prokurori parashtron të dhënat e grumbulluara deri në atë fazë të hetimit paraprak të cilat janë të vlerësuara si të mjaftueshme nga prokuroria për të arritur në përfundimin e natyrës kriminale të veprimit të kryer prej të pandehurit. Njoftimi i akuzës të pandehurit është sinteza e përfundimit të hetimeve prej prokurorit, referuar të dhënave të grumbulluara prej saj përgjatë ushtrimit të ndjekjes penale.

2.3. Akuza dhe gjykimi i drejtpërdrejtë

Ashtu siç e përmendëm më lart, akuza në fazën e hetimit paraprak hartohet nga prokurori në fillim, në mes ose në fund të hetimeve. Akuza gjithmonë është në varësi të të dhënave të mbledhura gjatë hetimit. Hetimet paraprake si rregull zgjasin 3 (tre) muaj nga dita e regjistrimit të emrit të personit që i atribuohet vepra penale në regjistrin e veprave penale. Më tej ky afat mund të zgjatet për shkak të natyrës komplekse të hetimit. Pra gjatë kësaj kohe të parashikuar në ligj prokurori ka të gjithë hapësirën e nevojshme për të realizuar një hetim të plotë si dhe për të konkluduar në hartimin dhe njoftimin e akuzës të pandehurit kur është rasti i duhur.

Përpos këtij rregulli në Kodin e Procedurës Penale është parashikuar dhe rasti kur prokurori mund të paraqesë në gjykatë kërkesën për gjykimin e të pandehurit pa respektuar afatin 3 (tre) mujor të hetimit që do t'i duhet për të sqaruar një çështje penale të nisur si hetim. Në këto raste të cilat lidhen me gjykimet alternative, prokurorit do t'i duhet që për një kohë të shkurtër të kryej të gjitha hetimet e nevojshme si dhe të hartojë akuzën përkatëse ndaj të pandehurit.

Një rast i tillë është parashikuar nga neni 400 e vijues i Kodit të Procedurës Penale që bën fjalë

për *Gjykimin e Drejtpërdrejtë*. E vlerësoj si pjesë të trajtimit tim në këtë punim edhe gjykimin e drejtpërdrejtë në lidhje me akuzën për shkak të veçorive që paraqet në këtë rast akuza dhe momenti kohor i njoftimit të saj tek i pandehuri, ku ky i fundit e merr këtë cilësi edhe në gjykim, pra pasi të jetë sjellë kërkesa për gjykim nga prokurori.

Në Kodin e Procedurës Penale në një kapitull të veçantë të tij janë parashikuar gjykimet e posaçme ku përfshihen gjykimi i drejtpërdrejtë dhe gjykimi i shkurtuar. Me ndryshimet e reja në Kodin e Procedurës Penale hyrë në fuqi më datë 1 gusht 2017 janë parashikuar edhe dy raste të reja të gjykimeve alternative që janë *Kërkesa për miratimin e urdhrit penal* parashikuar nga neni 406/a e vijues i K.Pr.Penale dhe *Gjykimi me marrëveshje* parashikuar nga neni 406/d i K.Pr.Penale.

Siç e përmendëm edhe më lart në interes të këtij punimi është shtjellimi i gjyimit të drejtpërdrejtë për shkak të veçorive që paraqet akuza në këtë gjykim si dhe për shkak të faktit se trajtimi i gjyimit të drejtpërdrejtë në raport me akuzën do të ilustrohet edhe me raste të praktikës gjyësore. Ndërsa përsa kohë rastet e reja të gjykimeve alternative nuk janë shoqëruar me praktikë gjyqësore për shkak se këto gjykime të reja sapo kanë hyrë në fuqi, vlerësoj se trajtimi i tyre në këtë punim vetëm në këndvështrimin teorik nuk do të ishte i plotë dhe i nevojshëm.

Gjykimi i drejtpërdrejtë në ndryshim nga gjykimi i zakonshëm paraqet disa veçori të cilat e shndërrojnë atë në një proces alternativ gjykimi. Veçoritë e gjyimit të drejtpërdrejtë lidhen me ekonominë gjyqësore të të gjithë procedimit penal, reduktimin e afateve të hetimit, kohë e shkurtër midis momentit ku ka ndodhur vepra penale dhe dërgimit të kërkesës së prokurorit për gjykimin e të pandehurit.

Referuar karakteristikave që ofron gjykimi i drejtpërdrejtë mund të themi se ky lloj i posaçëm gjykimi zbatohet në dy raste tipike:

Së pari, në bazë të nenin 400 paragrafi 1 të K.Pr.Penale ky gjykim aplikohet në rastin kur i pandehuri është arrestuar në flagrancë e

Së dyti, në bazë të nenit 400 paragrafi 3 të K.Pr.Penale gjatë marrjes në pyetje i pandehuri pohon për veprën penale të kryer dhe fajësia e tij është e qartë. Në këtë rast i pandehuri thirret për t'u paraqitur për gjykim brenda 15 ditëve nga dita që është regjistruar procedimi penal në regjistrin e veprave penale³⁹.

Nëse ndodhemi përpara njëri prej këtyre rasteve, prokurori me shumë mundësi mund të kërkojë në gjykatë gjykimin e të pandehurit duke zgjedhur procedurën e gjyimit të drejtpërdrejtë. Pra në dy rastet e përmendura më lart vërejmë se është reduktuar në kohë procesi i hetimit të çështjes penale. Gjithsesi reduktimi i hetimit paraprak në procedurën e gjyimit të drejtpërdrejtë nuk duhet të çënojë funksionin kushtetues dhe procedural të prokurorit për ushtrimin e ndjekjes penale, bërjen e akuzës dhe përfaqësimin e akuzës në emër të shtetit në procesin gjyqësor. Nga ana tjetër ky lloj gjykimi nuk kufizon të drejtat që gëzon i pandehuri në një proces gjyqësor. Të pandehurit në gjykimin e drejtpërdrejtë i njihen dhe i garantohen të gjitha të drejtat e të pandehurit nëse ky i fundit gjykohet në ritin e gjyimit të zakonshëm.

Gjykimi i drejtpërdrejtë sjell përfitime procedurale për të gjithë subjektet pjesëmarrës në këtë lloj gjykimi. Ashtu siç e përmendëm edhe më lart, gjykimi i drejtpërdrejtë karakterizohet nga

³⁹Skënderaj Klodjan, "Gjykimet e posaçme dhe rëndësia e tyre në procesin penal", Disertacion "Për mbrojtjen e gradës shkencore Doktor" Tiranë 2014, faqe 9

ekonomia gjyqësore për shkak se reduktohet ndjeshëm afati i hetimeve paraprake. Reduktimi i këtij afati është në dobi edhe të të pandehurit, pasi atij nuk do t'i duhet të qëndrojë i lidhur me hetimin paraprak për një kohë të gjatë derisa çështja të shkojë për gjykim.

2.3.1. Nevoja e gjykimit të drejtpërdrejtë

Gjykimi i drejtpërdrejtë si institut i së drejtës procedurale penale ka marrë si model parashikimet e kodit italian të Procedurës Penale. Respektivisht në nenet 449 deri 452 të Kodit të Procedurës Penale Italiane parashikojnë gjykimin e drejtpërdrejtë si një rit alternativ gjykimi.

Gjykimi i drejtpërdrejtë është i nevojshëm për shkak të karakteristikave që ai paraqet. Afati i hetimit siç e përmendëm edhe më lart është i kufizuar, ku në rastin e flagrancës afati hetimor është 48 orë dhe në rastin e pohimit të të pandehurit kur fajësia e tij është e qartë ky afat është 15 ditë. Në gjykimin e drejtpërdrejtë nuk aplikohet rregulli mbi rastet e papajtueshmërisë së gjyqtarit për shkak të pjesëmarrjes së tij në gjykimin e themelit.

Madje në gjykimin e drejtpërdrejtë gjyqtari që shqyrton kërkesën për vleftësimin e arrestit në flagrancë është i detyruar të marrë në shqyrtim edhe kërkesën për gjykimin e drejtpërdrejtë dhe nëse kjo kërkesë është në përputhje me ligjin, i njëjti gjyqtar procedon më tej me gjykimin e themelit të çështjes.

Në gjykimin e drejtpërdrejtë bëhet shqyrtimi i njëkohshëm i kërkesave për caktimin e masës së sigurimit dhe i gjykimit në themel të çështjes penale, nëse arrestimi vleftësohet i ligjshëm dhe nuk ka nevojë për hetime të tjera.

Në gjykimin e drejtpërdrejtë nuk gjejnë zbatim rregullat që lidhen me disa veprime përgatitore që zbatohen në gjykimin e zakonshëm siç mund të jenë rastet kur palëve përpara fillimit të shqyrtimit gjyqësor u ofrohen disa të drejta që lidhen me shqyrtimin e fashikullit për gjykim si dhe marrjen e kopjeve për aktet procedurale, e drejta për të parë sendet e sekuestruara parashikuar nga neni 332 i Kodit të Procedurës Penale. Në gjykimin e drejtpërdrejtë gjykata nuk është e detyruar të zbatojë rregullin e parashikuar nga neni 333 të Kodit të Procedurës Penale përse i përket njoftimit të datës së caktuar për seancën e parë gjyqësore, pasi seanca gjyqësore për shqyrtimin e themelit të çështjes penale vazhdon menjëherë pasi gjykata ka marrë vendimin e saj për të procedural me ritin e gjykimit të drejtpërdrejtë.

Duke përmendur karakteristikat kryesore të gjykimit të drejtpërdrejtë, mund të themi edhe arsyen e nevojës së këtij gjykimi në praktikë. Kodi ynë penal parashikon disa vepra penale që për nga konstrukti i tyre ligjor nuk kërkojnë hetime të gjata dhe komplekse. Mund të përmendim rastin e veprës penale të *“Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe municionit”* parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal, *“Prodhim, mbajtje, blerje apo shitje pa leje e armëve të ftohta”* parashikuar nga neni 279 i Kodit Penal, *“Prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive”* parashikuar nga neni 280 i Kodit Penal, *“Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”* parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal etj.

Referuar veprave penale të përmendur më lart mund të themi se kur autori i tyre kapet dhe arrestohet në kushtet e flagrancës është plotësisht e mundur që brenda afatit prej 48 orësh prokuroria bashkë me kërkesën për vleftësimin e arrestit në flagrancë të kërkojë edhe gjykimin e drejtpërdrejtë të të pandehurit për këtë çështje penale. Për këto vepra penale hetimet nuk mund të jenë komplekse në përgjithësi. Prokurori mund të mjaftohet në hetim, me sekuestrimin e sendit të

kundërligjshëm (duke plotësuar edhe kushtet teknike për të qenë i tillë) i cili mbahet paligjshmërisht prej autorit, me përcaktimin e gjendjes së dehur të personit që po drejton një automjet, apo me përcaktimin e faktit penal të mospasjes së lejes së drejtimit nga personi që është kapur në flagrancë në drejtimin e një automjeti.

Në të gjitha këto raste hetimet janë të thjeshta dhe mjafton afati prej 48 orësh që prokurori të plotësojë të gjithë fashikullin hetimor për ta sjellë në gjykim të pandehurin së bashku edhe me kërkesën për vleftësimin e arrestit në flagrancë. Këto janë edhe arsyet pse në disa raste zbatimi në praktikë i gjykimit të drejtpërdrejtë është i rëndësishëm.

Më sipër kemi evidentuar edhe karakteristikat e gjykimit të drejtpërdrejtë për qëllime të përcaktimi të pozicionit që ka i pandehuri në këtë lloj gjykimi. Në gjykimin e drejtpërdrejtë hetimi është i reduktuar dhe duke u bazuar në të gjitha dispozitat procedurale që e parashikojnë gjykimin e drejtpërdrejtë si subjekt procedural përballë prokurorit rezultojnë të jetë i pandehuri. Sipas nenit 400 të K.Pr.Penale parashikohen kushtet që duhet të plotësojë kërkesa e prokurorit për të proceduar me gjykim të drejtpërdrejtë nga ana e gjykatës.

Në rastin e kërkesës për vleftësimin e arrestit në flagrancë, ajo se çfarë vihet në diskutim është mungesa ligjore e përcaktimit të akteve që duhet të përmbajë fashikulli i prokurorit kur ai paraqet në gjykatë kërkesë për vleftësimin e arrestit në flagrancë e njëkohësisht kërkesën për gjykimin e drejtpërdrejtë të të pandehurit, si dhe i pozitës procedurale që ka personi i arrestuar i sjellë për gjykim të drejtpërdrejtë.

I referohemi flagrancës pasi në rastin kur i pandehuri ka pohuar dhe fajësia e tij është e qartë, afati prej 15 ditëve i parashikuar në ligj është i mjaftueshëm për prokurorin që të plotësojë fashikullin për gjykim me të gjitha aktet procedurale që janë të nevojshme për dërgimin në gjykatë të një çështje penale. Ndërsa në situatën e flagrancës të cilës i bashkohet kërkesa për gjykimin e drejtpërdrejtë mund të lindin probleme ligjore të cilat lidhen me:

- Aktet procedurale që duhet të përmbajë fashikulli i prokurorit për gjykimin e drejtpërdrejtë kur kjo kërkesë shoqërohet edhe me kërkesën për vleftësimin e arrestit në flagrancë.
- Pozitën procedurale të personit të arrestuar në flagrancë që në të njëjtën kohë është sjellë për gjykim të drejtpërdrejtë nga prokuroria përpara gjykatës.
- Kërkesa për gjykimin e drejtpërdrejtë në raport me aktin e njoftimit të akuzës.

Në lidhje me aktet procedurale të fashikullit për gjykimin e drejtpërdrejtë mendojmë se në këtë situatë juridike të pa përcaktuar ligjërisht në Kod, fashikulli për gjykimin e drejtpërdrejtë në rastin e kërkesës për vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe kërkesës për gjykim, i sjellë nga prokurori, duhet të përmbajë të gjitha aktet që parashikohen nga neni 332 i K.Pr.Penale. Pavarësisht se ndodhemi përpara një situatë kur prokurori paraqet kërkesën për vleftësimin e arrestit në flagrancë, ai është i bindur në ekzistencën e veprës penale dhe të kryerjes së saj prej të arrestuarit, përse kohë prokurori së bashku me kërkesën për vleftësimin e arrestit në flagrancë, paraqet edhe kërkesën për gjykimin e drejtpërdrejtë (pa pasur nevojë për hetime të mëtejshme) të të pandehurit.

Në këto kushte kërkesa për gjykim të drejtpërdrejtë është e njehsuar me kërkesën për gjykim që prokurori sjell përpara gjykatës në rastet e zakonshme. Kështu që kërkesa për gjykim të drejtpërdrejtë kur i bashkëngjitet kërkesës për vleftësimin e arrestit në flagrancë, duhet të

shoqërohet me aktet procedurale si pjesë e fashikullit për gjykim të parashikuara në nenin 332 të K.Pr.Penale.

Përsa i përket pozitës procedurale të personit të arrestuar në flagrancë në raport me nenin 400 të K.Pr.Penale kujtojmë se vetë kjo dispozitë nuk bën fjalë për njoftimin akuzës, si një veprim që kryhet prej prokurorit në fazën e hetimit paraprak në një rast të zakonshëm hetimi për një çështje penale.

Vlen të theksojmë se nenet 400 deri 402 të K.Pr.Penale i referohen në të gjitha rastet, të pandehurit si subjekt procedural ndaj të cilit është paraqitur kërkesa për gjykimin e drejtpërdrejtë. Kjo do të thotë se prokuroria përpara se të paraqesë kërkesën për vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe njëkohësisht me të edhe kërkesën për gjykimin e drejtpërdrejtë, duhet të formulojë dhe t'i njoftojë të pandehurit akuzën përkatëse. Kjo në mënyrë që i pandehuri të ketë mundësi përpara gjykatës për të dhënë mendimin e tij i cili është i nevojshëm në vendimmarrjen e gjykatës. Pra ndërmjet momentit të arrestimit në flagrancë të të dyshuarit dhe momentit të paraqitjes së kërkesës së prokurorit në gjykatë, prokurori duhet t'i njoftojë akuzën të arrestuarit, me qëllim që në gjykim ai të marrë cilësinë e të pandehurit.

Pavarësisht kohës së shkurtër të hetimit paraprak që në këtë rast është vetëm 48 orë, personi i arrestuar brenda kësaj kohe merr të gjitha cilësitë procedurale të përcaktuara nga Kodi i Procedurës Penale dhe të interpretuara nga Vendimi Unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 3 datë 27.09.2002 të përmendur më sipër.

Në bazë të nenit 400 të K.Pr.Penale prokurori përpara se të paraqesë kërkesë për gjykimin e drejtpërdrejtë në gjykatë duhet t'i njoftojë akuzën të pandehurit në përputhje me nenin 34 të K.Pr.Penale.

Në këtë moment mund të lind pyetja, nëse prokurori harron t'i njoftojë akuzën të pandehurit dhe dërgon për gjykim kërkesën për vleftësimin e arrestit në flagrancë së bashku me kërkesën për gjykimin e drejtpërdrejtë, cili do të jetë fati i kësaj çështjeje penale në gjykim?

Në këtë rast gjykata është e detyruar t'i kthejë aktet prokurorit për plotësimin e mëtejshëm të hetimeve, pa ju referuar pëlqimit të palëve në proces. Siç edhe e kemi theksuar akti i njoftimit të akuzës prej prokurorit është një veprim formal i rëndësisë së veçantë të përcaktuar nga neni 34 i Kodit të Procedurës Penale. Njoftimi merr rëndësi për prokurorin por edhe për të pandehurin në të njëjtën kohë.

Vetëm nëpërmjet akuzës së njoftuar i pandehuri vihet në dijeni për veprimet me natyrë kriminale të kryera prej tij (sipas përfundimit të nxjerrë nga prokurori) si dhe për përcaktimin ligjor konkret të këtyre veprimeve si vepër penale. Në këtë mënyrë i pandehuri pasi është njoftuar për të gjitha elementet e akuzës, i garantohet e drejta për të realizuar një mbrojtje efektive.

Nga ana tjetër njoftimi i akuzës si një akt formal ka rëndësi edhe për gjykatën. Në gjykimin e një çështje penale themeli, përpara gjykatës duhet të paraqitet personi që ka cilësinë e të pandehurit. Gjykata nuk mund të gjykojë në një çështje penale themeli në person me "cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet". Në lidhje me rëndësinë e njoftimit të akuzës në fazën

e hetimit paraprak dhe cilësinë e domosdoshme të të pandehurit që duhet të ketë personi i sjellë për gjykim, është shprehur edhe Gjykata e Lartë në vendimin e saj nr. 5/ 2008⁴⁰, në të cilin për këtë moment ajo ka theksuar se:

*“...Lidhur me tre vendimet gjyqësore të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, që u paraqitën si praktikë e kundërt me qëndrimin e mbajtur nga Gjykata e shkallës së parë dhe e Apelit Tiranë në gjykimin e ankimeve të personit nën hetim L. B dhe të pandehurit A. T., kolegji penal konstatoi që si rrethana faktike, ashtu dhe situatat juridike në çështjen objekt gjykimi nga ky Kolegj janë të ndryshme. Kjo pasi nuk u konstatua që me kërkesat për gjykim në të tre çështjet penale, ishin për tu gjykuar persona të cilët kishin cilësinë e të pandehurit cilësi të cilën e kishin marrë me komunikimin rregullisht të akuzës në fazën e hetimeve paraprake, nga prokurori. Kjo cilësi sipas përmbajtjes së pikës 3 të nenit 34 të K.Pr.Penale ruhet në çdo gjendje dhe shkallë të procesit, derisa të ketë marrë formë të prerë vendimi i pushimit, i pafajësisë ose i dënimit. Kurse për shkaqet e parashtruara më lart personi nën hetim L. B nuk e ka pasur këtë cilësi që në fillim dhe gjatë gjithë procedimit penal...kjo është rrethanë juridike që sjell si pasojë me natyrë ndaluese – moslejimin e vazhdimit të procedimit penal në ngarkim të tij.
...Për rrjedhojë në përfundim ky kolegj vë në dukje se:*

Mangësitë e konstatuara në procedimin penal ndaj personit nën hetim L. B gjatë fazës së hetimeve paraprake tregojnë në fakt për një proces jo të rregullt ligjor të kryer nga Prokuroria, proces ky i cili vuri në lëvizje Gjykatën e Lartë në mënyrë formale dhe që përbën një formë të “aktivizimit gjyqësor”.

Pra akti i njoftimit të akuzës edhe në rastin e kërkesës për gjykim të drejtpërdrejtë është një veprim i domosdoshëm që duhet të kryhet nga prokuroria me pasojë të drejtpërdrejta për ecurinë e mëtejshme të kërkesës për gjykim të drejtpërdrejtë.

2.3.2. Kërkesa për gjykim të drejtpërdrejtë dhe akti i njoftimit të akuzës

Po t'i referohemi vetëm dispozitave mbi gjykimin e drejtpërdrejtë të shkëputura nga dispozitat e tjera të Kodit mund të themi se kërkesa për gjykim të drejtpërdrejtë edhe mund të zëvendësojë aktin e njoftimit të akuzës. Kërkesa për gjykim në përgjithësi dhe përmbajtja e akuzës janë dy akte procedurale që sipas Kodit të Procedurës Penale hartohen nga prokurori. Kërkesa për gjykim në vetvete pasqyron përmbledhjen e rezultateve të hetimit duke përfshirë në të edhe akuzën me të gjitha elementet përbërës të saj. Në këtë kuptim kërkesa për gjykim e hartuar nga prokurori dhe që i njoftohet të pandehurit përpara se ajo të dërgohet në gjykatë përfshin në përmbajtjen e saj domosdoshmërisht edhe elementet thelbësore të akuzës që i është njoftuar më parë të pandehurit në kohën e hartimit të akuzës.

Në këtë kuptim mendojmë se kërkesa për gjykim dhe akuza janë akte procedurale të hartuara nga prokurori të nevojshme për procesin penal duke plotësuar një qëllim të përbashkët që është njoftimi i të pandehurit për shkaqet dhe natyrën e akuzës së ngritur ndaj tij dhe lajmërimi i të pandehurit për të përgatitur mbrojtjen e tij për akuzën e ngritur përpara gjykatës.

⁴⁰ Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 5 datë 12. 12. 2008

Referuar Kodit të Procedurës Penale të Italisë i marrë si model për hartimin e Kodit tonë të Procedurës Penale, njoftimi i akuzës së të pandehurit realizohet në kërkesën për gjykim që prokurori i dërgon gjykatës, apo në urdhrin për thirrje në gjykimin e drejtpërdrejtë që i bëhet të pandehuri⁴¹. Cilësinë e të pandehurit, personi nën hetim e merr në këtë rast vetëm në përfundimin e hetimeve. Ndërkohë në gjykimin e drejtpërdrejtë (sipas nenit 450 paragrafi 4 të Kodit të Procedurës Penale të Italisë) në rastin e flagrancës, akuzat të pandehurit i komunikohet në urdhrin e nxjerrë për dërgimin e çështjes penale në gjykimin e drejtpërdrejtë që i bashkëngjitet kërkesës për vleftësimin e arrestit në flagrancë. Deri në zhvillimin e seancës gjyqësore për vleftësimin e masës së arrestit në flagrancë, të pandehurit i jepet koha e nevojshme për t'u njohur dhe përgatitur me akuzën që është pjesë e urdhrin të nxjerrë nga prokurori për dërgimin e çështjes penale për gjykim.

Pra referuar Kodit të Procedurës Penale të Italisë mund të themi se i pandehuri e merr këtë cilësi në përgjithësi në kërkesën për gjykim që prokurori i dërgon gjykatës dhe për rastin e gjykimit të drejtpërdrejtë (gjendje e flagrancës) i pandehuri e merr këtë cilësi në kërkesën për gjykim (dekretin për thirrje në gjyq) që i bashkëngjitet kërkesës për vleftësimin e arrestit në flagrancë. Në të gjitha rastet i pandehuri sipas këtij modeli e merr këtë cilësi vetëm në përfundimin e hetimeve paraprake të drejtuar nga prokurori.

Kështu që po t'i referohemi Kodit të Procedurës Penale të Italisë, konkludojmë se nuk bëhet fjalë për zëvendësim të aktit të akuzës me kërkesën për gjykim që paraqet prokurori në përfundim të hetimeve paraprake. Akuzat dhe kërkesa për gjykim, janë të njehsuara në një akt të vetëm procedural i cili hartohet nga prokurori vetëm në përfundim të hetimeve paraprak.

Po t'i referohemi Kodit tonë të Procedurës Penale, themi me siguri se njoftimi i akuzës dhe kërkesa për gjykim janë dy akte procedurale të cilat të paktën formalisht ndryshojnë nga njëra – tjetra. Akti i njoftimi të akuzës i bëhet të pandehurit nga prokurori në çdo kohë që përfshihet në fazën e hetimit paraprak, pra në fillim, në mes apo në fundin e hetimeve paraprake. Prokurori është i lirë për të njoftuar akuzën të pandehurit dhe nuk kufizohet nga faza në të cilën ndodhen hetimet paraprake. I vetmi kufizim për prokurorin është gjendja e procedimit mbi të cilin ai do t'i duhet të vendos për njoftimin e akuzës. E thënë më qartë për njoftimin e akuzës prokurori kufizohet vetëm mbi bazën e dhënave të grumbulluara përgjatë hetimit të cilat duhet të jenë të mjaftueshme në vlerësimin e prokurorit që ky i fundit të hartojë dhe njoftojë akuzën të pandehurit.

Akti i njoftimi të akuzës nuk mund të revokohet më pas nga ana e prokurorit. Cilësia e të pandehurit që merr një person nën hetim pas njoftimit të akuzës nuk humbet. Kjo cilësi ruhet më pas në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit deri në vendimin e formës së prerë të pushimit, pafajësisë ose dënimit. Pas këtij veprimi prokurori nëse konstaton të meta në formulimin e akuzës apo të meta në funksion të faktit penal, të cilat nuk janë përfshirë në akuzë, mundet vetëm të ndryshojë akuzën e paraqitur më parë ose ta plotësojë atë⁴². Pas njoftimit të akuzës zyrtare përballë prokurorit qëndron i pandehuri të cilit nga ky moment i krijohet mundësia për të përgatitur një mbrojtje efektive për akuzën që atij i atribuohet.

⁴¹ Neni 60 i Kodit të Procedurës Penale Italiane

⁴² Neni 34 paragrafi 1 i K.Pr.Penale parashikon se: “Kur pas marrjes së një personi si të pandehur dalin të dhëna të reja që ndryshojnë akuzën e paraqitur ose e plotësojnë atë, prokurori merr vendim, të cilin ia njofton të pandehurit”.

Për këto shkaqe vlerësojmë se modeli ynë në lidhje me akuzën është më elastik se modeli italian. Nga njëra anë prokurori nuk është i detyruar t'i njoftojë akuzën të pandehurit vetëm në përfundim të hetimeve ndërkohë nga ana tjetër i pandehuri mund ta marrë këtë cilësi pa qenë i detyruar të presë përfundimin e hetimeve paraprake, duke pasur me tepër kohë dhe mundësi për të filluar përgatitjen e mbrojtjes së tij në funksion të akuzës së njoftuar përpara se të përfundojnë hetimet paraprake.

Në modelin tonë të procedurës penale akti i njoftimit të akuzës qëndron më vete dhe nuk mund të zëvendësohet nga kërkesa për gjykim e cila formulohet vetëm në përfundim të hetimeve paraprake. Kështu që referuar pyetjes për këtë çështje themi se bazuar në dispozitat e Kodit tonë të Procedurës Penale, akti i njoftimit të akuzës nuk mund të zëvendësohet me kërkesën për gjykim të drejtpërdrejtë. Në rastin e flagrancës prokurori pasi të vlerësojë se personi i arrestuar nga policia gjyqësore është kapur në kushtet e flagrancës, përpara se ai të paraqesë në gjykatë kërkesën për vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe kërkesën për gjykimin e drejtpërdrejtë të të arrestuarit, do t'i duhet t'i njoftojë më parë të arrestuarit akuzën për veprën penale të kryer.

Pas njoftimit të akuzës, prokurori mund të procedojë më tej me kërkesën për vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë dhe gjykimin e drejtpërdrejt të të pandehurit.

2.4. Akuza në gjykimin e drejtpërdrejtë dhe ndryshimet e reja në Kodin e Procedurës Penale

Në ndryshimet e reja të Kodit të cilat do të hyjnë në fuqi në datën 1 gusht 2017 përfshihen edhe disa ndryshime që i janë bërë dispozitave procedurale për gjykimin e drejtpërdrejtë. Neni 400 i K.Pr.Penale që parashikonte rastet e gjykimit të drejtpërdrejtë ka ndryshuar duke i modifikuar rastet e këtij gjykimi.

Rasti i parë përcaktohet nga neni 400 paragrafi 1 i K.Pr.Penale e bën fjalë për paraqitjen nga prokurori të kërkesës për gjykim të drejtpërdrejtë kur i pandehuri është arrestuar në flagrancë dhe hetohet për kryerjen e një veprë penale e cila gjykohet nga një gjyqtar. Në këtë rast prokurori brenda 48 orëve nga dita e arrestimit të të pandehurit, paraqet në gjykatë kërkesën për vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë dhe kërkesën për gjykimin e drejtpërdrejtë të tij⁴³.

Ndryshimet e reja në këtë rast paraqesin një kusht i cili nuk është i parashikuar në dispozitën aktuale e cila do të ndryshohet. Më konkretisht ndryshimet e reja përcaktojnë se në rastin e flagrancës kur nuk ka nevojë për hetime të reja prokurori mund të paraqesë së bashku me kërkesën për vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë dhe kërkesën për gjykimin e drejtpërdrejtë me kushtin që vepra penale për të cilën është sjellë kërkesa për gjykim të drejtpërdrejtë të gjykohet nga një gjyqtar.

⁴³ Neni 400 paragrafi 1 i K.Pr.Penale të ndryshuar parashikon se: "1. Kur i pandehuri është arrestuar në flagrancë dhe hetohet për kryerjen e një veprë penale që gjykohet nga një gjyqtar, prokurori paraqet në gjykatë brenda dyzet e tetë orëve nga arrestimi, kërkesën për vleftësimin e tij dhe gjykimin e njëkohshëm, kur çmton se nuk ka nevojë për hetime të mëtejshme."

Pra në ndryshim nga dipozita procedurale ekzistuese e cila nuk e kufizonte bërjen e kërkesës për gjykim të drejtpërdrejtë me kompetencën funksionale të gjykatës që do ta shqyrtonte këtë kërkesë (numrin e gjyqtarëve që nevojiteshin për gjykimin e një çështje penale sipas nenit 13 të K.Pr.Penale) dispozitat e reja vendosin si kusht që na rastin e flagrancës prokurori paraqet edhe kërkesën për gjykim të drejtpërdrejtë, vetëm për veprat penale që gjykohen nga një gjyqtar, pra për veprat penale që me ndryshimet e reja parashikojnë një dënim me burgim në maksimum deri në 10 vjet. Nëse një person është arrestuar në flagrancë pasi dyshohet se ai ka kryer një vepër penale që parashikon një dënim me burgim në maksimum më të madh se 10 vjet, p.sh për rastin e vrasjes me paramendim, vepër penale e cila gjykohet me një trup gjykues prej 3 gjyqtarësh, prokurori si rregull do të depozitojë në gjykatë kërkesën për vleftësimin e arrestit në flagrancë, por nuk mund të paraqesë edhe kërkesën për gjykim të drejtpërdrejtë.

Në ndryshimet e reja mbi nenin 400 paragrafi 1 të K.Pr.Penale është ruajtur cilësia e të pandehurit, ndaj të cilit prokurori në gjykatë paraqet kërkesën për vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë dhe kërkesën për gjykimin e drejtpërdrejtë të tij për veprën penale që është sjellë për gjykim. Kjo do të thotë se përpara se të nis gjykimi i drejtpërdrejtë, përballë gjyqtarit që do të gjykojë çështjen, si subjekte të tjera procedurale do të jenë prokurori dhe i pandehuri. Pra prokuroria normalisht duhet t'i njoftojë akuzën përkatëse të pandehurit përpara se të nis shqyrtimi në themel i çështjes.

Njoftimi i akuzës të pandehurit përpara se të fillojë gjykimi në themel është rregulluar nga neni 402 paragrafi 1/1 i K.Pr.Penale i ndryshuar. Sipas kësaj me ndryshimet e reja rezultojnë në seancë gjyqësore të shqyrtimit të kërkesës për vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë dhe të kërkesës për gjykim të drejtpërdrejtë sipas nenit 400 paragrafi 1 të K.Pr.Penale të ndryshuar, prokurori mund t'i komunikojë të pandehurit akuzën në seancë gjyqësore përpara gjyqtarit të vetëm që do të shqyrtojë dy kërkesat e prokurorit⁴⁴. Pra vetëm në situatën kur ndodhemi përpara kushteve të flagrancës ligji i jep mundësi prokurorit që përpara gjyqtarit të vetëm, të paraqesë si kërkesat për vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë dhe të gjyqimit të drejtpërdrejtë të personit ndaj të cilit kërkohet vleftësimi i ligjshëm i arrestit në flagrancë por në të njëjtën seancë gjyqësore prokurori ka mundësi që t'i komunikojë të pandehurit edhe akuzën zyrtare për veprën penale që ai e ka sjellë për gjykim.

Referuar këtyre ndryshimeve mund të nxjerrim disa përfundime të cilat në përgjithësi konfirmojnë përfundimet e parashtruara më sipër për gjykimin e drejtpërdrejtë.

Së pari me ndryshimet e reja Kodi ynë i Procedurës Penale vazhdon të ruaj traditën në modelin e përzgjedhur prej tij, sipas të cilit kërkesa për gjykim (në rastin konkret kërkesa për gjykimin e drejtpërdrejtë) dhe akuza janë akte të ndryshme procedurale të cilat nuk zëvendësojnë njëra – tjetrën. Edhe në një situatë kur hetimi mund të përfundojë brenda afatit prej 48 orësh, pra një hetim shumë i reduktuar, prokurori është i detyruar që përpara se të filloj shqyrtimi i kërkesës së tij për gjykim të drejtpërdrejtë, ai duhet t'i njoftojë të pandehurit akuzën përkatëse për veprën penale.

⁴⁴ Në nenin 402 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme: Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje: “1/1. Viktima dhe dëshmitarët njoftohen nga policia gjyqësore edhe me gojë. Në rastin e parashikuar nga paragrafi 1, i nenit 400, prokurori mund t'ia komunikojë akuzën të arrestuarit në seancë gjyqësore.”

Është e vërtetë që elementet e akuzës gjenden në kërkesën për gjykimin e drejtpërdrejtë me pasojë pavlefshmërie në rast mospërfshirjeje të këtyre elementeve⁴⁵, por gjithsesi modeli ynë procedural kërkon që akuzat dhe kërkesa për gjykim të jenë dy akte të ndryshme procedurale, të cilat formalisht duhet të hartohen nga prokurori përpara fillimit të gjykimit.

Vërehet se për herë të parë në gjykimin e drejtpërdrejtë informimi me saktësi i të pandehurit mbi elementet thelbësore të akuzës, të cilat sipas nenin 401 paragrafi 2 të ndryshuar, i është dhënë rëndësia e duhur kushtetuese me qëllim njohjen prej të pandehurit të elementeve të akuzës. Mos përfshirja në urdhrin e prokurorit për njoftimin e të pandehurit për paraqitje në seancë gjyqësore edhe të elementëve thelbësore të akuzës që janë parashtrimi i faktit penal dhe rrethanave të tij (shkaku i akuzës), duke treguar dispozitat përkatëse të ligjit (natyra e akuzës)⁴⁶ e bën këtë urdhër të pavlefshëm.

Së dyti njoftimi i akuzës të arrestuarit, në rastin e parashikuar nga neni 400 paragrafi 1 i K.Pr.Penale mund të bëhet dhe në seancë gjyqësore përpara fillimit të gjykimit të çështjes me ritin e gjykimit të drejtpërdrejtë. Fillimisht më duhet të vlerësoj teknikën e përdorur në hartimin e kësaj dispozite pasi është përcaktuar qartë dhe saktë cilësia e personit nën hetim, si i arrestuar përpara se atij t'i njoftohet akuzat. Sipas teknikës së përdorur prokurori mund t'i komunikojë të arrestuarit akuzën në seancë gjyqësore.

Nëpërmjet këtij arsytimi arrijmë në përfundimin se prokurori mund t'i komunikojë akuzën të arrestuarit në seancën e vleftësimit të arrestit në flagrancë pa kaluar më pas në pjesën e shqyrtimit të kërkesës së dytë mbi pranimin e gjykimit të drejtpërdrejtë. Gjithashtu për sa kohë kjo dispozitë procedurale nuk parashikon shprehimisht formën e komunikimit të akuzës në seancë prej prokurorit, mendojmë se si forma e shkruar ashtu edhe ajo verbale e komunikimit të akuzës janë të pranueshme për t'u realizuar nga prokurori.

Forma e shkruar e njoftimit të akuzës në seancë gjyqësore është forma më pak e diskutueshme për shkak se prokurori ruan praktikën e tij të njoftimit të akuzës e cila në fazën e hetimeve paraprake bëhet me shkrim. Në gjykim prokurori mund të paraqesë në formë të shkruar akuzën ndaj të pandehurit, të cilën e depoziton në fashikullin e sjellë për gjykim, duke i dhënë mundësi të pandehurit të njihet në seancë gjyqësore me elementët e akuzës.

Edhe forma verbale e njoftimit të akuzës në seancën e vleftësimit të arrestit në flagrancë, në vlerësimin tim është një formë e lejueshme që nuk çënon të drejtën e të pandehurit për t'u informuar plotësisht për akuzën e ngritur ndaj tij. Forma verbale e njoftimit të akuzës bëhet pjesë e procesverbalit të seancës gjyqësore që mbahet për këtë qëllim dhe kopja e këtij procesverbali i vihet në dispozicion të pandehurit.

⁴⁵ Në nenin 401 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme: Pikat 1 dhe 2 ndryshohen si më poshtë:

"1. Kur procedon me gjykim të drejtpërdrejtë, prokurori urdhëron paraqitjen në seancë të të pandehurit të arrestuar në flagrancë ose nën masën e sigurimit të parashikuar nga nenet 237, 238 ose 239, të këtij Kodi. Kur i pandehuri është i lirë, afati për t'u paraqitur nuk mund të jetë më i shkurtër se tri ditë."

2. Urdhri përmban, me pasojë pavlefshmërie, të dhënat e parashikuara në shkronjat "a", "b" dhe "c", të nenit 332/e, si dhe caktimin e vendit, datës dhe orës për t'u paraqitur, me paralajmërimin se nëse i pandehuri nuk paraqitet, do të shoqërohet me detyrim, si dhe datën e nënshkrimit e prokurorit."

⁴⁶ Shiko nenin 332/e pika "c" i ndryshimeve në Kodin e Procedurës Penale që do të hyjnë në fuqi më datë 1 gusht 2017

Forma verbale e njoftimit të akuzës në praktikë është e zbatueshme në rastin e aplikimit të akuzave të reja në procesin penal. Kjo formë e njoftimit të akuzës në seancë gjyqësore i nënshtrohet kontrollit gjyqësor dhe në kapitullin mbi akuzat e reja në procesin penal do të ofrojmë shembuj nga praktika gjyqësore të cilat kanë konfirmuar vlefshmërinë e përdorimit të formës verbale të njoftimit të akuzave të reja në procesin penal. Edhe në këtë rast mendoj se ndryshimet e reja ruajnë praktikën e konsoliduar të njoftimit të akuzës në seancë gjyqësore prej prokurorit edhe verbalisht.

Si rregull duhet të pranojmë se referuar nenit 400 paragrafi 1 të K.Pr.Penale (të ndryshuar), prokurori njoftimin e akuzës duhet ta realizojë brenda afatit prej 48 orësh, përpara se ai të paraqesë në gjykatë kërkesat për vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë dhe gjykimin e drejtpërdrejtë të çështjes. Vetëm në rast se natyra e çështjes mund të jetë disi komplekse dhe afati prej 48 orësh mund të rezultojë i pamjaftueshëm për prokurorin, atëhere ndryshimet e reja lejojnë opsionin e njoftimit të akuzës në seancë gjyqësore.

Rasti i dytë i paraqitjes së kërkesës për gjykim të drejtpërdrejtë është parashikuar në nenin 400 paragrafi 3 të K.Pr.Penale (të ndryshuar). Në rastin e dytë gjykimi i drejtpërdrejtë lejohet në situatat kur të pandehurit pasi i është vleftësuar i ligjshëm arresti në flagrancë dhe i është caktuar njëra prej masave të sigurimit që janë “Arresti në burg”, “Arresti në shtëpi” ose “Shtrimi i përkohshëm në spitalin psikiatrik”, brenda afatit 30 ditor nga dita e arrestimit prokurori vlerëson se nuk ka nevojë për hetime të tjera. Për këtë qëllim prokurori pasi ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore duke përfshirë në këtë rast edhe njoftimin e akuzës, paraqet në gjykatë kërkesën për gjykimin e drejtpërdrejtë⁴⁷.

Në situatën e dytë prokurori i njofton të pandehurit akuzën gjatë hetimeve paraprake të cilat nuk duhet të zgjasin më shumë se 30 ditë nga arrestimi i të pandehurit. Njoftimi i akuzës të pandehurit i bëhet me shkrim duke ndjekur praktikën e zakonshme të njoftimit të akteve procedurale nga prokurori tek i pandehurit gjatë hetimit paraprak.

2.4.1. Refuzimi i kërkesës për gjykim të drejtpërdrejtë dhe pozita procedurale e personit të sjellë për gjykim

Kërkesa për gjykim të drejtpërdrejtë që shoqëron kërkesën për vleftësimin e arrestit në flagrancë, jo detyrimisht pranohet nga gjykata për të proceduar më tej me ritin e gjykimit alternativ. Neni 400 paragrafi 2 i K.Pr.Penale parashikon të drejtën e gjykatës për të refuzuar kërkesën për gjykim të drejtpërdrejtë në dy raste.

Rasti i parë lidhet me vleftësimin e paligjshëm të arrestit në flagrancë dhe rasti i dytë lidhet me nevojën për të kryer hetime të mëtejshme.

Gjykata mund të vleftësojë të paligjshëm arrestin në flagrancë të kryer nga policia gjyqësore në rastet kur arrestimi i personit të dyshuar nuk është realizuar në kushtet e flagrancës. Praktika

⁴⁷ Pika 3 ndryshohet si më poshtë: “3. Kur i pandehuri është arrestuar në flagrancë dhe ai vleftësohet i ligjshëm, si dhe kur gjykata vendos njëzën nga masat e sigurimit të parashikuara nga nenet 237, 238 ose 239, të Kodit, prokurori paraqet në gjykatë kërkesë për gjykimin e drejtpërdrejtë, jo më vonë se tridhjetë ditë nga data e arrestimit, me përjashtim të rastit kur duhet të kryhen hetime të mëtejshme.

gjqësore na ofron mundësinë për t'u njohur me rastet kur gjykata vleftëson si të paligjshëm arrestimin në flagrancë të kryer nga policia gjqësore. Për ilustrim po japim një shembull.

Gjykata e Shkallës së Parë “Për Krimet e Rënda” Tiranë, me vendimin nr. 62/2014⁴⁸, për vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit ka parashtruar si më poshtë vijon:

“Arrestimi i shtetasit H. M është kryer nga policia gjqësore e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm duke vlerësuar se i hetuari ishte në kushtet e flagrancës.

Gjykata çmon se policia gjqësore nuk duhet të kryente arrestimin pasi i hetuari H. M nuk ka qenë në kushtet e flagrancës. Bazuar në nenin 252 të Kodit të Procedurës Penale⁴⁹ i hetuari H. M nuk është kapur në flagrancës. Ai nuk është kapur nga policia gjqësore në kryerje e sipër të krimit për të cilin po hetohet pasi ai nuk ka lidhje me rastin e arrestimit në flagrancë të shtetasit F. S më datë 13. 02. 2014. I dyshuari nuk ka qenë në ndjekje nga policia gjqësore menjëherë pas kryerjes së krimit si dhe nuk është kapur me sende të kundërligjshme. Rrjedhimisht arrestimi i të dyshuarit H. M. është kryer nga policia gjqësore në kundërshtim me ligjin.

Pra kur gjykata e vleftëson të paligjshëm arrestin në flagrancë, kërkesa për gjykimin e drejtpërdrejtë të të arrestuarit nuk pranohet për shqyrtim. Përjashtim nga ky rregull është rasti kur edhe pse gjykata ka refuzuar kërkesën e prokurorit për vleftësimin e flagrancës palët në proces (prokurori dhe i pandehuri) japin pëlqimin që gjykata të procedojë më tej me zhvillimin e gjykimit të drejtpërdrejtë⁵⁰. Me refuzimin e kërkesës për vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë rrjedhimisht refuzohet edhe kërkesa për gjykim të drejtpërdrejtë dhe aktet e sjella për gjykim i kthehen prokurorit.

Pas këtij vendimi të dhënë nga gjykata, prokurori është i detyruar të vazhdojë hetimet rreth veprës penale dhe autorit të mundshëm të saj.

Rasti i dytë i refuzimit të kërkesës për gjykim të drejtpërdrejtë lidhet me nevojën për hetime të mëtejshme për shkak se hetimet e përfunduara nuk kanë qenë të plota në vlerësimin e gjykatës, për shkak të mungesës të disa akteve të rëndësishme procedurale të cilat në bazë të nenit 332 të Kodit të Procedurës Penale duhet të jenë pjesë e fashikullit për gjykim.

Për ilustrim po japim një shembull.

Gjykata e Shkallës së Parë Sarandë me vendimin e saj nr. 84/2004⁵¹, për vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë dhe gjykimin e drejtpërdrejtë të shtetasit G. Ç ka parashtruar si më poshtë vijon:

⁴⁸ Vendim i Gjykatës së shkallës së parë Për Krimet e Rënda Tiranë me nr. 62 datë 15. 02. 2014

⁴⁹Neni 252 i K.Pr.Penale parashikon: “Është në gjendje flagrante ai që është kapur në kryerje e sipër të veprës penale ose ai që menjëherë pas kryerjes së veprës ndiqet nga poliëia gjqësore, nga i dëmtuari ose nga persona të tjerë ose që është kapur me sende dhe prova materiale, nga të cilat duket se ka kryer veprën penale.”

⁵⁰ Neni 400 paragrafi 2 i K.Pr.Penale

⁵¹ Vendim i Gjykatës së shkallës së parë Sarandë nr. 84 datë 18.04.2004

“Shtetasi G. Ç është arrestuar në flagrancë nga policia gjyqësore Saranda pasi ai është menjëherë pasi kishte vjedhur kasetofonin e një autoveture. Në momentin e arrestimit atij është gjetur dhe sekuestruar kasetofoni i vjedhur. Pas këqyrjes së automjetit ku rezultoi se dera e tij ishte e hapur dhe në të mungonte kasetofoni është pyetur personin nën hetim nga policia gjyqësore personi i arrestuar i cili pohoi se kasetofonin e automjetit e kishte për qëllime përfitimi pasi atij i duheshin para për të blerë lëndë narkotike sepse ishte përdorues i lëndëve narkotike.

Njëkohësisht policia gjyqësore kishte pyetur me cilësinë e personit që tregon rrethana të dobishme për veprën penale pronarin e automjetit prej të cilit ishte marrë kasetofoni nga i arrestuari. Pronari i automjetit deklaroi se kasetofoni i sekuestruar i përkiste automjetit të tij. Njëkohësisht ai deklaroi se të arrestuarin ai nuk e njohte personalisht dhe nuk ka pasur ndonjë konflikt të mëparshëm me të.

Gjykata vleftësoi të ligjshëm arrestin në flagrancë të kryer nga policia gjyqësore ndaj të arrestuarit G. Ç pasi ai është kapur nga policia gjyqësore në kryerje e sipër të veprës penale të vjedhjes parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal si dhe me sendet nga të cilat duket se ai e ka kryer veprën penale të vjedhjes, bazuar në nenin 252 të Kodit të Procedurës Penale.

Gjykata vlerëson se kërkesa e prokurorit për të proceduar me gjykim të drejtpërdrejtë në këtë nuk duhet të pranohet dhe aktet e sjella për gjykim duhet ti kthehen prokurorisë. Bazuar në nenin 400/2 të Kodit të Procedurës Penale gjykata nuk e pranon kërkesën për gjykim të drejtpërdrejtë edhe në rastin kur ajo vlerëson se hetimet nuk janë të plota. Në rastin në gjykim gjykata vlerëson se hetimet ndaj shtetasit G. Ç referuar akteve procedurale të sjella për gjykim nuk janë të plota.

Bazuar në nenin 331 dhe 332 të Kodit të Procedurës Penale në fashikullin për gjykim prokurori ndër të tjera duhet të përfshijë si akte procedurale aktin e njoftimit e akuzës, dokumentet që vërtetojnë identitetin e personit të sjellë për gjykim (certifikatën e lindjes) si dhe vërtetimin e gjendjes gjyqësore të të arrestuarit. Këto akte të përmendura më lart dhe që mungojnë në fashikullin për gjykim janë akte të rëndësishme. Këto akte duhet të jenë pjesë e fashikullit të gjykimit dhe si të tilla ato duhet të plotësohen nga prokurori gjatë fazës së hetimit.

Për mungesën e akteve procedurale të përmendura më lart gjykata refuzon kërkesën e prokurorit për të procedural me gjykim të drejtpërdrejtë.”

Refuzimi i kërkesës për gjykimin e drejtpërdrejtë të tij në dy rastet e përmendura më lart e kthen personin e arrestuar edhe një herë në fazën e hetimit paraprak. Kthimi i personit të arrestuar edhe njëherë për hetim me vendim gjykate, pas refuzimit të kërkesës për gjykimin e drejtpërdrejtë, nuk shoqërohet me ndryshimin e pozitës procedurale të të arrestuarit.

Personi i dërguar për gjykim të drejtpërdrejtë ka statusin e të pandehurit. Atij i njoftohet akuza nga prokurori përpara se të dërgohet për gjykim me procedurën e gjykimit të drejtpërdrejtë. Me kthimin e akteve edhe njëherë për hetim nga gjykata, personi i arrestuar vazhdon të ruaj cilësinë e të pandehurit. Hetimet e mëtejshme nga prokuroria do të kryhen ndaj tij me cilësinë e të pandehurit.

Pra në përgjigje të pyetjes së ngritur më sipër themi se në hipotezën e refuzimit të kërkesës për gjykim të drejtpërdrejtë, i pandehuri në hetimin e mëtejshëm nuk e humbet këtë cilësi. Ai

do të vazhdojë të ruaj statusin e të pandehurit deri në përfundimin e hetimeve paraprake dhe më tej në gjykim deri në dhënien e një vendimi të formës së prerë, pushimi, pafajësie apo dënimi.

Përpos këtyre dy rasteve të përmendura më lart në ndryshimet e reja në Kod në nenin 402 paragrafi 4 parashikohet mundësia e gjykatës për t'i kthyer aktet prokurorit nëse kërkesa për gjykimin e drejtpërdrejtë të sjellë prej tij në gjykatë nuk përfshihet në rastet e parashikuara nga neni 400 i këtij Kodi.

2.5. Kuptimi i ndryshimit dhe plotësimit të akuzës gjatë hetimeve paraprake

Më lart kemi prezantuar akuzën që i atribuohet të pandehurit nga prokurori në fazën e hetimit paraprak referuar nenit 34 të K.Pr.Penale aktualisht në fuqi. Kemi shpjeguar rëndësinë e madhe që kanë elementët përbërës të akuzës në momentin kur duhet t'i bëhen të ditur të pandehurit në momentin e njoftimit të saj. Njëkohësisht kemi shpjeguar vlerën e njoftimit të akuzës në fazën e hetimit paraprak në lidhje me cilësinë që merr i pandehuri pas këtij njoftimi, cilësi të cilën ai nuk e humb deri në përfundimin e plotë të procedimit penal të nisur ndaj tij.

Në këtë fazë pas njoftimit të akuzës prokurori nuk mund ta revokojë më akuzën. Në bazë të nenit 34 paragrafi 1 të K.Pr.Penale, prokurori mundet vetëm të ndryshojë akuzën ose ta plotësojë atë dhe pasi merr një vendim të tillë ai është i detyruar që këto ndryshime t'ia njoftojë të pandehurit në të njëjtën mënyrë siç ka njoftuar akuzën fillestare.

Pra referuar neni 34 paragrafi 1 të K.Pr.Penale paraqet interes për t'u ndalur e sqaruar kuptimi i termave mbi ndryshimin e akuzës dhe plotësimit të akuzës. Vlen të ndalemi në trajtimin e këtyre situatave për shkak se në kapitullin mbi akuzat e reja do të gjejmë të pranishme të njëjtat situata por të shoqëruara me disa elemente të tjerë plotësues që do ta vështirësonin punimin nëse nuk do të sqaroheshin rastet më të thjeshta, të ndryshimit dhe plotësimit të akuzës gjatë fazës së hetimit.

Ndryshimi i akuzës në fazën e hetimit paraprak është një veprim procedural që kryhet nga prokurori duke u bazuar në nenin 34 paragrafi 1 të K.Pr.Penale. Kur bëhet fjalë për ndryshimin e akuzës gjatë fazës së hetimit duhet të kuptojmë se bëhet fjalë për ndryshimin e elementeve përbërës të akuzës që mund të jenë shkaku ose natyra e saj. Themi se ndodhemi përpara ndryshimit të akuzës edhe në rastin kur ndryshojnë në të njëjtën kohë të dy elementët përbërës të akuzës, me kushtin e vetëm që fakti penal për të cilin ka nisur hetimi të jetë i njëjtë, ose të ketë lidhje logjike me faktin penal të cilit i referohet akuza e parë.

2.5.1. Ndryshimi i shkakt të akuzës

Shkaku i akuzës përbëhet nga elementët material të veprimit të kryer prej të pandehurit për të cilat ai është vënë nën akuzë. Kur i referohemi shkakt të akuzës duhet të kuptojmë veprimet konkrete të kryer prej të pandehurit në kohë dhe në një vend të përcaktuar, të cilat formojnë faktin ose faktet relevante të veprës penale. Shkaku i akuzës mund të ndryshojë gjatë fazës së hetimit nga momenti i njoftimit të akuzës së parë deri në momentin kur hetimet plotësohen me të dhëna të reja të grumbulluara të cilat pasqyrojnë veprimet e kryera prej të pandehurit, që janë të ndryshme nga veprimet e konstatuara prej prokurorisë në njoftimin e akuzës së parë.

Për ta konkretizuar ndryshimin e shkakut të akuzës po japim një shembull:

Personat A dhe B po hetohen nga prokuroria për kryerjen e veprës penale të “Vrasjes me dashje” kryer në bashkëpunim parashikuar nga nenet 76 – 25 të Kodit Penal. Gjatë hetimit paraprak në grumbullimin e të dhënave ndaj dy personave prokuroria i njofton secilit prej tyre akuzën e “Vrasjes me dashje” në bashkëpunim parashikuar nga neni 76 – 25 i Kodit Penal, në rolin e ekzekutorit për secilin prej të pandehurve për shkak se të dy të pandehurit kanë qëlluar drejtpërdrejtë me dy armë të ndryshme zjarri në drejtim të viktimës duke i shkaktuar vdekjen këtij të fundit.

Por më pas gjatë hetimeve me grumbullimin e të dhënave të reja ka rezultuar se shkak mbi të cilin është ngritur akuza e “Vrasjes me dashje” në bashkëpunim në rolin e ekzekutorit për të pandehurin B, ka ndryshuar. Më konkretisht mbi bazën e aktit të ekspertimit daktiloskopik të armëve të sekuestruar në vendin e ngjarjes për gjetjen e gjurmëve të gishtave në to ka rezultuar se në të dy armët e sekuestruara janë gjetur gjurmë të gishtave, vetëm të të pandehurit A.

Njëkohësisht nga procesverbali i këqyrjes së duarve të të dy të pandehurve të cilët u arrestuan nga policia gjyqësore menjëherë pas kryerjes së vrasjes ka rezultuar se vetëm në duart e të pandehurit A janë gjetur materiale që lidhen me faktorët plotësues të qitjes me armë zjarri, ndërsa nga duart e të pandehurit B nuk janë gjetur materiale të faktorëve plotësues të qitjes me armë zjarri. Nga akti i ekspertimit kriminalistik për faktorët plotësues të qitjes ka rezultuar se faktorët plotësues të gjetur në duart e të pandehurit A janë mbetje të elementit të antimoniumit që është element kimik që çlirohet gjatë procesit të qitjes me armë zjarri.

Njëkohësisht këto të dhëna të grumbulluara, konfirmojë deklaratimet e dhëna nga të pandehurit me cilësinë e personave ndaj të cilëve zhvillohen hetimet. Menjëherë pas arrestimit të tyre, ku të dy autorët në mënyrë të pavarur nga njëri – tjetri kanë deklaruar se drejt viktimës ka qëlluar me të dy armët e zjarrit vetëm personi A, të cilit i është bllokuar arma e parë e zjarrit pasi ai realizoi disa të shtëna dhe më pas personi A përdori armën e dytë të zjarrit duke vazhduar të qëllonte mbi viktimën. Gjatë kësaj kohe, personi B ndodhej së bashku me personin A në të njëjtin automjet të cilin po e drejtonte personi B. Pas kryerjes së vrasjes të dy të pandehurit u larguan me shpejtësi me automjetin që drejtohej nga personi B.

Prokuroria e ndodhur përpara këtyre të dhënave të reja bazuar në nenin 34 paragrafi 1 të Kodit të P.Pr.Penale ndryshon akuzën fillestare ndaj të pandehurit B duke akuzuar tashmë në bazë të të dhënave të reja për veprën penale të “Vrasjes me dashje” në bashkëpunim parashikuar nga neni 76 – 25 i Kodit Penal, në rolin e ndihmësit të të pandehurit A në këtë vrasje. Ndërkohë akuza për të pandehurin A mbetet e pandryshuar pasi ai është rolin e ekzekutorit në këtë veprë penale.

Në këtë rast themi se ndryshimi i shkakut të akuzës ndikoi në veprimin e mëtejshëm të prokurorit për të ndryshuar akuzën ndaj të pandehurit B nga roli i bashkë ekzekutorit që ai kishte në akuzën e parë në rolin e ndihmësit që ai mori në ndryshimin e akuzës.

2.5.2. Ndryshimi i natyrës së akuzës

Natyra e akuzës është elementi i dytë përbërës i akuzës së hartuar nga prokurori që duhet t'i njoftohet të pandehurit gjatë fazës së hetimit paraprak. Natyra e akuzës lidhet me karakteristikat ligjore që i jepet aktit apo veprimeve materiale konkrete të kryera prej të pandehurit. Pra me natyrën e akuzës duhet të kuptojmë cilësimin e drejtë ligjor që prokurori duhet t'i bëjë veprës penale të kryer nga i pandehuri. Do të kemi ndryshim të akuzës në funksion të ndryshimit të natyrës së veprës penale në ato raste kur shkak i akuzës mbetet i pandryshuar, por gjatë hetimit ndryshon cilësimi ligjor i veprës penale. Rasti i ndryshimit të natyrës së akuzës, si element thelbësor i saj është rast që evidentohet shpesh në praktikën hetimore si pjesë e praktikës gjyqësore.

Për ta konkretizuar po japim një shembull:

Duke ju referuar shembullit të dhënë më lart për ndryshimin e shkakut të akuzës e shtojmë kazusin me disa elementë të tjerë në funksion të evidentimit të ndryshimit të natyrës së akuzës.

Kështu pas njoftimit të akuzës së parë kundrejt dy të pandehurve për veprën penale të “Vrasjes me dashje” në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 76 – 25 të Kodit Penal, prokuroria në bazë të të dhënave të reja të grumbulluara gjatë hetimit evidentoi faktin se 5 ditë përpara kryerjes së vrasjes, viktimë së bashku me të pandehurin A janë konfliktuar në një Bar që ndodhet në qendër të qytetit të Tiranës. Në këtë konflikt viktimë e ka qëlluar të pandehurin disa herë në fytyrë dhe në pjesë të ndryshme të trupit me grushte. Pasi e kishte lënë të shtrirë në tokë personin A të pafuqishëm për të reaguar, viktimë është larguar i qetë nga lokali.

Ky fakt është përfutur në hetim nga prokurori nga një deklaram i dhënë prej vëllait të viktimës që ishte në dijeni të kësaj ngjarjeje si dhe është konfirmuar më pas me pamjet filmike të kamerave të sigurisë së lokalit ku ndodhi edhe përlëshja mes dy personave. Në pamjet filmike identifikohen qartë viktimë dhe i pandehuri A të cilët po grindeshin me njëri – tjetrin. Nga këto pamje filmike pasqyrohet qartë momenti kur viktimë ka qëlluar mbi të pandehurin disa herë në trupin dhe fytyrën e tij, duke e lënë të shtrirë në tokë.

Prokuroria pas këtyre të dhënave të reja të harmonizuara edhe me veprimin e ndjekjes dhe pritës me automjetin që të pandehurit i kishin bërë viktimës në ditën e ngjarjes, gjetjes së armëve të zjarrit për të realizuar vrasjen, konkludon se veprimet e të pandehurve nuk i përgjigjen në vazhdim elementeve të veprës penale të “Vrasjes me dashje” në bashkëpunim parashikuar nga nenet 76 – 25 të Kodit Penal, por i përgjigjen elementëve juridike të veprës penale të “Vrasjes me paramendim” në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 78/2 – 25 të Kodit Penal.

Në këtë rast ka ndryshuar natyra e akuzës si element thelbësor i saj, pasi veprimi i vrasjes së viktimës nga të pandehurit A dhe B në bashkëpunim me njëri tjetrin, nuk përputhen me elementët esencial të veprës penale të “Vrasjes me dashje” parashikuar nga nenet 76 – 25 të Kodit Penal. Këto veprime të të pandehurve të cilat janë të motivuara nga ndjenja e hakmarrjes që kishte i pandehuri A për poshtërimin që viktimë i kishte bërë atij në një mjedis të hapur për publikun, shoqëruar dhe me përgatitjen dhe pritën që të pandehurit i kishin ngritur viktimës duke e ndjekur atë me qëllimin e vetëm për ta varurë, përputhen me elementet esencial të veprës penale të “Vrasjes me paramendim” në bashkëpunim parashikuar nga nenet 78/2 – 25 të Kodit Penal.

Në këtë rast prokurori bazuar në nenin 34 paragrafi 1 të K.Pr.Penale duhet të procedojë me veprimin e ndryshimit të akuzës ndaj dy të pandehurve që lidhet me veprën e re penale, të “Vrasjes me paramendim” në bashkëpunim për shkak të ndryshimit të natyrës së akuzës si element përbërës i thelbit të akuzës. Ndryshimi i akuzës i cili duhet të bëhet me vendim të prokurorit duhet t’i njoftohet me shkrim të dy të pandehurve njësoj siç është vepruar prej prokurorit në rastin e njoftimit të akuzës së parë.

2.5.3. Ndryshimi i shkakut dhe i natyrës së akuzës në të njëjtën kohë

Në praktikë mund të ndodh që prokuroria mund të ndryshojë në të njëjtën kohë shkakun dhe natyrën e akuzës. Ndryshimi i të dy elementëve të akuzës në të njëjtën kohë sjell edhe ndryshimin e akuzës në tërësi në kuptim të nenin 34 paragrafi 1 të K.Pr.Penale. Në këtë rast prokurori duhet t’i njoftojë të pandehurit të akuzuar më parë prej tij për një vepër penale, ndryshimet e reja në akuzë. Akuza e ndryshuar në të dy elementet e saj zëvendëson akuzën e parë të ngritur nga prokurori ndaj të pandehurit.

Ndodhemi përpara rastit të ndryshimit në të njëjtën kohë të shkakut e natyrës së akuzës, kur i pandehuri fillimisht është akuzuar nga prokuroria për veprën penale të “Shfrytëzimit të prostitucionit” parashikuar nga neni 114/1 i Kodit Penal, në formën e shtyrjes për ushtrim prostitucioni dhe më pas gjatë hetimit ka rezultuar se i pandehuri ka konsumuar veprën penale të “Trafikimit të personave të rritur”, parashikuar nga neni 110/a – 2 të Kodit Penal, pasi i pandehuri nuk është kufizuar vetëm me veprimin e shtytjes për prostitucion.

Ai ka kryer edhe disa veprime të tjera ndaj të dëmtuarës, duke e rekrutuar atë më parë sesa ta shtynte për të prostituuar. Rekrutimin i pandehuri e kishte realizuar nëpërmjet mashtrimit të saj me qëllim shfrytëzimin e saj si prostitutë. Të gjitha këto elementë që lidhen me rekrutimin, mashtrimin e të dëmtuarës dhe shfrytëzimin e saj si prostitutë kanë ndryshuar në vetvete shkakun e akuzës të cilin prokuroria e kishte evidentuar më parë në komunikimin e akuzës fillestare.

Shkaku fillestar i akuzës ishte shtytja e të dëmtuarës në drejtim të ushtrimit të prostitucionit prej saj. Më pas nga hetimi rezultoi se i pandehuri nuk është mjaftuar me shtytjen e të dëmtuarës në ushtrimin e prostitucionit por veprimi i shtytjes ka qenë një pjesë e veprimeve komplekse të realizuara nga i pandehuri që lidhen me rekrutimin e të dëmtuarës, mashtrimin e saj si pjesë e rekrutimit dhe shfrytëzimin e saj si prostitutë. Pra shkaku fillestar i akuzës ka ndryshuar në vijim të hetimeve, nga shtytje për prostitucion në rekrutimin nëpërmjet mashtrimit me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit të të dëmtuarës.

Ndryshimi i shkakut të akuzës ka sjellë ndryshimin në të njëjtën kohë të natyrës së akuzës duke bërë që vepra penale e “Shfrytëzimit të prostitucionit” parashikuar nga neni 114 paragrafi 1 i K.Penal, të ndryshojë më pas në veprën penale të “Trafikimit të personave të rritur” parashikuar nga neni 110/a – 2 i K.Penal, për shkak se karakteristikat ligjore të veprimeve materiale të kryera prej të pandehurit përputhen me natyrën e re të veprës penale të “Trafikimit të personave të rritur”.

Me ndryshimin e të dy elementeve të akuzës ndryshon në tërësi edhe vetë akuza fillestare. Në këtë rast prokurori duhet t’i njoftojë të pandehurit ndryshimin e akuzës, nga ajo e

“Shfrytëzimit të prostitucionit” parashikuar nga neni 114 paragrafi 1 i K.Penal, në akuzën e re të ndryshuar, të “Trafikimit të personave të rritur” parashikuar nga neni 110/a – 2 i K.Penal.

Akuza e re e ndryshuar zëvendëson akuzën e parë të formuluar prej prokurorit. I pandehuri në këtë rast do të duhet të përgatis mbrojtjen e tij për akuzën e re të ndryshuar, në lidhje me veprën penale të “Trafikimit të personave të rritur” parashikuar nga neni 110/a – 2 i K.Penal.

Pra ndodhemi përpara ndryshimit të akuzës edhe në rastet kur gjatë hetimit për shkak të të dhënave të grumbulluara ndryshojnë në të njëjtën kohë elementet e shkakut dhe natyrës së akuzës.

2.5.4. Plotësimi i akuzës gjatë hetimeve paraprake

Në fazën e hetimit paraprak prokurori ka mundësinë të plotësojë akuzën e ngritur më parë ndaj të pandehurit kur përgjatë hetimit grumbullohen të dhëna të reja të cilat lidhen me ekzistencën e rrethanave rëndësuese që nuk janë komunikuar më parë të pandehurit në akuzë, apo me të dhëna në funksion të elementeve të një fakti të ri penal që nuk është përmendur në akuzën e parë. Në këtë mënyrë prokurori gjatë fazës së hetimit nëse grumbullon këto të dhëna të reja, ka të drejtë të plotësojë akuzën për të pandehurin, duke ja komunikuar rrethanën rënduese apo faktin e ri penal në të njëjtën mënyrë siç ka njoftuar më parë akuzën fillestare.

Plotësimi i akuzës nuk lidhet me ndryshimin e elementëve thelbësorë të akuzës së parë që janë shkak dhe natyra e akuzës. Në plotësimin e akuzës shkak dhe natyra e akuzës së parë të ngritur nga prokurori mbeten të pandryshuara.

Në funksion të të dhënave të reja shtesë të grumbulluara në hetim, akuza e parë plotësohet në kuptimin që asaj mund t’i bashkëngjiten rrethanat e reja rënduese apo një fakt penal që mund të jetë i ri ose mund të ketë lidhje me akuzën e parë. Tashmë me plotësimin e akuzës, pjesë e akuzës së parë bëhet jo vetëm fakti i parë penal për të cilin është ngritur edhe akuza e parë por në bazë të të dhënave të reja të dala gjatë hetimeve, akuza e parë plotësohet me rrethanën e re rënduese ose me faktin penal për të cilat prokuroria ka administruar tashmë të dhëna të mjaftueshme për plotësimin e akuzës.

Pra siç e përmendëm edhe më lart, do të ndodhemi përpara situatës juridike të plotësimit të akuzës në rastet kur të dhënat e reja të ofruara nga hetimi nuk ndryshojnë shkakun apo natyrën e akuzës, por ato plotësojnë akuzën duke ju shtuar asaj në formën e rrethanave rënduese apo të faktit të ri penal.

2.5.5. Plotësimi i akuzës me rrethanën rënduese

Themi se rrethana e re rënduese e evidentuar gjatë fazës së hetimit pas njoftimit të akuzës, përbën shkak që prokurori në bazë të nenin 34 paragrafi 1 të K.Pr.Penale të plotësojë akuzën duke shtuar si pjesë të saj dhe rrethanën rënduese të pa njoftuar më parë në akuzë. Rrethana e re rënduese është pjesë e plotësimit të akuzës dhe jo pjesë e ndryshimit të saj, për shkak se rrethana e re rënduese nuk prek e nuk ndryshon as shkakun e as natyrën e akuzës së ngritur më parë ndaj të pandehurit. Rrethana e re rënduese i bashkohet akuzës së parë.

Rrethanat rënduese janë parashikuar në nenin 50 të K.Penal. Në përgjithësi rrethanat rënduese janë elementë përbërës të individualizimit të dënimit të autorit të veprës penale. Individualizimi i dënimit është një institut i së drejtës penale i cili gjen pasqyrim në nenin 47 të Kodit Penal⁵². Në caktimit e dënimit për autorin e veprës penale përfshihet si element përbërës i dënimit dhe evidentimi i rrethanave rënduese kur vepra penale është kryer në prani të këtyre rrethanave.

Me rrethana rënduese nënkuptohen ato rrethana të cilat ndikojnë që dënimi të jetë më i rreptë (më i rëndë) brenda kufijve të parashikuar në ligj për veprën penale të kryer prej autorit të saj⁵³. Rrethanat rënduese kur nuk janë pjesë përbërëse e veprës penale konkrete të kryer nga autori i saj, por kanë qenë të pranishme në momentin e kryerjes së veprës penale prej autorit të saj, duhet t'i njoftohen të pandehurit si pjesë përbërëse e elementëve të akuzës. Kjo për shkak se rrethanat rënduese ashpërsojnë dënimin e autorit dhe si rrjedhim të pandehurit duhet t'i bëhet e ditur në mënyrë të hollësishme rrethana rënduese e përfutur gjatë hetimit, me qëllim që ai të realizojë mbrojtjen e tij efektive edhe për rrethanën rënduese të atribuar.

Rrethanat rënduese siç e përmendëm edhe më lart nuk janë pjesë e konstruktit të veprës penale. Rrethanat rënduese qëndrojnë më vete dhe janë të pavarura nga vepra penale. Ato bëhen pjesë e matjes (caktimit) të dënimit nëse janë të pranishme dhe shoqërojnë veprën penale të kryer prej autorit të saj.

Rrethanat rënduese duke ju referuar nenit 50 të K.Penal mund të kategorizohen si rrethana rënduese objektive që kanë lidhje me veprën penale të kryer prej autorit dhe rrethana rënduese subjektive që kanë lidhje me autorin e veprës penale⁵⁴.

Si rrethanë rënduese objektive mund të përmendim rrethanën rënduese të parashikuar nga neni 50 pika i) të Kodit Penal ku citohet se: *“kur vepra është kryer duke përdorur armë, municione luftarake, lëndë plasëse, djegëse, helmuese dhe radioaktive”*.

Si rrethanë rënduese subjektive mund të përmendim rrethanën rënduese të parashikuar nga neni 50 pika ë) të Kodit Penal ku citohet se: *“Kryerja e veprës penale me egërsi dhe mizori”*.

I përmendëm rrethanat rënduese në funksion të trajtimit të elementëve të plotësimit të akuzës për shkak se rrethanat rënduese shtojnë rrezikshmërinë e veprës penale dhe të autorit të saj kur ato janë të pranishme në kohën e kryerjes së veprës penale. Për sa kohë rrethanat rënduese ashpërsojnë dënimin e autorit të veprës penale, ato duhet t'i bëhen të ditura të pandehurit në momentin e njoftimit të akuzës. Nëse ato janë përfutur më vonë si rrethana pasi është njoftuar akuza e parë kundrejt të pandehurit, atëherë akuza duhet të plotësohet me rrethanën rënduese dhe t'i njoftohet të pandehurit në kohën kur këto rrethana rënduese janë zbuluar përgjatë hetimit nga prokurori.

⁵² Neni 47 i Kodit Penal parashikon: *“Gjykata cakton dënimin duke respektuar dispozitat e pjesës së përgjithshme të këtij Kodi dhe kufijtë e dënimeve të parashikuar në ligj për veprën penale. Në caktimin e dënimit ndaj personit ajo merr parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese.”*

⁵³ Dr. Salihu Ismet., “E drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme”, Prishtinë, tetor 2014, faqe 496

⁵⁴ Prof. Dr. Kaçupi Skënder., “E drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme”, “Cikël leksionesh, Universiteti Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë”, Viti Akademik 1995 – 1996

2.5.6. Plotësimi i akuzës për një fakt të ri penal

Gjatë hetimeve paraprake mund të ndodh që pasi të pandehurit t'i jetë njoftuar akuza e parë për kryerjen e një veprë penale, të dalin të dhëna të reja që e përfshijnë të pandehurin në kryerjen e një ose disa veprave të tjera penale të cilat nuk kanë qenë të ditura prej prokurorit në kohën e njoftimit të akuzës së parë. Pra gjatë hetimit prokuroria evidenton si fakt kryerjen prej të pandehurit të dy ose më shumë veprave penale. Kur prokuroria ka arritur të identifikojë veprat penale të kryera përpara njoftimit të akuzës, atëherë ajo pasi ka grumbulluar të dhënat e mjaftueshme për të gjitha veprat penale ndaj të pandehurit i njofton akuzën të pandehurit duke përfshirë në përmbajtje të akuzës të gjitha veprat penale të dyshuara si të kryera nga i pandehuri.

Ky është rregulli i përgjithshëm që ndjek prokurori në njoftimin e akuzës për të pandehurin kur ky i fundit dyshohet se ka kryer disa vepra penale për të cilat ka nisur hetimi.

Gjatë hetimeve mund të ndodh që ndaj të pandehurit fillimisht prokuroria i ka njoftuar atij akuzën për një vepër penale. Pas njoftimit të akuzës së parë në hetim prokurori grumbullon të dhëna të reja të cilat pasqyrojnë fakte të tjera penale që përbejnë vepra penale të pa njoftuar në akuzën e parë të pandehurit. Këto vepra penale duhet t'i njoftohen të pandehurit si pjesë e akuzës me qëllim që ai të përgatisë mbrojtjen e tij. Njoftimi i veprave të reja penale kundrejt të pandehurit mund të realizohet nga prokurori në hetim vetëm në formën e plotësimit të akuzës së parë me veprat e reja penale duke u bazuar në nenin 34 paragrafi 1 të K.Pr.Penale.

Edhe në këtë rast prokurori nuk mund të aplikojë formën e ndryshimit të akuzës ndaj të pandehurit pasi të dhënat e reja të përfutuara në hetim nuk ndryshojnë elementet e shkakut dhe të natyrës së akuzës së parë. Këto të dhëna pasqyrojnë fakte të reja penale të cilat e lidhin veprimtarinë kriminale të të pandehurit me shkelje të ligjit penal të ndryshëm nga shkelja e parë e ligjit penal të realizuar prej të pandehurit që tashmë ka qenë e evidentuar në akuzën e parë.

Kryerja e dy ose më shumë veprave penale prej një autori të vetëm është parashikuar si një institut i së drejtës penale që gjen pasqyrim në nenin 55 paragrafi 1 të Kodit Penal⁵⁵. Kryerja e dy ose më shumë veprave penale do të thotë shkelje nga ana e autorit ose e autorëve në bashkëpunim më shumë se një herë të një ose dispozitave që parashikojnë figura të veprave penale më vete, të pavarura nga njëra tjetra dhe dënime të veçanta. Veprat penale në rastin e bashkimit të tyre duhet të jenë kryer nga i njëjti person apo persona në bashkëpunim dhe për asnjë nga veprat penale të kryera të mos jetë dhënë një vendim gjyqësor⁵⁶.

Kështu që të gjitha veprat penale të kryera janë pjesë përbërëse e akuzës që prokurori duhet të hetojë dhe t'ja njoftojë të pandehurit në kohën që faktet penale evidentohen si vepra penale të konstatuara në hetim. Kur veprat penale të evidentuara në hetim janë të plota e nuk ka nevojë për kryerjen e hetimeve të tjera atëherë prokurori i njofton akuzën të pandehurit për të gjitha veprat penale të përfutuara gjatë hetimit.

⁵⁵ “Kur veprimet ose mosveprimet përmbajnë elementët e disa veprave penale, si dhe kur personi ka kryer disa vepra penale për të cilat nuk është dhënë akoma vendim, gjykata më parë cakton dënimin për çdo vepër penale dhe në përfundim jep një dënim të vetëm, që përbëhet nga dënimi më i rëndë i shtuar.”

⁵⁶ Kaçupi Skënder, “E drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme”, “Cikël leksionesh, Universiteti Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë”, Viti Akademik 1995 – 1996

Kur hetimet nuk janë të plota në kuptimin që më parë prokurori i ka njoftuar të pandehurit një akuzë për një vepër penale, por gjatë hetimit janë mbledhur të dhëna të reja të cilat të marra së bashku krijojnë elemente të një ose disa veprave të tjera penale të kryera prej të pandehurit, atëherë prokurori në këtë rast vepron me plotësimin e akuzës. Prokurori akuzën e parë e plotëson duke i shtuar edhe veprat e reja penale të konstatuara në hetim pas njoftimit të akuzës së parë të pandehurit.

Plotësimi i akuzës ndjek të njëjtën logjikë ligjore si edhe njoftimi i akuzës. Pas evidentimit të veprave të tjera penale shtesë, prokurori merr vendim për plotësimin e akuzës së parë. Vendimi i plotësimit të akuzës edhe me veprat penale të reja i njoftohet të pandehurit në të njëjtën mënyrë siç është vepruar edhe me njoftimin e akuzës fillestare.

Për të ilustruar po japim një shembull nga praktika gjyqësore:

“...Prokuroria “Për Krimet e Rënda” Tiranë më datë 21.08.2014 fillimisht ka regjistruar procedimin penal nr. 236 për veprën penale të “Shtrëngimit me anë të kanosjes ose dhunës për dhënie pasurie” në bashkëpunim parashikuar nga neni 109/b/1 dhe 25 të Kodit Penal në ngarkim të të pandehurve I. T dhe F. P.

Prokuroria “Për Krimet e Rënda” ka filluar hetimet të cilat lidhen me kallëzimin e bërë nga shtetasi F. R banor në komunën Rrashbull, Durrës. Kallëzuesi ka paraqitur kallëzimin e tij në policinë gjyqësore në varësi të Prokurorisë “Për Krimet e Rënda” më datë 21.08.2014.

Kallëzuesi në datë 18 gusht 2014 rreth orës 20.00 ka dalë nga shtëpia dhe ka shkuar tek dyqani minimarket i vogël në pronësi të shtetasit B.G pranë shtëpisë për të blerë një paketë cigare. Pasi mori cigaret nga dyqani i shtetasit B.G, është kthyer për në shtëpi, ku sapo është afruar në një kryqëzim pranë fushës së sportit i kanë dalë përpara të pandehurit F. P dhe I. T të cilët i njuh mirë pasi i ka fqinj në një lagje.

Të pandehurit F. P dhe I. T ishin në këmbë dhe sapo u afruan i pandehuri F. P i drejtohet duke i thënë “qe ku je kemi gjithë ditën që të kërkojmë”. Kallëzuesi i përgjigjet që “kam qenë në shtëpi dhe në punë”. I pandehuri F. vazhdoi duke i thënë që “po pret burri i huj të cilit i kanë humbur 6000 (gjashtë mijë) euro” pa përmendur emër se cili ishte ky person. Me tej kallëzuesi i thotë “që nuk e di se për çfarë po flisni”.

Pas kësaj bisede të pandehurit filluan që ta godisnin në pjesë të fytyrës me grushta e shpulla si dhe me shkelma nga këmbët e brinjët. Në këtë moment i pandehuri I. T i mori kallëzuesit me forcë telefonin tip samsung me ngjyrë gri metalizate ku në të ishin dy karta një e kompanisë AMC dhe një VODAFONE. I pandehuri I. i hoqi kartat nga telefoni ndërsa telefonin e mbajti.

Gjithashtu në momentin që po e qëllonin, të pandehurit i kanë thënë kallëzuesit se “ti ja ke blerë makinën H. H”, ndërsa kallëzuesi u thoshte “nuk ja kam blerë une pasi nuk kam lekë të blej makinë për vete dhe jo për H”. Kallëzuesi sqaron se shtetasi H. H është një shok i tij rreth 23 vjeç që jeton në një lagje me të.

Në vazhdim të pandehurit së bashku kërcënuan kallëzuesin që të shkonte me ta në plazh. Pas kësaj të pandehurit dhe kallëzuesi u nisen në këmbë nga Rrashbulli për në plazh duke ecur në linjën hekurudhore. Kallëzuesi tentoi që të largohej prej tyre por ata e kapën nga krahët dhe e detyruan që të vazhdonte rrugën me ta.

Rreth orës 21. 00 të tre personat dolën në plazh, ecën bregut të detit nga pjesa e quajtur Agip - Ura e Dajlanit deri kur shkuan te hotel C. G. Aty pasi arritën para hotelit u ulën në plazhin para secili nga një shezlong plazhi ku aty erdhi dhe një person tjetër i cili ishte i njohur të pandehurve.

Sipas kallëzuesit roja ishte rreth të gjashtëdhjetave dhe ata e thërrisnin "Xhaje". Kallëzuesi u shtri në shezlong dhe bëri sikur flinte gjumë, ku ndërkohe të pandehurit u larguan bashke me "xhajën" dhe 2-3 djem të tjerë dhe u ulën diku rreth 10 metra larg kallëzuesit në një shezlong tjetër. Pasi pa që të pandehurit u larguan rreth orës 01. 00 kallëzuesi u hoq zvarrë nëpër rërë derisa u largua rreth 100 metra larg e iku me vrap në shtëpi.

Në shtëpi ai shkoi rreth orës 02. 00 ku i ka shpjeguar nënës së tij për ngjarjen që i kishte ndodhur. Mamaja e këshilloi të mos denonëonte pasi mund ti bëjnë ndonjë gjë edhe më të rëndë. Pas kësaj kallëzuesi ra në gjumë dhe të nesërmen nuk doli nga shtëpia fare.

Në datë 21. 08. 2014 në kohën kur ishte në shtëpi, pasi ishte duke bere disa instalime elektrike, ka marrë aparatit e telefonit të motrës tip Nokia dhe i vendosi numrin e tij të kompanisë AMC 068..... dhe e ndezi atë rreth orës 10. 00. Aty ka parë që i erdhi një thirrje e humbur me numër privat. Pas 15-20 minutash i bie përsëri telefoni me numër privat dhe pasi e hap rezultoi se telefonuesi ishte i pandehuri F. P i cili i tha që hajde në plazh dhe sill me vete 1000 euro për person për kokë pra 2000 euro gjithsej se ndryshe do ti kishte punët keq, pasi do ti shkonin tek shtëpia dhe do ta vrisnin.

Kallëzuesi telefoni tek salla operative nga numri AMC dhe i shpjegoi se çfarë i kishte ndodhur. Punonjësi i policisë i kërkoi që të shkonte në Drejtorin të Policisë së Qarkut Durrës dhe të merrte takim me punonjësit për të bërë kallëzim dhe ndjekur çështjen në rrugë ligjore. Kallëzuesi me një fugon të linjës së Sukthit tek stacioni i "Mullirit të Bullgarit" ka shkuar ne Drejtorinë e Policisë së Qarkut Durrës ku ka bërë edhe kallëzimin ndaj të pandehurve.

Mbi kallëzimin e të dëmtuarit prokuroria ka regjistruar procedimin penal nr. 236/2014, për veprën penale të "Shtrëngimit me anë të kanosjes apo dhunës për dhënie pasurie" parashikuar nga neni 109/b/1 i Kodit Penal. Pas regjistrimit të procedimit penal prokuroria ka autorizuar kryerja e veprimeve simuluese të shoqëruar dhe me përgjimet telefonike të numrit 068.....7 të përdorur nga kallëzuesi F. R dhe numrit 068.....4 të përdorur nga personi i thirrur "L", që më vonë vërtetohet se ishte numri i të pandehurit I. T.

Në datë 22. 08. 2014 shërbimet e policisë gjyqësore i kanë dorëzuar paratë shtetasit F. R si pjesë e veprimeve stimuluese dhe kallëzuesi vetë është pajisur me një pajisje regjistruese USB.

Në fillim të dy të pandehurit janë takuar me kallëzuesin afër agjencisë së udhëtimeve Adriatika pranë staëionit të trenit Durrës, ku kanë ndenjur rreth 15 minuta dhe më pas të pandehurit janë ndarë dhe janë ulur në një lokal afër Raiffeisen Bank. Pas gjysëm ore, rreth orës 12.15 janë takuar me shtetasin F. R dhe të tre bashkë kanë dalë në këmbë në drejtim të Staëionit të Autobusëve të Shijakut.

Ata të tre janë kthyer përsëri pranë sheshit të agjencisë së udhëtimit Adriatika, ku të pandehurit F. P dhe I. T janë ulur në shkallët e pallatit në tunelin e hyrjes që të çon te porti. Në orën 13.30 janë çuar dhe kanë ecur në drejtim të një tuneli që gjendet në afërsi të agjencisë "Adriatika".

Në tunel kallëzuesi i ka dhënë të pandehurit I. T sasinë e parave të mbështjella në një qese plastmase. Në këtë kohë është afruar edhe i pandehuri F. P dhe të dy janë ndarë nga shtetasi F. R dhe kanë marrë drejtimin nga stacioni i autobusëve të Shijakut, duke fërkuar duart. Pasi kanë arritur te ky stacion të dy të pandehurit janë ndalur nga forcat e policisë dhe gjatë kontrollit të pandehurit I. T i është gjetur sasia prej 1000 euro si dhe aparati celular samsung që i përkiste kallëzuesit.

Gjatë hetimit prokuroria ka kryer aktin e ekspertimit mjeko-ligjor nr. 925 datë 23. 08. 2014 nga i cili rezulton se tek i dëmtuari F. R janë konstatuar një dërmishje me lokalizime që janë shkaktuar me mjete të forta mbrerëse që nuk kanë sjellë humbje të aftësisë për punë.

Në ora 14.30 të datës 21.08.2014 është autorizuar përgjimi i numri telefonik celular 068..... të përdorur nga shtetasi F. R. Ky përgjim është vlerësuar si i ligjshëm nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda me vendimin nr. 9... datë 22. 08. 2014. Gjithashtu menjëherë pas përgjimit të këtij numri, në datën 21. 08. 2014, ora 20.00 është autorizuar përgjimi i numrit telefonik celular 068..... të përdorur nga personi i thirrur “L” që më pas rezultoi se është numri i të pandehurit I. T. Ky përgjim është vlerësuar si i ligjshëm nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda me vendimin nr. 9.. datë 22.08.2014.

Përgjimet e bisedave telefonike pasqyrojnë komunikimet mes të pandehurve për mënyrën sesi ata do ti merrnin paratë kallëzuesit F. R.

Gjatë hetimit janë marrë tabulatet telefonike të telefonave që i përkasin të dy të pandehurve si dhe është kryer akti i ekspertimit kompjuterik i dy aparateve celulare te tipave Nokia dhe Samsung me kartat SIM përkatëse që i përkasin Kompanisë së Telefonisë Celulare AMC, aparate që u sekuestruan nga policia gjyqësore në momentin e arrestimit të të pandehurve I. T dhe F. P.

Në hetim janë pyetur të dy të pandehurit në lidhje me ngjarjen e ndodhur në Durrës, ku ata kanë dhënë versionin e tyre për këtë ngjarje.

Pas kryerjes së këtyre veprimeve hetimore prokuroria i njofton të pandehurve I. T dhe F. P akuzën e “Shtrëngimit me anë të kanosjes ose dhunës për dhënie pasurie” në bashkëpunim parashikuar nga neni 109/b/1 – 25 i Kodit Penal. Të gjitha veprimet hetimore të kryera më lart nga policia gjyqësore duke përfshirë edhe veprimin simulues të autorizuar nga prokurori janë realizuar në funksion të veprës penale të “Shtrëngimit me anë të kanosjes ose dhunës për dhënie pasurie” në bashkëpunim parashikuar nga neni 109/b/1 të Kodit Penal duke përfshirë në këtë vepër penale elementin e bashkëpunimit të të pandehurve I. T dhe F. P.

Pas njoftimit të akuzës së parë për të dy të pandehurit prokuroria ka grumbulluar edhe të dhëna të tjera gjatë hetimit të cilat lidhin të pandehurit I. T dhe F. P me kryerjen e veprave të tjera penale në dëm të kallëzuesit F. R.

Më konkretisht gjatë arrestimit të të pandehurit I. T policia gjyqësore i sekuestruar atij me cilësinë e provës materiale ndër të tjera edhe një aparat celulari i tipit “Samsung” që ka qenë në pronësi të kallëzuesit. Të pandehurit I. T dhe F. P i kanë marrë me dhunë aparatën celular kallëzuesit më datë 18 gusht 2014. Një fakti tillë në hetim konfirmohet jo vetëm nga deklaratimet e dhëna prej të dëmtuarit gjatë hetimit por edhe prej aktit të ekspertimit mjeko – ligjor mbi bazën e të cilit ka rezultuar se në trupin e të dëmtuarit F. R konstatohen dërmishje të

shkaktuara me mjete të forta mbrerëse. Këto veprime përmbajnë elementë të veprës penale të “Vjedhjes me dhunë” në bashkëpunim parashikuar nga neni 139 dhe 25 i Kodit Penal.

Gjithashtu gjatë hetimit ka rezultuar se të pandehurit në vijim nuk janë mjaftuar në datë 18 gusht 2014 vetëm me marrjen me dhunë të aparatit celular të të dëmtuarit. Të pandehurit kanë marrë me forcë fizikisht të dëmtuarin pa dëshirën e këtij të fundit drejt vendit të quajtur Agip në plazhin e Durrësit. Edhe ky veprim i kryer në bashkëpunim prej të pandehurve I. T dhe F. P përmban elemente të veprës penale të “Heqjes së paligjshme të lirisë” parashikuar nga neni 110/2 – 25 i Kodit Penal.

Të gjitha këto të dhëna të vlerësuara në harmoni me njëra – tjetrën të çojnë në përfundimin se të pandehurve pas njoftimit të akuzës së parë për veprën penale të “Shtrëngimit me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë” në bashkëpunim parashikuar nga parashikuar nga neni 109/b/1 dhe 25 të Kodit Penal do ti duhet ti plotësohet akuza edhe për vepra penale të “Vjedhjes me dhunë” në bashkëpunim, parashikuar nga neni 139 dhe 25 të Kodit Penal, “Heqjes së paligjshme të lirisë” në bashkëpunim, parashikuar nga neni 110/2 dhe 25 i Kodit Penal.

Plotësimi i akuzës për të dy të pandehurit bëhet në bazë të nenit 34/1 të Kodit të Procedurës Penale. Plotësimi i akuzës i njoftohet të dy të pandehurve I. T dhe F. P të cilët morën dijëni me nënshkrimin prej tyre të plotësimit të akuzës.

Në përfundim të hetimeve prokuroria i ka njoftuar akuzat (duke përfshirë edhe plotësimin e akuzave) të pandehurve I. T dhe F. P për veprat penale të “Shtrëngimit me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë” në bashkëpunim parashikuar nga parashikuar nga neni 109/b/1 dhe 25 të Kodit Penal, “Vjedhjes me dhunë” në bashkëpunim, parashikuar nga neni 139 dhe 25 të Kodit Penal, “Heqjes së paligjshme të lirisë” në bashkëpunim, parashikuar nga neni 110/2 dhe 25 i Kodit Penal.

Në këtë gjendje procedimi prokuroria ka paraqitur në gjykatë kërkesën për gjykim ndaj të pandehurve I. T dhe F. P...”.

Në përfundim mund të themi se plotësimi i akuzës nuk do të kishte asnjë vlerë nëse nuk do t’i njoftohej të pandehurit. Në kuadër të respektimit të rregullave mbi procesin e rregullt ligjor si shprehje e parimit të ligjshmërisë, i pandehuri duhet të vihet menjëherë në dijëni në formë të shkruar për plotësimin e akuzës së tij, në të njëjtën mënyrë siç është vepruar edhe për njoftimin e akuzës. Mos vënia në dijëni e të pandehurit për plotësimin e akuzës çënon standardin e mbrojtjes efektive. I pandehuri nuk mund të realizojë mbrojtjen e tij nëse ai nuk vihet në dijëni për plotësimin e akuzës.

Për të garantuar mbrojtjen efektive të të pandehurit, ky i fundit duhet të njoftohet nga ana e prokurorit mbi plotësimin e akuzës në mënyrë të qartë e të detajuar, me qëllim që plotësimi i akuzës jo vetëm të kuptohet mirë nga i pandehuri, por atij t’i jepet mundësia që të realizojë mbrojtjen efektive edhe për shtesën e akuzës.

Një tjetër përfundim i rëndësishëm mbi akuzën, referuar elementëve të sipërcituar është edhe fakti se akuza për nga natyra e saj është e paqëndrueshme, në kuptimin që ajo mund të ndryshojë apo të pasurohet gjatë hetimit, në varësi të të dhënave të mbledhura prej prokurorisë.

Në përfundim të fazës së hetimeve mund të themi se akuza fiton një farë qëndrueshmërie për shkak se ajo i nënshtrohet një veprimi kontrolli të përgjithshëm nga gjyqtari i seancës paraprake, i cili është një subjekt i ri procedural me funksione qartësisht të përcaktuara në ndryshimet e reja të Kodit të Procedurës Penale që hyjnë në 1 gusht 2017.

KAPITULLI III

AKUZAT E REJA NË SEANCËN PARAPRAKE

3.1. Organizimi dhe funksionimi i prokurorisë në ndryshimet e reja kushtetuese

Me ndryshimet e reja në Kodin e Procedurës Penale është parashikuar një model i ri i prokurorit në mënyrën e organizimit dhe funksionit të tij si organ kushtetues, ku njëkohësisht ka ndryshuar dhe mënyra e ushtrimit prej tij të ndjekjes penale dhe përfaqësimit të akuzës në gjykim.

Me ligjin nr. 76/2016, Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i janë bërë disa ndryshime të cilat kanë prekur edhe Prokurorinë si institucion kushtetues. Para ndryshimeve kushtetuese prokuroria ishte përcaktuar si Institucion Kushtetues që ishte e organizuar dhe funksiononte pranë pushtetit gjyqësor si një organ i centralizuar⁵⁷. Mbi bazën e këtij modeli kushtetues ishte ndërtuar edhe Kodi i Procedurës Penale i cili parashikonte ndër të tjera dhe mënyrën e organizimit dhe funksionimit të prokurorisë si subjekt procedural.

Kështu neni 24 i K.Pr.Penale në paragrafët 4 e 5 të tij përpara ndryshimeve, përcaktonte natyrën e centralizuar të funksionimit të prokurorisë përgjatë gjithë procedimit penal. Urdhrat dhe udhëzimet e prokurorit më të lartë ishin të detyruara për t'u zbatuar nga prokurori më i ulët si dhe prokurori më i lartë gëzonte të drejtën për të ndryshuar ose shfuqizuar vendimet e marra nga prokurori më i ulët, me ankim ose kryesisht⁵⁸. Gjithashtu prokurori më i lartë kishte të drejtë të ushtronte kompetencat e prokurorit më të ulët⁵⁹.

Vlerësuar në këndvështrimin e këtij punimi mund të themi se akuza si një akt i rëndësishëm procedural që hartohej nga prokurori i ngarkuar për kryerjen e një hetimi penal, nuk ishte një atribut ekskluziv i prokurorit të hetimit. Në këtë rast prokurori që hetonte një çështje penale në formulimin e akuzës gjatë hetimit do të duhej të konsultohet paraprakisht me drejtuesin e prokurorisë si një prokuror më i lartë në shkallë hierarkie, në të kundërt akuza e hartuar prej prokurorit që ndiqte hetimin pa konsultimin me eprorin e tij, mund të ndryshohej nga drejtuesi i prokurorisë përpara se çështja penale të dërgohej për gjykim.

Pra në rastet e formulimit të akuzës, ndryshimit ose plotësimit të saj prej prokurorit që kishte nisur hetimin për një çështje penale, kontributi në kryerjen e këtij veprimi hetimor si pjesë e ushtrimit të ndjekjes penale nuk ishte vetëm i prokurorit të hetimit, por ishte edhe i drejtuesit të prokurorisë si subjekti epror që kontrollonte hetimin e kujdesej për formulimin e drejtë të akuzës që duhej të përfaqësohej në gjykim.

⁵⁷ Neni 148/2 i Kushtetutës përpara ndryshimeve të fundit parashikonte se: “2. Prokurorët janë të organizuar dhe funksionojnë pranë sistemit gjyqësor si një organ i centralizuar.”

⁵⁸ Neni 24 në paragrafët 4 e 5 të K.Pr.Penale përpara ndryshimeve me Ligjin nr. 35/2017 parashikonin se: “4. Urdhrat dhe udhëzimet e prokurorit më të lartë janë të detyrueshme për prokurorin më të ulët.

5. Prokurori më i lartë ka të drejtë të vendosë ndryshimin ose shfuqizimin e vendimeve të marra nga prokurori më i ulët me ankim ose kryesisht.”

⁵⁹ Neni 25 paragrafi 2 i K.Pr.Penale përpara ndryshimeve me Ligjin nr.35/2017 parashikonte se: “2. Prokurori më i lartë ka të drejtë të ushtrorjë kompetencat e prokurorit më të ulët.”

Kështu që rezultatet e hetimit në përgjithësi dhe akuza në veçanti si pjesë përbërëse e hetimit të kryer nga prokurori përgjegjës, ishin objekt kontrolli prej drejtuesit të prokurorisë. Madje referuar dipozitave procedurale, Prokurori i Përgjithshëm në pozicionin e titullarit të akuzës në Republikën e Shqipërisë në ushtrimin funksioneve të tij kushtetuese e procedurale mund të ndërhynte edhe në procesin e hartimit të akuzës prej prokurorit të çështjes duke ndyshuar apo shfuqizuar vendimin e prokurorit të çështjes për njoftimin e akuzës që ai i kishte bërë të pandehurit.

Në ndryshimet e reja kushtetuese me ligjin nr. 76/2016, ndryshime të cilat janë botuar në Fletoren Zyrtare nr. 138 të vitit 2016 të cilat janë aktualisht në fuqi, rezulton se funksionet dhe organizimi kushtetues i prokurorit si subjekt procedural i ushtrimit të ndjekjes penale dhe përfaqësimit të akuzës në emër të shtetit në gjykim, kanë ndryshuar. Me ndryshimet e reja prokuroria nuk vepron më si organ i centralizuar por ajo është një organ i pavarur që respekton pavarësinë e brendshme të prokurorëve për hetimin dhe ndjekjen penale, sipas ligjit. Kjo do të thotë se në ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimin e akuzës në gjykim si një funksion kushtetues prokurori nuk është i varur e nuk kontrollohet për një çështje penale për të cilën është nisur një hetim nga eprori i tij. Në ushtrimin e funksionit të njoftimit të akuzës, prokurori i hetimit është i pavarur prej drejtuesit të prokurorisë apo edhe më tej prej Prokurorit të Përgjithshëm.

Pra me ndryshimet e reja kushtetuese mund të themi se këto ndryshime kanë decentralizuar funksionin e prokurorit në ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimit të akuzës në gjykim.

Një tjetër ndryshim kushtetues që lidhet me prokurorinë është përcaktimi në Kushtetutë edhe të një subjekti tjetër kushtetues që ushtron ndjekjen penale për veprat penale të korrupsionit, krimin të organizuar si dhe për veprat penale të kryera nga zyrtarët e lartë të përcaktuar nga neni 135 paragrafi 2 i Kushtetutës. Subjekti i ri kushtetues është Prokuroria e Posaçme dhe Njësia e Posaçme hetimore në varësi të saj. Prokuroria e Posaçme në ushtrimin e ndjekjes penale për veprat penale të përcaktuara në Kushtetutë është e pavarur nga Prokurori i Përgjithshëm⁶⁰.

Bazuar në këto ndryshime kushtetuese arrijmë në përfundimin se Prokuroria e Përgjithshme nuk ruan cilësinë e të qenurit të një organi unik në ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimin e akuzës në emër të shtetit në gjykim.

Tashmë me këto ndryshime kushtetuese ushtrimi i ndjekjes penale dhe përfaqësimi i akuzës në gjykim realizohet nga Prokuroria dhe Prokuroria e Posaçme për kategorinë e veprave penale dhe subjekteve të parashikuara në Kushtetutë. Të dy subjektet kushtetuese të ushtrimit të

⁶⁰ Neni 148 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i ndryshuar me ligjin 76/2016 datë 22.07.2016 parashikon: "1. Prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit. Prokuroria kryen edhe detyra të tjera të caktuara me ligj.

2. Prokuroria është organ i pavarur që garanton mbarëvajtjen, kontrollin e veprimeve të saj dhe respekton pavarësinë e brendshme të prokurorëve për hetimin dhe ndjekjen penale, sipas ligjit.

3. Prokuroria është organizuar dhe funksionon pranë sistemit gjyqësor.

4. Prokuroria e Posaçme dhe Njësia e Posaçme Hetimore për ndjekjen penale dhe hetimin e veprave penale të korrupsionit, krimin të organizuar dhe çështjeve penale sipas nenit 135, paragrafi 2, të Kushtetutës janë të pavarura nga Prokurori i Përgjithshëm. Njësia e Posaçme Hetimore është në varësi të Prokurorisë së Posaçme."

ndjekjes penale veprojnë në mënyrë të pavarur nga njëri – tjetri në kufijtë që Kushtetuta përcakton veprimin e tyre.

Këto ndryshime Kushtetuese padyshim që janë reflektuar dhe në ndryshimet që pësoi Kodi i Procedurës Penale.

Modeli i zgjedhur në Kodin e Procedurës Penale të ndryshuar, që pasqyron ndryshimin kushtetues të funksionimit të prokurorisë si subjekt procedural është një model që i përngjason sistemit inkuizitor të procesit penal. Sipas këtij modeli të ri të zgjedhur në ndryshimet e reja prokurori vërtet nuk kontrollohet në mënyrë vertikale prej prokurorit të tij, por tashmë kontrolli i hetimit dhe i akuzës së ngritur për hetimin e kryer do të realizohet nga një subjekt i ri procedural që është gjyqtari i seancës paraprake.

Në të gjitha sistemet procedurale, si inkuizitor ashtu dhe akuzator por dhe në sistemet e përziera, në fazën e hetimeve paraprake prokurori nuk është asnjëherë i pavarur. Në sistemet *Common Law* të së drejtës, të cilat kanë përkrahur modelin akuzator të procesit penal, hetimi i një çështjeje penale dhe akuza e ngritur nga prokurori shqyrtohet paraprakisht nga Juria e Madhe⁶¹.

Në sistemet e së drejtës kontinentale të njohura si *Civil Law*, të cilat kanë përkrahur kryesisht modelin inkuizitor të procesit penal ku përfshihen shtetet evropiane, hetimi dhe akuzat e ngritura nga prokurori paraprakisht kontrollohen nga një gjyqtar përpara se çështja penale të paraqitet për gjykim⁶².

Në ndryshimet e reja në Kodin tonë të Procedurës Penale është përfshirë edhe gjyqtari i seancës paraprake i cili në bazë të ligjit kontrollon hetimin dhe akuzën e ngritur nga prokurori përpara se çështja penale e hetuar të shkojë për gjykim. Mund të themi se edhe në këtë rast, modeli i përzgjedhur në Kodin tonë të Procedurës Penale për mënyrën sesi do të funksionojë gjyqtari i seancës paraprake dhe çfarë pushteti do të ushtrojë ai ndaj përfundimit të hetimeve dhe akuzës së ngritur prej prokurorit, përngjason me modelin italian të gjyqtarit të seancës paraprake.

Më poshtë do të trajtojmë gjyqtarin e seancës paraprake në raport me akuzën e ngritur nga prokurori në hetimi dhe mundësinë që i jepet prokurorit të ndryshojë akuzën apo ta plotësojë atë në seancën paraprake.

⁶¹ Grand Jury (Juria e Madhe) përbëhet nga qytetarë që janë përfaqësues të komunitetit të cilët marrin pjesë në administrimin e drejtësisë. Numri i pjesëmarrësve në Jurinë e Madhe nuk është i njëjtë për shtetet që aplikojnë Jurinë e Madhe si trupën gjyqësore që kontrollon hetimin në një çështje penale të nisur. Shtetet që praktikojnë Jurinë e Madhe janë Anglia dhe Uellsi, Skocia, Irlanda, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kanadaja, Australia etj. Statutory Instruments, 2011 No. 1709 (L 15) Senior Courts of England and Wales, Magistrate`s Courts of England and Wales, “The Criminal procedure rules” 2011.

“Federal Rules of criminal procedure”, Printed for the use of The Committee on the Judiciary House of Representatives, U.S. Government Printed Office: Washington 2010.

⁶² Për nevoja të këtij punimi janë studiuar disa kode të procedurave penale të vendeve të ndryshme, prej të cilave ka rezultuar se gjyqtari që kontrollon hetimet dhe akuzat përpara se çështja të shkojë në gjykim si subjekt procedural është i përfshirë në Kodet e Procedurave Penale të Kosovës, Serbisë, Estonisë, Letonisë, Hollandës, Kroacisë, Italisë, Francës, Gjermanisë.

3.2. Seanca paraprake

Në ndryshimet e reja në Kodin e Procedurës Penale është parashikuar mundësia e kontrollit të hetimeve dhe akuzave të ngritura nga prokurori në fund të hetimit nga gjyqtari i seancës paraprake. Ashtu siç e përmendëm edhe më sipër, me ndryshimet e reja të Kodit, prokurori funksionon në mënyrë të decentralizuar. Kontrolli i hetimeve dhe akuzave të ngritura nga prokurori nuk kryhet prej eprorit të tij që në rastet e zakonshme ishte drejtuesi i prokurorisë e në raste të veçanta Prokurori i Përgjithshëm.

Tashmë një veprim të tillë kontrolli mbi përfundimin e hetimeve, duke përfshirë edhe akuzën e kryen gjyqtari i seancës paraprake. Në këtë aspekt mund të themi se përzgjedhja e gjyqtarit të seancës paraprake në kontrollin e hetimeve të përfunduara përpara se çështja penale të dërgohet për gjykimin, është një zgjidhje që Kodi i Procedurës Penale me ndryshimet e reja e ka marrë duke u mbështetur në modelet më të zakonshme të sistemeve procedurale penale që janë në fuqi në një pjesë të mirë të shteteve evropiane. Mund të themi se verifikimi i hetimeve në seancë paraprake nga një gjyqtar, në ndryshimet e reja përngjason edhe me traditën tonë të së drejtës së procedurës penale të kontrollit të akt akuzës së prokurorit nga gjykata në seancë pregtitore të parashikuar në Kodet e Procedurës Penale të viteve 1953 dhe 1979⁶³.

Ndërkohë në lidhje me ndryshimet e reja mbi seancën paraprake, Gjyqtarin e seancës paraprake, pushtetin që ligji i ka dhënë gjyqtarit të seancës paraprake të disponojë mbi kërkesën e prokurorit, zhvillimin e seancës paraprake dhe renditja e dispozitave ligjore për ndryshimet e reja në Kod që lidhen me seancën paraprake, mund të themi se të gjitha këto ndryshime janë bërë duke marrë si model seancën paraprake të parashikuar në Titullin e IX të Kodit të Procedurës Penale të Italisë.

Me ndryshimet e reja, gjyqtari i seancës paraprake zhvillon një seancë gjyqësore me dyer të mbyllura në prani të detyrueshme të prokurorit dhe mbrojtësit të të pandehurit, me qëllim kontrollin e hetimeve të përfunduara nga prokurori përpara se çështja penale e hetuar të dërgohet për gjykim. Pra në seancë paraprake, gjyqtari i vetëm, në prani të palëve zhvillon një seancë gjyqësore për verifikimin paraprakisht të akt akuzës (kërkesës për gjykim) përpara se çështja penale të shkojë për gjykim në gjykatën e themelit.

Verifikimi dhe kontrolli që kryen gjyqtari i vetëm është paraprak e jo i hollësishëm. Verifikimi i aktakuzës (kërkesës për gjykim) të sjellë nga prokurori bazohet në dy drejtime kryesore që janë: *së pari* verifikimi i rezultateve të hetimit, nëse ato janë ose jo të plota; *së dyti*, verifikimi i akuzës së ngritur nga prokurori nëse ajo është e qartë dhe e saktë

Në lidhje me rastin e parë konstatojmë se gjyqtari i seancës paraprake kontrollon dhe vlerëson rezultatet e hetimit të përmendura në kërkesën për gjykim (aktakuzë) duke j'u referuar përmbajtjes së tyre. Nëse ai vlerëson se hetimet nuk janë të plota, pra nuk janë kyer të gjitha veprimet hetimore të nevojshme në funksion të faktit penal të hetuar dhe akuzës së ngritur nga

⁶³ Në kapitullin e parë të këtij punimi është trajtuar kontrolli i aktakuzës së prokurorit nga gjykata në seancat pregtitore në Kodet e Procedurave Penale të viteve 1953 dhe 1979.

prokurori urdhëron plotësimin e tyre duke përcaktuar drejtimin e hetimit dhe kur është rasti, gjyqtari mund të vendos edhe për aktet konkrete që duhet të kryhen nga ana e prokurorit⁶⁴.

Njëkohësisht gjyqtari i seancës paraprake me funksionet që i janë dhënë, me ndryshimet e reja, ka të drejtë të kontrollojë dhe ligjshmërinë e mbledhjes së provave nga prokuroria gjatë hetimeve si dhe vlefshmërinë e akteve procedurale të hartuara nga organi procedues në fazën e hetimit. Nëse gjyqtari konstaton akte procedurale të pavlefshme ose prova të papërdorshme që janë përfshirë në fashikullin për gjykim, i deklaron ato si të tilla me vendim e kur është e mundur urdhëron përsëritjen e tyre⁶⁵.

Rasti i dytë i kontrollit të hetimit nga Gjyqtarit i seancës paraprake që përbën fokusi e këtij punimi, lidhet me verifikimin e elementëve të akuzës, nëse ajo është e qartë dhe e saktë. Pra në seancë paraprake në prani të gjyqtarit që drejton këtë seancë gjyqësore me dyer të mbyllura, prokurori gjatë parashtrimit të rezultatit të hetimit si dhe duke dëgjuar edhe qëndrimin e mbrojtësit dhe të pandehurit në lidhje me aktet dhe provat e mbledhura gjatë hetimit, ka mundësi të ndryshojë apo të plotësojë akuzën me elementë të rinj, duke rregulluar në këtë mënyrë edhe aktakuzën (kërkesën për gjykim) përpara se çështja penale të dërgohet për gjykim në gjykatën kompetente.

Aspekti delikat mbi natyrën dhe përmbajtjen e akuzës ka të bëjë pikërisht me momentin në të cilin prokurori harton kërkesën për gjykim. Ky moment është i rëndësishëm si për prokurorin ashtu edhe për të pandehurin. Për prokurorin momenti i hartimit të kërkesës për gjykim është i rëndësishëm, për shkak se ky është momenti kur prokurori ka konkluduar për të gjitha elementet e veprës penale të kryera nga i pandehuri dhe të dhënat që ai ka grumbulluar në fazën e hetimit janë të mjaftueshme për të kërkuar gjykimin e të pandehurit. Në këtë moment prokurori qartëson përfundimisht akuzën definitive duke i njoftuar të pandehurit kërkesën për gjykim si dhe rikonfirmuar akuzën përfundimtare me të cilën i pandehuri do të përballet në gjykatë gjatë procesit gjyqësor.

Për të pandehurin momenti i hartimit të kërkesës për gjykim nga prokurori është gjithashtu i rëndësishëm, pasi vetëm pasi i pandehuri të njihet me kërkesën për gjykim e cila do të shqyrtohet fillimisht në një seancë paraprake në prani të tij, ai ka mundësi efektive për të përgatitur mbrojtjen pasi të ketë dëgjuar prokurorin. Dorëzimi i kërkesës për gjykim të të pandehurit dhe shqyrtimi i kësaj kërkesë fillimisht në një seancë paraprake nga një gjyqtar i vetëm, i jep mundësi këtij të fundit, të njihet me faktin penal për të cilin ai sillet në gjykim si dhe të njihet me dispozitat ligjore penale që e cilësojnë faktin penal të kryer si vepër penale. Pra në këtë moment të përfundimit të hetimeve i pandehuri njihet me akuzën përfundimtare (aktakuzën), të plotë dhe të qëndrueshme që është konfirmuar prej prokurorit nëpërmjet kërkesës për gjykim e cila do t'i nënshtrohet kontrollit fillestar nga ana e gjyqtarit të seancës paraprake.

⁶⁴ Neni 332/ç paragrafi 1 fjalia e parë në Kodin e Procedurës Penale të ndryshuar parashikon: “1. Kur çmon se hetimet paraprake nuk janë të plota, gjykata urdhëron plotësimin e tyre, duke përcaktuar drejtimin dhe, kur është rasti, edhe aktet që duhet të kryhen.”

⁶⁵ Neni 332/ç paragrafi 1 fjalia e dytë të K.Pr.Penale parashikon: “Kur konstaton akte të pavlefshme ose prova të papërdorshme, gjykata i deklaron ato me vendim dhe, kur është e mundur, urdhëron përsëritjen e tyre. Gjykata cakton afatin brenda të cilit hetimet duhet të përfundojnë dhe datën e seancës së re.”

Në këtë rast ndryshimet e reja i japin qëndrueshmëri më të qartë të akuzës pas verifikimit të saj që realizohet në seancë paraprake. Neni 332/d i K.Pr.Penale, në lidhje me çështjen e përmbajtjes së kërkesës për gjykim përcakton se akuza e shqyrtuar në seancë paraprake shndërrohet në një akuzë të qartë në përfundim të seancës paraprake. Qartësia e akuzës është produkt i diskutimit që realizohet në seancë paraprake midis palëve në proces. Nëse akuza e ngritur në hetim rezulton me probleme gjatë diskutimit në seancë paraprake, prokurori ka mundësi ta reflektojë këtë diskutim në veprimin e ndryshimit të akuzës apo njoftimin e një akuze për një fakt të ri penal⁶⁶.

Nëse prokurori nuk ndërhyt vetë në rregullimin e kësaj situate juridike, atëherë gjyqtari ka mundësi të ftojë prokurorin për të bërë korrigjimet apo saktësimet e nevojshme. Nëse prokurori nuk vepron, atëherë gjykata vendos që t'i kthejë aktet prokurorit për vazhdimin e hetimeve.

Për rrjedhojë mund të themi se akuza fiton natyrë qëndrueshmërie vetëm në momentin e paraqitjes së kërkesës për gjykim. Deri në këtë moment akuza ka natyrë të paqëndrueshme e provizore.

Zgjidhja e dhënë në ndryshimet e reja në Kod duke përcaktuar si subjekt procedural Gjyqtarin e seancës paraprake për kontrollin e hetimit dhe akuzës së ngritur nga prokurori në hetim, vlerësojmë se është një zgjidhje pozitive e cila do të përmirësojë cilësinë e hetimit e të përfaqësimit të akuzës në gjykim për prokurorin por nga ana tjetër do t'i sigurojë të pandehurit kohë dhe mjete të mjaftueshme që të mund të realizojë më me efektivitet të drejtën e mbrojtjes.

Një problem i parë i zgjidhur me ndryshimet e reja ishte fakti kur prokurori hartonte kërkesën për gjykim me formulimin e një akuze të ndryshme nga ajo e hartuar prej tij në vendimin e njoftimit të akuzës, duke e plotësuar atë me rrethana rënduese eventuale, të pa njoftuar më parë të pandehurit ose kur në kërkesën për gjykim prokurori mund të ndryshonte të dhëna në lidhje me datën dhe vendin e kryerjes së veprës penale apo përshtatimin e mënyrës së kryerjes së veprës në fjalë.

Në lidhje me këtë problem mund të servirim edhe një rast të praktikës të ndodhur gjatë hetimeve të një veprë penale që lidhej me Trafikimin e narkotikëve të hetuar nga Prokuroria “Për Krimet e Rënda” Tiranë. Më konkretisht në rastin konkret konstatohet se:

“...Prokuroria “Për Krimet e Rënda” Tiranë ka sjellë për gjykim çështjen penale në ngarkim të të pandehurit H.N me akuzën e “Trafikimit të narkotikëve” mbetur në tentativë parashikuar

⁶⁶ Ndryshimet e reja në Kodin e Procedurës Penale që do të hyjnë në fuqi në datë 1 gusht 2017, në nenin 332/d të tij parashikojnë se : “1.Kur gjatë seancës paraprake fakti del ndryshe nga ç’është përshkruar në kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq, rezulton një vepër tjetër penale, sipas shkronjës “b”, të paragrafit 1, të nenit 79, apo del një rrethanë rënduese që nuk është përmendur, prokurori ndryshon akuzën dhe ia komunikon të pandehurit të pranishëm. Kur i pandehuri nuk është i pranishëm, akuza e re i komunikohet mbrojtësit të tij, të cilit i jepen jo më shumë se 10 ditë kohë për të komunikuar me të pandehurin.

2. Kur gjatë seancës paraprake në ngarkim të të pandehurit del një fakt i ri penal që nuk është përmendur në kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq dhe për të cilin duhet të procedohet kryesisht, gjykata lejon komunikimin e akuzës për faktin e ri, kur prokurori paraqit kërkesë dhe i pandehuri jep pëlqimin. Në rast të kundërt, gjykata i kthen prokurorit aktet që lidhen me akuzën e re dhe njofton drejtuesin e prokurorisë.

3. Kur gjatë seancës paraprake del se cilësimi juridik i faktit është i gabuar, ose kur akuza nuk është formuluar në mënyrë të qartë dhe të saktë, gjykata fton prokurorin që të bëjë korrigjimet ose saktësimet e nevojshme. Në rast se prokurori nuk vepron, gjykata vendos t'i kthejë aktet. Ky vendim i njoftohet drejtuesit të prokurorisë.”

nga neni 283/a/1 – 22 i Kodit Penal. Prokuroria “Për Krimet e Rënda” Tiranë më datë 21. 10. 2016 ka regjistruar procedimin penal nr. 230 në ngarkim të personit nën hetim H.N për veprën penale të “Trafikimit të narkotikëve” mbetur në tentativë parashikuar nga neni 283/a/1 – 22 të Kodit Penal.

Gjatë hetimit ka rezultuar se më datë 20.10.2016 rreth orës 21³⁰ në Pikën e Kalimit Kufitar “Porti Detar Durrës” në vijën e dytë të kontrollit është paraqitur i pandehuri H.N për kontrollin e automjetit të tij me qëllim dalje nga territori shqiptar, për të kaluar kufirin shtetëror në drejtim të Italisë. I pandehuri drejtonte një automjet kamion me kokë tërheqëse tip “Renault” me targa AA 6... FF dhe rimorkio me targë DR4....E.

Punonjësit e policisë të stacionit kufitar të “Portit Detar Durrës”, gjatë kontrollit të ushtruar në automjet në brendësi të kokës tërheqëse të kamionit dhe më konkretisht në krevatin e drejtuesit të automjetit sipër dyshekut të mbuluar me batanije janë gjetur të fshehur 21 (njëzet e një) pako të mbështjella me natriban me ngjyrë të bardhë dhe ngjyrë kafe, brenda të cilave ndodhej material bimor me karakteristikat e bimës *cannabis sativa L.*

Më pas është kryer peshimi i materialit bimor të gjetur në kamionin e të pandehurit dhe ka rezultuar se pesha e përgjithshme e saj ishte 11 (njëmbëdhjetë) kilogram e 820 (tetëqind e njëzet) gram.

Në kërkesën për gjykim prokurori në ndryshim nga rezultatet e hetimit prokurori e kishte sjellë të pandehurin për gjykimin e veprës penale të trafikimit të një sasive prej 22 (njëzet e dy) kilogram *cannabis* e cila nuk i përgjigjej në të vërtetë sasisë së lëndës narkotike të sekuestruar të pandehurit në Portin e Durrësit nga policia gjyqësore që ishte 11 (njëmbëdhjetë) kilogram e 820 (tetëqind e njëzet) gram.

Në rastin konkret i pandehuri vetëm për të përfitur nga e drejta për të proceduar me gjykim të shkurtuar “saktifikoi” pozitën e tij procedurale duke pranuar të gjykohej në gjëndjen në të cilën ndodheshin aktet e sjella për gjykim nga prokuroria, pavarësisht se pozita e tij procedurale ishte rënduar padrejtësisht nga prokurori duke i atribuuar në kërkesën për gjykimin trafikimin e një sasive lënde narkotike më të madhe sesa ai realisht kishte dashur të trafikonte.

Në ndryshimet e reja të Kodit një problem i tillë i cili mund të hasej në hetim për shkak të të metave të hetimit, vlerësojmë se i është dhënë zgjidhje.

Njoftimi përfundimtar i akuzës, që duhet të përmbajë edhe përshkrimin e faktit për të cilin procedohet është pjesë e kërkesës për gjykim që fillimisht me këto ndryshime i nënshtrohet një kontrolli paraprak nga gjyqtari. Nëse rezultojnë probleme në kërkesën për gjykim në lidhje me përshkrimin e veprës penale, mënyrës sesi ajo është kryer si dhe me elementë të tjerë thelbësorë që duhet të individualizojnë qartësisht veprimet e të pandehurit, këtyre problemeve u jepet zgjidhje me ndryshimet e reja të cilat realizohen në seancën paraprake nga gjyqtari përgjegjës.

3.3. *Akuza dhe ndryshimi i saj në seancë paraprake*

Në trajtimin që lidhej me seancën paraprake u fokusua më tepër në natyrën e seancës paraprake në përgjithësi dhe funksionin e gjyqtarit të seancës paraprake në drejtim të verifikimit të hetimit të kryer nga prokuroria si dhe akuzave që prokurori ngre ndaj të pandehurit.

Njëkohësisht në ndryshimet e reja të përmendura më sipër rezulton se kërkesa për gjykim e sjellë nga prokurori, nuk është e mjaftueshme për gjykatën që të procedojë me regjistrimin e çështjes penale dhe të nis gjykimin e saj.

Kërkesa për gjykim e prokurorit që të jetë e vlefshme për gjykatën duhet të shoqërohet dhe nga një vendim i Gjyqtarit të seancës paraprake në të cilin duhet të pasqyrohen ndër të tjera edhe parashtrimi i faktit dhe i rrethanave të tij, duke treguar dispozitat konkrete të ligjit penal që i referohet fakti penal i hetuar⁶⁷. Pasqyrimi i drejtë e i plotë i faktit penal por dhe i dispozitës konkrete që i referohet fakti penal nga ana e gjyqtarit të seancës paraprake kur merr vendim për dërgimin e çështjes në gjykim është i një rëndësie të veçantë, mos përmbushja me korrektësi e të cilit sjell si pasojë pavlefshmërinë e vendimit⁶⁸.

Për këtë arsye mund të themi se përcaktimi i saktë i elementëve të akuzës në seancën paraprake merr një rëndësi të madhe.

Përpara se të analizojmë ndryshimin e akuzës në seancë paraprake, duhet të sqarojmë edhe një herë situatën që hartimi i akuzës, formulimi i saj në detaje dhe njoftimi i këtij formulimi të pandehurit është një veprim ekskluziv vetëm i prokurorit, si pjesë e ushtrimit të ndjekjes penale nga ana e tij. Në seancë paraprake gjyqtari nuk harton akuza të reja mbi të pandehurin, madje gjyqtari nuk ndryshon apo shfuqizon akuzën e ngritur nga prokurori.

Në seancë paraprake gjatë verifikimit të faktit penal të hetuar, në parashtrimin që prokurori kryen përpara gjyqtarit, mund të rezultojë se akuza e ngritur paraprakisht prej prokurorit nuk i përgjigjet faktit penal të hetuar e konstatuar në seancën paraprake. Gjithashtu referuar faktit të hetuar, mund të ndodhë që akuza e ngritur në hetim nuk “mbulon” të gjithë faktin penal të hetuar dhe është i nevojshëm shtimi i një akuzë të re mbi faktin penal të hetuar ose në një rast tjetër, në seancë mund të konstatohet përfundimi i të dhënave të reja të pa hetuara nga prokurori të cilat pasqyrojnë ekzistencën e një fakti të ri penal ndaj të cilit duhet të nisë ndjekja penale.

Në të gjitha këto raste gjyqtari i seancës paraprake ka për detyrë të lejojë prokurorin të kryej veprimet e duhura procedurale në mënyrë që hetimi ndaj të pandehurit të jetë i plotë dhe të mos krijojë probleme procedurale në gjykimin në themel të çështjes. Në këto raste vetë gjyqtari nuk procedon me rregullimin e akuzës apo nuk shton akuzë për veprën penale të re apo faktin e ri penal që është konstatuar në seancë paraprake si produkt i verifikimit të kryer nga gjyqtari në këtë seancë. I vetmi funksion i gjyqtarit është konstatimi i situatës së re të ndryshme nga ajo që

⁶⁷ Neni 332/e i K.Pr.Penale që bën fjalë për elementet e vendimit të gjyqtarit të seancës paraprake në pikën “c” të paragrafit të parë të tij parashikon me pasojë pavlefshmëri se: “1. Vendimi për dërgimin e çështjes në gjyq përmban: c) parashtrimin e faktit penal dhe rrethanave të tij, duke treguar dispozitat përkatëse të ligjit;”

⁶⁸ Neni 332/e i K.Pr.Penale në paragrafin e dytë të tij parashikon se: “2. Vendimi është i pavlefshëm kur i pandehuri nuk identifikohet me saktësi, ose kur mungojnë ose janë të pamjaftueshme kërkesat e parashikuara në shkronjën “c”, pika 1, të këtij neni.”

është përcaktuar më parë prej prokurorit në hetim duke lejuar prokurorin të veprojë në përmbushje të funksioneve të tij procedurale e kushtetuese për të saktësuar qartë e drejtë kontestimet e reja të verifikuara në seancë paraprake.

Edhe në rastin kur hetimi i kryer nga prokurori është i plotë në drejtim të mbledhjes së provave dhe përcaktimit të faktit penal por në vlerësimin e gjyqtarit të seancës paraprake cilësimi juridik i faktit prej prokurorit është i gabuar, atëherë gjyqtari i vetëm në seancë paraprake nuk e ndryshon dot këtë cilësim për shkak se në fazën e hetimit paraprak pjesë e së cilës është edhe seanca paraprake prokurori gëzon të drejtën kushtetuese të hartimit të akuzës, që përfshijnë mundësinë e prokurorit për të përcaktuar ligjin penal konkret që i përgjigjet faktit penal të hetuar prej tij ndaj të pandehurit. Në këtë rast të fundit gjyqtari ka vetëm një mundësi, kthimin e akteve prokurorit.

Në lidhje me rastet e ndryshimit të akuzës në seancë paraprake konstatojmë se me ndryshimet e reja në Kod, ndër të tjera në seancë paraprake është parashikuar mundësia e kontestimeve të reja përpara se çështja penale të dërgohet për gjykim.

Neni 332/d i K.Pr.Penale parashikon tre raste të kontestimeve të reja gjatë seancës paraprake. Këto raste janë të parashikuara njëkohësisht edhe në kapitullin e akuzave të reja gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes penale, i cili do të trajtohet në këtë punim në kapitujt pasardhës.

Në këtë pjesë të punimit do të ndalemi në trajtimin teorik të ndryshimit të akuzave në seancë paraprake të parashikuar në nenin 332/d të K.Pr.Penale për shkak se jemi në pamundësi për t'i ilustruar me shembuj nga praktika gjyqësore për vetë faktin se ndryshimet e reja hyjnë në fuqi më datë 1 gusht 2017. Në këtë pikë punimi është mbështetur në jurisprudencën e gjykatave italiane pasi modeli i ndryshimit të akuzës në seancën paraprake rezulton të jetë i ngjashëm me modelin italian mbi kontestimet e reja në seancë paraprake.

3.4. Ndryshimi i akuzës dhe njoftimi i akuzës për një vepër penale të re

Neni 332/d i K.Pr.Penale “Ndryshimi i akuzës në seancë paraprake” parashikon se:

“1. Kur gjatë seancës paraprake fakti del ndryshe nga ç’është përshkruar në kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq, rezulton një vepër tjetër penale, sipas shkronjës “b”, të paragrafit 1, të nenit 79, apo del një rrethanë rënduese që nuk është përmendur, prokurori ndryshon akuzën dhe ia komunikon të pandehurit të pranishëm. Kur i pandehuri nuk është i pranishëm, akuzat e reja i komunikohet mbrojtësit të tij, të cilit i jepen jo më shumë se 10 ditë kohë për të komunikuar me të pandehurin.

2. Kur gjatë seancës paraprake në ngarkim të të pandehurit del një fakt i ri penal që nuk është përmendur në kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq dhe për të cilin duhet të procedohet kryesisht, gjykata lejon komunikimin e akuzës për faktin e ri, kur prokurori paraqit kërkesë dhe i pandehuri jep pëlqimin. Në rast të kundërt, gjykata i kthen prokurorit aktet që lidhen me akuzën e re dhe njofton drejtuesin e prokurorisë.

3. Kur gjatë seancës paraprake del se cilësimi juridik i faktit është i gabuar, ose kur akuza nuk është formuluar në mënyrë të qartë dhe të saktë, gjykata fton prokurorin që të bëjë korrigjimet ose saktësimet e nevojshme. Në rast se prokurori nuk vepron, gjykata vendos t'i kthejë aktet. Ky vendim i njoftohet drejtuesit të prokurorisë. “

Neni 332/d, paragrafi 1 i K.Pr.Penale të ndryshuar, paraqet dy situata juridike të cilat lidhen me: *së pari*, ndryshimin e akuzës prej prokurorit në seancë paraprake kur fakti del ndryshe nga ç'është përshkruar në kërkesën për dërgimin e çështjes për gjykim e *së dyti*, kur rezulton një vepër tjetër penale që ka lidhje me atë për të cilën është sjellë i pandehuri ose kur del një rrethanë rënduese që nuk është përmendur në kërkesën për dërgimin e çështjes penale në gjykim.

Të dyja rastet e përmendura më lart në ndryshimet e reja janë përfshirë në të njëjtën situatë juridike që lidhet me ndryshimin e akuzës ndonëse të dyja këto raste janë të ndryshme nga njëra tjetra.

Ndryshimi i akuzës prej prokurorit në seancë paraprake mund të bëhet në rastin kur fakti i hetuar prej tij rezulton i ndryshëm gjatë prezantimit të bërë në seancë paraprake. Siç e kemi përmendur edhe më sipër, në zhvillimin e seancës paraprake bazuar në nenin 332/c paragrafi 2 të K.Pr.Penale, prokurori paraqet në mënyrë të përmbledhur rezultatet e hetimit duke treguar edhe provat ku mbështetet kërkesa për dërgimin e çështjes penale në gjyq.

Për t'u plotësuar kushti i ndryshimit të akuzës sipas nenit 332/d paragrafi 1 i K.Pr.Penale, duhet që fakti penal i prezantuar prej prokurorit në seancë paraprake të dalë ndryshe nga ai fakt që është përshkruar në kërkesën për dërgimin e çështjes për gjykim. Kur ligji i referohet faktit penal të hetuar duhet të kemi parasysh se fakti penal është pjesë thelbësore e elementit të akuzës.

Me fakt penal të konstatuar në hetim do të kuptojmë tërësinë e provave të mbledhura nga prokurori gjatë fazës së hetimit, të cilat pasqyrojnë veprimet ose mosveprimet e të pandehurit të kryera në rrethana të përcaktuara në mënyrë të qartë, me të cilat është shkelur apo cënuar një marrëdhënie shoqërore (vlerë apo e mirë juridike) e mbrojtur posaçërisht e konkretisht nga ligji penal. Pra kur i referohemi faktit penal, kemi parasysh faktin prej të cilit duhet të vërtetohet nëpërmjet provave kryerja ose jo e veprës penale, pasojave të ardhura prej saj, fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit si dhe shkallën e përgjegjësisë së tij⁶⁹.

Në këtë kuptim procesi gjyqësor shërben për të provuar faktet që kanë vlerë juridike. Faktet që duhet të vërtetohen me procedurë sipas doktrinës së procedurës penale quhen “fakte juridike relevante”. Faktet juridike relevante janë të gjitha faktet ekzistuese të cilat janë përfshirë në kushtet që i parashtron e drejta penale materiale mbi caktimin e sanksionit penal. Këto fakte gjenden në kushtet në të cilat e drejta e procedurës penale e lidh detyrimin e gjykatës të zhvillojë procedurën penale si dhe faktet të cilat gjenden në kushtet nga të cilat varet mënyra e ushtrimit të veprimeve procedurale⁷⁰.

Në këtë rast fakti penal i përcaktuar qartë merr një rëndësi të madhe edhe nga pikëpamja kushtetuese për shkak se fakti penal është një element thelbësor i akuzës pasi ai përfshihet në elementin e shkakut të akuzës. Siç e kemi përmendur edhe më sipër, jurisprudenca e Gjykatës

⁶⁹ Neni 149 i K.Pr.Penale

⁷⁰ Dr. Sahiti Ejup “E drejta e Procedurës Penale” Prishtinë 2005 faqe 134

Kushtetuese në vendimin e saj nr. 4 datë 10.02.2012 ka parashikuar si një të drejtë themelore në funksion të procesit të rregullt ligjor njoftimin që duhet t'i bëhet të pandehurit mbi shkakun dhe natyrën e akuzës prej autoriteteve shtetërore të ngarkuara nga ligji. Pra fakti penal duhet të jetë përcaktuar qartë në përfundim të hetimit me qëllim që ai të kuptohet drejt nga i pandehuri.

Me shprehjen *fakti penal del ndryshe nga ç'është përshkruar në kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq* duhet të kuptojmë rastin kur elementët përbërës të tij të evidentuara në hetim, në momentin e hartimit përfundimtar të akuzës prej prokurorit, janë ometuar ose nuk janë vlerësuar drejt prej tij. Pra fakti penal është i hetuar prej prokurorit dhe për këtë nuk ka asnjë dyshim, por elementët përbërës të tij nuk janë perceptuar drejt gjatë njoftimit të akuzës e këto elementë janë vënë në diskutim në seancën paraprake. Në seancë paraprake prokurori ka mundësi të reflektojë për elementët e faktit të përshkruar prej tij në kërkesën për gjykim dhe mbi bazën e këtij perceptimi ai mund të ndryshojë akuzën.

Për të ilustruar situatën e mësipërme po japim një shembull nga praktika:

Në kërkesën për dërgimin e çështjes për gjykim prokurori kërkon gjykimin e të pandehurit për veprën penale të *Trafikimit të narkotikëve mbetur në tentativë* parashikuar nga neni 283/a/1 e 22 të Kodit Penal. Në seancë paraprake gjatë prezantimit të rezultateve të hetimit dhe provave ku mbështetet kërkesa për gjykim, prokurori nuk ka vlerësuar drejt shkëmbimin e mesazhve telefonike që i pandehuri ka bërë në telefonin e tij me një person tjetër që nga përmbajtja e të cilave rezulton se personi i pidentifikuar në hetim është personi që kishte porositur lëndën narkotike dhe do të priste lëndën narkotike që do ta eksportonte i pandehuri. Këto të dhëna të çojnë në konkluzionin e një bashkëpunimi që i pandehuri e ka realizuar me një person tjetër.

Të dhënat kanë qenë pjesë e hetimit paraprak pasi ato janë përfutur nga këqyrja e aparatit celular të të pandehurit kryer prej policisë gjyqësore që kishte sekuestruar këtë send në momentin e ndalimit të të pandehurit. Shkëmbimi i mesazheve telefonike ka qenë pjesë e akteve të hetimit të përfshirë në fashikullin e sjellë për gjykim. Prokurori në fillim nuk ka vlerësuar drejt një rrethanë cilësuese me praninë e së cilës është kryer vepra penale e Trafikimit të narkotikëve, pavarësisht se kjo rrethanë ka qenë e evidente dhe e konstatuar si e tillë gjatë hetimit. Në seancën paraprake rrethana e evidentuar e ndryshon faktin e tillë perceptohet tashmë drejt prej prokurorit i cili në këtë moment mund të veprojë duke i njoftuar të pandehurit akuzën e ndryshuar nga ajo e *Trafikimit të narkotikëve mbetur në tentativë* parashikuar nga neni 283/a/1 e 22 të Kodit Penal në atë të *Trafikimit të narkotikëve në bashkëpunim mbetur në tentativë* parashikuar nga neni 283/a/2 e 22 të Kodit Penal.

Pra modifikimi i akuzës prej prokurorit në seancë paraprake në rastin më të mirë lidhet vetëm me vlerësimin e ri që prokurori u bën disa rrethanave apo elementëve të faktit të evidentuara në hetim, por të pa vlerësuar drejt prej tij në momentin e hartimit të akuzës përfundimtare. Për të kapërcyer këtë situatë e cila mund ta kthente hetimin edhe një herë prapa është parashikuar rasti i ndryshimit të akuzës në seancë paraprake, ndryshim i cili nuk sjell elemente të reja në drejtim të faktit penal të panjohur më parë prej të pandehurit, por sjell një vlerësim të ri që prokurori i bën faktit penal të hetuar tashmë prej tij.

Në rast përjashtimor ndryshimi i akuzës prej prokurorit mund të kryhet prej tij në seancë paraprake duke u mbështetur në të dhëna të cilat janë përfutur gjatë seancës paraprake, të cilat nuk i janë nënshtruar më parë hetimit prej prokurorit. Mbështetur në nenin 332/c të K.Pr.Penale,

seanca paraprake zhvillohet në prani të prokurorit, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij si dhe në prani të viktimës apo palëve private kur këto palë janë të pranishme në seancë. Në seancë paraprake i pandehuri ka të drejtë të parashtojë kërkesa që lidhen me pavlefshmërinë e akteve procedurale, papërdorshmërinë e provave, nevojën për marrjen e provave të reja, të cilat në vetvete mund të reflektojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në elementet e akuzës të ngritur prej prokurorit.

Përjashtimi i një prove mbi të cilën është mbështetur prokurori për hartimin e akuzës, për shkak të papërdorshmërisë së saj, konstatimi i një akti të pavlefshëm për shkak të shkeljes së detyrimit ligjor prej prokurorisë apo policisë gjyqësore, si dhe marrja e provave të reja të kërkuara prej të pandehurit në seancë paraprake (përfshirë edhe të drejtën që ai gëzon për t'u pyetur në lidhje me procedimin penal) i japin mundësi prokurorit të reflektojë për vlerësimin edhe një herë të faktit penal, kur nën dritën e zhvillimeve të reja të konstatuara në seancë paraprake fakti paraqitet tashmë i ndryshëm nga ai që ishte sjellë për gjykim. Edhe në këtë rast prokurori ka mundësi të ndryshojë akuzën ndaj të pandehurit.

Rasti i dytë i parashikuar nga neni 332/d paragrafi 1 i K.Pr.Penale bën fjalë për konstatimin e një veprë penale të re që ka lidhje me atë që është sjellë për gjykim, referuar nenit 79/1 gërma "b" i K.Pr.Penale apo me një rrethanë rënduese që nuk është përmendur në kërkesën e prokurorit.

Në lidhje me rrethanën rënduese mendojmë se vlejnjë të njëjtat rregulla që i përmendëm më sipër mbi ndryshimin e akuzës për shkak se fakti rezultonte i ndryshëm nga ç' ishte përshkruar prej prokurorit në kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq. Më konkretisht nëse rrethana rënduese është evidentuar si e tillë gjatë hetimit por nuk është përmendur prej prokurorit në kërkesën për gjykim dhe në seancën paraprake një rrethanë e tillë rënduese bëhet e evidente, prokurori në këtë rast i njofton të pandehurit rrethanën rënduese të cilën ai për shkak të një vlerësimi jo të drejtë, nuk ja kishte njoftuar të pandehurit në kërkesën për dërgimin e çështjes për gjyq.

Rrethana rënduese bëhet pjesë e akuzës dhe formulimi i ri i njoftohet të pandehurit në seancë paraprake prej prokurorit, me qëllim që i pandehuri të jetë i qartë për të gjitha elementet e akuzës për nevoja të përgatitjes së mbrojtjes së tij.

Njëkohësisht neni 332/d paragrafi 1 i K.Pr.Penale parashikon mundësinë që në seancë paraprake prokurori t'i komunikojë të pandehurit akuzën për një vepër tjetër penale që ka lidhje me atë për të cilën i pandehuri është sjellë në gjykim, lidhje kjo që është parashikuar nga neni 79/1 gërma "b" i K. Pr. Penale.⁷¹

Neni 79 i K.Pr.Penale parashikon rastet e bashkimit të procedimeve penale, ndërkohë pika "b" e këtij neni parashikon rastin e bashkimit të procedimit penal kur një i pandehur ka kryer disa vepra penale. Pra prokurori në seancë paraprake mund t'i njoftojë të pandehurit një akuzë të re për një vepër penale që ai dyshohet se ka kryer e që ka lidhje me akuzën e parë të sjellë

⁷¹ Neni 79 i K.Pr.Penale mbi rastet e bashkimit të procedimeve penale, në paragrafin e parë në gërmën "b" të tij përcakton se: "1.Organi procedues mund të vendosë bashkimin e procedimeve: ...b) kur një person akuzohet për disa vepra penale;"

për gjykim. Që të ndodhemi përpara kësaj situate duhet të ekzistojë kushti i konkurrimit të veprave penale.

Në lidhje me konkurrimin e veprave penale kujtojmë se është një institut i së drejtës penale i parashikuar si i tillë nga neni 55 i Kodit Penal⁷². Mbi konkurrimin e veprave penale do të flasim në kapitullin e akuzave të reja në fazën e gjyqimit por në këtë rast shkurtimisht mund të themi se ndodhemi në rastin e *konkurrimit ideal* të veprave penale kur bëhet fjalë për njoftimin e një akuzë të re për një vepër penale që rezulton në seancë paraprake dhe që ka lidhje me akuzën e parë që është sjellë për gjykim i pandehuri.

Në rastin e njoftimit të një vepre penale të re në seancë paraprake, prokurori ndodhet në situatën e konkurrimit ideal të veprave penale⁷³. Pra në këtë rast elementët bazë të njoftimit të një vepre të re penale që ka lidhje me atë për të cilën i pandehuri është sjellë për gjykim, janë tashmë të evidentuara kryesisht në fazën e hetimeve paraprake. Ky përfundim mbështetet në natyrën e konkurrimit ideal të veprave penale. Veprimi i të pandehurit për të cilin ai është sjellë në gjykim dhe është i evidentuar gjatë hetimit paraprak, përmban elementë të dy ose më shumë veprave penale dhe në gjykim i pandehuri është sjellë fillimisht për një vepër penale.

Për ta kuptuar më mirë këtë situatë po japim një shembull:

I pandehuri është futur në banesën e një personi kur ky i fundit nuk ka qenë në shtëpi, ka marrë në banesë vlera monetare dhe sende të çmuara që i pandehuri i ka gjetur të fshehura në një vend të caktuar në banesë dhe njëkohësisht i pandehuri për të hyrë dhe për të dalë nga banesa ka shkatërruar derën kryesore të banesës, ka thyer xhamat e dritares së banesës si dhe ka shkatërruar disa sende me vlerë ekonomike si televizor, frigorifer dhe orendi të tjera shtëpiake, të cilat i pandehuri nuk ka pasur mundësi që t'i merrte me vete si sende të vjedhura.

Të gjitha të dhënat e përmendura më lart janë evidentuar në hetim si pjesë e veprimit të kryer prej të pandehurit. Në fazën e njoftimit të akuzës prokurori i komunikon të pandehurit akuzën e “Vjedhjes” parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal, pasi vepra penale nuk është kryer në asnjë prej rrethanave cilësuese që parashikojnë paragrafët e tjerë të kësaj dispozite penale.

Në seancë paraprake gjatë parashtrimit të rezultateve të hetimit, në përshkrimin me hollësi të veprimeve që i pandehuri kishte kryer kur ishte futur në banesë, prokurori deklaroi se i pandehuri kishte shkatërruar edhe disa sende, të cilat ai nuk kishte mundur t'i merrte me vete si sende të vjedhura, të cilat kishin vlerë ekonomike në bazë të një akti ekspertimi vlerësues të kryer në hetim dhe si rrjedhim pasojat materiale për të dëmtuarin nga ky veprim ishin të mëdha.

Në këtë rast prokurori konstaton se i pandehuri ka kryer dy vepra penale me të veprimit të tij në banesën e të dëmtuarit. Këto vepra penale janë pasojë e veprimit të kryer prej të pandehurit në banesën e të dëmtuarit. Rrjedhimisht bazuar në nenin 55 paragrafi 1 të K.Penal, fakti penal

⁷² Neni 55 paragrafi 1 i Kodit Penal parashikon se: “Kur veprimet ose mosveprimet përmbajnë elementët e disa veprave penale, si dhe kur personi ka kryer disa vepra penale për të cilat nuk është dhënë akoma vendimi, gjykata më parë cakton dënimin për çdo vepër penale dhe në përfundim jep një dënim të vetëm, që përbëhet nga dënimi më i rëndë i shtuar.”

⁷³ Conso Giovanni, Grevi Vittorio “Compendio di Procedura Penale” seconda edizione “CEDAM 2003, faqe 705

i përkon rastit të konkurrimit ideal të veprave penale kur me veprimin e tij i pandehuri kryen dy ose më shumë vepra penale.

Në rastin konkret prokurori në seancë paraprake përveç akuzës për “Vjedhje” të parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal mund t’i njoftojë të pandehurit edhe akuzën e re që ka lidhje me akuzën e parë për shkak të konkurrimit ideal të veprave penale që është akuza e “Shkatërrimit të pronës” e parashikuar nga neni 150 i K.Penal. Një veprim të tillë procedural prokurori mund ta kryejë në seancë paraprake si pjesë e ushtrimit të ndjekjes penale prej tij.

3.4.1. Propozimi për ndryshimin e nenit 332/d paragrafi 1 të K.Pr.Penale

Ashtu siç e kemi përmendur më sipër neni 332/d i K.Pr.Penale, në dy paragrafët e tij është bazuar në modelin e përcaktuar nga neni 423 i K.Pr.Penale të italisë. Në përgjithësi neni 332/d paragrafi 1 i K.Pr.Penale është hartuar drejt në pikëpamje të teknikës së përdorur pasi në të dalin në pah elementët e ndryshimit të akuzës, njoftimin e akuzës për veprën penale të re që ka lidhje me atë që është sjellë për gjykim apo edhe rrethanën rënduese që nuk është përmendur në kërkesën për dërgimin e çështjes në gjykim.

Gjithsesi në hartimin e këtij paragrafi mendoj se është përmendur si veprim specifik që mund të realizojë prokurori vetëm ndryshimi i akuzës dhe këtë ndryshim ai i’a komunikon të pandehurit të pranishëm në seancë paraprake.

Me qëllim përmirësimit të këtij paragrafi propozoj që veprimet e prokurorit që lidhen me kontestimet e reja duhet të përfshihen si veprimi i njoftimit të akuzës për veprën penale që rezultoi në seancë paraprake nëse ka dhe njoftimi i rrethanës rënduese. Në këtë pikëpamje ky propozim gjen harmoni edhe me nenin 423/1 të K.Pr.Penale të italisë.

Për këtë qëllim mendoj se neni 332/d paragrafi 1 i K.Pr.Penale duhet të riformulohet si në vijim:

“1.Kur gjatë seancës paraprake fakti del ndryshe nga ç’është përshkruar në kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq, rezulton një vepër tjetër penale, sipas shkronjës “b”, të paragrafit 1, të nenit 79, apo del një rrethanë rënduese që nuk është përmendur, prokurori ndryshon akuzën, shton veprën penale të re ose rrethanën rënduese dhe ia komunikon të pandehurit të pranishëm. Kur i pandehuri nuk është i pranishëm, akuza e re i komunikohet mbrojtësit të tij, të cilit i jepen jo më shumë se 10 ditë kohë për të komunikuar me të pandehurin.”

3.5. Njoftimi i akuzës për faktin e ri penal

Neni 332/d i K.Pr.Penale në paragrafin 2 parashikon situatën e njoftimit të akuzës në seancë paraprake për një fakt të ri penal. Nëpërmjet kësaj dispozite i jepet mundësia prokurorit që të ushtrojë ndjekjen penale edhe gjatë fazës së shqyrtimit të kërkesës që ai ka paraqitur në seancë paraprake mbi dërgimin e çështjes penale në gjykim.

Ushtrimi i ndjekjes penale prej prokurorit në këtë rast drejtohet jo vetëm kundër të pandehurit për akuzën e parë të sjellë në kërkesën për gjykim por kjo ndjekje penale fillon për

një fakt të ri që evidentohet prej prokurorit në seancë paraprake. Që të ushtrohet ndjekja e dytë penale prej prokurorit ndaj të pandehurit në seancë paraprake duhet të plotësohen disa kushte të parashikuara nga neni 332/d paragrafi 2 i K.Pr.Penale.

Së pari prokurori duhet të ketë sjellë në gjykatë një kërkesë për dërgimin e çështjes në gjykim ndaj të pandehurit, kërkesë e cila shqyrtohet në seancë paraprake nga një gjyqtar. Në kërkesën për gjykim prokurori normalisht ka përfunduar hetimin ndaj të pandehurit, ka mbledhur provat e nevojshme si dhe i ka njoftuar përfundimisht akuzën për kryerjen e një vepre penale.

Së dyti, gjatë shqyrtimit të kërkesës së prokurorit në seancë paraprake del një fakt i ri i cili nuk është përmendur në kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq dhe për të cilin duhet të procedohet kryesisht. Kur kjo dispozitë i referohet një fakti të ri penal duhet të kemi parasysh që me fakt të ri do të kuptojmë tërësinë e të dhënave të cilat njoftojnë për ekzistencën e një dyshimi të kryerjes së një vepre penale prej të pandehurit. Fakti i ri i evidentuar në seancë paraprake normalisht përfshin të dhëna fillestare me të cilat mund të ngrihet dyshimi i lidhjes së të pandehurit me kryerjen e një vepre tjetër penale prej tij, të ndryshme nga ajo që është sjellë për gjykim prej prokurorit. Pra fakti i ri penal ka nevojë të verifikohet më tej nëpërmjet procesit të hetimit.

Fakti i ri penal sipas kësaj dispozite nuk duhet të jetë i përmendur në kërkesën e sjellë për gjykim prej prokurorit. Kjo do të thotë se fakti i ri penal nuk ka asnjë lidhje objektive (lidhje nëpërmjet veprimeve me natyrë kriminale) me veprën penale për të cilën i pandehuri është sjellë për gjykim. Pra fakti i ri penal i referohet një ngjarje tjetër kriminale e cila normalisht ka ndodhur në një kohë dhe vend tjetër, të ndryshëm nga vepra penale për të cilën i pandehuri është sjellë për gjykim. E vetmja lidhje midis faktit të ri penal dhe veprës penale ekzistuese, elementet e së cilës shqyrtohen në seancë paraprake është i pandehuri si subjekti i dyshuar se ka kryer të dy veprat penale. Në këtë rast lidhja midis faktit të ri penal dhe veprës penale të sjellë për gjykim materializohet në një lidhje subjektive.

Vetëm për shkak të lidhjes subjektive bëhet e mundur që prokurori në seancën paraprake të procedojë në të njëjtën seancë kur është rasti edhe me njoftimin e akuzës së dytë për të pandehurin që lidhet me faktin e ri penal të evidentuar në seancën paraprake.

Fakti i ri mund të evidentohet në seancë paraprake nga parashtrimet e subjekteve që marrin pjesë në këtë seancë. Mund të themi së paku teorikisht, se fakti i ri penal në seancë paraprake mund të parashtrohet edhe nga viktimat e veprës penale që është subjekt pjesëmarrës në këtë seancë.

Më konkretisht seanca paraprake, pavarësisht se është seancë në të cilën verifikohen vetëm aktet procedurale dhe provat e mbledhura nga prokurori gjatë hetimit paraprak, në të mund të marrin pjesë edhe viktimat ose trashëgimtarët e saj. Në seancë paraprake viktimat kanë të drejtë të parashtrajnë përpara gjyqtarit pretendimet e tyre në lidhje me hetimin dhe pozicionin që ata mbajnë në lidhje me hetimet e kryera⁷⁴. Në parashtrimin e tyre viktimat mund të ofrojnë në dobi

⁷⁴ Neni 332/c paragrafi 4 i K.Pr.Penale që hyn në fuqi më datë 1 gusht 2017 në lidhje me zhvillimin e seancës paraprake dhe pjesëmarrjen e viktimës së veprës penale në këtë seancë parashikon: “4. Pas të pandehurit paraqesin pretendimet e tyre viktimat dhe palët e tjera private, kur janë të pranishme.”

të procedimit të dhëna të reja, të cilat mund të formojnë elementët e një fakti të ri penal që nuk është ditur më parë nga prokuroria.

Si rrjedhim prokurori ka mundësi reale që në seancë paraprake në lidhje me këtë fakt të ri të procedojë në dy mënyra. Nëse ai është i qartë e nuk ka nevojë për veprime të mëtejshme, i njofton të pandehurit në seancë paraprake akuzën për faktin e ri të evidentuar, në të kundërt prokurori mund të tërheqë aktet për faktin e ri duke ndjekur rrugën e zakonshme me fillimin e hetimeve..

Për ta ilustruar atë çfarë thamë më sipër mund të sjellim një shembull.

I pandehuri është sjellë për gjykim nga prokuroria me akuzën e “Plagosjes së rëndë” me dashje ndaj viktimës parashikuar nga neni 88/1 i Kodit Penal. Në seancë paraprake pasi prokurori dhe i pandehuri me mbrojtësin e tij parashtruan qëndrimet e tyre në lidhje me procedimin penal, në radhë për të paraqitur parashtrimet e tij u paraqit edhe viktima. Viktima ndër të tjera pasi mbaroi prezantimin e tij për ngjarjen që lidhej me plagosjen e tij prej të pandehurit, deklaroi se i pandehuri paraqet rrezikshmëri të lartë shoqërore dhe nuk është ndaluar vetëm në kryerjen e veprës penale të plagosjes së rëndë me dashje. Viktima deklaroi se i pandehuri ka kryer edhe veprën penale të “Ndërtimit të paligjshëm” në tokë publike, parashikuar nga neni 199/a paragrafi 2 i K. Penal, pasi ai po kryen punime të reja në një tokë publike, pa leje dhe punimet kanë shkuar në katin e tretë të ndërtimit.

Për këtë fakt viktima sjell në seancë edhe disa dokumente të cilat përlligjin deklarin e tij mbi ndërtimin e paligjshëm.

Në këtë moment prokurori është i detyruar - për këtë fakt të ri të evidentuar në seancë paraprake - të procedojë në përputhje me nenin 332/d paragrafi 2 të K.Pr. Penale.

Fakti i ri siç e përmendëm edhe më sipër, nuk duhet të jetë përmendur në kërkesën për gjykim si dhe është e kuptueshme që për faktin e ri penal prokuroria duhet të procedojë kryesisht, që do të thotë se fakti i ri penal i referohet kategorive të veprave penale për të cilat prokuroria vepron *ex officio*.

Gjithashtu neni 332/d paragrafi 2 i K.Pr.Penale parashikon dhe mënyrat sesi duhet të veprojë prokurori në rast se në seancë paraprake evidentohet fakti i ri penal, i papërmendura në kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq. Sipas kësaj dispozite prokurori mund të veprojë në dy mënyra të cilat janë në varësi të qartësisë e mjaftueshmërisë së elementëve elementeve thelbësorë që përbëjnë faktin penal të ri. Këto mënyra janë:

a) Nëse fakti penal i ri është plotësisht i qartë dhe i mjaftueshëm për prokurorin, ai mund të procedojë më tej me njoftimin e akuzës për faktin e ri në drejtim të të pandehurit, nëse edhe i pandehuri jep pëlqimin për të proceduar me njoftimin e akuzës së re. Nëse arrihet kjo marrëveshje gjyqtari e lejon prokurorin që t’i komunikojë të pandehurit akuzën e re për faktin penal që u evidentua në seancë paraprake. Më tej i pandehuri do të përgatitet për gjykim për dy ose më shumë vepra penale të akuzuara prej prokurorit.

b) Në rast se fakti i ri penal nuk është i plotë deri në nivelin që prokurori mund të njoftojë akuzë, si dhe kur duhet të kryhen veprime të tjera hetimore, prokurori vepron sipas rregullimit të zakonshëm. Në këtë rast ai nuk komunikon akuzë për faktin e ri penal por i kërkon gjyqtarit t'i kthej aktet që lidhen me faktin e ri penal të evidentuar në seancë paraprake. Në të njëjtën mënyrë veprohet edhe në rastin kur i pandehuri nuk jep pëlqimin që prokurori t'i komunikojë akuzën për faktin e ri penal. Me kthimin për faktin e ri penal, prokurori procedon më përfaqësimin e akuzës për veprën e parë penale të cilën ai e ka sjellë për gjykim, ndërsa për faktin e ri penal, aktet e të cilit prokurorit i janë kthyer nga gjyqtari i seancës paraprake, prokurori vazhdon normalisht hetimin duke ndjekur rrugën e zakonshme në lidhje me kryerjen e hetimeve.

Ashtu siç u përmend mbi rastet e njoftimit të akuzës për një vepër tjetër penale edhe në rastin e njoftimit të akuzës për faktin e ri penal ndodhemi përpara një situatë e cila e ngarkon të pandehurin me kryerjen prej tij, të dy ose më shumë veprave penale. Në këtë rast veprat penale nuk kanë një lidhje organike me njëra tjetrën. Ato janë kryer në kohë e vende të ndryshme prej të pandehurit. Kështu që rasti i njoftimit të akuzës për një fakt të ri penal në seancë paraprake përkon me situatën juridike të bashkimit real të veprave penale e parashikuar si e tillë nga neni 55 paragrafi 1 të K. Penal. Më gjerësisht për këtë situatë juridike do të flasim në kapitullin mbi akuzat e reja gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes.

3.6. Ndryshimi i cilësimit juridik të faktit në seancë paraprake

Në paragrafin e tretë të nenit 332/d të K.Pr.Penale parashikohet mundësia e ndryshimit të cilësimit juridik të faktit të sjellë për gjykim nga prokurori. Kjo dispozitë procedurale në fakt parashikon disa situata juridike të cilat lejojnë gjyqtarin e seancës paraprake, në rastet kur prokurori nuk vepron me iniciativën e tij, të ndërhyjë në drejtim të përcaktimit të drejtë të cilësimit ligjor të faktit penal ose në drejtim të saktësisë dhe qartësisë së elementëve të akuzës së ngritur nga prokurori.

Fillimisht duhet të sqarojmë se ndërhyrja e gjyqtarit në këtë rast nuk është e natyrës hartuese të elementëve të akuzës. Siç edhe e kemi përmendur më lart ndjekja penale që përfshin hartimin, njoftimin dhe përfaqësimin e akuzës në gjykim është një atribut ekskluziv i prokurorit që Kushtetuta ja ka dhënë vetëm këtij organi kushtetues. Në këtë rast e vetmja alternativë që disponon gjyqtari i seancës paraprake, si mundësi e fundit për të është kthimi i akteve prokurorit nëse ky i fundit nuk vepron sipas ftesës (kupto udhëzimin) të dhënë prej gjyqtarit. Veprimi i kthimit të akteve prej gjyqtarit ka një natyrë regresive, pasi e kthen procedimin penal në fazën e hetimit paraprak për herë të dytë.

Neni 332/d paragrafi 3 parashikon dy raste se kur gjyqtari ndërhyr dhe e fton prokurorin që të bëjë korrigjimet ose saktësimet e nevojshme që lidhen me elementët e akuzës.

Rasti i parë lidhet me situatën kur gjyqtari vlerëson se cilësimi juridik i faktit penal prej prokurorit është i gabuar, për shkak të mos përputhshmërisë midis elementëve të faktit të hetuar dhe karakteristikave ligjore të dispozitës penale të përzgjedhur nga prokurori në aktin e njoftimit të akuzës. Kur kemi trajtuar akuzën jemi ndalur edhe në elementët thelbësore të saj, ku një prej tyre është dhe natyra e akuzës. Kur i referohemi natyrës së akuzës duhet të kemi parasysh cilësimin e drejtë ligjor që i bëhet veprimit kriminal të kryer prej të pandehurit.

Cilësimi i drejtë ligjor, me referencë të saktë në ligjin penal parashikon veprimin kriminal të kryer prej të pandehurit si vepër penale. Kështu që cilësimi i drejtë ligjor i faktit penal të hetuar është një komponent i rëndësishëm i përmbajtjes së akuzës.

Mund të ndodh që prokurori mbi bazën e të dhëna të mbledhura në hetim, mund të ketë përcaktuar drejt faktin penal, që do të thotë se ka përcaktuar drejt veprimet me natyrë kriminale të kryera prej të pandehurit, por nuk ka përcaktuar saktë cilësimin juridik të veprës penale që përkon me veprimin kriminal të të pandehurit. Ndodhemi përpara rastit të cilësimit juridik të gabuar të faktit penal kur nuk realizohet përputhshmëria midis elementeve të veprës penale të përcaktuar në ligjin penal me faktin penal të hetuar dhe të sjellë për gjykim.

Jemi përpara rastit të cilësimit juridik të gabuar të faktit penal kur psh., i pandehuri e ka vrarë viktimën për të “marrë gjakun” e vëllait të tij të vrarë prej viktimës më parë dhe pavarësisht se një fakti i tillë është evidentuar në hetim, prokurori gabimisht e ka cilësuar veprimin e vrasjes që kreu i pandehuri si veprën penale të “Vrasje me paramendim” për hakmarrje parashikuar nga neni 78/2 i Kodit Penal. Në këtë rast cilësimi i duhur ligjor duhet të ishte “Vrasje për gjakmarrje” parashikuar nga neni 78/a i Kodit Penal.

Në një rast të tillë gjyqtari në seancë paraprake duhet të ftojë prokurorin të rregullojë cilësimin juridik të veprës penale. Normalisht prokurori nëse ndodhet përpara kësaj situate duhet të procedojë sipas parashikimit të nenit 332/d paragrafi 1 i K.Pr.Penale. Mbështetur në paragrafin e parë të kësaj dispozite procedurale prokurori duhet të ndryshojë akuzën në seancë paraprake nga ajo e “Vrasje me paramendim” për hakmarrje, parashikuar nga neni 78/2 i Kodit Penal në atë të “Vrasjes për gjakmarrje” parashikuar nga neni 78/a i Kodit Penal. Nëse prokurori nuk vepron në këtë situatë të qartë juridike, atëherë gjyqtari procedon me kthimin e akteve prokurorit. Me kthimin e akteve prokurorit fillon për herë të dytë faza e hetimit paraprak.

Rasti i dytë i ndërhyrjes së gjyqtarit të seancës paraprake lidhet me situatën kur akuza nuk është formuluar në mënyrë të qartë dhe të saktë. Sipas këtij rasti gjyqtari nuk kufizohet vetëm në verifikimin e elementëve të cilësimit ligjor të faktit penal por ai e shtrin verifikimin e tij edhe në elementët e qartësisë dhe saktësisë së akuzës. Elementet e qartësisë dhe saktësisë së akuzës të referojnë tek komponenti i shkakut të akuzës.

Kur i referohemi komponentit të shkakut të akuzës duhet të kemi parasysh tërësinë e veprimeve apo mosveprimeve të ndërmara prej të pandehurit, të cilat i identifikojnë këto veprime si vepër penale të parashikuar nga ligji penal. Në këtë kuptim gjyqtari në seancë paraprake verifikon edhe cilësinë e hetimit nëse ai është i plotë ose jo.

Akuzë e paqartë do të thotë se në hetim mungojnë elementë provueshmërie për të qartësuar plotësisht veprimin ose veprimet kriminale të kryera prej të pandehurit. Ndodhemi përpara një akuze të paqartë në rastin kur prokuroria ka akuzuar të pandehurin për veprën penale të “Vrasjes me dashje” të mbetur në tentativë parashikuar nga neni 76 e 22 të Kodit Penal, kur i pandehuri e ka goditur me një mjet mprehës të dëmtuarin në kofshë, një herë dhe plaga e krijuar nga goditja ishte sipërfaqësore dhe për këtë rast nuk ka elementë të mjaftueshëm provueshmërie që të konfirmonin faktin penal se goditja e vetme është bërë me qëllim vrasjen e të dëmtuarit. Në ndryshim nga akuza e cila është e paqartë për shkak të elementëve provues të mjaftueshëm gjyqtari mund të ftojë prokurorin të ndryshojë akuzën pasi referuar elementëve të provueshmërisë fakti penal përkon me veprën penale të “Plagosjes së rëndë me dashje”

parashikuar nga neni 88/1 i Kodit Penal sepse në bazë të provave të mbledhura ka rezultuar se plagosja ka qenë e rrezikshme për jetën në çastin e shkakimit të saj. Pas këtij veprimi i pandehuri nuk kishte qenë i interesuar për të vazhduar më tej goditjet në drejtim të trupit të të dëmtuarit.

Akuzë e pasaktë do të thotë përcaktim jo i plotë i faktit penal në raport me cilësimin ligjor të kryer prej prokurorit. Në këtë rast të fundit mund të themi se fakti penal në vetvete është i plotë dhe nuk ka nevojë të plotësohet me elementë shtesë të provueshmërisë. Ajo se çfarë e bën të pasaktë akuzën në këtë rast nuk është fakti penal i hetuar por cilësimi juridik që në këtë rast është jo preciz. Ndodhemi përpara situatës së akuzës së pasaktë kur veprimi kriminal i kryer prej të pandehurit është evidentuar drejt nga prokuroria në hetim, por për këtë veprim kriminal prokuroria ka ngritur ndaj të pandehurit një akuzë në vend që të ngrinte dy ose më shumë akuza.

Përshembull në rastin kur i pandehuri i ka vënë viktimës lëndë plasëse ekspoziv në banesë me qëllim për ta vrarë atë dhe si rezultat i shpërthimit të komanduar viktima vdes në banesën e tij, ndërsa banesa pësoi dëmtime të rënda materiale. Në këtë rast prokurori e akuzon të pandehurin vetëm për veprën penale të “Vrasjes me paramendim” për hakmarrje parashikuar nga neni 78/2 i Kodit Penal dhe më pas paraqet kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq në gjykatë.

Normalisht referuar këtij fakti gjyqtari i seancës paraprahe duhet të konstatojë se akuza e ngritur nga prokurori nuk është e saktë pasi referuar faktit penal (i cili është i plotë,) i pandehuri duhej të akuzohej nga prokuroria edhe për veprat penale të “Shkatërrimit të pronës me ekspoziv” parashikuar nga neni 152 paragrafi 2 i Kodit Penal si dhe veprën e “Mbajtjes pa leje të lëndëve plasëse” parashikuar nga neni 278/7 i Kodit Penal. Në këtë rast gjyqtari duhet të ftojë prokurorin të saktësojë akuzën përfundimtare ndaj të pandehurit.

Në të dy rastet e paqartësisë dhe pasaktësisë së akuzës gjyqtari në seancë paraprahe fton prokurorin që të procedojë sipas nenit 332/d paragrafët 1 e 2 të K.Pr.Penale. Nëse prokurori refuzon ftesën e gjyqtarit për të proceduar me qartësimin dhe saktësimin e elementëve të akuzës, atëherë gjyqtari vendos kthimin e akteve prokurorit duke njoftuar edhe drejtuesin e prokurorisë për këtë vendim.

3.7. Vlerësime të përgjithshme mbi ndryshimin e akuzës në seancë paraprahe

Fillimisht nënvizojmë se ndryshimi i akuzës në seancë paraprahe dhe kapitulli i akuzave të reja në shqyrtimin gjyqësor kanë ngjashmëri me njëra – tjetrën. Në të dy rastet prokurori mund të ndryshojë akuzën e parë të komunikuar në të njëjtën situatë, mund të njoftojë një akuzë të re për një vepër penale që ka lidhje me atë për të cilën i pandehuri është sjellë për gjykim, mund të njoftojë një akuzë të re për një fakti të ri penal që nuk është përmendur në kërkesën për gjykim.

Pavarësisht se ngjashmëritë janë të dukshme, përsëri ndryshimi i akuzës në seancë paraprahe nuk mund të zëvendësojë kapitullin e akuzave të reja. Ndryshimi i akuzave në seancë paraprahe është një instrument në të cilin si prokurori ashtu edhe gjyqtari ndërveprojnë referuar kryesisht akteve të sjella për gjykim nga prokurori. Pra vendimi për të ndryshuar akuzën, shtuar një akuzë të re për një vepër penale që ka lidhje me atë që është sjellë për gjykim, njoftuar një

akuzë për një fakt të ri penal të papërmendur në kërkesën për gjykim bazohet në aktet procedurale të mbledhura gjatë fazës së hetimit paraprak.

Rrjedhimisht dhe vendimi i ndryshimit të akuzës në këtë rast është “i pjesshëm” pasi bazohet vetëm në aktet e prokurorit. Qëllimi i vendosjes së modelit të ndryshimit të akuzës në seancë paraprake lidhet me verifikimin e akuzës nga një gjyqtar përpara se çështja e dërguar për gjykim t’i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor në themel. Pra në këtë rast gjyqtari i seancës paraprake funksionon si hallkë kontrolli në verifikimin e cilësisë së hetimit të kryer nga prokurori dhe akuzës së ngritur prej tij referuar faktit penal të hetuar. Pas këtij verifikimi dosja penale shkon në gjykim më e plotë duke reduktuar problemet që mund të lindin në gjykim me akuzën e hartuar prej prokurorit.

Gjithsesi më sipër u citua se ndryshimi i akuzës në seancë paraprake nuk zëvendëson kapitullin e akuzave të reja. Në gjykimin e çështjes penale në themel, akuzat e reja si model lejojnë prokurorin të ndryshojë akuzën, të shtojë një akuzë për një veprë penale të re, apo një akuzë për një fakt të ri penal gjatë shqyrtimit gjyqësor. Një veprim i tillë prej prokurorit në gjykim është një produkt që normalisht rezulton nga debati gjyqësor i provave të shqyrtuara. Rrjedhimisht në këtë rast akuzat e reja të shfaqura nga gjykim janë më të qëndrueshme e më të plota për shkak se ato mbështeten në debatin e provave të shqyrtuara.

Për këtë arsye mund të themi se ndryshimi i akuzave në seancë paraprake nuk zëvendëson akuzat e reja në gjykim.

Kështu që dhe në trajtimin e ndryshimit të akuzave në seancë paraprake nuk janë përfshirë të gjitha elementet e akuzave të reja pasi këto elementë evidentohen qartësisht vetëm gjatë debatit gjyqësor e për këtë arsye trajtimi i akuzave të reja do jetë më i plotë.

Trajtimi i ndryshimit të akuzës në seancë paraprake është kryesisht një trajtim teorik për shkak se ndryshimet e reja në Kod do të hyjnë në fuqi më datë 1 gusht 2017 dhe si rrjedhojë këto dispozita nuk janë shoqëruar me praktikë gjyqësore. Gjithsesi modeli i ndryshimit të akuzës në seancë paraprake i përfshirë në ndryshimet e reja në Kod është një model i ngjashëm me modelin italian mbi ndryshimin e akuzës. Për rrjedhojë është e rëndësishme referimi i jurisprudencës së gjykatave italiane të cilat kanë trajtuar elementet e akuzës dhe seancën paraprake.

Më poshtë do të sjellim një rast nga praktika gjyqësore Italiane mbi akuzën që prokurori që prokurori ka sjellë për shqyrtim në seancë paraprake dhe mënyrën sesi duhet të veprojnë gjyqtari kur akuzat nuk është e qartë dhe e saktë.

3.8. *Akuza gjenerike dhe vlerësimi i saj në seancë paraprake*

Seanca paraprake është një hallkë e rëndësishme në gjithë procedimin penal pasi në këtë seancë për herë të parë gjyqtari verifikon kërkesën e sjellë për gjykim nga prokurori, pra nëse ajo është e plotë apo ka probleme. Kuptohet se për të korrigjuar këto probleme nevojitet ndërhyrja e gjyqtarit.

Referuar jurisprudencës italiane, në një pjesë të rasteve prokurori ka sjellë përpara gjyqtarit të seancës paraprake kërkesën për gjykim në përmbajtje të së cilës është e përfshirë akuza me natyrë gjenerike, e cila është bërë pjese e trajtimeve gjyqësore deri sa Gjykata e Kasacionit në Itali ka dalë me vendim unifikues në funksion të trajtimit të akuzës gjenerike⁷⁵. Për shkak të referimeve që Gjykata e Kasacionit në Itali i ka bërë akuzës gjenerike e është hasur shpesh në seancë paraprake dhe mënyrës se si duhet të veprojë gjyqtari i vetëm i vendosur para kësaj situatë, e kam vlerësuar si pjesë të rëndësishme të këtij punimi përfshirjen në trajtim të akuzës gjenerike me qëllim dhënien e një kontributi paraprak për raste të ngjashme që mund të hasim edhe në praktikën tonë gjyqësore.

Fillimisht duhet të ndalemi për të dhënë një përgjigje pyetjes se çfarë është akuza gjenerike.

Në përshkrimin shkurtimisht të faktit që nxiti Gjykatën e Kasacionit në Itali të nxjerrë një vendim unifikues në lidhje me akuzën gjenerike mund të themi se:

“Me vendimin e datës 12.03.2007 gjyqtari i seancës paraprake i Gjykatës së Pordenone në Itali, ka konstatuar natyrën përmbledhëse dhe gjenerike të përshkrimit që i është bërë faktit penal prej prokurorit në kërkesën për dërgimin e çështjes për gjyq ndaj të pandehurit D.B. Theksojmë se bazuar në nenin 60/1 të K.Pr.Penale Italiane personi nën hetim e merr cilësinë e të pandehurit nëpërmjet kërkesës së dërgimit të çështjes për gjykim.

I pandehuri është akuzuar nga prokuroria për veprën penale të parashikuar nga nenet 56 dhe 629 të Kodit Penal Italian (që i korrespondon në Kodin tonë Penal veprës penale të Shtrëngimit me anë të kanosjes ose dhunës për dhënie pasurie mbetur në tentativë). Për shkak të mungesës së përshkrimit të elementëve të dhunës dhe kanosjes të konsumuara prej të ndaluarit, elementë që janë përshkruar nga pala e dëmtuar në paraqitjen e informacionit përmbledhës, gjyqtari i seancës paraprake i ka kthyer akte prokurorit referuar neneve 423 dhe 521 të K.Pr. Penale Italiane.

Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim prokurori pranë Gjykatës së Pordenones duke kundërshtuar vlerësimin që gjyqtari i seancës paraprake i ka bërë të metave të akuzës që lidhen me natyrën përmbledhëse dhe gjenerike të saj pa specifikuar elementët konstituiv të veprës penale. Sipas prokurorit, kthimi i akteve prokurorit për motivet e përcaktuar në vendim nga gjyqtari e bëjnë vendimin të paligjshëm dhe për këto arsye ai kërkoi prishjen e këtij vendimi nga Gjykata e Kasacionit.

Nga pikëpamja e së drejtës Seksionet e Bashkuara të Gjykatës shtruan për diskutim pyetjen: Nëse është i parregullt dhe rrjedhimisht i ankimueshëm në Kasacion procedimi penal në të cilin gjyqtari i seancës paraprake deklaroi nul (të pavlefshëm) kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq, për shkak të natyrës së papërcaktueshme apo gjenerike të akuzës së hartuar nga prokurori dhe si rrjedhim të disponojë me kthimin e akteve prokurorit?

Sipas këtij vendimi gjyqtari i seancës paraprake nga momenti i parashtrimit prej prokurorit të rezultatit të hetimit dhe deri në momentin e diskutimit ndërmjet palëve gjatë debatit të seancës, nëse konstaton në aktin e akuzës mungesën minimale të përmbajtjes së elementëve të domosdoshëm të saj, ose konstaton paqartësinë dhe pasaktësinë e faktit penal, ka detyrimin të

⁷⁵ Vendim unifikues i Gjykatës së Kasacionit të Italisë nr. 5307 datë 01.02.2008

aktivizojë mekanizmat korigjues gjatë seancës paraprake, duke përcaktuar në mënyrë të motivuar me anë të një vendimi të ndërmjetëm elementët e faktit dhe arsyet juridike të vlerësimit të tij për akuzën dhe pas këtij veprimi gjyqtari duhet t'i kërkojë shprehimisht prokurorit që të procedojë më tej me sqarimin dhe plotësimet e duhura të parashikuara nga neni 423/1 i K.Pr.Penale Italiane⁷⁶.

Kontrolli gjyqësor i seancës paraprake mbi vlerën e akuzës mbështetur në instrumentet e parashikuara nga neni 423/1 të K.Pr.Penale Italiane evitojnë situatat e kthimit të akteve prokurorit edhe një herë nga e para, pa u vënë më parë në diskutim elementët e akuzës. Vetëm pas këtij veprimi të kryer nga gjyqtari i seancës paraprake e në rast të mungesës së përfshirjes së prokurorit në kërkesën për korigjim, shtim ose ndryshim të akuzës në afatet e përcaktuara nga vendimi i ndërmjetëm i gjyqtarit në seancë paraprake, pra në rast të evidentimit të një “konflikti kronik” midis gjyqtarit dhe prokurorit mbi përcaktimin e akuzës është e lejueshme që gjyqtari t'i kalojë aktet prokurorit që jo domsdoshmërisht duhet të shoqërohet me deklarinimin e pavlefshëm të kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq (pasi një gjë e tillë nuk është parashikuar nga legjislatori)⁷⁷.

Është veprim i parregullt dhe rrjedhimisht i pranueshëm për rekurs në Kasacion procedimi penal në të cilin gjyqtari i seancës paraprake disponon me kthimin e akteve prokurorit për akuza gjenerike apo të papërcaktuara, pa njoftuar më parë prokurorin për të bërë saktësimet e nevojshme.

Nisur nga prezantimi narrativ i vendimit të mësipërm mund të nxjerrim disa përfundime.

Akuzë “gjenerike” ose e “papërcaktuar” është ajo akuzë e formuluar nga prokurori i cili ka pasqyruar në mënyrë mekanike gërmën e dipozitës penale inkriminuese, pa e azhurnuar këtë dispozitë me elementët konstituiv të faktit penal konkret të verifikuar gjatë hetimit.

Në këtë rast mund të themi se të gjithë elementët përbërës të faktit penal janë të evidentuar përgjatë hetimit, vetëm se këto elemente nuk janë pasqyruar me nga prokurori me përpikmërinë e duhur⁷⁸.

Akuza gjenerike nuk është një institut i së drejtës procedurale penale. Ajo është një produkt i praktikës gjyqësore që lidhet me sjelljen dhe veprimin e prokurorit në hartimin e akuzës dhe paraqitjen e saj për gjykim. Në akuzën gjenerike hetimi është i plotë. Aktet të cilat pasqyrojnë veprimet e kryera nga i pandehuri janë evidentuar në mënyrë të qartë, por ajo që e bën të paplotë akuzën është mos saktësimi prej prokurorit i elementëve konkrete të veprimit të kryer nga i pandehuri në akuzën që ai i atribuon të pandehurit. Në akuzën gjenerike prokurori mjaftohet me përshkrimin e dispozitës penale që inkriminon veprimin e të pandehurit.

⁷⁶ Neni 423/1 i K.Pr.Penale të Italisë i korrespondon nenit 332/d paragrafit 1 të Kodit tonë të Procedurës Penale

⁷⁷ Ky moment është rregulluar nga legjislatori ynë në ndryshimet e reja në Kodin e Procedurës Penale në nenin 332/d paragrafi 3 të tij, që hyn në fuqi më datë 1 gusht 2017

⁷⁸ Perrotta Giulio, “La genericità dell'imputazione”, 17 maggio 2012 gjendet në www.diritto.it/la-genericita-dell-imputazione

Përshembull referuar rastit të përmendur në Vendimin Unifikues të Gjykatës së Kasacionit në Itali, mund të themi se akuzat e përmendur në kërkesën për dërgimin e çështjes në gjykim prej prokurorit ishte një akuzë e përgjithshme për shkak se prokurori nuk kishte saktësuar në akuzë se me çfarë veprimi kriminal (me kanosje apo dhunë) i pandehuri kryen veprën penale të “Zhvatjes” (Shtrëngimit me anë të kanosjes ose dhunës për dhënie pasurie sipas dispozitës penale korresponduese në Kodin tonë Penal).

Duke mos përcaktuar në përmbajtjen e akuzës veprimin konkret kriminal të realizuar prej të pandehurit në funksion të veprës penale, prokurori në të vërtetë kishte ndërtuar një akuzë gjenerike. Ai ishte mjaftuar me përshkrimin në akuzës të veprës penale të “Zhvatjes” duke cituar nenet 56 dhe 629 të Kodit Penal Italian që bëjnë fjalë për Institutin e “Tentativës” dhe veprën penale të “Zhvatjes”.

Sipas këtij vendimi gjyqtari i seancës paraprake, me të drejtë kishte konstatuar se në elementët e akuzës mungonte veprimi ose veprimet konkrete kriminale të kryera prej të pandehurit, që duhet të ishin kanosja ose dhuna, ndonëse nga aktet përmbledhëse të verifikuara prej tij, këto elemente ishin të pasqyruara. Ajo se çfarë Kasacioni në Itali vlerësoi si të parregullt, vendimin e gjyqtarit të seancës paraprake, ishte vendimmarrja e tij për t’i kthyer aktet prokurorit edhe një herë në fazën e hetimit, pa ndërmarrë më parë insitativën për t’i bërë të ditur prokurorit problemet që kishte akuzat e sjellë për gjykim.

Sipas Kasacionit vënia në dijeni në seancë paraprake e prokurorit nga gjyqtari i kësaj seancë për akuzën e papërcaktuar apo gjenerike, duhet të realizohet nga gjyqtari nëpërmjet një vendimi të ndërmjetëm në përmbajtje të të cilit duhet të gjenden qartësisht arsyet se pse akuzat është gjenerike e si duhet të korrigjohet ajo prej prokurorit. Gjyqtari këtë veprim e kryen *duke aktivizuar mekanizmat korrigjuese të akuzës gjatë seancës paraprake të parashikuar nga neni 423/1 i K.Pr.Penale Italiane*.

Mekanizmat korrigjuese të akuzës parashikuar nga neni 423 paragrafi 1 i K.Pr.Penale Italiane janë mekanizma të cilat lejojnë prokurorin të ndryshojë akuzën - kur fakti del ndryshe në seancë paraprake nga ç’është përshkruar në kërkesën për gjykim, - ekziston një vepër penale e re e lidhur me atë që është sjellë për gjykim, por e papërmendur në kërkesën e dërgimit të çështjes në gjyq, - ose është evidentuar një rrethanë rënduese që nuk është përmendur në akuzë.

Në të gjitha këto raste të konstatuara në seancë paraprake gjyqtari duhet të veprojë duke njoftuar fillimisht prokurorin për të metat që përmban akuzat e sjellë në kërkesën për gjykim. Gjyqtari nuk duhet të mjaftohet me konstatimin e këtyre të metave dhe si rezultat të kthejë menjëherë aktet prokurorit. Në këtë situatë gjyqtari duhet të ftojë prokurorin për të korrigjuar paqartësinë ose pasaktësinë e akuzës dhe ky korrigjim duhet të kryhet nga prokurori në seancë paraprake.

Nëse prokurori nuk vepron pas ftesës që gjyqtari i bën për saktësimin e akuzës, madje ai refuzon të reflektojë mbi ftesën e bërë nga gjyqtari, atëherë krijohet një situatë konfliktuale midis gjyqtarit dhe prokurorit që Kasacioni e përkufizon si një “konflikt kronik”.

Zgjidhja e vetme e këtij “konflikti kronik” është përdorimi prej gjyqtarit të seancës paraprake si mjet të fundit, pushtetin e tij që është vendimi për kthimin e akteve prokurorit.

Në këtë situatë themi se gjyqtari e përdor si mjet të fundit vendimmarrjen për kthimin e akteve prokurorit sepse ky vendim ka një natyrë regressive, pasi çështja penale kthehet edhe një herë në fazën e hetimeve paraprake.

Përfundimet e mësipërme besoj se duhet të vlejné edhe për praktikën tonë gjyqësore që në një kohë të afërt do të ndeshet me situata të ngjashme. Më duhet të theksoj se paragrafi i tretë i nenit 332/d të K.Pr.Penale është rrjedhojë e përfundimeve të prezantuara nga Gjykata e Kasacionit, Itali në Vendimin e saj Unifikues me numër 5307, datë depozitimi 01.02.2008.

Ndërsa në lidhje me praktikën gjyqësore vendase mund të themi se akuza gjenerike është evidentuar në mjaft raste. Në ato raste kur gjykata është ndeshur me një akuzë gjenerike, ajo nuk ka pasur instrumentet e duhura ligjore (përpara ndryshimeve të fundit në Kod) për të rregulluar një situatë të tillë të paqartë. Themi se nuk ka pasur instrumentet e duhura për shkak se akuza ishte e përpiluar nga prokurori në fazën e hetimit e cila pasqyrohej në kërkesën për gjykim që prokurori edhe këtë akt e hartonte në fazën e hetimit.

Në gjykimin e themelit gjykata duhet të zgjidhte problemet që lidheshin me themelin e çështjes penale dhe nuk mund të ndërhynte për të korrigjuar akuzën gjenerike për shkak të pozicionit të paanshëm që ajo ka normalisht. Korrigjimet e elementëve të akuzës mund të realizohen në seancë paraprake përpara se të shqyrtohet në themel kërkesa e prokurorit për gjykimin e të pandehurit. Meqenëse mungonte faza e verifikimit të akuzës në seancë paraprake, risku që gjykata e themelit të përballej me akuza gjenerike ishte i madh.

Një akuzë gjenerike e sjellë për gjykim nga prokurori mund të shoqërohet me probleme në gjykimin e themelit të saj.

Së pari, akuza gjenerike është një akuzë e paqartë ose e pasaktë. Si rrjedhim i pandehuri vendoset në një situatë të pasigurtë juridike. Përballë një akuze gjenerike i pandehuri nuk ka mundësi të realizojë mbrojtje efektive.

Së dyti, ndodhur përpara një akuze gjenerike gjykata e themelit me të drejtë mund t'i mohojë të pandehurit kërkesa për gjykime alternative, siç mund të jetë kërkesa për gjykim të shkurtuar, duke i mohuar të pandehurit përfitimin ligjor të uljes së dënimit me 1/3 e tij. Arsyeja përse gjykata e themelit mund të refuzojë kërkesën për gjykimin e shkurtuar lidhet me gjendjen e akteve që prokurori ka sjellë për gjykim. Nëse këto akte duke përfshirë akuzën, si një akt i rëndësishëm procedural nuk janë të qarta e të sakta dhe nuk harmonizohen me aktet e tjera që pasqyrojnë veprimet konkrete të të pandehurit por që nuk gjenden të shprehura në aktin e akuzës, mund të sjellin për pasojë refuzimin e kërkesës për gjykimin e shkurtuar.

Pra akuza gjenerike ndikon negativisht në mbarëvajtjen e gjykimit në themel të të pandehurit.

Nga praktika jonë gjyqësore po ofrojmë një rast të prezantimit prej prokurorit të një akuze gjenerike në gjykimin e themelit të një çështje penale.

“Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë “Për Krime të Rënda” Tiranë ka regjistruar procedimin penal nr. 2., datë2014 për veprat penale “Vjedhje me armë”, “Grup i strukturuar kriminal”, “Kryerja e veprave penale nga grupi i strukturuar kriminal”,

parashikuar nga nenet 140, 333/a, 334 të Kodit Penal. Këto vepra penale janë kryer në Shqipëri në disa qytete dhe në disa vende të ndryshme.

Në regjistrin e njoftimit të veprave penale me urdhërin e datës 18.12.2014 është regjistruar ndër të tjerë dhe emri i shtetasit I.

Fillimisht prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë bazuar në shkresën nr. 7... prot. datë....2014 të Drejtorisë së Marrëdhënive Juridiksionale më Jashtë në Ministrinë e Drejtësisë ka regjistruar procedimin penal nr. 6... viti 2014, në ngarkim të shtetasit I., për veprën penale të “Mbajtjes pa leje të armëve luftarake”, parashikuar nga neni 278/5 i Kodit Penal.

Regjistrimi i procedimit penal ndaj të pandehurit I., lidhet me vendimin për t’i hapur rrugë ekzekutimit të një letërporosie nga Ministria e Drejtësisë së Republikës së Shqipërisë ardhur nga Autoritetet Gjyqësore të një shteti tjetër. Konkretisht Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit në shtetin e huaj me anë të një letërporosie mbështetur në Konventën “Për ndihmën e ndërsjelltë juridike në fushën penale” i ka kërkuar Autoriteteve Gjyqësore Shqiptare regjistrimin dhe ndjekjen penale të shtetasit I, si një ndër personat e burgosur, të arratisur nga një burg në shtetin e huaj duke e mbështetur këtë kërkesë në nenin 21 të Konventës Evropiane “Për ndihmë të ndërsjelltë gjyqësore në fushën penale”. Kësaj kërkesë i është hapur rrugë për ekzekutim nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë nëpërmjet shkresës nr. 1... prot, datë2014 drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme për vazhdimin e mëtejshëm të procedurave gjyqësore.

Me vendimin datë2014 Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka shpallur moskompetencen tokësore të procedimit penal nr. 6.... të vitit 2014 në ngarkim të shtetasit I., për veprën penale “Mbajtjes pa leje të armëve luftarake” parashikuar nga neni 278/5 i Kodit Penal dhe i ka kaluar aktet Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Kjo e fundit me vendimin datë 24.12. 2014 ka bashkuar këtë procedim me atë me numër nr.1..... datë2014 në ngarkim të të pandehurit F. për shkak të procedimit të lidhur.

Me vendimin datë2014 Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ka shpallur moskompetencen e saj lidhur me këtë procedim penal dhe i ka kaluar aktet për kompetencë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë “Për Krime të Rënda Tiranë”, e cila tashmë kishte regjistruar procedimin penal nr.2, datë2014 për veprat penale të “Vjedhjes me armë”, “Grup i strukturuar kriminal”, “Kryerja e veprave penale nga grupi i strukturuar kriminal”, të parashikuar nga nenet 140, 333/a, 334 të Kodit Penal në ngarkim, të shtetasit I., së bashku edhe me persona të tjerë që dyshoheshin se ishin të përfshira në ngjarjet që po hetonte prokuroria.

Me vendimin datë2015 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë “Për Krime të Rënda Tiranë” janë pranuar aktet e procedimit penal nr.1../2014 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës duke u bashkuar me aktet e procedimit penal nr.2...../2014.

Me urdhërin datë2015 në regjistrin e njoftimit të veprave penale lidhur me këtë procedim (2...../2014) në ngarkim të shtetasve I. dhe F., janë regjistruar dhe veprat penale të “Vrasjes së punonjësve të policisë” kryer në bashkëpunim dhe të mbetur në tentativë parashikuar nga neni 79/b i Kodit Penal, “Prodhimit dhe mbajtje pa leje të armëve dhe municioneve luftarake” parashikuar nga neni 278/5 i Kodit Penal, “Krijimi i grupit të

strukturuar kriminal” parashikuar nga neni 333/a i Kodit Penal si dhe “Kryerja e veprave penale nga grupi i strukturuar kriminal” parashikuar nga neni 334 i Kodit Penal. Këto akuza rezultojnë t’i jenë njoftuar shtetasve I. dhe F më datë2015 duke i marrë ata me cilesinë e të pandehurve.

Më datë2015 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Për Krime të Rënda Tiranë është përcjellë nga Prokuroria e Përgjithshme praktika që shoqëron këtë kërkesë Për ndihme juridike të autoriteteve gjyqësore Greke.

Më datë2015 me vendim të prokurorit, i është shtuar akuza e re të pandehurit I., për veprën penale të “Largimit të të burgosurit nga vendi i qendrimit”, parashikuar nga neni 323/2 i Kodit Penal.

Gjykata e Shkallës së Parë Për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin gjyqësor nr.2...., datë 2015 ka vendosur masën e sigurimit “arrest në burg” ndaj shtetasit I. si i dyshuar për kryerjen e veprave penale “Vrasje e punonësve të policisë” kryer në bashkëpunim mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 79/b i Kodit Penal, “Prodhimi dhe mbajtja pa leje të armëve dhe municioneve luftarake”, parashikuara nga neni 278/5 i Kodit Penal, “Krijimi i grupit të strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 333/a i Kodit Penal, “Kryerja e veprave penale nga grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 334 i Kodit Penal.

Me vendimin nr. 5...datë2014 po ndaj këtij shtetasi ishte vendosur e njëjta masë sigurimi në kuadër të procedimit penal nr. 2.../2014 për rastet e vjedhjeve të kryera në Shqipëri.

Me vendimin datë2015 nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Për Krime të Rënda Tiranë është ndarë procedimi penal në atë me nr. 2.../2014 dhe 2.../1/ të vitit 2015, ku ky i fundit lidhet me kërkesat e autoriteteve greke të drejtësisë për ndjekjen penale të të pandehurve F. dhe I.

Mbi bazën e kërkesave të ardhura me letërporosi prej autoriteteve gjyqësore të huaja prokuroria Për Krimet e Rënda ka regjistruar procedimi penal nr.2.../1 në ngarkim të të pandehurve I. dhe F. duke u paraqitur kërkesa për gjykim në ngarkim të tyre pranë kësaj gjykate më datë2015, duke u akuzuar secili prej tyre për veprën penale të “Grupit të strukturuar kriminal” parashikuar nga neni 333/a i Kodit Penal, “Kryerjen e veprave penale nga grup i strukturuar kriminal”, për veprat penale të kryera në kuadrin e Grupit të strukturuar kriminal: “Vrasje e punonjësve të policisë” kryer në bashkëpunim dhe e mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 79/b i Kodit Penal, “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve dhe municioneve luftarake”, parashikuar nga neni 278/5 i Kodit Penal, “Largimi i të burgosurit nga vendi i qendrimit”, parashikuar nga neni 323/2 i Kodit Penal, ndërsa i pandehuri F. edhe për veprat penale “Vjedhja” kryer në bashkëpunim dhe me shumë së një herë, parashikuar nga neni 134/2 i Kodit Penal, “Vjedhje me arme”, kryer në bashkëpunim parashikuar nga nenet 140 dhe 25 të K.Penal.

Në seancë gjyqësore prokurori i çështjes sqaroi akuzën në ngarkim të të pandehurit lidhur me veprën penale “Grupi i strukturuar kriminal”, duke e kualifikuar atë në paragrafin e dytë të nenit 333/a të Kodit Penal: “Pjesëmarrja në grupin e strukturuar kriminal”. Kjo pasi

nuk rezulton të ketë qenë specifikuar në kërkesën për gjykim paragrafi i nenit 333/a që parashikon veprën penale të “Grupit të strukturuar kriminal”.⁷⁹

Gjithashtu, edhe në parashtrimin e kërkesave gjatë shqyrtimit gjyqësor, prokurori saktësoi akuzat ndaj të pandehurit I., saktësim që gjen pasqyrim në vijim.

Në kërkesën për gjykim, si dhe në aktin e njoftimit të akuzës prokuroria, megjithese e kishte përcaktuar faktin kriminal se bëhej fjalë për tentativë vrasje të dy punonjësve të policisë, gardianë të burgut në shtetin e huaj, për të dy këto fakte penale prokuroria i kishte kualifikuar vetëm një herë si veprë penale mbështetur në nenin 79/b të Kodit Penal që bën fjalë për “Vrasjen e punonjësit të policisë”.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor prokuroria ka saktësuar akuzën ndaj të pandehurit I., duke e kualifikuar dy herë akuzën për “Vrasje të punonjësit të policisë” mbetur në tentativë, në kuadër të grupit të strukturuar kriminal bazuar në nenin 79/c, 28/4 dhe 22 të Kodit Penal. Ky saktësim i akuzës nga prokuroria u bë në gjykim prej saj, për shkak se vetë kjo dispozitë penale kishte pësuar ndryshime me ligjin nr. 144/2014. Për shkak të zbatimit të ligjit më të favorshëm ndaj të pandehurit, prokuroria ka saktësuar akuzën duke u mbështetur në nenin 79/c dy herë.

Për akuzën e “Mbajtjes pa leje të armëve luftarake” në kuadër të grupit të strukturuar kriminal parashikuar nga neni 287/5 i Kodit Penal prokuroria saktësoi akuzën duke e cilësuar përfundimisht në gjykim si “Mbajtjes pa leje të armëve luftarake” në kuadër të grupit të strukturuar kriminal parashikuar nga neni 278/2 të Kodit Penal, pasi kjo dispozitë penale ka qenë në fuqi në kohën kur është kryer vepra penale, duke qenë edhe në të njëjtën kohë një dispozitë penale më e favorshme.

Në lidhje me veprën penale të “Grupit të strukturuar kriminal” parashikuar nga neni 334 të Kodit Penal, prokuroria në gjykim saktësoi se ndaj të pandehurit I., akuzat në këtë rast lidhej me cilësinë e pjesëmarrësit të të pandehurit në këtë grupim dhe jo në cilësinë e organizatorit që shton rrezikshmërinë e veprës penale.

Për saktësimin e akuzave në gjykim, gjykata i dha mundësi të pandehurit dhe mbrojtësit të tij për të përgatitur mbrojtjen bazuar në nenin 376 të K.Pr.Penale. Brenda kësaj mundësie gjykata i bëri të ditur mbrojtjes që ajo mund të hiqte dorë nga e drejta për gjykimin e shkurtuar dhe të procedonte më tej me ritin e gjyqimit të zakonshëm.

Mbrojtja pas përfitimit të kohës së dhënë për të përgatitur mbrojtjen, u paraqit në gjykim me qendrimin se ajo ishte e njohur me saktësimin e akuzës, pasi fakti penal ndaj të pandehurit ishte i njohur prej tyre në fazën e hetimit paraprak, saktësimi i akuzës nuk rëndonte pozitën e të pandehurit dhe në lidhje me këtë situatë të krijuar në gjykimin e pandehurit dhe mbrojtësit të tij, vazhdojnë t'i qëndronin kërkesës për gjykimin e shkurtuar duke përfshirë edhe saktësimin e akuzës në kërkesën për gjykim të shkurtuar...”

Në këtë rast themi se akuzat gjenerike të hartuara nga prokurori në hetim sollën një problem në gjykim që ishte zvarritja e gjyqimit të çështjes penale përtej afateve të zakonshme që kjo çështje penale duhet të përfundonte me ritin e gjyqimit të shkurtuar.

⁷⁹ Vendim i Gjykatës së shkallës së parë “Për Krimet e Rënda” Tiranë nr. 71 datë 19.05.2016

Besoj se me ndryshimet e reja në Kod në gjykimin e themelit nuk do të ndeshen me problemet e akuzave gjenerike, pasi me përfshirjen e gjyqtarit të seancës paraprake në procedimin penal, paqartësitë dhe pasaktësitë e akuzës gjenerike do të verifikohen si fillim në seancë paraprake.

3.9. Të drejtat e të pandehurit sipas nenit 34/a të Kodit të Procedurës Penale

Deri tani kemi trajtuar akuzën, elementët e saj dhe ndryshimet që pëson ajo në varësi të të dhënave të mbledhura gjatë fazës së hetimit. Kështu që deri tani në këtë punim jemi përqendruar më shumë tek sjellja dhe veprimet e nevojshme që duhet të përmbush prokurori në funksion të ndjekjese penale. Jo pa qëllim nuk e kemi trajtuar bashkërisht me prokurorin, të pandehurin si subjektin tjetër procedural me rëndësi të madhe për të gjithë procesin penal, për shkak se trajtimi i këtij subjekti duhet të realizohet si pikë më vetë në këtë punim.

Më lart kemi shpjeguar se momenti i njoftimit të akuzës ndryshon pozitën procedurale të personit të akuzuar. Tashmë me njoftimin zyrtarisht të akuzës personi nën hetim merr cilësinë e të pandehurit. Cilësia e të pandehurit ruhet në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit derisa vendimi i pushimit, i pafajësisë apo i dënimit të ketë marrë formë të prerë. Në rast të prishjes së vendimit të pushimit ose kur nga Gjykata e Lartë vendos rigjykimin edhe një herë të çështjes penale, cilësia e të pandehurit në rigjykim rimerret sërish.

Pra vendimi i njoftimit të akuzës që prokuroria i bën personit nën hetim merr një rëndësi të madhe, sepse ky vendim nuk mund të revokohet më tej prej prokurorit. Për shkak të kësaj cilësie i pandehuri është i detyruar të përballlet me një proces gjyqësor në rastin e zakonshëm ose në hetim prokurori duhet të nxjerrë vendim mbi pushimin e akuzës me qëllim heqjen e cilësisë së të pandehurit.

Gjithsesi përpara ndryshimeve të fundit të Kodit, me njoftimin e akuzës të pandehurit përfundonte detyrimi ligjor që prokurori kishte në raport me procedimin penal të nisur. Deri në këtë fazë Kodi ishte i qartë në përcaktimin e detyrimeve që duhet të përmbushte prokurori, por pas njoftimit të akuzës normalisht për të pandehurin lindin disa të drejta procedurale. Kodi i Procedurës Penale në fuqi, pa përfshirë ndryshimet e reja nuk përcaktonte në mënyrë specifike se cilat ishin të drejtat e të pandehurit të cilat ai mund t'i ushtronte pas marrjes së kësaj cilësie.

Me ndryshimet e reja të bëra me Ligjin nr. 35/2017 është parashikuar si risi “Letra e të drejtave” të të pandehurit⁸⁰.

Të drejtat e të pandehurit pas njoftimit të akuzës duhet t'i bëhen të qarta njësoj siç i bëhet e qartë njoftimi i akuzës. Kjo do të thotë se detyrimi i prokurorisë nuk mbaron vetëm me njoftimin me shkrim të akuzës që ai i atribuon të pandehurit duke u siguruar që i pandehuri e ka marrë dhe e ka kuptuar aktin e njoftimit të akuzës. Me ndryshimet e reja prokurorit i shtohen detyrimet në raport me informimin në mënyrë të plotë, të të drejtave që gëzon i pandehuri pas njoftimit të akuzës. Këto të drejta janë të parashikuara shprehimisht në nenin 34/a paragrafi 1 të K.Pr.Penale

⁸⁰ Neni 34/a paragrafi 1 gërmat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh” dhe “e” i K.Pr.Penale, hyrë në fuqi më datë 1 gusht 2017.

dhe prokurori për njoftimin e tyre duhet të përdorë të njëjtin standard që përdoret në rastin e njoftimit të akuzës.

Të drejtat që gëzon i pandehuri pasi merr këtë cilësi përfshihen në setin e “Letrave të të Drejtave” dhe ky set duhet t’i njoftohet të pandehurit me shkrim prej prokurorit, duke u siguruar që i pandehuri ka marrë dijeni për “Letrën e të Drejtave” kundrejt nënshkrimit të tij.

“Letra e të Drejtave” përmban: a) njoftimin në një kohë sa më të shkurtër, në gjuhën që kupton, për veprën penale për të cilën hetohet, si edhe për shkaqet e akuzave; b) të përdorë gjuhën që flet ose kupton ose të përdorë gjuhën e shenjave, si dhe të ndihmohet nga një përkthyes dhe interpretues nëse ka paaftësi të kufizuar në të folur dhe në të dëgjuar; c) të heshtë, të paraqesë lirisht për mbrojtjen e tij, si dhe të mos u përgjigjet pyetjeve të caktuara; ç) të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi të zgjedhur prej tij; d) të ketë një mbrojtës të siguruar nga shteti, nëse mbrojtja është e detyrueshme ose nuk ka mundësi financiare për të pasur një mbrojtës, sipas parashikimeve të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi për ndihmë juridike;

dh) të takohet privatisht dhe të komunikojë me mbrojtësin që e përfaqëson; e) të këtë kohë të mjaftueshme dhe lehtësi për të përgatitur mbrojtjen;

Siç shihet të drejtat e përmendura më sipër që përfshihen në “Letrën e të Drejtave” të të pandehurit, janë një garanci më shumë për të pandehurin, i cili në momentin e njoftimit të akuzës duhet të informohet saktësisht për të gjitha veprimet e mundshme që ai mund t’i kryej në funksion të mbrojtjes së tij. Njoftimi për të drejtat që gëzon i pandehuri pas komunikimit të akuzës është një proces që lejon të pandehurin të përgatisë realisht mbrojtjen e tij, pasi vetëm pas këtij momenti i pandehuri kupton arsyet e vërteta të cilësisë që merr në një procedim penal të nisur kundër tij.

Këto të drejta janë njësoj të vlefshme dhe duhet t’i njoftohen në të njëjtën mënyre edhe personit të arrestuar ose të ndaluar⁸¹. Sipar rastit të paraqitur “Letra e të Drejtave” për personin e arrestuar ose të ndaluar, duhet t’i dorëzohet me shkrim, kundrejt nënshkrimit të të arrestuarit ose të ndaluarit nga oficeri i policisë gjyqësore ose prokurori.

Kështu që vlerësoj edhe një herë se ndryshimet e reja në Kod referuar “Letrës së të Drejtave” të të pandehurit, janë ndryshime cilësore të cilat do të bëjnë të mundur rritjen e nivelit të garancive që gëzon i pandehuri në procesin penal.

⁸¹ Neni 34/b paragrafi 1 i Kodit të Procedurës Penale të ndryshuar, i cili hyn në fuqi më datë 1 gusht 2017

KAPITULLI IV

AKUZAT E REJA NË PROCESIN PENAL

4.1. *Konsiderata të përgjithshme mbi akuzat e reja*

Deri tani kemi prezantuar akuzën dhe elementët thelbësore të saj në fazën e hetimit paraprak si dhe seancën paraprake, ku akuzat mund të modifikohet në varësi të të dhënave të përftuara në hetim ose në seancë paraprake. Gjatë hetimit prokurori është subjekti procedural i ngarkuar nga ligji të hartojë akuzën me vendim dhe më pas të njoftojë të pandehurin, i cili e merr këtë cilësi vetëm pasi vihet në dijeni në mënyrë të qartë e të detajuar për elementët e veprës penale për të cilën procedohet.

Pra një nga funksionet thelbësore me natyrë procedurale e kushtetuese të prokurorisë është hartimi dhe njoftimi i akuzës kundrejt të pandehurit. Rregulli i përgjithshëm kërkon që prokuroria njoftimin e akuzës ta realizojë në fazën e hetimit paraprak pasi ai të ketë regjistruar më parë procedimin penal për veprën penale si dhe emrin e të pandehurit si person të cilit i atribuohet vepra penale në regjistrin e njoftimit për veprat penale si dhe të ketë kryer hetimet e nevojshme për të konkluduar në formulimin e akuzës.

Njoftimi i akuzës që prokurori realizon ndaj të pandehurit është një moment i rëndësishëm, pasi me këtë veprim prokurori konkretizon procesin e ndjekjes penale ndaj të pandehurit. Në vetvete ndjekja penale nuk përfundon me njoftimin e akuzës dhe as me dërgimin e çështjes penale në gjyq. Njoftimi i akuzës në hetim nga prokurori ndaj të pandehurit dhe paraqitja e kërkesës për gjykim me akuzën e njoftuar tashmë të pandehurit, vetëm konkretizon ndjekjen penale e cila vazhdon edhe pas përfundimit të fazës së hetimeve paraprake me përfaqësimin e akuzës në gjykimin e themelit.

Pra vazhdimi i ndjekjes penale ndaj të pandehurit vijon më tej me përfaqësimin e akuzës në gjyq. Në gjykatë prokurori nëpërmjet paraqitjes së kërkesës për gjykim mbrojtës akuzës e ngritur prej tij në hetim. Ndjekja penale që prokurori ushtron ndaj të pandehurit në gjykim sjell së paku dy detyrime për gjykatën.

Së pari, me ndjekjen penale, gjykata është e detyruar të vendos me një vendim përfundimtar mbi faktin penal të përcaktuar qartë dhe të fiksuar nga prokurori në përmbajtjen e akuzës që gjen pasqyrim në kërkesën për gjykim të sjellë prej tij. Pra gjykata nuk mund t'i shmanget detyrimit për t'u shprehur me vendim mbi akuzën e sjellë për gjykim prej prokurorit, si shprehje e ndjekjes penale që prokurori ushtron në gjykim ndaj të pandehurit.

Së dyti, gjykata nuk ka të drejtë për të vendosur me vendim mbi një fakt penal të ndryshëm nga ai i përcaktuar prej prokurorit në përmbajtjen e akuzës që i është njoftuar të pandehurit.

Për sa kohë ushtrimi i ndjekjes penale prej prokurorit vazhdon edhe përgjatë fazës së shqyrtimit gjyqësor, atëherë me të drejtë mund të themi se prokurori në funksionin e tij kushtetues dhe procedural, të ushtrimit të ndjekjes penale mundet të veprojë në gjykim edhe me paraqitjen e akuzave të reja për të pandehurin, të ushtrrojë ndjekjen penale ndaj të pandehurit

për një fakt të ri penal të zbuluar prej tij gjatë gjykimit apo të ndryshojë akuzën e sjellë për gjykim ndaj të pandehurit për të njëjtin fakt.

Të gjitha këto veprime prokurori gjatë gjykimit i ushtron në funksion të ndjekjes penale si një detyrim kushtetues dhe procedural. Pra ndryshimi i akuzës, akuza për një veprë tjetër penale apo akuza për një fakt të ri janë forma të ushtrimit të ndjekjes penale të prokurorit në gjykim, të cilat gjejnë rregullim në institutin e akuzave të reja të parashikuar nga nenet 372 deri 377 të Kodit të Procedurës Penale.

Instituti i akuzave të reja në Kodin e Procedurës Penale nuk rregullon vetëm veprimtarinë e prokurorit në gjykim në funksion të ushtrimit prej tij të ndjekjes penale që lidhet me situata të reja që kanë dalë gjatë gjykimit të çështjes penale në drejtim të akuzës së ngritur apo edhe në drejtim të hetimit të përfunduar. Instituti i akuzave të reja rregullon sjelljen e të pandehurit, duke i ofruar atij të drejta procedurale të mjaftueshme për të realizuar e garantuar mbrojtje efektive në drejtim të situatës së re të krijuar gjatë gjykimit.

Njëkohësisht për sa kohë nëpërmjet akuzave të reja ligji i ofron mundësinë prokurorit të ndryshojë akuzën në gjykim, si shprehje e ushtrimit të ndjekjes penale prej tij ndaj të pandehurit pa u kufizuar në shkallën e procedimit penal atëherë me të drejtë edhe gjykatës ligji i krijon mundësinë që faktit penal të hetuar, për të cilin është ngritur një akuzë, të mund t'i përcaktojë cilësimin e duhur ligjor në funksion të postualit latin "*jura novit curia*"⁸².

Pra instituti i akuzave të reja si promotor të saj në gjykim ka në fillim prokurorin, i cili për shkak të ushtrimit të ndjekjes penale lejon edhe subjektet e tjera procedurale të realizojnë të drejtat e tyre si aspekt i respektimit parimit të një procesi të rregullt ligjor. Të pandehurit në këtë rast i ofrohen të njëjtat garanci që ai ka edhe në fazën e hetimit paraprak. Garancia kryesore në këtë rast është vënia në dispozicion nga gjykata për të përgatitur mbrojtjen e tij mbi situatën e re ligjore të krijuar me ndryshimin e akuzës, njoftimin në gjykim të akuzës për një veprë penale të re, apo faktit të ri penal për të cilat i pandehuri vihet në dijeni vetëm gjatë gjykimit.

Në situatën e re ligjore përfshihet edhe gjykata si subjekti procedural i ngarkuar nga ligji për të dhënë një vendim në lidhje me akuzën e sjellë për gjykim ndaj të pandehurit. Gjykata është i vetmi subjekt procedural që jep një vendim të bazuar në ligj për akuzën e ngritur.

Në këtë kuptim gjykata është organi që interpreton ligjin penal në mënyrë përfundimtare për çështjen penale të sjellë për gjykim. Si rrjedhojë, instituti i akuzave të reja e ka përfshirë gjykatën në funksionin e saj thelbësor të dhënies së drejtësisë, për shkak të zbatimit vetëm prej saj të ligjit penal si pjesë e vendimit përfundimtar në zgjidhjen e drejtë të çështjes penale. Gjykata në këtë rast faktit penal të sjellë për gjykim me vendimin e saj përfundimtar i jep cilësimin e drejtë ligjor, duke mos e lidhur këtë cilësim me cilësimin e dhënë nga prokurori në momentin e hartimit të akuzës prej tij.

Por shpesh ndodh që nevoja e njohjes së të pandehurit me akuzën për kryerjen e veprave penale alternative të vijë si rezultat i kryerjes së një hetimi të kufizuar në fazën e hetimeve paraprake, hetim nëpërmjet të cilit nuk është arritur ajo siguri absolute në lidhje me përcaktimin e drejtë të faktit penal. Në raste të tjera përcaktimi i faktit objekt akuze ndaj të pandehurit, mund

⁸² Gjykata e njeh ligjin

të duket paraprakisht i qartë e i plotë, por mbi bazën e vlerësimit të ri të provave të marra gjatë fazës së hetimeve paraprake ose gjatë shqyrtimit gjyqësor, mund të krijojnë nevojën e rishikimit të objektit të akuzës nëpërmjet një veprimi korrigjues, plotësues apo modifikues⁸³.

Dispozitat e Kodit të Procedurës Penale që i lejojnë prokurorit ndryshimin e akuzës janë miratuar nga ligjvënësi me qëllim shmangien e një procesi ndaj të akuzuarit për vepra penale të reja të konstatuara në gjykim. Duke patur si qëllim efikasitetin e procesit gjyqësor, gjykimin brenda një afati të arsyeshëm kohor të çështjes është krijuar mundësia e ndryshimit apo integritetit të akuzës duke vazhduar gjykimin me ndryshimet e reja në të njëjtin proces gjyqësor. Në të vërtetë, në lidhje me dispozitat që rregullojnë institutin e ndryshimit të akuzës, në shikim të parë konstatohet që ligjvënësi ka vendosur të kufizojë iniciativën e modifikimit vetëm në lidhje me rastet kur shqyrtimi gjyqësor krijon siguri rreth elementëve të rinj e të ndryshëm, të pandeshur më parë gjatë hetimeve paraprake.

Për të prezantuar rëndësinë e institutit të akuzave të reja, në praktikën gjyqësore dhe vështirësitë që sjell interpretimi i tyre në rastet konkrete kemi marrë për studim disa shembuj të praktikës gjyqësore si të gjykatave vendase ashtu edhe të gjykatave italiane. Rikujtojmë se punimi i referohet kryesisht praktikës së gjykatave italiane mbi kapitullin e akuzave të reja për shkak të ngjashmërisë së modeleve të përzgjedhura nga dy legjislacionet.

Në këtë kuptim po ndalemi fillimisht tek jurisprudenca e gjykatave italiane për të vënë në dukje karakteristikat e përbashkëta të kontestimeve të reja (akuzave të reja) në procesin penal.

Gjykatat Italiane kanë mbajtur qëndrime të ndryshme në kohë të ndryshme për çështjet që lidhen kryesisht me faktin nëse elementet e reja të provave për akuzën e re apo faktin e ri penal janë kusht që ato të jenë evidentuar gjatë shqyrtimit gjyqësor, apo këto elementë kanë qenë të evidentuara gjatë hetimit por prokurori nuk i ka integruar në kërkesën për gjykim së bashku me akuzën fillestare.

Fillimisht jurisprudenca e gjykatave italiane duke përfshirë edhe doktrinën e kohës⁸⁴ kanë mbajtur qëndrim se vetëm elementët e reja të provave të zbuluara gjatë shqyrtimit gjyqësor do lejonin një kontestim të ri, në raport me akuzën fillestare duke u bërë pjesë integrale e saj e ky kontestim i ri duhej t'i njoftohej të pandehurit.

Kështu në Gjykatën e Shkallës së Parë të Agrigentos (Itali) në shtator të vitit 2007 ka nisur një proces gjyqësor kundër 17 (shtatëmbëdhjetë) peshkatarëve me shtetësi tuniziane të cilët ishin arrestuar në ishullin Lampedusa në Itali më datë 8 gusht 2007 dhe sjellë për gjykim me akuzën e “Favorizimit të emigracionit klandestin” sipas dispozitave të Kodit Penal Italian.

Prokurori në seancë gjyqësore i kërkoi gjykatës që ndaj të pandehurve të shtojë edhe një akuzë të re përveç akuzës fillestare për të cilën të pandehurit ishin sjellë për gjykim. Më konkretisht prokurori kërkoi që shtimin e akuzës që parashikohet nga neni 1100 paragrafi i parë i Kodit Detar Italian për dy komandantët e motopeshkarexhave tuniziane (Rezistenca ose dhuna

⁸³ Modifica dell'imputazione “Principio del contraddittorio e nuove contestazioni: tra interpretazione funzionale e tutela del diritto di difesa, Andrea Monteleone faqe 2 gjendet edhe në www.archiviopenale.it

⁸⁴ Paolo Tonini “Lineamenti di diritto processuale penale”, Giufre Editore, Torino 2012, faqe 301

kundër një anije luftarë), nenin 1100 paragrafi i dytë i Kodit Detar Italian, ndërkohë që për pjesën tjetër të ekuipazhit dhe nenin 337 të Kodit Penal Italian që bën fjalë për veprën penale të “Kundërshtimi i një punonjësi që kryen detyrë shtetërore apo shërbim publik”.

Në seancë gjyqësore mbrojtja e të pandehurve kundërshtoi mundësinë e shtimit të akuzave të reja nga prokurori, duke argumentuar se parimi sipas të cilit akuzat e re bëhet pjesë e gjykimit, vetëm në rastet kur vepra penale konkurruese bazohet në elementë të reja prove të evidentuara për herë të parë gjatë shqyrtimit gjyqësor të akuzës së parë. Pra elementët e reja të provave mbi të cilat duhet të bazohet akuzat e re nuk duhet të jenë zbuluar përpara shqyrtimit gjyqësor, siç është rasti i fazës së hetimeve paraprake si dhe këto elementë të rinj prove nuk duhet të jenë përmendur në kërkesën për dërgimin e çështjes për gjykim.

Nëse konstatohet një veprim i tillë në gjykim atëherë vendimi i gjykatës është i pavlefshëm pjesërisht për pjesën që ky vendim shprehet për akuzën e re që të pandehurit i është shtuar në gjykim, mbështetur mbi elementet e provës të evidentuar në fazën e hetimit ose të përmendur në kërkesën e dërgimit të çështjes penale në gjykim. Sipas mbrojtjes, në rastin në gjykim akuzat e re për veprën penale konkurruese është e bazuar në elemente prove të verifikuar nga prokurori gjatë fazës së hetimit. Ky veprim nëse do të lejohet nga gjykata do të dëmtonte të drejtën e mbrojtjes të të pandehurve, të cilët do të shiheshin si të paragjykuar nga mundësia eventuale që ata kanë për të kërkuar gjykim të shkurtuar në lidhje me veprën penale të re.

Njëkohësisht në këtë seancë mbrojtja për të mbështetur argumentin e saj paraqiti në gjykatë disa vendime të Gjykatës së Kasacionit në Itali, që në raste të ngjashme kishin vlerësuar se kontestimet e reja (akuzat e reja në tërësi) mund të pranohen në gjykim, vetëm në rastin kur ata mbështeten në elementë prove të cilat janë zbuluar për herë të parë gjatë debatit gjyqësor⁸⁵. Nëse kontestimi i ri i bërë nga prokurori mbështetet mbi prova të evidentuara gjatë hetimit, ato nuk duhet të pranohen nga gjykata si kontestime të reja, me pasojë pavlefshmërinë e pjesës së vendimit përfundimtar të gjykatës që e lidh pjesën e vendimit me kontestimin e ri.

Kujtojmë se në vendimin e Gjykatës së Kasacionit të Italisë me nr. 10125/2005, pjesë e vendimit ku mbrojtja bazoi argumentin e saj ishte përcaktuar se:

“Akuzat e shtuar në lidhje me një veprë penale konkurruese apo rrethanë rënduese, të pa përmendura në kërkesën për gjykim, pranohet vetëm kur bazohet në elementë të dala për herë të parë gjatë shqyrtimit gjyqësor. Si rrjedhojë kur bazohet në elementë të njohur gjatë hetimeve paraprake, vendimi është i pavlefshëm⁸⁶.”

Si rrjedhim Gjykata e Agrigentos në Itali në seancën gjyqësore të datës 9 Tetor 2007, nuk pranoi kërkesën e prokurorit për të përfshirë akuzën për një veprë penale të re si pjesë të gjykimit me akuzën e parë duke vlerësuar të drejtë argumentat që dha mbrojtja për këtë rast.

Qëndrimi i jurisprudencës italiane, përfshirë këtu edhe Gjykatën e Kasacionit, më pas ka ndryshuar në lidhje me elementët e provave mbi të cilat duhet të bazohet prokurori për të proceduar më tej me akuzat e reja. Përfundimisht qëndrimi i përmendur në çështjen penale të

⁸⁵ Në procesin gjyqësor mbrojtja paraqiti disa vendime të Gjykatës së Kasacionit të ngjashëm me rastin në gjykim të cilat ishin: Suprema Corte - Cass. Pen. sez. VI del 22 marzo 2000 n. 6251, Cass. Pen. sez. III del 17 marzo 1998 n. 5072 (Pecchioni), Cass. Pen. sez. II del 16 dicembre 2003 n. 6584, Cass. Pen. sez. VI, 22 febbraio 2005 n. 10125

⁸⁶ Cass. pen., Sez. VI, n. 10125/2005

sipërcituar është braktisur në vitet në vijim, duke u përkrahur qëndrimi i ri sipas të cilit kontestimet e reja që përfshijnë ndryshimin e akuzës, akuzën për një veprë penale të re që konkurren me atë që është sjellë për gjykim apo një rrethanë rënduese e papërmendur në kërkesën për gjykim, mund të bëhet nga prokurori pas hapjes së shqyrtimit gjyqësor deri në përfundimin e tij, duke u bazuar edhe në elementet e provave të marra nga prokurori gjatë hetimeve paraprake.

Si një rast që përligj ndryshimin e jurisprudencës së gjykatave italiane po paraqesim rastin e shqyrtuar nga Gjykata e Kasacionit të atij vendi, në vendimin nr. 30255 datë 12.07.2013⁸⁷.

Ky rast bën fjalë për një gjykim të zhvilluar në Gjykatën e Triestes ndaj të pandehurit P.F., i cili u deklarua fajtor nga kjo gjykatë për veprat penale të parashikuara nga neni 186/7, 187/8 si dhe nga neni 186/2 gërma “c” i Kodit Rrugor në Itali për shkak se në datë 20 shkurt 2009, i pandehuri pasi ishte përplasur me një tjetër autoveturë, kishte vazhduar të drejtonte automjetin e tij në një rrugë në sens të kundër drejtimit, duke përshkruar një gjatësi rreth 11 km e në fund automjeti që ai drejtonte përplasët me një kamion.

Pasi i pandehuri u dërgua në spital, ai refuzoi ti nënshtrohej një ekzaminimi mjeko ligjor të kërkuar nga forcat e rendit, në kuptim të nenit 186 të Kodit Rrugor Italian. Nga analizat e gjakut të kryera për qëllime klinike, rezultoi se i pandehuri kishte një nivel alkooli në gjak në sasinë 2,3 gram për litër. Mbi bazën e verifikimeve në seancë gjyqësore, gjykata e deklaroi fajtor të pandehurin për veprat penale të përmendura më lart, vendim i cili u la në fuqi edhe në Gjykatën e Apelit.

Mbrojtësi i të pandehurit paraqiti rekurs në Gjykatën e Kasacionit, ku ndër të tjera kërkoi pavlefshmërinë e vendimit të gjykatës së shkallës së parë e cila deklaroi fajtor të pandehurin edhe për një akuzë të re që kishte lidhje me veprat penale të sjella për gjykim, të njoftuar nga prokurori të pandehurit në seancë gjyqësore, akuzë e re e cila bënte fjalë për krimin e “Drejtimit të automjetit në gjendje të dehur”. Arsyet e rekursit lidheshin me faktin se sjellja e të pandehurit për këtë veprë penale të njoftuar në gjykim, rezultonte nga aktet që i kishte në dispozicion prokurori që në fazën e hetimeve paraprake dhe këto prova nuk u zbuluan në gjykim gjatë fazës së shqyrtimit gjyqësor. Pra sipas mbrojtjes janë shkelur kushtet e parashikuara nga neni 517 i K. Pr.Penale italiane.

Në lidhje me këtë pikë të rekursit Gjykata e Kasacionit në vendimin e saj u shpreh se:

“...kontestimi për akuzën e re të drejtimit të automjetit në gjendje të dehur nuk mund të pranohet me argumentin se krimi nuk ka qenë i konstatuar gjatë shqyrtimit gjyqësor, por ka rezultuar tashmë i ditur nga prokurori që nga aktet e marra në fazën e hetimit paraprak. Ky argument nuk gjen mbështetje në jurisprudencën konstante të kësaj gjykate duke e legjitimuar kontestimin suplementar në të dyja situatat (së fundmi shiko Vendimin nr. 6 datë 22.09.2009, nr. 44980 Rv. 245284).

Duhet theksuar se nga momenti i marrjes së njoftimit të kryerjes së veprës penale e deri në momentin e paraqitjes së kërkesës për gjykim dhe më pas deri në vendimin përfundimtar që e

⁸⁷ Cass. Pen., Sez. IV, n. 30255, 12.07.2013

zgjidh çështjen në themel, akuza konkrete ndaj personit nën hetim dhe më pas të pandehurit, mund të pësojë ndryshime që vijnë si rezultat i një vlerësimi më të mirë të elementëve të provës, të marra apo si rezultat i elementëve të reja, të dala gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Sygjerimet e dhëna në fazën e propozimit të normatives aktuale kanë patur si objektiv kryesor shmangien në mënyrën më absolute të situatave që pas modifikimit të akuzës, procesi të pësonte një tërheqje (regres) në fazën e mëparshme, pra që gjykata të vendoste si rezultat i ndryshimit të akuzës nga ana e prokurorit, kthimin e akteve prokurorisë me qëllim që të mbante parasysh të dhënat e reja dhe të ushtronte ndjekjen penale sipas një skeme të re që duhet të niste nga fillimi.

Ligjvënesi në përgjithësi ka mundur një rezultat substancialisht të përshtatshëm në përputhje me objektivat e përcaktuara edhe pse gjykatat i kanë dhënë më elasticitet konceptit “*elementë të provës të dala gjatë shqyrtimit*”.

Me të vërtetë, leximi i dispozitave të mësipërme të krijojnë përshtypjen se ndryshimi i akuzës mund të bëhet vetëm pas njohjes së re të marrë nga prokurori gjatë shqyrtimit gjyqësor. Por në ndryshim nga ky qëndrim, jurisprudenca siç pamë më sipër, ka dhënë një interpretim krejtësisht të ndryshëm, i cili bazuar në ligjin procedural dhe parimet që autorizojnë prokurorin për modifikimin e akuzës gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk përcakton kufizime apo ndalime. Pra duke njohur mundësinë e ndryshimit të akuzës, nisur edhe nga ajo çfarë ka dale nga elementët e provës të marrë gjatë hetimeve paraprake apo sipas një vlerësimi të ndryshëm të tyre.

4.2. *Ndryshimi i akuzës dhe elementët e saj*

Kapitulli i akuzave të reja fillon me dispozitën mbi “*Ndryshimin e akuzës*” të parashikuar nga neni 372 i K.Pr.Penale. Kjo dispozitë nuk është prekur nga ndryshimet e reja në Kod që do të hyjnë në fuqi më datë 1 gusht 2017. Një pjesë të trajtimit të ndryshimit të akuzës e kemi sqaruar në kapitullin e ndryshimit të akuzës në seancë paraprake, për shkak se elementët që përfshihen në ndryshimin e akuzës në të dy rastet janë të ngjashëm.

Në trajtimin në vijim do të ndalemi në momentet e ndryshimit të akuzës gjatë shqyrtimit gjyqësor. Në këtë rast ndryshimi i akuzës është produkt që rezulton nga provat e shqyrtuara në debatin gjyqësor të paraqitur nga palët në proces.

Në fillim po pasqyrojmë përmbajtjen e nenit 372 të K.Pr.Penale që bën fjalë për ndryshimin e akuzës i cili parashikon se:

“1. Kur gjatë shqyrtimit gjyqësor fakti del ndryshe nga ç’është përshkruar në kërkesën për gjykim dhe gjykimi i tij është në kompetencën e asaj gjykate, prokurori ndryshon akuzën dhe procedon me akuzën përkatëse.”

Nga intepretimi i dispozitës së sipërpërmendur në lidhje me aplikimin e saj kërkohet të ekzistojnë disa elementë thelbësor të cilat mund të renditen si në vijim:

Së pari, ndodhemi në fazën e shqyrtimit gjyqësor; *së dyti*, fakti duhet të dalë ndryshe nga ç’është përshkruar në kërkesën për gjykim; *së treti*, fakti i ndryshuar përfshihet në kompetencën e së

njëjtës gjykatë për t'u shqyrtuar; së katërti, prokurori ndryshon akuzën dhe procedon më tej me akuzën e ndryshuar

4.2.1. Faza e shqyrtimit gjyqësor

Kur veprohet me ndryshimin e akuzës themi se në këtë rast ndodhemi përpara një situatë të re e cila nuk ka qenë e parashikuar më parë prej subjekteve procedurale. Në fazën e shqyrtimit gjyqësor prokurori sjell përpara gjykatës kërkesën për gjykimin e të pandehurit. Në kërkesën për gjykim prokurori përcakton akuzën konkrete që i atribuohet të pandehurit. Akuza përfundimtare është sintezë e procesit të vlerësimit të të gjitha të dhënave të mbledhura nga prokurori në fazën e hetimit paraprak. Më tej me ndryshimet e reja në Kodin e Procedurës Penale akuza i nënshtrohet verifikimit të bërë në seancë paraprake nga një gjyqtar.

Verifikimi i përmbajtjes së akuzës ose thënë ndryshe verifikimi i të gjithë elementëve thelbësore të saj realizohet në seancë gjyqësore paraprake, në prani edhe të të pandehurit, i cili ka të drejtë të paraqesë të gjithë qëndrimin e në tij në këtë seancë në raport me elementët e akuzës. Ndodhur përpara kësaj situatë mund të themi se për sa kohë akuza e prokurorit i është nënshtrohet edhe procesit të verifikimit përpara gjyqtarit dhe në prani të të pandehurit, atëherë akuza duhet të bëhet e qëndrueshme. Si rrjedhim në fazën e shqyrtimit gjyqësor situata e ndryshimit të akuzës do të ishte e panevojshme, pasi rastet në praktikë nuk do të ekzistonin.

Në të vërtetë ndryshimi i akuzës në fazën e shqyrtimit gjyqësor mund të ndodhë pavarësisht se akuza i është nënshtrohet paraprakisht edhe verifikimit nga gjyqtari i vetëm. Arsyeja e ndryshimit të akuzës lidhet me natyrën e paqëndrueshme dhe elastike të saj, veçori këto të cilat i kemi përmendur kur kemi trajtuar akuzën si një institut të së drejtës procedurale.

Pra dhe në fazën e shqyrtimit gjyqësor akuza mund të ndryshojë. Në këtë aspekt mundësia e ndryshimit të akuzës në gjykim është e pranueshme të ndodhë, për shkak se në procesin gjyqësor, në ndryshim nga faza e hetimeve paraprake - ku të dhënat e mbledhura i nënshtrohen vetëm vlerësimit të njëanshëm të prokurorit si rezultat i të cilave ai harton akuzën për të pandehurin, - provat i nënshtrohen procesit të ekzaminimit të dyfishtë (*cross examination*). Si rezultat i debatit gjyqësor dhe përfutimit të provave të reja, të servirura në fazën e shqyrtimit gjyqësor vlerësimi i prokurorit mbi faktin penal të sjellë për gjykim mund të ndryshojë.

Kështu që mund të themi se faza e gjykimit është hapësira ku akuza e ngritur nga prokurori i nënshtrohet detyrimisht një procesi të ri të shqyrtimit të provave. Pas këtij procesi ekziston mundësia që prokurori të reflektojë sërish mbi akuzën fillestare të sjellë për gjykim për shkak se vlerësimi i tij pas debatit gjyqësor mbi provat e shqyrtuara mund të ketë ndryshuar. Kjo është edhe arsyeja që ndryshimi i akuzës ndodhë edhe në fazën e shqyrtimit gjyqësor.

4.2.2. Fakti del ndryshe nga ç'është përshkruar në kërkesën për gjykim

Elementi i dytë e më i rëndësishmi që ndikon në ndryshimin e akuzës ka të bëjë me faktin e sjellë për gjykim. Neni 372 i K.Pr.Penale kërkon që fakti i sjellë për gjykim duhet të dalë ndryshe nga ç'është përshkruar në kërkesën për gjykim.

Për të argumentuar se çfarë duhet kuptuar me shprehjen e *daljes ndryshe të faktit nga ai i përshkruar në kërkesën për gjykim*, duhet fillimisht të ndalemi në shpjegimin e faktit të sjellë për gjykim nga prokurori.

E vlerësoj si pjesë të rëndësishme të këtij punimi trajtimin në veçanti të faktit, pasi ky element është i pranishëm në të gjitha dispozitat procedurale të kapitullit të akuzave të reja dhe rrjedhimisht trajtimi për faktin penal do të bëhet për të gjitha dispozitat e kapitullit. Pra fakti penal është element përbërës në rastet e *Ndryshimit të akuzës (neni 372 i K.Pr.Penale)*, *Akuza për një veprë penale (neni 373 i K.Pr.Penale)*, *Akuza për një fakti të ri (neni 374 i K.Pr.Penale)*, *Ndryshimi i cilësimit juridik (neni 375 i K.Pr.Penale)*.

Për shkak se fakti penal është element thelbësor i akuzës e si rrjedhim për sa kohë akuzat e reja i referohen situatave juridike të cilat ndryshojnë natyrën e akuzës në gjykim, padyshim që këto ndryshime fokusohen tek fakti penal i cili është element thelbësor i akuzës⁸⁸.

Në lidhje me pyetjen se çfarë është fakti i prezantuar prej prokurorit në gjykim mund të themi se në Kodin e Procedurës Penale, në mënyrë indirekte jepet përshkrimi i faktit nisur nga këndvështrimi i provave në procesin penal.

Kështu neni 149 i K.Pr.Penale kur shpjegon kuptimin e provës përfshin faktet të cilat i shndërrojnë provat në mjetin e domosdoshëm që janë në shërbim të procesit penal për zbulimin e së vërtetës⁸⁹. Referuar nenit 149 të K.Pr.Penale faktet në një proces penal janë të lidhura me veprën penale (me ekzistencën ose jo të saj), me pasojat e ardhura nga vepra penale, më fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit si dhe me shkallën e përgjegjësisë të tij.

Në gjykim procesi i të provuarit bazohet në fakte që kanë lidhje me akuzën, fajësinë e të pandehurit, caktimin e masave të sigurimit, dënimin dhe përgjegjësinë civile, si dhe faktet nga të cilat varet zbatimi i normave procedurale⁹⁰. Për efekt të këtij studimi do bazohemi në faktet që kanë lidhje me akuzën dhe fajësinë e të pandehurit, për shkak të trajtimit të faktit si pjesë përbërëse e akuzave të reja në procesin penal.

Duke ju referuar dispozitave procedurale të përmendura më sipër, mund të themi se fakti i përfshirë në të gjitha dispozitat e kapitullit të akuzave të reja, nuk është gjë tjetër veçse fakti penal i përmendur shpesh në jurisprudencë. Themi se fakti i përmendur në dispozitat e akuzave të reja është fakti penal, pasi në shqyrtim gjyqësor objekti i të provuarit prej prokurorit është fakti që ka lidhje me akuzën e ngritur, pra fakti që ka lidhje me veprën penale të dyshuar se është kryer nga i pandehuri.

Fakti penal në vetvete përfaqëson faktin objektiv, i cili karakterizohet nga veprimet e kryera prej autorit të veprës penale, veprime të cilat i drejtohen marrëdhënieve shoqërore që përbëjnë objektin e veprës penale e të cilat mbrohen konkretisht nga ligji penal. Fakti penal si elementë të tij, përfshin veprimet ose mosveprimet (kur këto të fundit janë pjesë përbërëse e veprës penale) të kryera nga autori ose autorët e veprës penale, elementë të cilat lidhen me mënyrën e

⁸⁸ Në pjesën e elementeve të akuzës në këtë punim kemi trajtuar edhe faktin si pjesë përbërëse e elementit të shkakut të akuzës.

⁸⁹ Neni 149 i K..Pr.Penale

⁹⁰ Neni 150 i K..Pr.Penale

kryerjes së veprës penale (sidomos në rastet kur mënyra është pjesë e rëndësishme e strukturës së veprës penale), të cilat përfshijnë mjetet e kryerjes, forma e kryerjes së veprës, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, pasoja e ardhur nga vepra penale, formën e fajit të autorit të veprës penale si dhe shkallën e përgjegjësisë penale të tij.

Pra përbën fakt penal nga pikëpamja procedurale e në mënyrë specifike në lidhje me akuzën, ajo çfarë përbëhet nga elementë objektivë (sjellje, lidhje shkakësore, pasojë) dhe subjektive (elementi psikologjik)⁹¹, që duke u integruar krijojnë një përputhje perfekte me llojin e veprës penale të përshkruar në rrugë abstrakte nga dispozitat ligjore penale materiale dhe të posaçme të cilat parashikojnë edhe sanksionet e natyrës penale. Duke analizuar elementët thelbësorë të faktit penal që në doktrinë e hasim edhe si fakti historik i përcaktuar më sipër, kuptojmë se sa të shumta mund të jenë aspektet që e plotësojnë dhe karakterizojnë atë në mënyra nga më të ndryshmet. Sjellja, për shembull mund të ketë natyrën e veprimit ose të mosveprimit, mund të jetë realizuar nëpërmjet një manifestimi konkret direkt (si për shembull ajo e kryer nga ekzekutori material) ose indirekt (ajo e realizuar nga ekzekutori moral). Pasoja mund të lidhet me një moment historik të pa përcaktuar ose të përcaktuar në mënyrë të gabuar dhe kështu edhe natyra psikologjike e sjelljes konfigurohet si pakujdesi, dashje apo paramendim⁹².

Të gjithë elementët e përmendur më lart janë pjesë e fakti penal. Fakti penal është pjesë përbërëse e parimit kushtetues “*Ne bis in idem*” i cili është trajtuar gjerësisht nga jurisprudenca dhe doktrina vendase dhe ajo e huaj⁹³.

Sipas trajtimeve që i janë bërë parimit “*Ne bis in idem*” themi se fakt i njëjtë do të thotë “i njëjti fakt objektiv” i cili karakterizohet nga të njëjtat veprime, subjekte dhe objekt material. Pra, “fakt i njëjtë” do të thotë që fakti jo vetëm në tërësinë e tij të jetë i njëjtë, por edhe se asnjë element i tij përbërës nuk duhet të rezultojë të jetë i ndryshëm gjatë debatit kontradiktor, nga ajo mënyrë sikurse ai është përcaktuar në akuzën e paraqitur nga prokurori. Ajo që kondicionon ndryshimin e cilësimit juridik është vlerësimi i ndryshëm që i bëhet kësaj shtate objektive nën dritën e dispozitave ligjore, duke derivuar në një cilësim ligjor të ndryshëm nga ai që ka bërë prokurori të shprehur në akuzën e paraqitur për gjykim. Në këto kushte, duhet bërë një diferencim nga rasti kur kemi një fakt të ri, i cili është i ndryshëm nga i pari e si i tillë shërben si pikënisje për ngritjen e një akuze të re. Në këtë rast të fundit, nuk mund të flasim për ekzistencën e kriterit të dyte “i njëjti fakt”.

Koncepti “i njëjti fakt” duhet parë i lidhur në mënyrë thelbësore me parimin “*Ne bis in idem*” në themel të të cilit ai qëndron. Kjo pasi jo në pak raste, aplikimi i parimit “*Ne bis in idem*” kushtëzon veprimet e organeve proceduese. Në këto kushte, për vetë rëndësinë që paraqet ky parim, mund konsiderohet si kriter ndihmës që duhet të meret parasysh nga prokurori por edhe nga gjykata kur këto subjekte procedojnë me dispozitat që lidhen me akuzat e reja.

Evidentimi i këtij parimi si një kriter ndihmës për të përcaktuar natyrën e faktit lidhet me mundësinë e një perceptimi të drejtë të ngjarjes e cila ndikon drejtpërdrejt në saktësinë e veprimit që duhet të kryhet prej prokurori ose gjykatës.

⁹¹ Gaito Alfredo, “La Prova Penale” UTET, 2008, faqe 352

⁹² Ganaj Françesk, “Akuzat penale në procesin penal dhe garancitë e të pandehurit”, temë e prezantuar si pjesë e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, Mars 2017, faqe 37

⁹³ Mos gjykimit apo mos dënimit dy herë për të njëjtin fakt

Pra kriteri i njëjti fakt, i referohet të njëjtit veprim, sjellje, fakt, veprë penale dhe kualifikim ligjor të tij, të cilat formojnë bazën e kësaj vepre e për të cilën personi është dënua apo liruar⁹⁴.

Le të kthehemi tek trajtimi i shprehjes *fakti del ndryshe nga ç'është përshkruar në kërkesën për gjykim*, që është pjesë e elementëve përbërës të ndryshimit të akuzës i parashikuar nga neni 372 i Kodit të Procedurës Penale.

Fakti i ndryshëm nga ai i përcaktuar në kërkesën për gjykim lidhet me vlerësimin e ri që prokurori natyrisht i bën faktit penal, i cili tashmë është produkt i debatit gjyqësor. Kur dispozita në këtë rast parashikon shprehjen "*fakti del ndryshe nga ç'është përshkruar në kërkesën për gjykim*", duhet të kuptojmë se në këtë rast nuk ndodhemi përpara një fakti të ndryshëm. Në këtë rast ndodhemi përpara të njëjtit fakt penal që është përmendur në kërkesën për gjykim dhe që është hetuar paraprakisht nga prokuroria në fazën e hetimit. Fakti mund të rezultoj i ndryshëm në gjykim për shkak të modifikimit që ai mund të ketë pësuar si rezultat i një vlerësimi të ri të provave të debatuar tashmë nga palët në proces ose për shkak të provave të reja të marra në gjykim, të cilat në harmoni edhe me ato që janë shqyrtuar në gjykatë, mund ta prezantojnë faktin penal ndryshe nga ai që është përshkruar në kërkesën për gjykimin e çështjes.

Pra në procesin gjyqësor elementët e faktit penal të përmendura më sipër mund të ndërthuren apo të zëvendësojnë njëri - tjetrin në varësi të zhvillimit të procesit gjyqësor. Themi se jemi në prezencë të ndryshimit të faktit, në kuptimin e përdorur nga neni 372 K.Pr.Penale, pra fakt të ndryshëm, kur përballë një akuze të parë të specifikuar në të gjithë elementët identifikues të faktit penal, të mbërrihet, falë elementëve të provës të nxjerra apo të vlerësuar në shqyrtimin gjyqësor, në transformimin e kësaj akuze të parë, pikërisht në elementët thelbësorë. Pra duhet të bëhet fjalë për elementët përcaktues e thelbësorë, në mënyrë që të mos tejkalohet në përfshirjen në këtë koncept të rastit të cilësimit ligjor të ndryshëm apo të faktit krejtësisht të ri⁹⁵.

Për këtë arsye më lart ju referuam parimit "*ne bis in idem*" si një kriter ndihmës i cili na orienton për të identifikuar qartësisht se çfarë duhet të kuptojmë me fakt, cilët janë elementët përbërës të tij dhe kur ndryshojnë faktet, në dukje të ngjashëm prej njëri – tjetrit.

Në referimin e mësipërm themi se dy janë rastet kur prokurori procedon me ndryshimin e akuzës në gjykim për shkak se fakti del ndryshe nga ai që është përmendur në kërkesën për gjykim. Këto raste janë, *së pari* kur kemi të bëjmë me vlerësim të ndryshëm të faktit prej prokurorit në gjykim si rrjedhojë e debatit gjyqësor të kryer mbi provat e shqyrtuara (elementi i natyrës së akuzës), *së dyti* me paraqitjen e provave të reja të cilat në gjykim e plotësojnë faktin penal duke i dhënë atij një vlerësim të ndryshëm nga vlerësimi që i është bërë në kërkesën për gjykim (elementi i shkakut të akuzës).

Të dy rastet që e shtyjnë prokurorin për të ndryshuar akuzën lidhen me dy elementët thelbësorë që përbëjnë akuzën që janë shkaku (fakti penal) si dhe natyra (kualifikimi ligjor si veprë penale e faktit penal) e saj. Për shkak të paqëndrueshmërisë së akuzës për shkak të nyrës

⁹⁴ Bani Erion, Dardha Luveta, Dervishi Marsela, Gjuzi Adelajda, Goxha Diamela, Hasani Dritan, Mihali Elona, Muçi Emona. "Ndryshimi i cilësimit juridik të veprës penale dhe e drejta për një proces të rregullt ligjor sipas KEDNJ", Revista Juridike nr. 2 Viti i XII, botuar nga Shkolla e Magjistraturës, Qershor 2012

⁹⁵ Ganaj Françesk. "Akuzat penale në procesin penal dhe garancitë e të pandehurit", temë e prezantuar si pjesë e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, Mars 2017, faqe 37

së saj që është gjithmonë e varur prej të dhënave që mblidhen edhe në proces gjyqësor mund të rezultojë që elementët e shkakut apo të natyrës së akuzës të ndryshojnë në gjykim.

Referuar rastit të parë, vlerësimi të ndryshëm të faktit penal në gjykim, mund themi se prokurori ndryshon në gjykim akuzën ndaj të pandehurit kur fakti penal i sjellë për gjykim nuk ka ndryshuar, në kuptimin që nuk janë marrë prova të reja në gjykim që të ndryshojnë elementët e faktit penal. Në këtë rast ka ndryshuar vetëm vlerësimi i prokurorit mbi faktin penal për shkak të debatit gjyqësor.

Vlerësimi i ndryshëm i faktit prej prokurorit mund të vijë si rezultat i interpretimit të ndryshëm që prokurori i bën elementit të natyrës së akuzës (përshkrimi ligjor të veprës penale) duke u bazuar në debatin gjyqësor. Kështu mund të themi se interpretimi i ndryshëm i dipozitës penale mund të lidhet me fazën e veprimtarisë kriminale, me veprën penale ose me disa rrethana cilësuese të kryerjes së veprës penale.

Për shembull prokurori fillimisht ka sjellë për gjykim të pandehurin për veprën penale të Trafikimit të narkotikëve në formën e eksportimit, parashikuar nga neni 283/a/1 i Kodit Penal, ndërkohë që në gjykim pa marrë ndonjë provë të re, është konstatuar nga debati gjyqësor se lënda narkotike është sekuestruar brenda territorit shtetëror dhe si rrjedhim ajo nuk ka mundur të dalë nga kufiri shtetëror. Në këtë rast prokurori referuar elementit të natyrës së akuzës që lidhet me përcaktimin e fazës së veprimtarisë kriminale reflekton dhe duhet të ndryshojë akuzën për të pandehurin, në atë të Trafikimit të narkotikëve në formën e eksportimit mbetur në tentativë parashikuar nga neni 283/a/1 e 22 i Kodit Penal.

Rasti i paraqitur më sipër është i përfshirë në Vendimin nr. 1/2007 të dhënë nga Gjykata e Shkallës së Parë “Për Krimet e Rënda”⁹⁶, e cila për momentin e ndryshimit të akuzës në lidhje me përcaktimin e saktë të fazës në të cilën kalon veprimtaria kriminale ka sqaruar se:

“...Prandaj gjykata konkludon se të pandehurit J. V. dhe Z. R. kanë konsumuar me veprimet e tyre veprën penale të “Trafikimit të narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/a/2 i Kodit Penal. Por megjithëse të pandehurit kanë ndërmarre veprime të drejtpërdrejta për kryerjen e veprës penale, vepra është ndërprerë dhe nuk ka përfunduar me kalimin e lëndës narkotike përtej kufirit shqiptar me Greqinë për shkaqe të pavarura nga vullneti i tyre. Me ndërhyrjen e forcave të policisë në afërsi të kufirit me shtetin grek vepra penale nuk ka mundur të realizohet plotësisht...”

Sqarojmë se nga ana e organit të akuzës vetëm në konkluzionet përfundimtare ndryshoi akuzën dhe u kërkua prej saj që vepra penale e kryer prej të pandehurve të kualifikohej sipas nenit 283/a/2 e 22 të Kodit Penal, ndërkohe në kërkesën për gjykim dhe aktin e njoftimit të akuzës për të pandehurit përcaktohej vepra penale e parashikuar nga neni 283/a/2 të Kodit Penal.

Gjithashtu mund të ndodhemi në rastet kur në gjykim, pa ndryshuar fakti penal, që do të thotë se në procesin gjyqësor nuk janë marrë prova të reja, prokurori duke vlerësuar rrethanat e kryerjes së veprës penale si pasojë e debatit gjyqësor procedon me ndryshimin e akuzës së të pandehurit në gjykim.

⁹⁶ Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë “Për Krimet e Rënda” Tiranë, nr. 1 datë 08.01.2007

Në vendimin e dhënë nga Gjykata e Shkallës së Parë “Për Krimet e Rënda” Tiranë, me nr. 11/2015 rezultojnë të paraqitura faktet e mëposhtme⁹⁷:

“...Në datë 15.03.2014, çifti Xh.H. dhe A.N. të shoqëruar me makinë nga i ndjeri P.H., janë nisur nga qyteti i Tiranës për në Durrës në banesën e shtetasit A.N. për të kthyer vajzën e tij A. Pasi kanë arritur në banesën e shtetasit A. N., kanë parkuar automjetin e tyre brenda oborrit dhe janë futur brenda në banesë ku janë ulur në ambientet e kuzhinës.

Më pas midis të ndjerit P.H. dhe të pandehurit A.N. ka lindur një debat i ashpër pasi i pandehuri A.N. u kërkonte arsyeën e ndarjes së çiftit. Gjatë këtij debati, i pandehuri A.N. ka shkuar nga kuzhina në dhomën tjetër, atje ka marrë një armë gjahu dhe me të është kthyer përsëri në kuzhinë. Me armën e gjahut ka qëlluar njëherë në drejtim të të ndjerit P.H.

Në këtë moment i ndjeri P.H. është çuar në këmbë bashkë me deklaruesin Xh., për ti marrë armën e gjahut të pandehurit A.N. Më tej i pandehuri A.N. me një kaçavidë ka qëlluar në kokë deklaruesin Xh.H., por ky i fundit pasi ka marrë goditjet pas koke, ka arritur t’ia heq nga dora të pandehurit kaçavidën. Më tej konflikti është ashpërsuar dhe i pandehuri A. N. ka marrë mbi bufe një thikë buke me dorezë druri dhe ka qëlluar fillimisht deklaruesin Xh. dhe më pas të ndjerin P. H. , në pjesën e kraharorit, barkut dhe të shpinës. Gjithashtu i pandehuri e ka goditur të ndjerin P. H. edhe në anën e djathtë të ballit ku i ka shkaktuar një plagë.

Gjatë kësaj kohe nga banorët e lagjes janë dëgjuar zhurma në banesën e të pandehurit A.N. Në këtë banesë ka shkuar fillimisht gjyshi i Xh, shtetasi H.H i cili ka hapur derën e shtëpisë duke e shtyrë. Më pas aty është futur edhe halla e tij shtetasja Sh.K, të cilët kanë nxjerrë jashtë të ndjerin P.H. dhe shtetasin Xh.H.

Në momentin kur shtetasi Xh.ka dalë jashtë është drejtuar për në shtëpinë e tij, por ajo ishte e mbyllur dhe më pas është futur në shtëpinë e fqinjës së tij, shtetases L.P.

Të ndjerin P.H. e kanë marrë shtetasit H.H. dhe Sh.K. duke e nxjerrë jashtë shtëpisë së të pandehurit. I ndjeri P.H. përpara oborrit të shtëpisë së babait të tij H.H. është rrëzuar në gjunjë.

I pandehuri A.N. duke ndjekur lëvizjet e deklaruesit Xh.H. ka qëlluar jashtë shtëpisë me armë gjahu 2 herë në drejtim të tij, ku si pasojë e goditjes me armën e gjahut ka mbetur e plagosur shtetasja N.Sh. e cila është banore e lagjes dhe fqinje me shtetasin A. N.

Pas kësaj ngjarje i ndjeri P. H. është dërguar në spitalin e Durrësit por si pasojë e goditjeve të shumta të marra në trup ka ndërruar jetë. Shtetasi Xh.H. ka pritur në banesën e shtetases L.P. ardhjen e policisë, ku kjo e fundit e ka dërguar në spital të dëmtuarin.

Më pas prokuroria më datë 25.11.2014 i ka njoftuar akuzën të pandehuri A.N. për veprën penale të “Vrasjes për shkak të marrëdhënieve familjare” në dëm të shtetasit P.H. parashikuar nga nenin 79/c i Kodit Penal dhe “Vrasjes për shkak të marrëdhënieve familjare” mbetur në tentativë në dëm të shtetasit Xh. H. parashikuar nga neni 79/c e 22 i Kodit Penal. Pas njoftimit të akuzës më datë 03.12.2014 prokuroria ka depozituar në gjykatë kërkesën për gjykimin e të pandehurit A.N. për akuzat e përmendura më lart duke i bashkëngjitur kërkesës edhe fashikullin hetimor i cili përmbante të gjitha aktet e hartuar nga prokuroria gjatë fazës së hetimit paraprak.

⁹⁷ Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë “Për Krimet e Rënda” Tiranë, nr. 11 datë 22.01.2015

Prokuroria në konkluzionet përfundimtare ndryshoi njërën prej akuzave që ajo kishte ngritur ndaj të pandehurit A.N. Prokuroria duke argumentuar se i pandehuri A.N. dhe viktimja P.H. nuk përfshiheshin në rrethin e krushqisë së afërt siç e parashikon rrethin e krushqisë neni 16 i Kodit të Procedurës Penale⁹⁸, ndryshoi njërën akuzë të të pandehurit A.N. nga “Vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare” ndaj viktimës P.H. parashikuar nga neni 79/c i Kodit Penal në atë të “Vrasjes me dashje” ndaj viktimës P.H. parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal...”

Ndryshimi i akuzës mund të ndryshojë edhe për shkak të ndryshimit të ligjit penal. Nëse ligji i kohës kur është kryer vepra penale është ndryshuar gjatë kohës që i pandehuri po gjykohe për veprën penale të kryer prej tij, kjo situatë është e mjaftueshme për prokurorin që ai të ndryshojë akuzën në gjykim për shkak të ndryshimit të elementit të natyrës së akuzës. Në këtë rast ndaj të pandehurit do të zbatohet ligji penal i ndryshuar, vetëm në ato raste kur dispozita e tij parashikon një dënim më të favorshëm për të pandehurin në krahasim me dispozitën e ligjit të mëparshëm penal.

Për shembull gjatë hetimit ka rezultuar se në banesën e të pandehurit është gjetur një armë zjarri dhe për këtë fakt penal prokuroria më kohën kur është konstatuar ky fakt e akuzon të pandehurin për veprën penale të *Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe municionit* të parashikuar nga neni 278/5 të Kodit Penal, parashikuar me ndryshimet e ligjit nr. 144/2013 të cilit ju shtuan edhe dy paragrafë me Ligjin nr. 135/2015. Në kohën kur është konstatuar fakti penal i mbajtjes pa leje të armës luftarake në banesën e të pandehurit, dispozita penale e kohës, pra neni 278/5 i Kodit Penal parashikonte një dënim me burgim nga një deri në pesë vjet.

Ndërkohë kur çështja penale është sjellë për gjykim ndaj të pandehurit kanë hyrë në fuqi dispozitat e reja të Kodit Penal, të ndryshuar me Ligjin nr. 82/2016. Kjo dispozitë penale e ndryshuar përcakton në nenin 278/3 të Kodit Penal, se mbajtja e armëve në banesë pa lejen e organeve kompetente shtetërore dënohet me burgim nga një deri në tre vjet. Si rezultat i ndryshimit vetëm të dispozitës penale, pa u ndryshuar fakti penal, në gjykim prokurori procedon me ndryshimin e akuzës duke u mbështetur në ndryshimet e reja të Kodit Penal, të cilat favorizojnë veprën penale të kryer prej të pandehurit. Të gjitha këto ndryshime të akuzës të përmendura më lart i referohen elementit të natyrës së akuzës.

Në lidhje me rastin e dytë të paraqitjes së provave të reja në gjykim, mund të themi se kemi të bëjmë me elementin e shkakut të akuzës. Kur themi se ndryshon shkakut i akuzës do të kemi parasysh situatën e ndryshimit të elementëve të cilat lidhen me faktin penal. Gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes mund të paraqiten prova të reja të cilat plotësojnë faktin penal me ndonjë rrethanë të re të njohur, por të paverifikuar hollësisht në hetim ose mund të paraqiten prova të reja të cilat i japin një kuptim të ndryshëm faktit penal të sjellë për gjykim dhe si rrjedhim lejojnë prokurorin që të ndryshojë akuzën. Në këto raste prokurori duhet të ndryshojë akuzën e sjellë në gjykim me akuzën e re e cila bazohet edhe në provat e reja të marra gjatë gjykimit.

Pra ndryshimi i faktit penal në gjykim mund të vijë për dy arsye kryesore që janë: paraqitja e provave të reja të cilat e paraqesin ndryshe faktin penal ose një vlerësim i ndryshëm që

⁹⁸ Neni 16 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se krushqi e afërt janë: “...krushqi e afërt (vjuhërr, vjehërrë, dhëndër, nuse, kunatë, thjeshtri, thjeshtra, njerku e njerka).”

prokurori i bën faktit penal, duke u mbështetur në debatin për provat që ai ka paraqitur në gjykim.

Ndodhemi përpara rastit të paraqitjes së provave të reja që pasqyrojnë rrethana të paverifikuara hollësisht në hetim, në rastin kur në hetim janë akuzuar dy persona se në bashkëpunim me njëri – tjetrin kanë kryer veprën penale të *Trafikimit të narkotikëve* mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 283/a/2 i Kodit Penal. Rrethanën e bashkëpunimit prokurori e mbështeste në një përgjim ambiental, i cili ishte transkriptuar jo plotësisht nga oficeri i policisë gjyqësore që e kishte kryer këtë veprim në kushtet e urgjencës e për të përligjur arrestimin në flagrancë të të dy të pandehurve.

Më konkretisht në vendimin nr. 136/2014 të dhënë nga Gjykata e Shkallës së Parë “Për Krimet e Rënda” Tiranë janë paraqitur faktet e mëposhtme⁹⁹:

“...Prokuroria “Për Krimet e Rënda” Tiranë ka sjellë për gjykim çështjen penale në ngarkim të të pandehurve G.C. dhe M.P. me akuzën e “Trafikimit të narkotikëve” mbetur në tentativë parashikuar nga neni 283/a/2 e 22 i Kodit Penal. Prokuroria “Për Krimet e Rënda” Tiranë më datë 24.11.2012 ka regjistruar procedimin penal nr. 179 në ngarkim të personave nën hetim G.C. dhe M.P., për veprën penale të “Trafikimit të narkotikëve” mbetur në tentativë parashikuar nga neni 283/a/2 e 22 të Kodit Penal.

Gjatë hetimit ka rezultuar se më datë 24.11.2012 në Pikën e Kalimit Kufitar Muriqan Shkodër janë paraqitur të pandehurit G.C. dhe M.P. me automjetin tip “Benz Mercedes” me targë AA 982 FB që drejtohej nga i pandehuri G.C., për të kryer procedurën e kalimit kufitar nga Republika e Shqipërisë për të shkuar në Republikën e Malit të Zi. Punonjësit e policisë të stacionit kufitar të Muriqanit Shkodër, gjatë kontrollit paraprak të ushtruar në automjet në hapësirën ndërmjet motorit dhe serbatorit kanë konstatuar montimin e një llamarine të salduar. Në fundin e saj policia ka gjetur një profil metalik “ele” e cila ishte e lidhur me pjesën e poshtme të automjetit.

*Në këtë hapësirë të krijuar nga pllaka metalike me shasinë e automjetit me anë të endoskopit forcat e policisë kanë gjetur të fshehur 41 pako të mbështjella me plastmasë të tejdukshëm dhe shirit natribani me ngjyrë kafe. Në përfundim të kontrollit punonjësit e policisë kanë sekuestruar 41 (dyzet e një) pako të fshehura në automjet brenda të cilave kishte lëndë bimore të presuar me ngjyrë dhe erë karakteristike si ajo e bimës *cannabis sativa*.*

*Forcat e policisë pas kontrollit të ushtruar në automjetin e të pandehurit, dyshuan se sasia e lëndës bimore të gjetur të fshehur në automjet ishte *Cannabis* që është produkt herbal i bimës *Cannabis Sativa*. Pas këtij veprimi, forcat e policisë kanë kapur në flagrancë të pandehurit G. C. dhe M. P. si persona që udhëtonin me automjetin ku u gjet e fshehur lëndë e dyshuar si narkotike. Policia gjyqësore arrestoi të dyshuarit në kushtet e flagrancës pasi ata u kapën në kryerje e sipër të një krimi.*

Në momentin e ndalimit të të dyshuarve policia gjyqësore realizoi edhe një përgjim ambiental të tyre në ambientet e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Shkodër më datë 24.11.2012.

⁹⁹ Vendim i Gjykatës së shkallës së parë “Për Krimet e Rënda” Tiranë nr. 136 datë 25.11.2014

Në këtë gjendje procedimi prokuroria ka sjellë për gjykim çështjen penale në ngarkim të të pandehurve G. C. dhe M. P. akuzuar për veprën penale të “Trafikimit të narkotikëve” mbetur në tentativë parashikuar nga neni 283/a/2 – 22 i Kodit Penal. Fillimisht prokuroria akuzën e trafikimit të narkotikeve në bashkëpunim për të dy të pandehurit e kishte mbështetur në një bisedë ambientale të realizuar midis të pandehurve në mjediset e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Shkodër. Kjo bisedë është përgjuar nga prokuroria dhe është e vleftësuar e ligjshme nga gjykata. Në procesverbalin e transkriptimit të kësaj bisede nga policia gjyqësore Shkodër më datë 24 nëntor 2012 të pandehurit M.P. i është atribuar shprehja:

M: Kot s'ja futëm nga Bari ma mirë!

G: Eeee?

M: T' kishim ik nga Bari!...

G: As se kan pa letra makinet e asnji send n' bote!

Në seancë gjyqësore gjykata dëgjoi nëpërmjet sistemit audio bisedën e përgjuar midis të pandehurve. Gjatë procesit të dëgjimit të bisedës ambientale gjykata konstatoi se ekzistonin mospërputhje midis bisedës së përgjuar dhe procesverbalit të transkriptimit i mbajtur nga policia gjyqësore në 24 nëntor 2012. Për shkak të transkriptimit jo të plotë të bisedës së përgjuar, gjykata mbështetur në nenin 223 të K.Pr.Penale duke marrë në konsideratë edhe kundërshtimet që paraqiti i pandehuri M.P. dhe mbrojtësi i tij për procesverbalin e transkriptimit, vendosi të transkriptojë edhe një herë bisedën e përgjuar midis të pandehurve.

Pas transkriptimit të plotë të kësaj bisede më datë 05.11.2014 nga policia gjyqësore në “Sektorin e Përgjimit të Telekomunikacioneve dhe Marrëdhënieve me Shërbimet Informative” në Prokurorinë e Përgjithshme, me vendimin e gjykatës në seancë gjyqësore ka rezultuar se i pandehuri M.P. nuk e ka thënë atë shprehje që u përmend më lart. Në transkriptimin e ri të realizuar me vendim gjykate ajo shprehje i atribuohet të pandehurit G.C. Më konkretisht: Në transkriptimin e bisedës G.C. është shënuar me gërmën A.

Personi A – E. “S’ja futëm nga Bari ma mirë, të kishna ik nga Bari, ç’aty kalova herën e parë, a e duhur, as kan pa letra makine as sen në botë.”

Prokuroria për fjalët e transkriptuara gabim nga policia gjyqësore Shkodër për të pandehurin M. P. e kishte ngarkuar me përgjegjësi penale atë duke e konsideruar si bashkëpunëtor të të pandehurin G. C. në trafikimin e narkotikëve. Meqënëse fjalët e përshkrura më lart nuk ishin thënë prej të pandehurit M.P., prokuroria vlerësoi gjatë gjykimin se nuk ekziston bashkëpunimi mes dy të pandehurve dhe në fund ndryshoi akuzën për të pandehurin G.C., duke e akuzuar përfundimisht për veprën penale të “Trafikimi të narkotikëve” në tentativë, parashikuar nga neni 283/a/1 e 22 i Kodit Penal si dhe për të pandehurin M.P., bazuar në nenin 377 të K.Pr.Penale tërhoqi akuzën në gjykim ndaj tij...”

Në këtë rast prova e re, transkriptimi i plotë i bisedës ambientale të përgjuar e cila ishte sjellë si provë më parë në gjykim por nuk ishte e vlerësuar drejt gjatë hetimit, ndikoi në ndryshimin e faktit penal, pasi tashmë inkriminonte vetëm njërin prej të pandehurve.

Ndodhemi përpara rastit të marrjes së provave të reja (të cilat pas debatit të tyre e paraqesin ndryshe faktin e sjellë për gjykim) në rastin kur prokuroria në fazën e hetimit i njofton të pandehurit akuzën e vrasjes me dashje të mbetur në tentativë parashikuar nga nenet 76 e 22 të Kodit Penal, për shkak se i pandehuri gjatë një grindjeje të çastit me një mjet mprehtës (jo thikë)

kishte goditur në qaftë të dëmtuarin. Pasi mori ndihmën e parë mjekësore i dëmtuari ishte larguar jashtë shtetit për probleme pune dhe në hetim nuk ishte realizuar pyetja e tij me cilësinë e personit që tregon rrethana të dobishme për hetimin. Akuza e vrasjes me dashje të mbetur në tentativë, ishte mbështetur vetëm duke u bazuar në kartelën mjekësore të të dëmtuarit pa u realizuar akti i ekspertimit mjeko ligjor.

Në gjykim u paraqit personalisht i dëmtuari, i cili shpjegoi se grindja me të pandehurin ka qenë momentale dhe plaga që ai mori në qafë si pasojë e goditjes me mjet mprehtës nuk ishte e rëndë. I pandehuri pas kësaj goditjeje i kishte dhënë personalisht ndihmën e parë mjekësore dhe e kishte dërguar vetë në spital. Pas dëshmisë së dhënë nga i dëmtuari prokuroria në gjykim kërkoi kryerjen e aktit të ekspertimit mjeko ligjor të të dëmtuarit, duke u mbështetur në kartelën klinike të të dëmtuarit por edhe në ekzaminimin fizik nga ana e mjekut ligjor. Akti i ekspertimit mjeko ligjor arriti në përfundimin se plaga e marrë prej të dëmtuarit nuk ka qenë e rrezikshme për jetën në momentin e shkakimit të saj dhe se kjo plagë përfshihet në kategorinë e plagosjes së lehtë.

Pas këtij momenti prokurori në seancë gjyqësore ndryshoi akuzën nga akuza e “Vrasjes me dashje” mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 76 e 22 të Kodit Penal, në atë të “Plagosjes së lehtë me dashje” parashikuar nga neni 89 të Kodit Penal e duke qenë se kjo vepër penale në bazë të nenit 284 paragrafi 1 të K.Pr.Penale ndiqet me ankimin e të dëmtuarit i kërkoi gjykatës të procedonte me njoftimin e të dëmtuarit.

Në rastet e ndryshimit të akuzës si rezultat i ndryshimit të shkakut të saj në gjykim, ndryshimi i faktit penal shoqërohet në përgjithësi dhe me ndryshimin e natyrës së akuzës.

Në të gjitha rastet e paraqitura më sipër, fakti i sjellë për gjykim nuk është një fakt i ri penal. Në këto raste jemi përpara të njëjtit fakt penal të hetuar, por në gjykim ai paraqitet ndryshe, për shkak të ndryshimit të disa elementeve të tij të cilat nuk i japin faktit një kuptim të ri por e modifikojnë atë në raport me elementët shtesë që janë përfutur në gjykim.

4.2.3. Kompetenca e gjykatës për të shqyrtuar akuzën e ndryshuar

Neni 372 i K.Pr.Penale parashikon ndër të tjera se prokurori në gjykim procedon me akuzën e ndryshuar kur fakti penal i cili paraqitet ndryshe gjatë gjykimit është në kompetencë për t’u shqyrtuar nga e njëjta gjykatë që ka nisur gjykimin. Pra fakti i dalë ndryshe në gjykim duhet të jetë në kompetencën e së njëjtës gjykatë, që prokurori të procedojë më tej me shqyrtimin e akuzës së ndryshuar.

Çështja e parë që mund të ngrihet për diskutim është identifikimi i llojit të kompetencës për të cilën bën fjalë neni 372 i K.Pr.Penale.

Kodi i Procedurës Penale parashikon tre lloje kompetencash, të cilat janë, kompetenca territoriale, kompetenca lëndore dhe kompetenca funksionale.

Kompetenca tokësore është e parashikuar në nenin 76 të K.Pr.Penale¹⁰⁰, e në bazë të kësaj dispozite kompetenca territoriale përcaktohet nga vendi ku është kryer vepra penale apo nga vendi ku kanë ardhur pasojat e saj. Kur vendi i treguar më lart nuk dihet, kompetenca tokësore i takon gjykatës ku ka vendbanimin ose vendqëndrimin i pandehuri dhe në pamundësi të përcaktimit të vendit të banimit ose qëndrimit të të pandehurit, kompetenca përfundimisht i takon gjykatës së vendit ku ka regjistruar prokuroria për herë të parë çështjen penale.

Për sa kohë neni 372 i K.Pr.Penale nuk parashikon llojin e kompetencës që e lidh faktin e ndryshuar me gjykatën që duhet t'a shqyrtojë këtë fakt mendoj se në rastin e kompetencës tokësore gjykata, pas ndryshimit të akuzës, kur konstaton se ajo nuk ka kompetencë tokësore duhet t'i dërgojë aktet në gjykatën që gëzon sipas ligjit kompetencën tokësore për të shqyrtuar akuzën e ndryshuar. Ky argumentim mbështetet në nenin 85 të K.Pr.Penale sipas të cilit:

“Në qoftë se në gjykimin e shkallës së parë gjykata çmon se procedimi është në kompetencën e një gjykate tjetër, shpall me vendim moskompetencën e vet për çdo lloj shkak dhe urdhëron dërgimin e akteve gjykatës kompetente.”

Sipas kësaj dispozite gjykata në shkallë të parë shpall moskompetencën e vet për çdo lloj shkak, duke përfshirë në të dhe shkaqe që lidhen me territorin se ku duhet të gjykohet çështja penale.

Gjithsesi duke dashur të jap mendimin tim personal, vlerësoj se neni 372 i K.Pr.Penale duhet t'i shtohet një element, i cili duhet të përjashtojë mundësinë e ndryshimit të kompetencës territoriale gjykatës që gjykon akuzën e ndryshuar prej prokurorit. Në këtë rast mendoj se legjislatori duhet të ndjekë të njëjtin standard në përcaktimin e kompetencës për rastin e ndryshimit të akuzës, siç e ka ndjekur në rastin e parashikuar nga neni 373 të K.Pr.Penale, që bën fjalë për njoftimin e akuzës në gjykim për një vepër penale të re. Në këtë rast të fundit legjislatori ka parashikuar se prokurori i komunikon të pandehurit veprën penale ose rrethanën, por me kusht që gjykimi të mos jetë në kompetencë të një gjykate më të lartë.

Kur bën fjalë për gjykatë më të lartë, legjislatori i referohet gjykatës më të lartë duke marrë për bazë kriterin e kompetencës lëndore ose të kompetencës funksionale.

Mendoj se në këtë rast duhet të rregullohet neni 372 i K.Pr.Penale për sa i përket kompetencës në këtë mënyrë:

“Kur gjatë shqyrtimit gjyqësor fakti del ndryshe nga ç’është përshkruar në kërkesën për gjykim dhe gjykimi i tij nuk është në kompetencën e një gjykate më të lartë, prokurori ndryshon akuzën dhe procedon me akuzën përkatëse.”

¹⁰⁰ Neni 76 i K.Pr.Penale parashikon se: “1. Kompetenca tokësore përcaktohet, me radhë, nga vendi ku është kryer ose është tentuar të kryhet vepra penale ose vendi ku ka ardhur pasoja. 2. Në qoftë se vendi i treguar në paragrafin 1 nuk dihet, kompetenca i përket, me radhë, gjykatës së vendqëndrimit ose të vendbanimit të të pandehurit. 3. Në qoftë se as kështu nuk mund të përcaktohet kompetenca, kjo i përket gjykatës së vendit ku ndodhet prokuroria që ka regjistruar e para veprën penale. 4. Rregullat e caktuara në paragrafët e mësipërm zbatohen edhe gjatë hetimit paraprak.”

I njëjti formulim është parashikuar dhe nga modeli italian mbi ndryshimin e akuzës gjatë shqyrtimit gjyqësor, në rastet kur një veprim i tillë kryhet nga prokurori për shkak se fakti del ndryshe gjatë debatit gjyqësor¹⁰¹.

Ndryshimi i propozuar mendoj se do t'i sjellë dobi gjykimit, pasi kompetenca tokësore në ndryshimin e akuzës nuk duhet të bëhet shkak që procedimi penal që është në shqyrtim në gjykatë, pasi janë marrë edhe prova, të pësojë regres duke e dërguar çështjen penale me akuzë të ndryshuar, në një gjykatë tjetër që gëzon kompetencën tokësore për të shqyrtuar akuzën e ndryshuar.

Në këtë rast shqyrtimi i çështjes penale që mbart dhe akuzën e ndryshuar do të rinisë nga e para. Fillimi i çështjes penale nga e para në gjykatën e re, për shkak të kompetencës tokësore nuk besoj se duhet të përliqet në rastin e ndryshimit të akuzës. Siç e dimë kompetenca tokësore është një element i rëndësishëm i procesit gjyqësor që lidhet me përcaktimin në territor të gjykatës që duhet të gjykojë çështjen penale. Përcaktimi i kompetencës tokësore merr rëndësi për procesin gjyqësor vetëm në rastin kur kundërshtimi i saj kërkohet nga palët në gjykim¹⁰².

Rrjedhimisht, nëse nuk është kërkuar kundërshtimi i kompetencës tokësore nga palët në fillim të gjykimit, atëherë procesi është i rregullt dhe vendimi përfundimtar i dhënë nga gjykata nuk duhet të bëhet objekt vlerësimi nga një gjykatë më e lartë për shkak të kompetencës tokësore.

Ndërkohë kompetenca lëndore përcakton gjykatën që duhet të gjykojë një kategori çështjesh penale të cilat janë përcaktuar shprehimisht në ligj.

Referuar Kodit të Procedurës Penale, kompetenca lëndore lidhet me kategorinë e çështjeve penale që duhet të gjykohen nga gjykatat e veçanta ose me pozitën zyrtare të subjektit penal që merr cilësinë e të pandehurit. Neni 74 i K.Pr.Penale përcakton kompetencën lëndore të gjykatave që veprojnë në territorin tonë¹⁰³.

Ndërkohë neni 75/a i K.Pr.Penale përcakton kategorinë e krimeve që gjykohen nga Gjykata “Për Krimet e Rënda” si dhe neni 75/b i K.Pr.Penale përcakton kategorinë e personave zyrtarë që duhet të gjykohen në themel nga Gjykata e Lartë si një gjykatë fakti. Gjithsesi me ndryshimet e fundit në Kod që do të hyjnë në fuqi më datë 1 gusht 2017, kompetenca lëndore ndryshon për shkak të krijimit të një strukture të re gjyqësore, Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në kompetencë lëndore të së cilës janë parashikuar gjykimi i veprave penale të korrupsionit, krimit të organizuar dhe i zyrtarëve të lartë shtetërorë që më parë gjykoheshin nga Gjykata e Lartë si gjykatë fakti¹⁰⁴.

¹⁰¹ Neni 516 paragrafi 1 i Kodit të Procedurës Penale Italiane

¹⁰² Neni 83 paragrafi 2 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se: “Moskompetenca tokësore dhe ajo që rrjedh nga bashkimi i procedimeve për shkak lidhje, mund të ngrihet ose të kundërshtohet, vetëm para se të ketë filluar shqyrtimi gjyqësor.”

¹⁰³ Neni 74 parashikon se: “Gjykata e rrethit gjyqësor është kompetente për gjykimin e veprave penale, përveç atyre që i përkasin kompetencës së gjykatës për krime të rënda dhe Gjykatës së Lartë”.

¹⁰⁴ Shiko nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale të ndryshuar, që hyn në fuqi më datë 1 gusht 2017

Pyetja që mund të shtrohet për diskutim është - Çfarë do të ndodh me gjykimin e një çështje penale kur ndryshimi i akuzës shoqërohet me ndryshimin e kompetencës lëndore?

Për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetjeje duhet t'i referohemi jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese e cila në lidhje me kompetencën lëndore si pjesë e përcaktimit të parimit kushtetues të “Një gjykatë të krijuar me ligj” në vendimin e saj nr. 11/2009 shprehet se¹⁰⁵:

“...Kërkuesi pretendon se është gjykuar nga gjykatat e krimeve të rënda për veprën penale të vrasjes kundër disa personave mbetur në tentativë, kur duhej të gjykohej nga gjykatat e zakonshme të rretheve gjyqësore dhe, si rrjedhojë, i është cënuar e drejta kushtetuese për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës e të nenit 6 të Konventës Europiane “Mbi Liritë dhe të Drejtat Themelore të Njeriut”.

Në lidhje me këtë aspekt, Gjykata gjen me vend që të ritheksojë, se shprehja “gjykatë ... e caktuar me ligj” në nenin 42/2 të Kushtetutës mbulon jo vetëm bazën ligjore për vetë ekzistencën e gjykatës, por edhe kompozimin e trupit gjykues të ngarkuar për shqyrtimin e çdo çështje konkrete (Vendimi nr.14, datë 17.04.2007 i Gjykatës Kushtetuese). Vetë kompetenca lëndore e gjykatës është e lidhur ngushtë me kompozimin e trupit gjykues të ngarkuar për shqyrtimin e çdo çështje konkrete. Në këtë kontekst, fjala “ligj”, sipas nenit 42 të Kushtetutës, përfshin edhe legjislacionin për krijimin dhe kompetencën e gjykatëve, ku kompetenca për gjykimin e çështjeve penale ka të bëjë me rrethin e akuzave, shqyrtimi i të cilave është atribut i gjykatave të llojeve dhe niveleve të ndryshme.

Në përputhje me sa më sipër, Gjykata vlerëson se, nëse një gjykatë nuk ka juridiksion/kompetencë për të gjykuar të pandehurin në përputhje me dispozitat që zbatohen sipas legjislacionit përkatës, ajo nuk është “e krijuar me ligj” sipas kuptimit të nenit 42/2 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të Konventës Europiane.

Bazuar në standardin e GJEDNJ (çështja Jorgic v. Germany), Gjykata çmon gjithashtu, se shprehja “gjykatë e krijuar me ligj”, si element i procesit të rregullt ligjor i parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës Europiane, reflekton parimin e shtetit të së drejtës të sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës sipas të cilit, e drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit...”.

Pra në rastin kur ndryshimi i akuzës në gjykim shoqërohet dhe me ndryshimin e kompetencës lëndore të gjykatës që duhet të shqyrtojë akuzën e ndryshuar, atëherë gjykata në të cilën është paraqitur kërkesa për ndryshimin e akuzës, duhet të procedojë me dërgimin e çështjes penale me akuzën e ndryshuar në gjykatën kompetenca lëndore e së cilës përfshin gjykimin e akuzës së ndryshuar. Veprimi i mosdërgimit të çështjes penale në gjykatën kompetente për shkak të lëndës prej gjykatës ku është paraqitur ndryshimi i akuzës nga prokurori, shoqërohet me cënimin e vendimit përfundimtar, për shkak se vendimi është dhënë nga një gjykatë “jo e krijuar me ligj”.

Kompetenca funksionale ka për objekt rregullimin e numrit të gjyqtarëve për të gjykuar një çështje penale. Kompetenca funksionale rregullohet nga neni 13 i K.Pr.Penale. Në paragrafin 3 të nenit 13 të K.Pr.Penale përcaktohet gjykimi nga Gjykatat e rretheve gjyqësore me një gjyqtar,

¹⁰⁵ Vendim i Gjykatës Kushtetuese me nr. 11 datë 23.04.2009

të veprave penale, për të cilat parashikohet dënim me gjobë ose me burgim në maksimum jo më shumë se 7 vjet. Veprat e tjera penale gjykohen me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë¹⁰⁶.

Në rastin e ndryshimit të akuzës prej prokurorit sipas nenit 372 të K.Pr.Penale, ku fillimisht fakti penal është sjellë për gjykim për një vepër penale e cila gjykohet me një gjyqtar, por ndërkohë në gjykim ndryshimi i akuzës lidhet me një vepër tjetër penale për gjykimin e të cilës duhen tre gjyqtarë, atëherë si duhet të veprojnë gjykata në këtë rast?

Edhe për këtë situatë përsëri Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj i ka dhënë zgjidhje problemit që lidhet me përcaktimin e kompetencës funksionale në gjykimin e një çështje penale.

Kështu në vendimin nr. 47/2015¹⁰⁷, Gjykata Kushtetuese shprehet se: “...Gjykimi nga një gjykatë e caktuar me ligj është një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, i sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së. Gjykata ka theksuar se termi “gjykatë” karakterizohet, në sensin material, nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve që janë në kompetencë të saj, në një proces të zhvilluar mbi një procedurë ligjërishit të përcaktuar dhe në pajtim me shtetin e së drejtës. E drejta e çdo pale për t’u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente, kërkon që gjykata të ketë juridiksion për të dëgjuar çështjen dhe që kompetenca t’i jetë dhënë asaj prej ligjit. Kompetenca e gjyqtarit është kufiri që përcakton fushën e juridiksionit brenda të cilit ai është i detyruar të procedojë për zgjidhjen e një çështjeje të caktuar. Tejkalimet e kompetencave mund të merren në shqyrtim prej Gjykatës kur ka pasur një shkelje të tillë të ligjit procedural që ka cënuar të drejtat kushtetuese për një proces të rregullt ligjor.

Rrjedhimisht çështja që shtrohet për zgjidhje është sesi duhet të operojë gjykata kur si pasojë e ndryshimit të akuzës, vepra penale duhet gjykuar jo me 1 (një) por me 3 (tre) gjyqtarë.

Mbi këtë problematikë sjellim në vëmendje vendimin e dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, e cila në një rast u shpreh si vijon: “Gjykata vendosi ndryshimin e trupit gjykues pasi për shkak të ndryshimit të akuzës, kjo çështje duhet të gjykohet më trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë si dhe gjykimi i çështjes duhet të fillojë nga fillimi”¹⁰⁸.

Jemi të mendimit se kjo vendimmarrje nuk i përgjigjet qëllimit të normave procedurale që rregullojnë kompetencën funksionale të gjyqtarit. Referuar nenit 85 të K.Pr.Penale e më konkretisht normave juridike që rregullojnë kompetencën gjyqësore, parashikohet se:

¹⁰⁶ Me ndryshimet e fundit të Kodit të Procedurës Penale me Ligjin nr.35/2017 që hyn në fuqi më datë 1 gusht, pika 3 e nenit 13 është ndryshuar duke zëvendësuar numrin “7” me numrin “10”

¹⁰⁷ Vendim nr. 47 datë 01.04.2015 i Gjykatës Kushtetuese

¹⁰⁸ Shih Vendimin nr 76, dt. 24.02.2010 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë

“Në qoftë se në gjykimin e shkallës së parë gjykata çmon se procedimi është në kompetencën e një gjykate tjetër, shpall me vendim moskompetencën e vet për çdo lloj shkak dhe urdhëron dërgimin e akteve gjykatës kompetente”¹⁰⁹.

Vlerësojmë se përdorimi i termit “një gjykatë tjetër” nuk duhet kuptuar vetëm Gjykata e një rrethi gjyqësor, e ndryshme nga gjykata që po shqyrtonte çështjen por edhe ajo gjykatë që po e gjykon çështjen, e cila për shkak se vepra duhet gjykuar nga trupë gjyqësore nuk mund të vazhdoj më tej gjykimin.

Ky qëndrim është bindës duke ju referuar edhe legjislacioneve të huaja. Disa legjislacione e kanë të rregulluar nga norma procedurale dhe jo nga vendimmarrja gjyqësore qëndrimin e mësipërm. Më sipër u përmend rregullimi që neni 516 i K.Pr.Penale italiane i bënte situatës së mësipërme. Të njëjtën zgjidhje jep edhe Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, në nenin 351 pika 1 të të cilit ku citohet se:

“Nëse për gjykimin e çështjes nga paragrafi 1. i këtij neni është kompetent departamenti tjetër në kuadër të gjykatës themelore, trupi gjykues, pas dëgjimit të palëve, vendos se a do t’ia dërgojë çështjen për të cilën është duke e drejtuar shqyrtimin gjyqësor gjykatës drejtpërdrejt më të lartë kompetente për të marrë vendim”¹¹⁰.

Duke e përmbledhur edhe në këtë rast themi se respektimi i kompetencës funksionale nga gjykata në të cilën është paraqitur ndryshimi i akuzës prej prokurorit, merr një rëndësi të madhe kushtetuese. Në rast mos respektimi të kompetencës funksionale përgjatë procesit të ndryshimit të akuzës, vendimi përfundimtar i dhënë prej gjykatës rrezikon të çënohet nga kontrolli i gjykatave më të larta, për shkak se vendimi nuk është dhënë nga “një gjykatë e krijuar me ligj.”

4.2.4. Ndryshimi i akuzës si e drejtë ekskluzive e prokurorit

Neni 372 i K.Pr.Penale i jep mundësi prokurorit të vlerësojë situatën kur fakti në gjykim del ndryshe nga ç’është paraqitur në kërkesën për gjykim. Nëse ndodhemi përpara një situatë të tillë prokurori vepron vetë me ndryshimin e akuzës si subjekti që ushtron ndjekjen penale. Për mënyrën sesi procedon prokurori për ndryshimin e akuzës, nuk parashikohet me hollësi nga neni 372 i K.Pr.Penale. Në këtë rast, në ndihmë vjen jurisprudenca e Gjykatës së Lartë e cila në një vendim të saj mbi një çështje që ishte gjykuar më parë nga Gjykata e Shkallës së Parë Elbasan përcakton sesi duhet të procedojë prokurori kur ndodhet përpara rastit të ndryshimit të akuzës.

“...Sipas nenit 372, 373 e 374 të K.P.P. është organi i prokurorisë ai që ndryshon akuzën, akuzon për një vepër tjetër që lidhet me atë që gjykohet, apo akuzon për një fakt të ri i cili nuk është përmendur në kërkesën për gjykim. Në këto raste, gjykata nuk ka për detyrë të miratojë qëndrimin e prokurorit lidhur me akuzën, por është e detyruar të vazhdojë gjykimin me akuzën

¹⁰⁹ Neni 85 i K.Pr.Penale

¹¹⁰ Ganaj Françesk. “Akuzat penale në procesin penal dhe garancitë e të pandehurit” temë e prezantuar si pjesë e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, Mars 2017, faqe 46

e re, ose të ndryshuar, me kushtin që ne bazë të nenit 376 të K.P.P. ti bëjë të ditur të pandehurit se ai ka të drejtë për një afat kohor për tu mbrojtur kundrejt akuzës së re, ose të ndryshuar...”.

Në këtë vendim, Gjykata e Lartë interpreton në mënyrë të drejtë përmbajtjen e të nenit 372 të K.Pr.Penale, duke sanksionuar nga pikëpamja jurisprudenciale qëndrimin sipas të cilit: ndryshimi akuzës është e drejtë ekskluzive e prokurorit në seancë gjyqësore, gjykata luan rol pasiv në drejtim të ndryshimit të akuzës, si dhe gjykata ka detyrimin procedural të vazhdojë gjykimin me akuzën e ndryshuar, bazueshmëria në ligj e së cilës i nënshtrohet verifikimit në dhomë këshillimi në momentin e hartimit dhe shpalljes së vendimit përfundimtar¹¹¹.

Dhe doktrina ecën në këtë linjë¹¹². Kur prokurori kërkon ndryshimin e akuzës gjykata nuk duhet të marrë vendim mbi kërkesën e prokurorit, pasi kërkesa duhet të vlerësohet si njohje efektive e faktit që përfaqësuesi i akuzës ka ndryshuar akuzën në lidhje me veprën penale për të cilën zhvillohet gjykimi.

Problemi i fundit që duhet të trajtojmë për ndryshimin e akuzës është forma që duhet të ndjekë prokurori në seancë gjyqësore për ndryshimin e akuzës.

Në fazën e hetimit paraprak në rastin e njoftimit të akuzës sipas nenit 34 të K.Pr.Penale, prokurori harton me shkrim aktin e njoftimit të akuzës e më pas aktin e shkruar, i'a njofton të pandehurit. Më ndryshimet e reja në Kod, prokurori së bashku me njoftimin e akuzës duhet t'i njoftojë me shkrim të pandehurit kundrejt nënshkrimit prej këtij të fundit dhe “Letrën e të Drejtave”, ashtu siç edhe e kemi trajtuar më lart.

Në gjykim na paraqiten dy situata me të cilat mund të përballlet prokurori për njoftimin e ndryshimit të akuzës, situata të cilat lidhen me praninë e të pandehurit personalisht në seancë gjyqësore në momentin kur prokurori vepron me ndryshimin e akuzës, si dhe me mungesën e të pandehurit kur prokurori procedon me ndryshimin e akuzës.

Në rastin kur i pandehuri është i pranishëm në seancë gjyqësore, mendoj se prokurori mund të procedojë drejtpërdrejtë me ndryshimin e akuzës në seancë gjyqësore dhe t'i njoftojë këtë ndryshim drejtpërdrejtë të pandehurit në seancë gjyqësore. Në këtë rast akuzat e ndryshuar pasqyrohet në proces verbalin e seancës gjyqësore dhe i pandehuri nëse ka nevojë të marrë një informacion shtesë, përveç asaj që merr në seancë gjyqësore, mund të sigurojë një kopje të procesverbalit të seancës gjyqësore. Pra ndryshimi i akuzës në seancë gjyqësore nga prokurori në prani të të pandehurit, mund të bëhet edhe verbalisht duke ja komunikuar në seancë ndryshimin e akuzës së të pandehurit. Themi se ndryshimi i akuzës bëhet në seancë gjyqësore edhe verbalisht si opsion, për shkak se nëse ajo bëhet me shkrim nuk paraqet asnjë problem që mund të lidhet me vlefshmërinë e këtij veprimi.

Në përgjithësi praktika gjyqësore ka pranuar ndryshimin e akuzës prej prokurorit në seancë gjyqësore në prani të të pandehurit edhe kur prokurori ka vepruar në mënyrë verbale për

¹¹¹ Ganaj Francesk. “Akuzat penale në procesin penal dhe garancitë e të pandehurit” temë e prezantuar si pjesë e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, Mars 2017, faqe 36

¹¹² Frashëri Marsida “Akuzat e reja sipas legjislacionit tonë procedural në fuqi“, botuar në “Mbi disa çështje të së drejtës procedurale penale”, Botim i Shkollës së Magjistraturës nr. 1, viti 2010 faqe 166

ndryshimin e akuzës. Në këtë pikë përmendim vendimin e Gjykatës së Lartë nr. 636 datë 25.11.2009 me të cilin ndajmë qëndrime të ndryshme¹¹³.

Në këtë vendim Gjykata e Lartë, për mënyrën sesi prokurori duhet të veprojë kur ndryshon akuzën në seancë gjyqësore shprehet se:

“...Organi i akuzës, duke arsyetuar se në veprimet e të gjykuarve janë konsumuar elementët e veprës penale të vrasjes me dashje, i ka dërguar ata për gjykim, të akuzuar sipas nenit 76-25,89 e 278/2 të K.Penal.

Por në konkluzionet përfundimtare të paraqitura para gjykatës së shkallës së parë, prokurori ka kërkuar nga gjykata që dy të gjykuarit të deklaroheshin fajtorë dhe dënoheshin sipas dispozitës së nenit 78 e 25 të K.Penal.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke gjetur të mbështetur në ligj pretendimet e ngritura në rekurs nga ana e dy të gjykuarve, çmon se vendimet e të dyja gjykatave të faktit janë marrë në shkelje të dispozitave procedurale penale që lidhen me paraqitjen e akuzave të reja dhe si të tilla ato duhet të prishen.

Është e vërtetë që nga ana e gjykatës së shkallës së parë, pas konkluzioneve përfundimtare të prokurorit, ju është kërkuar formalisht mendim të gjykuarve dhe mbrojtësve nëse donin kohe për të paraqitur prova për akuzën e parashikuar nga neni 78 i K.Penal, ndërkohe që atyre nuk ju ishte komunikuar ndonjë akuzë e re. Në këtë rast gjykata ka vepruar ndesh me dispozitën e nenit 372 të K.Pr.Penale. Sipas kësaj dispozite: “kur gjatë shqyrtimit gjyqësor fakti del ndryshe nga ç’është përshkruar në kërkesën për gjykim ... prokurori ndryshon akuzën dhe procedon me akuzën përkatëse.” Rregullat procedurale që lidhen me marrjen e cilesise se të pandehurit janë parashikuar në nenin 34 të K.Pr.Penale. Sipas kësaj dispozite, ndër të tjera është parashikuar se akti i njoftimit të akuzës i njoftohet të pandehurit dhe mbrojtësit, duke treguar në të dhenat e mjaftueshme për marrjen si të pandehur. Po sipas kësaj dispozite, kur pas marrjes së një personi si të pandehur dalin të dhëna të reja që ndryshojnë akuzën e paraqitur ose e plotësojnë atë, prokurori merr vendim, të cilin ja njofton të pandehurit.

Në zbatim të rregullimeve procedurale të sipërcituara, edhe në rastin e parashikuar nga dispozita e nenit 372 të K.Pr.Penale, kur gjatë shqyrtimit gjyqësor prokurorit i lind nevoja të ndryshojë akuzën, ai është i detyruar që me vendim t’i komunikojë të pandehurit akuzën e re dhe të zbatojë të gjitha detyrimet procedurale që burojnë nga përmbajtja e nenit 34 të K.Pr.Penale. Vetëm pasi nga ana e prokurorit të zbatohen rregullat që lidhen me akuzat e reja, gjykata mund të procedojë, duke zbatuar detyrimet që rrjedhin nga dispozita e nenit 376 të K.Pr.Penale.

Nga përmbajtja e dispozites së nenit 372 të K.Pr.Penale del qartë se në rastin konkret nga ana e prokurorit duhet të ishte ndryshuar akuzat dhe ai duhet të procedonte me akuzën e re. Kështu kjo dispozitë parashikon se: “kur gjatë shqyrtimit gjyqësor fakti del ndryshe nga ç’është përshkruar në kërkesën për gjykim ... prokurori ndryshon akuzën ...”.

Ndryshe nga kjo mënyrë procedimi, në gjykimin e të pandehurve K. rezulton se prokurori nuk ka ndryshuar akuzën, por ai është mjaftuar vetëm me kërkesën drejtuar gjykatës që t’i

¹¹³ Vendim i Gjykatës së Lartë nr. 636 datë 25.11.2009

deklaronte fajtorë dhe dënuar të gjykuarit për një akuzë më të rëndë se ajo e përshkruar në kërkesën për gjykim. Në zbatim të rregullave procedurale penale, gjykata duhet të procedonte duke i kërkuar prokurorit t'i komunikonte të gjykuarve akuzën e re sipas nenit 34 të K.Pr.Penale dhe nëse prokurori do të njihete të gjykuarit me akuzën e parashikuar nga neni 78 e 25 i K.Penal dhe me të dhënat e mjaftueshme për këtë akuzë, gjykata duhet t'u bënte të ditur të pandehurve të drejtën për të kërkuar një afat për mbrojtjen“.

Sipas këtij argumentimi rezulton se prokuroria përpara se të procedojë me ndryshimin e akuzës në gjykim, duhet të marrë një vendim për ndryshimin e akuzës (që duhet kuptuar se vendimi do merret me shkrim sipas nenit 34 të K.Pr.Penale) dhe më pas këtë vendim në bazë të nenit 34 të K.Pr.Penale duhet t`ja njoftojë të pandehurit në seancë gjyqësore. Rregullat procedurale të parashikuara nga neni 372 në lidhje me nenin 376 të K.Pr.Penale nuk vlejné sipas vendimit të gjykatës, nëse ato nuk shoqërohen edhe me rregullat e parashikuara nga neni 34 i K.Pr.Penale.

Në këndvështrimin tim vlerësoj se prokurori në procesin e ndryshimit të akuzës në çështjen e përmendur më lart, ka vepruar drejt në përputhje me rregullat që përcaktojnë ndryshimin e akuzës të parashikuara nga nenet 372 e 376 të K.Pr.Penale.

Në prani të të pandehurve, në seancë gjyqësore në konkluzionet përfundimtare madje dhe me shkrim prokurori ka ndryshuar akuzën. Ndryshimin e akuzës që është pasqyruar me shkrim në konkluzione përfundimtare prokurori në seancë ja ka njoftuar të pandehurve. Në këtë mënyrë prokurori ka vepruar drejt duke përmbushur të gjitha detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i nenit 372 – 376 të K. Pr. Penale.

Neni 372 i K.Pr.Penale nuk përcakton momentin procedural se kur prokurori në seancë gjyqësore duhet të veprojë me ndryshimin e akuzës. Si rrjedhim referuar praktikës gjyqësore, prokurori është i lirë për të proceduar me ndryshimin e akuzës në çdo moment të fazës së gjykimit kur ai vlerëson se duhet të ndërhyjë me veprimin e ndryshimit të akuzës, për shkak edhe të natyrës së paqëndrueshme të akuzës të cilën e kemi trajtuar më lart. Pra në këtë aspekt prokurori është i lirë të procedojë me ndryshimin e akuzës dhe dhënien e konkluzioneve përfundimtare, duke mos pasur ndonjë kufizim ligjor.

Në të kundërt me sa u tha më sipër, vendimi i Gjykatës së Lartë praktikisht i vendos kufizim prokurorit, në kohën se kur duhet të veprojë me ndryshimin e akuzës. Sipas këtij vendimi, prokurori nuk mund të veprojë me ndryshim akuze në konkluzionet përfundimtare, por përpara konkluzioneve ai duhet t'i njoftojë të pandehurit akuzën e ndryshuar, duke respektuar kushtet e parashikuara nga neni 34 i K.Pr.Penale që për mendimin tim, janë kushte që vlejné vetëm për fazën e hetimit paraprak e jo për fazën e gjykimit.

Ndërkohë në rastin kur prokurori duhet të procedojë me ndryshimin e akuzës në mungesë të të pandehurit, ai duhet të kërkojë respektimin e kushteve të parashikuara nga neni 376 paragrafi 3 të K.Pr.Penale¹¹⁴. Në këtë rast dispozita është e qartë e mosrespektimi i saj sjell cënimin e vendimit të gjykatës.

¹¹⁴ Neni 376 paragrafi 3 i K.Pr.Penale parashikon se: “Kur i pandehuri gjykohet në mungesë, prokurori i kërkon gjykatës që akuzat e re të përfshihen në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor dhe që ekstrati i procesverbalit t'i njoftohet të pandehurit. Në këtë rast kryetari ndërpret shqyrtimin gjyqësor dhe cakton një seancë të re, duke respektuar afatet e treguara në paragrafin.”

Ndryshimi i akuzës nga prokurori në gjykim, në mungesë të të pandehurit duhet detyrimisht t'i njoftohet me shkrim, pasi nuk ekziston mënyrë tjetër komunikimi me të pandehurin që gjykohet në mungesë. Në këtë rast ndryshimi i akuzës bëhet pjesë e procesverbalit gjyqësor dhe ekstrati i tij i njoftohet të pandehurit. Për të realizuar këtë veprim, gjykata duhet të ndërpresë seancën gjyqësore e të caktojë një seancë të re, me qëllim të sigurohet se i pandehuri në mungesë ka marrë dijeni për ndryshimin e akuzës të bërë prej prokurorit në seancë gjyqësore.

Pra në gjykimin e të pandehurit në mungesë, ndryshimi i akuzës i bërë nga prokurori në seancë gjyqësore duhet t'i njoftohet me shkrim.

4.3. *Akuza për një vepër tjetër*

Neni 373 i K.Pr.Penale parashikon rastin e akuzës kur gjatë shqyrtimit gjyqësor, prokurori mund t'i atribuojë të pandehurit për një vepër tjetër penale. Neni 373 i K.Pr.Penale parashikon se:

“Kur gjatë shqyrtimit gjyqësor del një vepër penale tjetër që ka lidhje me atë që gjykohet, sipas nenit 79 gërma “b”, ose një rrethanë rënduese që nuk është përmendur në kërkesën për gjykim, prokurori i komunikon të pandehurit veprën penale ose rrethanën, por me kusht që gjykimi të mos jetë në kompetencë të një gjykate më të lartë.”

Ndërkohë në nenin 79 pika “b” të K.Pr.Penale që bën fjalë për rastet e bashkimit të procedimeve penale parashikohet se: *“1.Organi procedues mund të vendosë bashkimin e procedimeve: ...b) kur një person akuzohet për disa vepra penale;”*

Për nevoja të trajtimit të pjesës së punimit që i referohet akuzës për një vepër tjetër, duhet të sqarojmë në këndvështrimin historik, ndryshimin ligjor që ka pësuar neni 79 gërma “b” i K.Pr.Penale, me Ligjin nr. 8813 datë 13.06.2002.

Pasqyrimi që i kemi bërë më sipër nenit 79 gërma “b” i K.Pr.Penale reflekton ndryshimin ligjor që i është bërë kësaj dipozite procedurale me ligjin e vitit 2002. Përpara ndryshimeve të këtij ligji, neni 79 gërma “b” i K.Pr.Penale parashikonte se:

“1.Ka bashkim procedimesh:...b - kur një person akuzohet për disa vepra të kryera me një veprim a mosveprim të vetëm ose me disa veprime a mosveprime për arritjen e një qëllimi të vetëm kriminal;”

Ndryshimet në nenin 79 gërma “b” të K.Pr.Penale do na ndihmojnë në trajtimin në këtë punim të akuzës për një vepër tjetër penale. Ashtu siç u parashtrua më sipër neni 373 i K.Pr.Penale paraqet dy situata - kur prokurori ndërhyt në procesin gjyqësor duke i njoftuar në seancë gjyqësore të pandehurit akuzën për një vepër penale që ka lidhje me atë që gjykohet, - si dhe duke i njoftuar rrethanën rënduese të papërmendur në kërkesën për gjykim.

Rasti i parë lidhet me njoftimin prej prokurorit të veprës tjetër penale që ka lidhje me atë që gjykohet. Neni 373 i K.Pr. Penale parashikon dy kushte të cilat duhet të plotësohen në gjykim në mënyrë që prokurori të ndërhyjë për t'i njoftuar të pandehurit akuzën për një vepër tjetër penale.

Këto kushte janë: kur gjatë shqyrtimit gjyqësor del një vepër penale tjetër dhe vepra tjetër penale e dalë në shqyrtimin gjyqësor, të ketë lidhje me atë që gjykohet sipas nenit 79 gërma “b” të Kodit.

Më poshtë po analizojmë me radhë kushtet e kërkuara nga neni 373 i K.Pr.Penale për veprën tjetër penale.

4.3.1. Lidhja e veprave penale

Po të shihet me kujdes, termat e përdorur nga neni 373 i K.Pr.Penale vërejmë se legjislatori në këtë rast ka përdorur fjalët “*vepër tjetër penale që ka lidhje me atë që gjykohet*”, për të identifikuar me qartësi situatën në të cilën duhet të ndërhyjë prokurori. Në këtë rast në ndryshim nga situata tjetër e parashikuar nga neni 374 i K.Pr.Penale, kur legjislatori ka parashikuar rastin e “*faktit të ri*”, në nenin 373 të K.Pr.Penale është përmendur situata e “*veprës tjetër penale që ka lidhje me atë që gjykohet.*”

Vepër tjetër penale do të thotë që në procesin gjyqësor kur prokurori procedon me njoftimin e saj tek i pandehuri, fakti penal është i identifikuar qartësisht, pasi fakti penal nuk është një fakt i ri i cili është konstatuar vetëm gjatë procesit gjyqësor, si dhe fakti penal nuk ka nevojë që t’i nënshtrohet hetimit paraprak, pasi ai plotëson të gjitha kushtet për t’u identifikuar si vepër penale.

Midis faktit penal dhe veprës penale në kuptimin e kërkuar nga nenet 373 e 374 të K.Pr.Penale ekziston një ndryshim thelbësor, i cili lidhet me identifikimin e ngjarjes kriminale të ndodhur. Ndërsa fakti i ndodhur në përgjithësi ka nevojë t’i nënshtrohet hetimit paraprak, me qëllim mbledhjen e të dhënave të nevojshme për të konkluduar në ekzistencën ose jo të veprës penale, elementëve përbërës të saj, autorin ose autorët pjesëmarrës në kryerjen e veprës penale. Ndërkohë në rastin e veprës penale të dalë në gjykim, themi se hetimi paraprak është kryer dhe janë mbledhur të gjitha të dhënat e nevojshme që e identifikojnë faktin penal në një vepër penale konkrete.

Hetimi është i kryer për shkak se vepra tjetër penale është e lidhur ngushtësisht me veprën e parë penale për të cilën është sjellë për gjykim i pandehuri. Vepra e parë penale i është nënshtrohet hetimit paraprak dhe elementet e saj janë mbledhur e vlerësuar si të tilla prej prokurorit që në përfundimin e hetimeve.

Si rrjedhim për shkak të lidhjes së ngushtë që duhet të ekzistojë midis veprës penale të hetuar e asaj të dalë në gjykim, elementët thelbësorë të veprës penale të hetuar, janë elementë përbërës dhe të veprës tjetër penale të konstatuar në gjykim. Kështu që dhe vepra penale tjetër e konstatuar në gjykim nuk është vepër penale e re, pasi elementët përbërës të saj janë mbledhur gjatë fazës së hetimeve paraprake e për rrjedhim këto elementë janë të njohura për prokurorin dhe të pandehurin përpara fillimit të shqyrtimit gjyqësor të çështjes. Më poshtë do të trajtojmë natyrën e lidhjes së ngushtë që duhet të ekzistojë midis veprës penale të sjellë për gjykim me veprën penale të konstatuar në gjykim.

Kur ligjvënësi i referohet shprehjes “*vepër tjetër penale*” ka pasur parasysh situatën në të cilën fakti penal që referon te vepra tjetër penale i është nënshtrohet hetimit paraprak dhe në

gjykim elementët thelbësorë të veprës tjetër penale nuk janë elemente të reja të panjohura si për prokurorin ashtu edhe për të pandehurin për shkak se këto elemente që përbëjnë veprën tjetër penale janë mbledhur kryesisht në fazën e hetimit paraprak në funksion të hetimit të veprës së parë penale. Kështu që akuza për një vepër tjetër penale në gjykim, nuk duhet kuptuar si akuzë për një vepër të re penale, por duhet kuptuar si akuzë për një vepër tjetër penale të hetuar që në fazën e hetimit paraprak kur janë mbledhur të dhënat për hetimin e veprës së parë penale që është sjellë për gjykim.

Akuza për një vepër tjetër penale i jep mundësi prokurorit të procedojë në gjykim me atribumin ndaj të pandehurit, të një veprë tjetër penale, pa qenë nevoja që prokurori për veprën penale tjetër të nis hetimin nga e para. Vepra penale tjetër e evidentuar në gjykim nuk ka nevojë për hetim të ri, pasi hetimi për këtë vepër penale është kryer nga prokurora në të njëjtën kohë dhe bashkërisht me hetimin e veprës penale që prokurori ka sjellë fillimisht për gjykim.

Në rastin e akuzës për një vepër tjetër penale në gjykim, i pandehuri tashmë ndodhet në një situatë tjetër që realisht i rëndon pozitën e tij procedurale. Me atribumin e akuzës për një vepër tjetër penale nga prokurori në gjykim, i pandehuri duhet të përgjigjet së paku për dy vepra penale të dyshuara si të kryera prej tij. Ai duhet të përgjigjet për veprën e parë penale që është sjellë për gjykim nga prokurori si dhe për veprën tjetër penale të cilën prokurori i'a njofton të pandehurit në seancën gjyqësore ku po gjykohet vepra e parë. Pra të pandehurit në gjykim i shtohet edhe një vepër tjetër penale. Në këto kushte i pandehuri në gjykim duhet të përgatisë mbrojtjen e tij për dy vepra penale. Në këtë rast ndodhemi përpara situatës juridike të shtimit të akuzës së prokurorit në gjykim ndaj të pandehurit.

Në teorinë e së drejtës penale si dhe në praktikë gjyqësore janë të njohura rastet kur një i pandehur kryen dy ose më shumë vepra penale për të cilat ai i nënshtrohet gjykimit të tyre. Gjykimi i dy ose më shumë veprave penale të kryera nga i pandehuri, sipas situatës mund të hetohen dhe gjykoen në një procedim të vetëm penal ose në procedime të ndryshme penale.

Neni 373 i K.Pr.Penale parashikon situatën kur i pandehuri dyshohet se ka kryer dy ose më shumë vepra penale dhe këto vepra penale duhet t'i nënshtrohen gjykimit brenda një procesi gjyqësor.

Rastet kur një person kryen dy ose më shumë vepra penale, janë raste që trajtohen nga teoria e së drejtës penale, për shkak se secila nga veprat penale përmban një dënim të parashikuar si të tillë nga ligji penal dhe si rrjedhim ligji penal i ka dhënë si zgjidhje të vetme kësaj situatë duke parashikuar një dispozitë të përgjithshme penale që parashikon rastet kur dhe si duhet të zbatohen dispozitat penale të bashkimit të dënimeve kur autori duhet të përgjigjet penalisht për kryerjen e dy ose më shumë veprave penale¹¹⁵. Në teorinë e së drejtës penale rastet e bashkimit të veprave penale të kryera nga një autor i saj, njihen ndryshe si rastet e konkurrimit të veprave penale. Kryerja e dy ose më shumë veprave do të thotë shkelje nga ana e autorit të më shumë se një herë të një ose më shumë dispozitave që parashikojnë figura të veprave penale të veçanta për të cilat ligji penal parashikon dënime të ndryshme. Referuar nenit 55 të K.Penal vërejmë se

¹¹⁵ Neni 55 paragrafi 1 i Kodit Penal mbi caktimin e dënimeve për disa vepra penale parashikon se: “Kur veprimet ose mosveprimet përmbajnë elementët e disa veprave penale, si dhe kur personi ka kryer disa vepra penale për të cilat nuk është dhënë akoma vendim, gjykata më parë cakton dënimin për çdo vepër penale dhe në përfundim jep një dënim të vetëm, që përbëhet nga dënimi më i rëndë i shtuar.”

parashikohen dy raste të bashkimit (konkurrimit) të veprave penale të cilat janë *bashkimi real dhe bashkimi ideal i veprave penale*.

Bashkim ideal kemi në rastet kur autori me një veprim ose mosveprim ka kryer dy ose më shumë vepra penale. Bashkim real kemi në rastet kur autori me akte të veçanta kryen dy ose më shumë vepra penale të ndryshme nga njëra – tjetra. Në bashkimin ideal ose real veprat mund të kryhen me dashje ose nga pakujdesia me veprim ose mosveprim. Ato parashikohen nga dispozita të ndryshme penale e përbëjnë figura të veçanta të veprës penale. Në bashkimin e veprave penale gjykata cakton përfundimisht një dënim të vetëm për autorin për të gjitha veprimet e tij por ajo është e detyruar që për çdo veprë të caktojë më parë dënime të veçanta¹¹⁶.

Më lart përmendëm llojet e bashkimit të veprave penale për shkak se shtjellimi i mësipër do të na nevojitet për të trajtuar lidhjen që duhet të ekzistojë midis veprës penale në gjykim dhe veprës tjetër penale si dhe në rasin e lidhjes midis fakti të ri penal me veprën penale të sjellë për gjykim.

4.3.2. Lidhja e veprës tjetër penale me atë që gjykohet sipas nenit 79/b të K.Pr.Penale

Për të identifikuar lidhjen dhe natyrën midis dy veprave penale duhet më parë t'i referohemi nenit 79/b të K.Pr.Penale. Kjo dispozitë parashikon situatën e bashkimit të procedimit penal kur një person akuzohet për disa vepra penale. Duke ju referuar strikt gjermës “b” të nenit 79 të K.Pr.Penale mund të themi se lidhja midis dy veprave penale është e përgjithshme. Kjo do të thotë se personi i akuzuar mund t'i ketë kryer veprat penale në të njëjtën kohë e më një veprim të vetëm, ose ai mund të ketë kryer veprat penale në të njëjtën kohë por me veprime të ndryshme apo të ketë kryer veprat penale në kohë të ndryshme. Pra mënyra sesi paraqitet lidhja e veprave penale sipas nenit 79/b të K.Pr.Penale nuk na jep zgjidhjen e duhur.

Lidhja e parashikuar nga neni 79/b i K.Pr.Penale mund të konfundojë në gjykim situatat e akuzës për një veprë tjetër penale, me atë të akuzës për një fakti të ri penal kur dihet se këto situata janë krejtësisht të ndryshme. Nga mënyra sesi është parashikuar lidhja e veprave penale në nenin 79/b të K.Pr.Penale, mund të themi se dhe në rastin e akuzës për një fakti ri ekziston lidhja e faktit të ri penal me akuzën në gjykim, për shkak se në bazë të nenin 79/b të K.Pr.Penale, për të pasur një lidhje mes dy veprave penale mjafton që ato t'i ketë kryer një person.

Kështu që prokurori mundet gabimisht (duke ju referuar nenit 79/b të K.Pr.Penale) të procedojë në gjykim sipas nenit 373 të K.Pr.Penale duke i njoftuar akuzën të pandehurit për një veprë tjetër penale, në vend që të procedojë sipas nenit 374 të K.Pr.Penale që bën fjalë për rastin e njoftimit të akuzës për një fakt të ri penal.

Konfondimi i këtyre situatave vjen si rrjedhojë e formulimit të nenit 79/b të K. Pr. Penale. Për shkak të një formulimi të tillë të përgjithshëm që parashikon rastin e lidhjeve të veprave penale vetëm duke ju referuar autorit të saj, themi se në gjykim prokurori mund të gabojë duke bërë një vlerësim jo të drejtë të situatës kur ai ndërhyjë duke i njoftuar të pandehurit në gjykim

¹¹⁶ Kaçupi Skënder, Cikël leksionesh për të Drejtën Penale, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, Viti akademik 1995 – 1996

akuzën për një veprë tjetër penale në vend që të procedojë me instrumentin e akuzës për një fakt të ri penal.

Ngatërrimi i këtyre situatave me njëra tjetrën sjell pasoja negative për procedimin penal në tërësi, për shkak se në eventualitetin e gjykimit të çështjes penale në gjykatën e apelit, çështja penale mund të prishet e të kthehet edhe një herë për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, për shkak të shkeljes së dispozitave procedurale mbi akuzat e reja¹¹⁷.

Për mënyrën sesi është ndërtuar neni 373 i K.Pr.Penale themi se vepra penale që i njoftohet të pandehurit në gjykim nuk është veprë penale e re. Arsyet se përse nuk është një veprë penale e re i përmendëm më lart. Siç thamë më sipër, vepra penale e sjellë për gjykim e identifikuar nga prokurori si vepra penale kryesore për të cilën janë bërë hetimet dhe vepra penale e evidentuar gjatë shqyrtimit gjyqësor kanë elementë të përbashkët me njëra tjetrën. Kushti që të dy veprat penale duhet të kenë elemente të përbashkëta është përmendur në nenin 373 të K.Pr.Penale, sipas të cilit vepra penale tjetër (jo e re) që del gjatë gjykimit duhet të ketë lidhje me atë që gjykohet. Lidhja në këtë rast midis dy veprave penale është një lidhje që i referohet objektit të procedimit penal të sjellë për gjykim, pra lidhja i referohet vetëm elementeve objektive të procedimit penal¹¹⁸.

Pra deri tani kemi sqaruar se veprat penale për të cilat i pandehuri përballet në gjykim sipas nenit 373 të K.Pr.Penale janë vepra të cilat kanë të përbashkëta elementet objektive të tyre. Pra elementët të cilat janë evidentuar në hetim për një veprë penale të sjellë në gjykim nga prokurori janë të njëjta me elementët e veprës tjetër penale që prokurori i njofton të pandehurit në gjykim. Në ndryshim nga elementët subjektiv të veprave penale që nënkupton kryerjen e disa veprave penale nga një person dhe këto vepra penale lidhen me njëra tjetrën vetëm për shkak të subjektivit të saj si autor i veprave penale, në rastin e elementëve objektive të veprave penale lidhja midis tyre realizohet për shkak të elementëve të përbashkët objektive që ato kanë me njëra tjetrën, si dhe për shkak të kryerjes së tyre nga i njëjti autor.

Njëkohësisht për sa kohë i pandehuri në gjykim do të përgjigjet për dy ose shumë vepra penale, atëherë në këtë rast ndodhemi përpara situatës së konkurrimit të veprave penale të cilat u trajtuan më sipër.

Kur trajtuam rastet e konkurrimit të veprave penale në mënyrë të përgjithshme sqaruam karakteristikat dhe ndarjen e konkurrimit të veprave penale, në konkurrimin ideal dhe konkurrimin real të veprave penale. Në vijim të analizës për nenin 373 të K.Pr.Penale më sipër sqaruam se lidhja midis dy veprave penale në gjykim është lidhje që lidhet me elementët objektive të përbashkët që kanë veprat penale me njëra tjetrën si dhe me faktin që vepra penale

¹¹⁷ Neni 428/1 gërma “ç” parashikon se: “1. Gjykata e apelit, pasi shqyrton çështjen, vendos:...ç) prishjen e vendimit dhe kthimin e akteve gjykatës së shkallës së parë kur nuk janë respektuar dispozitat që lidhen me kushtet për të qenë gjyqtar në çështjen konkrete, me numrin e gjyqtarëve që është i domosdoshëm për formimin e kolegjeve të caktuara në këtë Kod, me ushtrimin e ndjekjes penale nga prokurori dhe pjesëmarrjen e tij në procedim, me pjesëmarrjen e përfaqësuesit të të dëmtuarit akuzues dhe të mbrojtësit të të pandehurit, me shkeljen e dispozitave për paraqitjen e akuzave të reja, si dhe në çdo rast kur në dispozita të veçanta është parashikuar pavlefshmëria e vendimit.

¹¹⁸ Conso Giovanni, Grevi Vittorio., “Compiendo di Procedura Penale” Seconda edizione, CEDAM 2003, faqe 703

e dalë në gjykim nuk është një vepër penale e re, në kuptimin që nuk është hetuar më parë nga gjykata. Elementët thelbësorë të veprës tjetër penale të dalë në gjykim janë të identifikuar në fazën e hetimit paraprak si elementë përbërës të veprës së parë penale që është sjellë për gjykim nga prokurori.

Duke ju referuar karakteristikave të përmendura më lart themi se neni 373 i K.Pr.Penale parashikon rastin e konkurrimit ideal të veprave penale.

4.3.3. Konkurrimi ideal i veprave penale dhe akuza ndaj një veprë tjetër penale

Ndodhemi në situatën e parashikuar neni 373 i K.Pr.Penale kur autori (i pandehuri) me një veprim ka realizuar figurat ligjore të më shumë veprave penale. Karakteristikë e bashkimit ideal të veprave penale është uniteti i veprimit (pra i një veprimi të vetëm) dhe realizimi i më shumë padrejtësive (pasojave) për shkak të këtij veprimi.

Pra konkurrimi ideal i veprave penale ekziston kur me një veprim janë realizuar të gjitha tiparet objektive e subjektive kriminale të disa figurave të veprave penale ose disa herë është realizuar padrejtësia e një figure të njëjtë e me atë janë lënduar më shumë të mira materiale¹¹⁹.

Me një veprim është e mundur të ketë realizim disa herësh të figurës ligjore të të njëjtës vepër (psh. vrasje e shumëfishtë me bombë) ose të jenë realizuar figurat ligjore të veprave të ndryshme (psh. si pasojë e shpërthimit të lëndës plasëse të jetë shkaktuar vrasja e një personi, plagosja e rëndë e një personi tjetër dhe shkatërrim i pronës në pronësi të një personi të tretë).

Në rastin e parë bëhet fjalë për bashkim ideal homogjen, kurse në rastin e dytë për bashkim ideal heterogjen. Në të dy rastet bëhet fjalë për vepra penale të cilat veprimi i autorit është identik (i njëjtë dhe i vetë). Me të drejtë bëhet fjalë për vepër, veprimi i vetëm i të cilës nuk është specifikuar, por përshkrimi ligjor e përcakton veprimin kryerës përmes përcaktimit të pasojave që duke ju referuar shembullit të mësipërm janë vrasje, plagosje e rëndë, shkatërrim prone¹²⁰.

Për këtë arsye themi se elementët përbërës tek të dy veprat penale janë të njëjtë në nenin 373 të K.Pr.Penale pasi në rastin e konkurrimit ideal, qoftë në formën homogjene apo heterogjene të tij, veprimi kriminal i vetëm i realizuar prej autorit është i evidentuar që në fazën e hetimit paraprak. Për një veprim kriminal të evidentuar në hetim, prokurori ka sjellë në gjykim të pandehurin për një vepër penale, por gjatë shqyrtimit gjyqësor mund të rezultojë se i njëjti veprim kriminal të ketë sjellë edhe një pasojë tjetër penale që në gjykim identifikohet me një vepër tjetër penale, elementet e së cilës (në këtë rast veprimi kriminal) janë të njohura për prokurorin e të pandehurin. Kjo pasi të njëjtat elementë të veprimit kriminal janë hetuar më parë dhe prokurori ka sjellë për gjykim veprën e parë penale të kryer nga autori i saj.

¹¹⁹ Kambovksi Vllado, “E Drejta Penale Pjesa e Përgjithshme”, Shtëpia Botuese “FURKAM ISM” Shkup 2007, faqe 416

¹²⁰ Kambovksi Vllado, po aty

Në aspektin procedural thënë me fjalë të tjera në gjykim, prokurori ka sjellë veprën penale bazë, duke identifikuar dhe veprimin kriminal të kryer prej autorit të saj. Pra elementët përbërës të veprës penale të sjellë në gjykim, janë veprimi konkret kriminal i evidentuar gjatë fazës së hetimeve paraprake si dhe njëra prej pasojave penale të ardhura prej këtij veprimi. Në të vërtetë në rastin e parashikuar nga neni 373 i K.Pr.Penale, veprimi kriminal i vetëm i kryer i dyshuar si i kryer prej të pandehurit nuk është mjaftuar të sjellë vetëm një pasojë penale që është vepra penale e sjellë për gjykim prej prokurorit.

Në seancë gjyqësore prokurori ka mundësi të njoftojë akuzën tjetër penale ndaj të pandehurit për pasojën e dytë penale të shkaktuar nga i njëjti veprim kriminal i dyshuar prej të pandehurit. Në këtë rast prokurori nuk duhet të veprojë sipas rregullit të përgjithshëm, të tërheq dosjen për figurën e dytë të veprës penale e të rinis dhe një herë hetimin për shkak se fakti penal është i hetuar tashmë. Veprimi kriminal i cili përfshihet në elementët e anës objektive të të dy veprave penale është i njëjtë e i evidentuar tashmë gjatë fazës së hetimit paraprak për veprën e parë penale dhe për të nuk ka nevojë të kryhen hetime të tjera.

Në gjykim prokurori identifikon vetëm pasojën e dytë penale të shkaktuar nga i njëjti veprim kriminal. Elementët e identifikimit të pasojës së dytë penale prej të njëjtit veprim kriminal mund të jenë evidentuar si në fazën e veprimeve paraprake, ashtu dhe gjatë gjykimit. Pasoja e dytë penale e shkaktuar nga i njëjti veprim kriminal, që duhet të shoqërohet me njoftimin e akuzës për veprën penale tjetër në gjykim, nuk përmban elementët e një fakti të ri penal, pasi pasoja e dytë penale ka ardhur që në kohën kur autori i saj ka realizuar veprimin kriminal. Në këtë rast i njëjti veprim kriminal ka shkaktuar në të njëjtën kohë dy pasoja penale të cilat përfaqësojnë dy figura të ndryshme të veprave penale. I pandehuri fillimisht është sjellë për gjykim prej prokurorit vetëm për njërin prej figurave të veprave penale, ndërkohë në gjykim prokurori ka mundësinë t'i njoftojë akuzën të pandehurit edhe për figurën e dytë të veprës penale. Të dy figurat e veprave penale burojnë nga i njëjti veprim kriminal.

Pra kur prokurori i njofton të pandehurit akuzën për një vepër penale tjetër në gjykim (neni 373 i K.Pr.Penale), ai paraprakisht duhet të sigurohet se vepra e dytë penale konkurron me veprën e parë në bazë të kriterëve mbi konkurrimin ideal të veprave penale. Kështu neni 373 i K.Pr.Penale që bën fjalë për akuzën në lidhje me një vepër tjetër penale, i lidh veprat penale sipas modelit të konkurrimit ideal të veprave penale.

Kujtojmë se të njëjtat zgjidhje ofron edhe neni 517 i K.Pr.Penale të italisë kur i referohet lidhjes së veprave penale sipas kriterëve të parashikuara nga neni 12/1 gërma “b” i K.Pr.Penale të italisë¹²¹.

Për sa kohë sistemi ynë procedural penal në përgjithësi dhe kapitulli i akuzave të reja në veçanti ngjason me atë italian, për shkak se Kodi i Procedurës Penale së italisë është përzgjedhur si një model vlerësues për hartimin e Kodit tonë të Procedurës Penale, atëherë edhe elementet e rëndësishëm të instituteve të së drejtës procedurale, që në rastin tonë është përcaktimi i lidhjes midis veprave penale sipas nenit 373 të K.Pr.Penale duhet të merren në të

¹²¹ Neni 12/1 gërma “b” i Kodit të Procedurës Penale Italiane për rastet e bashkimit të procedimeve parashikon se: “1. Ka bashkim procedimesh:... b) kur një person akuzohet për disa vepra penale të kryera me një veprim apo mosveprim të vetëm, ose me disa veprime a mosveprime të kryera për arritjen e të njëjtit mendim kriminal.”

njëjtën mënyrë siç ato janë parashikuar në modelin e origjinës. Vetëm në këtë mënyrë situata juridike e parashikuar nga neni 373 i K.Pr.Penale bëhet më e qartë për palët në proces dhe për gjykatën, kur ndodhemi përpara rastit të përcaktimit të lidhjes midis dy veprave penale.

Kështu që në kuadër të propozimeve për përmirësimin e Kodit tonë në lidhje me akuzat e reja duhet të shtoj se neni 79 paragrafi 1 gërma “b” përpara ndryshimeve që i janë bërë me Ligjin nr. 8813 datë 13.06.2002 përmban përcaktimin e duhur ligjor të situatës juridike që parashikon neni 373 i K.Pr.Penale.

Në vijim të këtij argumenti mendoj se neni 79 paragrafi 1 gërma “b” në Kodin e Procedurës Penale duhet të ndryshojë si më poshtë:

“1. Organi procedues mund të vendos bashkimin e procedimeve: ...b) kur një person akuzohet për disa vepra penale të kryera me një veprim apo mosveprim të vetëm, ose me disa veprime a mosveprime të kryera prej tij për arritjen e qëllim të vetëm kriminal.”

4.3.4. Vepra penale vazhduese dhe akuza për një vepër tjetër penale

Më sipër theksuam se situata juridike e parashikuar nga neni 373 i K.Pr.Penale lidhet me rastin e konkurrimit ideal të veprave penale. Me propozimin për ndryshimet e reja në Kod me qëllim përcaktimin në mënyrë korrekte të lidhjes që duhet të ekzistojë midis veprës penale të parë dhe asaj që duhet t’i njoftohet të pandehurit në gjykim është dhe rasti i dytë, i cili lidhet me veprën penale vazhduese e cila është përfshirë dhe në lidhjen e veprave penale të përcaktuara nga neni 12 paragrafi 1 gërma “b” të Kodit të Procedurës Penale të italisë.

Në praktikë gjyqësore janë evidentuar raste kur një person brenda një afati të shkurtër kohor kryen një mori veprimesh në seri (të ngjashme me njëra – tjetrën) të cilat mund t’i identifikojmë si shumë vepra penale të të njëjtit lloj, të cilat kryhen në më shumë se një akt apo veprim njerëzor. Kjo situatë i përgjigjet një rasti specifik që ka të bëjë me konkurrimin real homogjen të veprave penale¹²². Në veprën penale vazhduese dënimi i autorit nuk përlllogaritet sipas formulës bazë që përcakton dënimin në rastin e konkurrimit real të veprave penale, por supozohet se autori i saj ka kryer një vepër penale të vetme në mënyrë të vazhduar¹²³. Rastet tipike të veprës penale vazhduese të përmendura edhe nga doktrina janë rastet e arkëtarëve në një supermarket që çdo ditë për një vit rresht vjedhin një sasi të jo të madhe parash (psh. 500 lekë të reja) nga xhiroja ditore, apo rastet e vjedhjes së energjisë elektrike çdo ditë në orare të veçanta nga një subjekt kontraktor i lidhur me OSHEE-në etj.¹²⁴

Në doktrinë është përcaktuar se vepra penale vazhduese ndër të tjera është pjesë e nevojshme e praktikës gjyqësore edhe për arsye procedurale juridike, pasi ndihmon në thjeshtimin e zbatimit të procedurës penale në rastin e evidentimit të saj në praktikë. Nëse nuk do të ekzistonte në teorinë e së drejtës penale vepra penale vazhduese, atëherë në praktikë do të krijoheshin probleme të mëdha për shkak të numrit të madh të veprave penale të kryera që duhet të shoqërohen me një numër të madh akuzash për secilën prej veprave. Gjithashtu më pas në

¹²² Mëngjesi Sokol, “Bazat e doktrinës së të drejtës penale”, “Botimet Morava” Tiranë 2016, faqe 405

¹²³ Mëngjesi Sokol, po aty

¹²⁴ OSHEE – Operatori i shpërndarjes së energjisë elektrike

gjykim, do të duhet të vërtetoheshin të gjitha veprat penale si pjesë e akuzave dhe në fund do të duhet të caktohej dënimi i posaçëm për secilën veprë penale, duke bërë në përfundim edhe bashkimin e dënimit për secilën prej tyre. Pra vepra penale vazhduese në aspektin procedural, shpesh vështirësitë e mëdha me të cilat do të përballëj gjykata gjatë gjykimit të një numri të madh të veprave penale homogjene.

Për këtë arsye vepra penale vazhduese trajtohet si një veprë penale e vetme, pavarësisht numrit të madh të veprave penale homogjene që përfshihen në veprën penale vazhduese. Në veprën penale vazhduese nuk ka rëndësi hollësia dhe detaji i rrethanave në të cilat është kryer çdo veprë veç e veç si pjesë përbërëse e veprës penale vazhduese. Në shqyrtimin gjyqësor mjafton të provohet se janë kryer një seri veprash homogjene që plotësojnë elementët e anës objektive dhe subjektive të veprës penale vazhduese, pa u ndalur në aspektin e provueshmërisë së të njëjtëve elementë për secilën prej veprave veç e veç.

Në këtë aspekt themi se procesi gjyqësor për gjykimin e një veprë penale vazhduese përfshin të gjitha veprat penale homogjene që janë pjesë përbërëse e veprës penale vazhduese. Vepra penale të marra në veçanti nuk përfaqësojnë një entitet të vetin të tyre. Ato janë pjesë e të njëjtit qëllim kriminal të parashikuar prej autorit të tyre e për rrjedhim nuk mund të qëndrojnë më vete. Si rrjedhim gjatë procesit gjyqësor vendimi përfundimtar që mund të marrë gjykata, në raport me veprën penale vazhduese është një vendim i vetëm penal në të cilin do të gjejnë pasqyrim të gjitha veprat penale seriale që janë pjesë përbërëse e veprës penale vazhduese.

Në këtë vendim konsiderohen si të përfshira dhe ato veprime vetjake pjesë përbërëse e veprës penale vazhduese të cilat janë zbuluar nga prokuroria pasi vendimi penal i dënimit të autorit për veprën penale vazhduese ka marrë formë të prerë. Në këtë rast vlen parimi procedural “*ne bis in idem*”. Kjo do të thotë se pasi vendimi për veprën penale vazhduese ka marrë formë të prerë, nëse më pas zbulohet ndonjë veprë tjetër, pjesë përbërëse e serialit të veprës penale vazhduese, organi i ndjekjes penale privohet nga e drejta për të nisur procedimin penal për veprën e re si veprë e posaçme të zbuluar më pas për shkak të parimit “*ne bis in idem*”. Vepra penale e posaçme e zbuluar më pas nga organi i ndjekjes penale është pjesë përbërëse e zinxhirit të veprave të tjera të gjykuara si element konstituiv të veprës penale vazhduese. Kështu nëse zbulohet se pas nëntë vjedorëve të kryera në seri, për të cilat është dënuar autori i tyre për krimin vazhdues, i njëjti autor në kushte të njëjta ka kryer edhe dy vjedorë të tjera, ai për dy rastet e zbuluara përjashtohet nga nisja apo vazhdimi i mëtejshëm i procedimit të dytë penal për shkak të parimit “*ne bis in idem*”.¹²⁵

Nisur nga sa u trajtua më sipër, referuar nenit 373 të K.Pr.Penale themi se edhe për rastin e veprës penale vazhduese vlen i njëjti rregull si për rastin e konkurrencimit ideal të veprave penale. Në gjykimin e veprës penale vazhduese nëse prokurori evidenton në gjykim edhe ndonjë veprë të veçantë që është pjesë e serisë së veprave penale që formojnë veprën penale vazhduese, prokurori në këtë rast plotëson akuzën në bazë të nenit 373 të K.Pr.Penale, duke shtuar veprën penale të identifikuar në gjykim (e cila nuk është veprë penale e re) si pjesë të akuzës së veprës penale vazhduese dhe rrjedhimisht shtimin e akuzës duhet t`ja njoftojë në gjykim të pandehurit.

¹²⁵ Kambovski Vllado, “E Drejta Penale Pjesa e Përgjithshme”, Shtëpia Botuese “FURKAM ISM” Shkup 2007, faqe 425

4.3.5. Rrethana rënduese për veprën penale në gjykim

Neni 373 i K.Pr.Penale parashikon dhe rastin e njoftimit të të pandehurit prej prokurorit mbi rrethanën rënduese që ka lidhje me veprën penale të sjellë për gjykim, por që nuk është përmendur prej prokurorit në kërkesën për gjykim. Ashtu siç e përmendëm më sipër, midis veprës penale të sjellë për gjykim dhe rrethanës rënduese duhet të ekzistojë një lidhje natyrore. Lidhja duhet të jetë e tillë që në momentin e kryerjes së veprës penale të jetë e pranishme edhe rrethana ose rrethanat rënduese të parashikuara nga Kodi Penal.

Neni 51 i K.Penal parashikon rrethanat rënduese të cilat rëndojnë pozitën e autorit të veprës penale kur ato kanë qenë të pranishme në kohën e kryerjes së veprës penale. Për këtë arsye njoftimi i rrethanës rënduese sipas nenit 373 të K.Pr.Penale të pandehurit në gjykim merr rëndësi për shkak se atij duhet t'i jepet koha dhe mundësia për të përgatitur mbrojtjen edhe kundër rrethanës rënduese të njoftuar në gjykim e cila vlen për shkak të rëndimit të pozitës procedurale të të pandehurit.

Për të kuptuar sesi zbatohen në praktikë njoftimi i akuzës që lidhet me një vepër tjetër penale në gjykim po ofrojmë disa shembuj.

Në fillimi do të paraqesim një vendim gjyqësor të dhënë nga Gjykata e Kasacionit në Itali, për shkak se në këtë vendim të përzgjedhur janë përcaktuar qartë kushtet mbi bazën e të cilave duhet të veprojë prokurori për t'i njoftuar të pandehurit në gjykim akuzën për një vepër tjetër penale të lidhur me atë vepër që është sjellë më parë në gjykim. Në këtë vendim gjykata përcakton edhe pasojat që e shoqërojnë vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta kur nuk zbatohen drejt rregullat mbi njoftimin e akuzës për një vepër tjetër penale.

Gjykata e Kasacionit në Itali me vendimin me nr. 30255 datë 12.07.2013 ka parashtruar ngjarjen e mëposhtme:

“Në Gjykatën e Triestes në Itali është zhvilluar gjykimi ndaj të pandehurit P.F., i cili u deklarua fajtor nga kjo gjykatë për veprat penale të parashikuara nga neni 186/7, 187/8 si dhe nga neni 186/2 gërma “c” i Kodit Rrugor në Itali duke e dënuar për dy shkeljet e para të vlerësuara si pjesë përbërëse të veprës penale vazhduese me një dënim prej 4 muaj burgim dhe 5000 euro gjobë, si dhe për shkeljen e tretë me 6 muaj burgim dhe 4000 euro gjobë. Gjykata gjithashtu disponoi me konfiskimin e automjetit në pronësi të të pandehurit si dhe caktoi si dënim administrativ për të pandehurin pezullimin e së drejtës për të drejtuar mjete të transportit për një periudhë prej dy vjetësh.

Në datë 20 shkurt 2009 i pandehuri pasi ishte përplasur me një tjetër autoveturë, kishte vazhduar të drejtonte automjetin e tij në një rrugë në sens të kundërt drejtimi duke përshkruar një gjatësi rreth 11 km dhe në fund automjeti që ai e drejtonte përplaset me një kamion.

Pasi i pandehuri u dërgua në spital, ai refuzoi ti nënshtrohej një ekzaminimi mjeko – ligjor të kërkuar nga forcat e rendit në kuptim të nenit 186 pika 4 dhe 5 si dhe nga neni 187 pika 3 dhe 4 të Kodit Rrugor Italian. Nga analizat e gjakut të kryera për qëllime klinike rezultoi se i pandehuri kishte një nivel alkooli në gjak në sasinë 2, 3 gram për litër. Mbi bazën e verifikimeve

në seancë gjyqësore, gjykata e deklaroi fajtor të pandehurin për veprat penale të përmendura më lart vendim i cili u la në fuqi edhe në Gjykatën e Apelit.

Mbrojtësi i të pandehurit paraqiti rekurs në Gjykatën e Kasacionit ku ndër të tjera ai kërkoi pavlefshmërinë e vendimit të gjykatës së shkallës së parë e cila deklaroi fajtor të pandehurin edhe për një akuzë të re që kishte lidhje me veprat penale të sjellë për gjykim të njoftuar nga prokurori të pandehurit në seancë gjyqësore, akuzë e re e cila bënte fjalë për shkeljen e “Drejtimit të automjetit në gjendje të dehur”. Arsyet e rekursit lidheshin me faktin se sjellja e të pandehurit për këtë veprë penale të njoftuar në gjykim, rezultonte nga aktet që i kishte në dispozicion prokurori që në fazën e hetimeve paraprake dhe këto prova nuk u zbuluan në gjykim gjatë fazës së shqyrtimit gjyqësor. Pra sipas mbrojtjes janë shkelur kushtet e parashikuara nga neni 517 i K. Pr. Penale Italiane.

Në lidhje me këtë pikë të rekursit Gjykata e Kasacionit në vendimin e saj u shpreh se: “...kontestimi për akuzën e re të drejtimit të automjetit në gjendje të dehur nuk mund të pranohet me argumentin se shkelja nuk ka qenë e konstatuar gjatë shqyrtimit gjyqësor, por ka rezultuar tashmë e ditur nga prokurori që nga aktet e marra në fazën e hetimit paraprak. Ky argument nuk gjen mbështetje në jurisprudencën konstante të kësaj gjykate duke e legjitimuar kontestimin suplementar në të dyja situatat (së fundmi shiko vendimin nr. 6 datë 22. 09. 2009, nr. 44980 Rv. 245284). Për një tjetër arsye rekursi duhet të pranohet.

Akuza e re që ishte “Drejtimi i automjetit në gjendje të dehur” që i është njoftuar të pandehurit në seancë gjyqësore kur po gjykoreshin dy shkeljet e para të kryera prej tij, nuk është veprë penale konkurruese në kuptimin e veprës penale të lidhur me atë që gjykohet sipas nenit 12/1 gërma “b” ashtu siç është përcaktuar nga neni 517 i K. Pr. Penale Italiane. Ndërmjet veprës së “Drejtimit në gjendje të dehur” dhe asaj të “Refuzimit të testit për alkoolin” të parashikuar nga nenet 186 dhe 187 të Kodit Rrugor Italian nuk ekziston në fakt ajo lidhje e qartësuar nga neni 12/1 gërma “b” që parashikon se veprat penale janë të lidhura me një veprim ose mosveprim të vetëm, si dhe me disa veprime për arritjen e një qëllimi të vetëm kriminal. Në këtë rast mund të vlerësohet si i zbatueshëm neni 518 i K.Pr.Penale Italiane (Akuza për një fakti të ri) nga momenti që i pandehuri në gjykim përmes mbrojtësit të tij kundërshtoi menjëherë akuzën për veprën penale të lidhur me atë që po gjykohej.

Në përfundim Gjykata e Kasacionit vendosi të anullojë pa e ridërguar për gjykim vendimin e ankimuar vetëm për pjesën e shkeljes së “Drejtimit në gjendje të dehur” duke hequr dënimin prej 6 muajsh dhe gjobën prej 4000 euro, ndryshon gjithashtu dënimin administrativ të pezullimit të lejes së drejtimit për automjete në afatin 1 vjeçar; vendos njoftimin e këtij procedimi të anuluar Prokurorit të Republikës së Triestes për përcaktimet e mëtejshme të tij.”

Nga vendimi i sipërcituar konkludojmë se përcaktimi i saktë i situatës në të cilën duhet të veprojë prokurori për njoftimin e akuzës për një veprë penale të lidhur me atë që gjykohet, merr një rëndësi të madhe për procesin gjyqësor. Akuza për një veprë penale të lidhur me atë që gjykohet duhet t’i njoftohet të pandehurit në gjykim në rastin kur veprat penale konkurrojnë me njëra – tjetrën mbi bazën e rregullave të përcaktuara nga konkurrimi ideal i veprave penale ose për shkak se veprat e kryera prej autorit janë pjesë përbërëse e një qëllimi të vetëm kriminal, duke i cilësuar këto veprime si pjesë e veprës penale vazhduese.

Nëse prokurori nuk ndodhet përpara situatës së përmendur më sipër në gjykim, atëherë ai nuk mund të veprojë me njoftimin e akuzës për një vepër tjetër penale. Një veprim i tillë mund të sjellë si pasojë cënimin e procesit penal nga një gjykatë më e lartë, për shkak të mosrespektimit të dispozitave që lidhen me akuzat e reja.

Në vendimin nr. 618 datë 10.12.2003 të Gjykatës së Lartë, janë konstatuar faktet e mëposhtme¹²⁶:

“Më datë 03.05.2002 rreth ores 03⁰⁰, në marrëveshje me njëri tjetrin të gjykuarit I. F., I. D., dhe E.A., kanë dalë me furgonin e këtij të fundit tek vendi ku nisen furgonat me qëllim që të gjenin ndonjë refugjat që kishte nevojë për transport për ta marrë dhe për ta vjedhur gjatë rrugës. Aty kanë gjetur të dëmtuarit, shtetasit Y.B dhe L.B, të cilët po prisnin ndonjë automjet për të shkuar njëri në Tiranë dhe tjetri në Elbasan. Pasi i kanë marrë në furgon, rrugës pranë Libonikut i gjykuari E. A., i ka thënë se do të kthehej për në fshatin Sheqiras, për shkak se do të ndërronte punëtorin. Në afërsi të Urës së Drithasit ka ndaluar me preteksin për nevoja personale. Pasi kanë zbritur të gjithë nga makina, të gjykuarit kanë filluar të godasin dy të dëmtuarit, duke përdorur edhe levë hekuri e duke i rrëzuar ata pa ndjenja në tokë. Kanë marrë paratë dhe sendet që ata kishin me vete në trup, si dhe çantat e janë larguar. Pas kallëzimit të bërë prej të dëmtuarve, policia ka mundur të arrestojë në shtëpinë e tij të gjykuarin I. F, ndërsa dy të gjykuarit e tjerë menjëherë pas ngjarjes janë larguar në drejtim të paditur, duke iu fshehur hetimit dhe gjyimit.

Megjithëse është vertetuar dhe pranuar se të gjykuarit kanë vjedhur me dhunë në bashkëpunim dy shtetas, të dëmtuarit e lartpërmendur, gjykatat kanë lejuar gabime në cilësimin ligjor të kësaj vepre penale.

Kështu të gjykuarit janë deklaruar fajtorë dhe dënuar vetëm një herë për veprën penale të mësipërme të parashikuar nga nenet 139 dhe 25 të K.P., në vend që të deklaroheshin fajtor dhe të dënoheshin dy herë për kryerjen e kësaj vepre, për arsye se vjedhja është kryer në dëm të dy personave.

Gjykata e apelit ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë me arsyetimin se, vërtet vepra është kryer në dëm të dy personave, por jo në momente të veçanta, prandaj ajo do të quhet si e kryer një herë.

Ky arsyetim bie ndesh me kuptimin dhe zbatimin e drejtë të nenit 139 të K.Penal, i cili parashikon se, vjedhja e shoqëruar më përdorimin e dhunës dënohet.

Kjo nënkupton se, personi që e ka kryer vjedhjen do të përgjigjet penalisht aq herë për të, sa të jetë numri i personave të dëmtuar, pavarësisht nga fakti se vjedhja është bërë në të njëjtën kohë apo me shkopje ndaj personave të dëmtuar. Pra, në këtë rast nuk mund të bëhet fjalë për zbatimin e teorisë së krimit vazhdues.

Një qëndrim analog kanë mbajtur Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendimin nr.284, datë 06.10.2000, kur kanë interpretuar nenin 143 të K.P. që bën fjalë për veprën penale të vjedhjes nëpërmjet mashtrimit.

¹²⁶ Vendim i Gjykatës së Lartë nr. 618 datë 10.12.2003

Në këto rrethana, pavarësisht nga fakti se në rekursin e paraqitur nga prokurori kërkohet që, ndryshimi i cilësimit ligjor të veprës penale të bëhet nga ky Kolegj, ky i fundit gjykon se, meqënëse në këtë rast bëhet fjalë për shtimin e një akuze të re dhe të rëndë në ngarkim të të gjykuarve, atë të vjedhjes me dhunë në bashkëpunim, parashikuar nga neni 139 & 25 i K.P., kjo akuzë duhet t'i bëhet e njohur atyre në gjykimin e shkallës së parë, me qëllim që të respektohen të drejtat që u garanton ligji procedural penal dhe pikërisht neni 376 i K.Pr.Penale.

Referuar fakteve të përmendura më lart themi se që në fillim akuza nuk është ngritur drejt nga prokurori. Veprimet e të pandehurve janë drejtuar në cënimin e dy marrëdhënieve shoqërore (të mirave juridike) që janë pasuritë e veçanta të secilit prej të dëmtuarve. Në përfundim të hetimit prokurori gabimisht ka ngritur një akuzë të vetme për tre të pandehurit, në vend që të ngrinte dy akuza për veprën penale të “Vjedhjes me dhunë” pasi nga kjo ngjarje ka pasur të dëmtuar në pasuri dy persona prej veprimit të përbashkët të të pandehurve. Në këtë rast nuk ndodhemi përpara veprës penale vazhduese për shkak se nga veprimi i koordinuar i të pandehurve nuk është dëmtuar vetëm një e mirë materiale (element që kërkohet nga vepra penale vazhduese) por janë dëmtuar dy të mira materiale (pasuritë e veçanta të secilit prej të dëmtuarve), që nuk kanë asnjë lidhje me njëra – tjetrën.

Pyetja nëse në gjykim a mund të procedonte prokurori me njoftimin e akuzës të të pandehurve për veprën penale të “Vjedhjes me dhunë” në rastin e të dëmtuarit të dytë sipas parashikimit të nenit 373 të K. Pr. Penale?

Mendoj se në këtë rast prokurori duhet të procedonte sipas nenit 373 të K.Pr.Penale që bën fjalë për njoftimin e akuzës për një vepër penale të lidhur me atë që gjykohet. Referuar argumenteve që dhamë më lart mbi lidhjen objektive që duhet të ekzistojë midis dy veprave penale, në rastin konkret themi se të dy veprat penale të “Vjedhjes me dhunë” konkurrojnë me njëra – tjetrën në konkurrimin ideal të veprave penale.

Dhuna që është elementi i përbashkët i të dy veprave penale të “Vjedhjes me dhunë” përfaqëson një veprim të vetëm, të realizuar në bashkëpunim prej tre të pandehurve që është ushtruar prej tyre në të njëjtën kohë ndaj dy të dëmtuarve.

Në këto kushte mënyra e vetme për të proceduar me njoftimin edhe të akuzës së dytë prej prokurorit është zbatimi i nenit 373 të K.Pr.Penale. Në këtë kuptim vlerësoj se Gjykata e Lartë, në mënyrë korrekte ka prishur vendimet e dhëna nga dy gjykatat më ulëta, për shkak të mosrespektimit të dispozitave procedurale që lidhen me zbatimin e akuzave të reja, duke identifikuar në mënyrë të qartë situatën juridike.

Në këtë situatë vlerësoj se ekzistojnë pika të përbashkëta të interpretimit ligjor për dispozitën procedurale të akuzës për një vepër tjetër penale midis Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës së Kasacionit në Itali në vendimet e paraqitura më lart.

Rasti i tretë lidhet me një çështje penale të gjykuar nga Gjykata e shkallës së parë “Për Krimet e Rënda” Tiranë. Në vendimin nr. 09/2014 pasqyrohen faktet e mëposhtme¹²⁷:

¹²⁷ Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë “Për Krimet e Rënda” Tiranë nr. 09 datë 21.01.2014

“Më datë 23.11.2012 rreth orës 06⁰⁰ në Pikën e Kalimit Kufitar Kapshticë, Korçë është paraqitur i pandehuri J.C., duke drejtuar automjetin kamion tip “Mercedes Benz” me targë AA 8.... CS për të kryer procedurën e kalimit kufitar nga Republika e Shqipërisë për në Republikën e Greqisë. Punonjësit e policisë kufitare gjatë kontrollit fizik të ushtruar në automjetin e të pandehurit në vijën e dytë në pjesën e poshtme të automjetit kanë gjetur një sasi me material bimor të mbështjellë me ngjitës natriban në 52 (pesëdhjetë e dy) pako, për të cilën punonjësit e policisë dyshuan se ishte lëndë narkotike.

Së bashku me materialin bimor forcat e policisë kanë gjetur të fshehur në të njëjtin vend në kamion edhe një armë zjarri automatike model 56, me kalibër 7. 62 mm me numër serie 03221 – 83. Lënda narkotike dhe arma e zjarrit ishin të fshehura poshtë shasisë së kamionit. Vetë shasia e kamionit ishte e modifikuar. Shasia ishte e mbuluar me një fletë llamarinë të salduar. Punonjësit e policisë gjatë kontrollit të kamionit ju desh të çanin fletën e llamarinës me një mjet prerës. Brenda hapësirës së krijuar në të gjithë shasinë e kamionit, pas çarjes së fletës së llamarinës punonjësit e policisë gjetën të fshehur sasinë e lëndës narkotike dhe armën e zjarrit që u sekuestruan nga policia gjyqësore.

Lënda e dyshuar si narkotike që përmbante materialin bimor e gjitha peshonte 65 (gjashtëdhjetë e pesë) kilogram e 712, 2 (shtatëqind e dymbëdhjetë presje dy) gram. Policia gjyqësore dyshoi se materiali bimor i gjetur mund të ishte lëndë narkotike e llojit cannabis. Forcat e policisë kanë sekuestruar lëndën e dyshuar si narkotike dhe armën e zjarrit si dhe kanë kapur në flagrancë të pandehurin J.C., që ishte drejtuesi i automjetit ku u gjet e fshehur lënda e dyshuar si narkotike së bashku me armën e zjarrit. Gjithashtu policia gjyqësore sekuestroi kamionin tip “Mercedes Benz” me targë AA 8.... CS që drejtohej nga i pandehuri pasi në këtë automjet u gjetën të fshehura sendet e kundërligjshme. Policia gjyqësore arrestoi të dyshuarin në kushtet e flagrancës, pasi u kap në kryerje e sipër të një krimi.

I pandehuri J.C., në rrethana të pakonfirmuara gjatë hetimit paraprak është vënë në posedim të automjetit tip “Mercedes Benz” me targë AA 8... CS që nuk është në pronësi të tij si dhe nga pronari i automjetit nuk i është dhënë të pandehurit e drejta për ta përdorur këtë kamion. Gjithashtu i pandehuri J.C., nuk posedon dëshminë përkatëse për të drejtuar një mjet motorik të tipit kamion. I pandehuri, pasi është vënë në zotërim të automjetit pa poseduar dëshminë përkatëse në të cilin ndodhej e fshehur lënda narkotike dhe arma e zjarrit është drejtuar në Pikën e Kalimit Kufitar Kapshticë, Korçë për të shkuar në Greqi. Arsyeja e përmendur nga i pandehuri në deklaratimet e dhëna në hetim se ai po shkonte në Greqi me një automjet të gjetur të braktisur për të blerë një gomë autokombajne nuk përputhet me veprimet konkrete të kryera nga i pandehuri.

...

Gjatë shqyrtimit gjyqësor të kësaj çështje penale sipas ritit të gjykimit të zakonshëm, gjykata pasi shqyrtoi të gjitha provat e kërkuara nga palët në proces, procedoi kryesisht me marrjen e një prove të re që ishte konfirmimi nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor nëse i pandehuri J.C., a ishte pajisur me një dëshmi aftësie për të drejtuar automjete dhe nëse po, çfarë kategorie automjetesh mund të drejtonte i pandehuri sipas përcaktimit që bëhen në Kodin Rrugor. Arsyeja se pse gjykata procedoi me marrjen e këtij dokumenti si provë kryesisht lidhet me faktin se gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk kishte rezultuar që të pandehurit, prokuroria ti kishte sekuestruar dokumentin e dëshmisë së aftësisë për drejtim automjeti.

I pandehuri u kap në flagrancë nga policia gjyqësore duke drejtuar një kamion që nuk ishte në pronësi të tij. Rrjedhimisht prokuroria duhej të kishte hetuar edhe mbi aftësinë ligjore të të pandehurit për të drejtuar një automjet tip kamion. Meqenëse një veprim i duhur hetimor nuk u krye nga prokuroria në hetim, gjykata vendosi të procedojë kryesisht bazuar në nenin 367 të Kodit të Procedurës Penale për ta marrë vetë këtë provë të rëndësishme.

Me shkresën nr. 11491/1 prot. datë 14. 11. 2013 Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor i kthen përgjigje Gjykatës duke konfirmuar se: “Shtetasi J.C., është i pajisur me Dëshmi Aftësie për Drejtimin e Automjetit me Nr. Serie 874033, të Kategorisë “B” me numër Prot. 5H/6921, datë 20. 11. 2004, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Korçë”.

Pas marrjes së këtij konfirmimi prokuroria i komunikoi të pandehurit J.C., në seancë gjyqësore akuzën e “Drejtimin të automjetit në gjendje të dehur apo pa dëshmi” parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal.

Gjykata vlerësoi se i pandehuri J.C., e ka konsumuar tërësisht veprën penale të “Drejtimin të automjetit në gjendje të dehur apo pa dëshmi” parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal. I pandehuri J.C., më datë 23. 11. 2012 rreth orës 05⁰⁰ të mëngjesit i është drejtuar Pikës së Kalimit të Kufirit Kapshticë, Korçë duke drejtuar një automjet kamion tip Mercedes – Benz me targë AA 806 CS. I pandehuri me automjetin që po drejtonte do të shkonte në Greqi. Kamioni që po drejtonte i pandehuri ka një peshë maksimale të autorizuar (me ngarkesë) 5600 (pesëmiqë e gjashtëqind) kilogram.

Bazuar në nenin 115/3 të Kodit Rrugor automjetet me peshë të përgjithshme me ngarkesë të plotë, më të madhe se 3. 50 tonë, drejtohen nga persona që zotërojnë leje drejtimi të kategorisë “C”. I pandehuri J.C., nuk zotëron leje të drejtimin të kategorisë “C”, por zotëron një leje drejtimi të kategorisë “B”. Personi që zotëron një leje drejtimi të kategorisë “B” është i paaftë që të drejtoj një automjet për të cilin duhet leja e drejtimin të kategorisë “C”.

Fakti se i pandehuri ka konsumuar edhe veprën penale të “Drejtimin të automjetit në gjendje të dehur apo pa dëshmi” parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, bëhet më i plotë kur ai lidhet edhe faktin se i pandehuri në kamionin që po drejtonte pa lejen përkatëse të drejtimin, kishte fshehur një armë zjarri dhe lëndë narkotike të llojit cannabis sativa të cilën do ta trafikonte në Greqi...

Edhe në këtë rast vlerësoj se ndërhyrja e prokurorit që i njoftoi të pandehurit në seancë gjyqësore akuzën për veprën penale të lidhur me ato për të cilat ai ishte sjellë në gjykim, sipas parashikimeve të nenit 373 të K.Pr.Penale është një veprim i drejtë dhe i mbështetur në ligj.

Referuar faktit të hetuar ka rezultuar se fillimisht i pandehuri është akuzuar për veprat penale të “Trafikimit të narkotikëve” dhe “Trafikimit të armëve” parashikuar nga neni 283/a/1 dhe 278/a/1 të Kodit Penal. Gjatë gjykimit rezultoi se kamioni i drejtuar nga i pandehuri për në kufirin shtetëror, nuk ishte në pronësi të tij dhe për këtë kamion ai nuk ishte i pajisur me lejen e drejtimin. Rrjedhimisht në gjykim, pasi ky fakt u konfirmua me ndërhyrjen e gjykatës, prokurori duhet të procedonte me njoftimin e një akuzë të re që lidhej me veprën penale të “Drejtimin të automjetit në mënyrë të parregullt” parashikuar nga neni 291 i K. Penal.

Prokurori në këtë rast veprim sipas përcaktimit të parashikuar nga neni 373 i K.Pr.Penale duke i njoftuar të pandehurit në gjykim akuzën shtesë për një vepër tjetër penale të lidhur me ato që është sjellë për gjykim. Vepra penale e “Drejtimit të automjetit në mënyrë të parregullt” është e lidhur me veprat penale të “Trafikimit të narkotikëve” dhe “Trafikimit të armëve”, për shkak të konkurrimit ideal heterogjen të veprave penale. I pandehuri me një veprim të vetëm, drejtimi i automjetit, kishte kryer tre vepra penale respektivisht të trafikut të narkotikëve, mbajtjes pa leje të armës luftarake dhe drejtimit të automjetit pa lejen përkatëse të drejtimit.

Kështu që njoftimi i akuzës prej prokurorit në bazë të nenit 373 të K.Pr.Penale ishte një veprim i drejtë i mbështetur në ligj.

Meqënëse më lart kemi trajtuar me hollësi *Ndryshimin e akuzës dhe Akuzën për një vepër tjetër*, tani na mbetet për t’u trajtuar edhe instrumenti i fundit që prokurori ka në dispozicion të tij, në funksion të ushtrimit të ndjekjes penale gjatë procesit gjyqësor që është *Akuza për një fakt të ri* parashikuar nga neni 374 i K.Pr.Penale. Shtjellimi i *Akuzës për një fakti të ri* bëhet më i lehtë, për shkak të trajtimit më sipër, në mënyrë shteruese të mjeteve që ka në dispozicion prokurori gjatë gjykimit për të ushtruar ndjekjen penale.

4.4. Akuza për një fakt të ri

Akuza për një fakt të ri është parashikuar në nenin 374 të K.Pr.Penale si pjesë e kapitullit të *Akuzave të Reja*. Akuza për një fakt të ri është një mjet tjetër procedural mbi bazën e së cilës prokurori ndërhyr në procedimin penal që është në gjykim duke e njoftuar të pandehurin për faktin e ri të konstatuar në gjykim një akuzë të re. Në pamje të parë rezulton se midis akuzës për një vepër penale tjetër të lidhur me atë që po gjykohet dhe akuzës për një fakt të ri ekzistojnë ngjashmëri me njëra tjetrën, ngjashmëri të cilat mund të çojnë në përfundimin se qenia e dy dispozitave procedurale të ngjashme do të përbënte një rast të tepërt që nuk do t’i sillte dobi procedimit penal.

Gjithsesi mund të themi se ngjashmëria midis këtyre dy dispozitave është një ngjashmëri periferike e cila lidhet vetëm me faktin se i pandehuri në gjykim, në të dy situatat duhet të përballet dhe me një akuzë shtesë. Pra në të dy rastet ndodhemi përpara situatës së konkurrimit të veprave penale. Pavarësisht këtij elementi të përbashkët të dy dispozitat procedurale kanë ndryshime me njëra tjetrën, për shkak se ato rregullojnë situata të ndryshme procedurale të cilat mund të jenë prezente në një çështje penale në gjykim.

Më poshtë do të trajtojmë elementët përbërës të nenit 374 të K.Pr.Penale dhe situatën procedurale se kur kjo dispozitë duhet të zbatohet nga prokurori.

Neni 374 i K.Pr.Penale që bën fjalë për *Akuzën për një fakt të ri* parashikon se:

“1. Kur gjatë shqyrtimit gjyqësor del një fakt i ri në ngarkim të të pandehurit që nuk është përmendur në kërkesën për gjykim dhe për të cilin duhet proceduar kryesisht, prokurori procedon në format e zakonshme, duke tërhequr dosjen për të vazhduar hetimet paraprake. Megjithatë, në qoftë se prokurori kërkon, gjykata mund të lejojë shqyrtimin në të njëjtën seancë kur i pandehuri jep pëlqimin dhe nuk dëmtohet shpejtësia e procedimit.”

Duke ju referuar përmbajtjes së nenit 374 të K.Pr.Penale konstatojmë këto elementë: së pari, evidentimi i një fakti të ri në gjykim, për të cilin procedohet kryesisht; së dyti tërheqja e dosjes për vazhdimin e hetimit, e së treti marrëveshja midis prokurorit dhe të pandehurit për të lejuar shqyrtimin në të njëjtën seancë gjyqësore.

4.4.1. Fakti i ri në gjykim

Siç e përmendëm edhe më sipër, gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes penale të sjellë për gjykim duhet të dalë një fakt i ri i cili nuk është përmendur në kërkesën për gjykim. Një fakt i ri në gjykim do të thotë që në shqyrtimin gjyqësor të çështjes penale, prokurori konstaton një ngjarje të kundërligjshme, krejtësisht të ndryshme nga ajo që ai ka hetuar dhe e ka sjellë për gjykim e cila nuk ka asnjë lidhje në elementet e saj objektiv as me ndonjë rrethanë cilësuese apo rënduese, por as me ndonjë vepër penale të lidhur me atë që është sjellë për gjykim.

Fakti i ri është zbuluar në gjykim dhe deri në këtë moment ai ka qenë i panjohur për prokurorin dhe rrjedhimisht nuk i është nënshtruar hetimit paraprak si një fakt penal¹²⁸. Ndodhemi përpara fakti të ri në gjykim kur psh., i pandehuri në gjykim pohon autorësinë e tij për një tjetër vepër penale që nuk ka asnjë lidhje në elementët e saj me atë që gjykohet¹²⁹. Në këtë rast bëhet fjalë për një fakti të ri që është i ndryshëm prej veprës penale të sjellë për gjykim, për të cilin prokurori duhet të ushtrojë në mënyrë autonome ndjekjen penale. Në vijim të mendimit, mund të themi se fakti i ri është qartësisht i dallueshëm prej atij që po shqyrtohet në procesin gjyqësor.

Në ndryshim nga neni 373 i K.Pr.Penale në të cilin në gjykim konstaton një vepër tjetër penale, në situatën e parashikuar nga neni 374 i K.Pr.Penale prokurori konstaton ekzistencën e një fakti të ri penal. Midis situatave të parashikuara nga dispozitat e mësipërme vërehet një ndryshim, i cili në terma ligjorë përfaqëson veprën penale në nenin 373 të K.Pr.Penale dhe faktin e ri në nenin 374 të K.Pr.Penale.

Situata e nenit 373 të K.Pr.Penale i referohet akuzës së ngritur në gjykim për veprën penale të lidhur për shkak se të dy veprat penale, si ajo e hetuar ashtu edhe ajo e konstatuar në gjykim kanë si elemente të përbashkët veprimin e vetëm të kundërligjshëm të kryer prej të pandehurit i cili ka sjellë dy ose më shumë pasoja penale të parashikuara si vepra të ndryshme penale. Mund të thuhet gjithashtu se veprat penale janë vepra sferike të cilat lidhen me njëra – tjetrën për shkak të të njëjtit qëllim kriminal të planifikuar prej autorit të tyre. Në këtë rast hetimi në përgjithësi është i plotë për shkak se hetimi i përfunduar për veprën e parë penale të sjellë për gjykim, ka integruar në përmbajtjen e tij edhe hetimin për veprën penale të lidhur, të konstatuar në gjykim sipas nenit 373 të K.Pr.Penale.

Për këtë arsye neni 373 i K.Pr.Penale përdor termin ligjor vepër penale kur prokurori do t'i duhet të procedojë me njoftimin e akuzës në gjykim të pandehurit, pasi elementet e veprës penale të dalë në gjykim janë të evidentuara për shkak të hetimit të kryer për veprën e parë penale.

¹²⁸ Mercone M., "Diritto Processuale Penale", XI Edizione, "Edizione Giuridiche Simone" 2003

¹²⁹ Vendim i Gjykatës së Kasacionit në Itali, seksioni V, me nr. 10310 datë 30. 09. 1998

Ndërkohë në nenin 374 të K.Pr.Penale përdoret termi “fakt i ri” për shkak se si fillim ky fakt nuk i është nënshtruar hetimit paraprak pasi ai nuk dihej dhe nuk ka rezultuar nga të dhënat e mbledhura prej prokurorisë gjatë hetimit të veprës së parë penale. Kjo do të thotë se elementët përbërës të faktit të ri penal, nuk kanë asnjë lidhje me ato elementë që përbëjnë veprën penale të sjellë për gjykim. Fakti i ri normalisht duhet t’i nënshtrohet hetimit paraprak duke respektuar parimin e ushtrimit të ndjekjes penale, sipas së cilës vetëm nëpërmjet hetimit të plotë prokurori duhet të konkludojë nëse fakti i ri përbën apo jo vepër penale e nëse është vepër penale, a është apo jo autor i saj i pandehuri që gjykohet për veprën e parë penale.

Në vija të përgjithshme themi se situata e parashikuar nga neni 374 i K.Pr.Penale i përgjigjet rasteve kur i pandehuri dyshohet se ka kryer dy ose më shumë vepra penale në kohë të ndryshme, me veprime të ndryshme prej të cilave janë cënuar apo dëmtuar marrdhënie të ndryshme shoqërore që mbrohen posaçërisht nga ligji penal. Pra neni 374 i K.Pr.Penale parashikon situatën e konkurrimit real të veprave penale.

Ndodhemi përpara konkurrimit real të veprave penale, kur autori i tyre ka kryer më shumë se një vepër penale. Kjo situatë paraqet formën më të thjeshtë të konkurrimit të veprave penale. Në konkurrimin real dallohet pluraliteti i veprimeve të autorit që do të thotë se çdo vepër penale realizohet me veprime të veçanta. Në konkurrimin real është e mundur që me më shumë veprime të autorit të jenë realizuar shumë figura ligjore të të njëjtës vepër penale (psh rasti i kryerjes së shumë vjedhjeve) ose me shumë veprime të jenë realizuar figura të ndryshme ligjore (psh në një rast vrasja, në një rast tjetër vjedhja, në një rast tjetër plagosja e rëndë). Në shembullin e parë bëhet fjalë për konkurrimin homogjen të veprave penale, ndërsa në shembullin e dytë bëhet fjalë për konkurrimin heterogjen të veprave penale¹³⁰.

Në konkurrimin real të veprave penale ekziston një autor për disa vepra penale të kryera prej tij, të cilat nuk kanë lidhje me njëra tjetrën. I vetmi komponent i përbashkët për veprat penale të kryera në konkurrimin real të tyre është subjekti (autori) i njëjtë i veprave penale. Kjo është edhe arsyeja pse neni 374 i K.Pr.Penale i jep mundësinë prokurorit që t’i atribuojë të pandehurit në seancë gjyqësore, akuzën për një fakti të ri e cila përfaqëson një akuzë shtesë.

Përveç modelit italian prej të cilit ne kemi përfshirë në sistemin tonë të procedurës penale rastin e akuzës për një fakti të ri¹³¹ (akuza shtesë), thuajse për të njëjtën situatë gjendet një parashikim i ngjashëm ligjor edhe në kodet procedurale penale të disa shteteve, të cilat kanë qenë pjesë e studimit për këtë punim. Më konkretisht Kodi i Procedurës Penale të Kosovës¹³², Kodi i Procedurës Penale të Kroacisë¹³³, Kodi i Procedurës Penale të Serbisë¹³⁴, Kodi i Procedurës Penale të Gjermanisë¹³⁵, parashikojnë mundësinë e shtimit të akuzës ndaj të pandehurit në gjykim për një fakt të ri. Fakti i ri lidhet me vepra penale të dyshuara që janë kryer nga i pandehuri gjatë kohës që ai po gjykohet për veprën e parë penale të sjellë për gjykim ose vepra penale e mëparshme e dyshuar si e kryer nga i pandehuri zbulohet në gjykim.

¹³⁰ Kambovksi V., “E Drejta Penale Pjesa e Përgjithshme”, Shtëpia Botuese “FURKAM ISM” Shkup 2007, faqe 417

¹³¹ Neni 518 i Kodit të Procedurës Penale të Italisë

¹³² Neni 351/1 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës

¹³³ Neni 442/1 paragrafi 2 i Kodit të Procedurës Penale të Kroacisë

¹³⁴ Neni 410 i Kodit të Procedurës Penale të Serbisë

¹³⁵ Neni 266/1 i Kodit të Procedurës Penale të Gjermanisë

Prokurori mund t'i njoftojë të pandehurit akuzën për faktin e ri penal në gjykim në rastin kur vepra penale e cila përfshihet në faktin e ri penal të dalë në gjykim ndiqet kryesisht prej prokurorisë. Në rast se fakti i ri penal i konstatuar në gjykim përfshin një veprë penale për të cilën ndjekja penale nuk mund të realizohet kryesisht prej prokurorit, në këtë rast prokurori nuk mund të procedojë më tej me njoftimin e akuzës.

4.4.2. Tërheqja e dosjes dhe vazhdimi i hetimit

Procedura që duhet të ndjekë prokurori në rastin e konstatimit të një fakti të ri në gjykim, është e ndryshme nga ajo që ai ndjek kur njofton akuzën për një veprë penale të lidhur me atë që gjykohet. Fakti i ri penal nuk ka elementë të përbashkët me veprën penale të sjellë për gjykim. I vetmi element që lidh faktin e ri me veprën penale në gjykim është subjekti, pra i pandehuri.

Në rastin e konstatimit të faktit të ri në gjykim, prokurori duhet të veprojë sipas rregullave të përgjithshme. Fakti i ri ka nevojë për hetim për të identifikuar elementët e veprës penale, lidhjes së saj me të pandehurin, përfshirjen e mundshme të personave të tjerë pjesëmarrës në veprë penale etj. Për faktin e ri penal të konstatuar në gjykim, prokurori nuk ka nevojë të bëjë kërkesë në gjykatë për të tërhequr dosjen penale. Madje vlerësoj se edhe termi “*duke tërhequr dosjen*” i parashikuar nga neni 374 i K.Pr.Penale është i tepërt e mendoj se nuk duhet të jetë pjesë intergrale e kësaj dispozite procedurale.

Në këtë rast prokurori vlerëson se në gjykim ka dalë një fakt i ri në ngarkim të të pandehurit, ai duhet të fillojë procedimin penal. Prokurori duhet t'a ushtrojë këtë veprim në funksion të ushtrimit të ndjekjes penale për çdo fakt penal të parashikuar si të tillë nga ligji penal, kur ndjekja penale duhet të nis kryesisht. Edhe pse ndodhet në gjykim, prokurori nuk kufizohet nga gjykata për të nisur ndjekjen penale ndaj një fakti të ri penal.

Në ndryshim nga situatat e tjera të zakonshme, të regjistrimit të një procedimi penal të ri në prokurori, në rastin e parashikuar nga neni 374 i K.Pr.Penale, fakti i ri penal zbulohet në prani të prokurorit gjatë shqyrtimit gjyqësor. Në këtë rast fakti i ri penal nuk vjen prej burimeve të ndryshme të njoftimit, por ai zbulohet drejtpërdrejtë në gjykimin e një çështjeje penale, në prani të prokurorit.

Me zbulimin e faktit të ri penal ndaj të pandehurit, fakt për të cilin procedohet kryesisht, prokurori vepron sipas rregullave të përgjithshme. Ai merr kopje të të gjitha akteve procedurale të shqyrtuara në gjykim, prej të cilave është zbuluar fakti i ri penal në ngarkim të të pandehurit dhe me këto akte fillon ndjekjen e re penale ndaj të pandehurit. Aktet procedurale të shqyrtuara në gjykatë shërbejnë si pikënisje për regjistrimin e procedimit penal në prokurori e fillimin e hetimeve paraprake, ku personi të cilit i atribuohet fakti penal i ri, është i pandehuri në gjykim për veprën e parë penale.

Në këtë rast kemi dy procedime penale, njëri prej të cilëve është në shqyrtim gjyqësor dhe procedimi i ri penal i nisur për shkak të faktit penal të zbuluar në gjykim ndaj të pandehurit. Pas zbulimit të faktit të ri penal në gjykim, prokurori nuk tërheq të gjithë dosjen penale, që do të thotë se prokurori nuk tërheq edhe aktet të cilat lidhen me veprën e parë penale të sjellë prej tij në gjykim. Vepra e parë penale e sjellë për gjykim duhet të përfundojë së gjykuari pavarësisht

se në shqyrtimin e saj është zbuluar një fakt i ri penal në ngarkim të të pandehurit. Siç e përmendëm edhe më sipër, fakti i ri penal nuk ka lidhje me veprën penale që po gjykohet. Rrjedhimisht vepra e parë penale e sjellë për gjykim ndjek procesin e zakonshëm të gjykimit dhe përfundimit të tij, pa u ndërprerë prej zbulimit të faktit të ri penal në gjykim e pa u ndikuar prej mënyrës sesi prokurori do të procedojë për faktin e ri penal.

Për këtë arsye themi se shprehja që përcakton veprimin e prokurorit “*duke tërhequr dosjen*” është një shprehje që nuk duhet jetë pjesë e formulimit të neni 374 të K.Pr.Penale, për shkak se përdorimi i saj i pavend mund të sjellë tërheqjen e të gjithë dosjes penale të sjellë për gjykim, duke përfshirë edhe veprën penale që është në gjykim. Vepra penale e sjellë për gjykim nuk kalon për hetim me tërheqjen e dosjes penale prej prokurorit. Në situatën e parashikuar nga neni 374 i K.Pr.Penale, nëse prokurori tërheq dosjen për të vazhduar hetimet paraprake, tërheqja e dosjes bëhet vetëm për zbulimin e faktit të ri penal në gjykim. Në këtë rast gjykata vazhdon gjykimin për veprën penale të sjellë më parë për gjykim nga prokurori.

Me qëllim përmirësimit e përmbajtjes së nenit 374 të K.Pr.Penale referuar dhe modelit italian sesi është hartuar dispozita procedurale e “*Faktit të ri penal të dalë në gjykim*”¹³⁶, propozoj rregullimin e fjalisë së parë të nenit 374 të K.Pr.Penale si më poshtë:

Fakti i ri penal i zbuluar në gjykim

“Përtej rasteve të parashikuara nga neni 373 i Kodit të Procedurës Penale, prokurori procedon në format e zakonshme nëse gjatë shqyrtimit gjyqësor në ngarkim të të pandehurit zbulohet një fakt i ri i papërmendur në kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq, për të cilin duhet proceduar kryesisht.”

4.4.3. Marrëveshja për shqyrtimin e faktit të ri në të njëjtën seancë gjyqësore

Një element tjetër shtesë i parashikuar nga neni 374 i K.Pr.Penale është mundësia që i jepet prokurorit për të proceduar në të njëjtën seancë gjyqësore edhe me faktin e ri penal. Në këtë rast prokurori nuk është krejtësisht i lirë të procedojë me në të njëjtën seancë gjyqësore edhe me faktin e ri penal. Pra procedimi i faktit të ri penal në gjykim varet nga vullneti dhe pëlqimi që duhet të jap i pandehuri në seancë si dhe nga elementë që lidhen me shpejtësinë e gjykimit që janë në vlerësim të gjykatës.

Në ndryshim nga neni 373 i K.Pr.Penale sipas të cilit prokurori ishte krejtësisht i lirë për të proceduar në të njëjtën seancë gjyqësore edhe me njoftimin dhe gjykimin e akuzës për një veprë penale të lidhur me atë që është sjellë për gjykim pa u ndikuar nga sjellja e të pandehurit apo gjykatës për këtë veprim, në rastin e parashikuar nga neni 374 të K.Pr.Penale prokurori është i kufizuar në kërkimin e tij për të proceduar në të njëjtën seancë gjyqësore edhe me faktin e ri penal.

Në këtë rast themi se kufizimi i përcaktuar nga neni 374 i K.Pr.Penale është i arsyeshëm për shkak të respektimit të së drejtës së mbrojtjes që duhet të sigurojë i pandehuri ndaj faktit të ri

¹³⁶ Neni 518 i Kodit të Procedurës Penale Italiane

penal që ai mëson në gjykim, si dhe për shkak të respektimit të afatit kohor të arsyeshëm brenda të cilit duhet të gjykohet një çështje penale që është një detyrim të cilin duhet ta realizojë gjykata. Kështu që për të realizuar gjykimin në të njëjtën seancë gjyqësore edhe të faktit të ri penal, prokurori duhet të marrë pëlqimin e të pandehurit dhe lejen e gjykatës.

Pëlqimi i të pandehurit për të proceduar me gjykimin e faktit të ri penal është element i rëndësishëm me pasojë cënimin e vendimit nga gjykata më të larta. Për një fakt të ri penal të zbuluar në gjykim i pandehuri duhet të jap pëlqimin e tij të shprehur qartësisht për tu gjykuar në të njëjtin proces gjyqësor sepse ai pas dhënies së pëlqimit do ti duhet të përgatisë mbrojtjen e tij si për veprën penale të sjellë për gjykim ashtu edhe për faktin e ri penal. Madje mbrojtje për faktin e ri penal do të thotë njohje paraprake me elementet e shkakut dhe të natyrës së akuzës që i referohet fakti i ri penal si dhe me njohjen e të gjitha provave të mbledhura nga prokurori të cilat duhet të shqyrtohen për faktin e ri penal. Për këtë arsye themi se pëlqimi i të pandehurit është i rëndësishëm për të vijuar më tej procedimin edhe me gjykimin e faktit të ri penal në të njëjtën proces gjyqësor.

Gjithësesi edhe pëlqimi i të pandehurit për të proceduar me faktin e ri penal nuk është i mjaftueshëm për prokurorin. Në këtë rast ligji i jep mundësi gjykatës të verifikojë marrëveshjen e arritur midis prokurorit dhe të pandehurit për gjykimin e faktit të ri penal në funksion të shpejtësisë së gjykimit.

Për gjykatën nëse fakti i ri penal është i kompleks që do të thotë se shqyrtimi i tij e vështirëson gjykimin e veprës së parë penale atëherë gjykata mund të mos lejojë gjykimin në të njëjtën seancë gjyqësore të faktit të ri penal pavarësisht marrëveshjes së arritur midis prokurorit edhe të pandehurit. Fakti i ri penal është një fakt kompleks kur për të provuar ekzistencën e tij në gjykim prokurorit do ti duhet të kërkojë për shqyrtim një numër i madh provash, si dëshmitarë, akte ekspertimit, prova të kërkuara me letërporosi nga autoritetet e huaja gjyqësore etj. Përballë kësaj situatë normalisht gjykata mund të refuzojë kërkesën për gjykimin e faktit të ri në të njëjtën seancë gjyqësore për shkak të vështirësisë dhe zvarritjes që ai mund ti shkaktojë procesit gjyqësor në tërësi.

Duke përfunduar trajtimin për faktin e ri themi se gjatë shqyrtimit gjyqësor nëse zbulohet një fakt i ri penal prokurori duhet të veprojë sipas rregullave të përgjithshme që parashikojnë fillimin e ndjekjes penale. Fakti i ri penal duhet ti nënshtrohet verifikimit të tij në fazën e hetimit paraprak dhe më pas nëse rezulton se fakti penal është një vepër penale atëherë prokurori e dergon të pandehurin për herë të dytë në gjykim, tashmë për tu gjykuar për një vepër të re penale.

Përfundim nga rregulli i përmendur më lart është rasti kur fakti i ri penal gjykohet në të njëjtën seancë gjyqësore me veprën penale të sjellë më parë për gjykim. Prokurori mund të kërkojë gjykimin e faktit të ri penal në të njëjtin gjykim, kur në vlerësimin e tij fakti i ri është i qartë, provueshmëria e tij mund të realizohet edhe gjatë gjykimit pa qenë e nevojshme konsumimi i fazës së hetimeve paraprake. Gjithësesi në rastin e fundit, prokurori duhet të veprojë me kërkesë në gjykim, kërkesë për të cilën duhet të japë pëlqimin edhe i pandehuri dhe në këtë mënyrë në seancë gjyqësore mund të arrihet një marrëveshje mes palëve në proces për gjykimin e faktit të ri penal të zbuluar në gjykim.

Marrëveshja e arritur, gjithashtu i nënshtrohet vlerësimit të gjykatës. Nëse gjykata çmon se fakti i ri penal shkakton vështirësi për gjykimin e veprës së parë penale duke zvarritur procesin gjyqësor atëherë fakti i ri penal nuk gjykohet në të njëjtën seancë me veprën penale. Marrëveshja nuk është e detyrueshme për tu zbatuar nga gjykata. Nëse marrëveshja nuk arrihet, atëherë prokurori procedon sipas rregullit të zakonshëm të përmendur më lart.

Më poshtë kam për zgjedhur raste të praktikës gjyqësore që i referohet kuptimit të faktit të ri penal në gjykimin e një çështje penale.

Në vendimin e Gjykatës së Lartë me nr. 610/2007 janë paraqitur faktet e mëposhtme¹³⁷:

“Prokuroria e Rrethit Durres ka derguar për gjykim të gjykuarit R. dhe J. K, me akuzën e vrasjes së mbetur në tentative në bashkepunim dhe arme mbajtjes pa leje.

Sipas organit të akuzës, dy të gjykuarit, vellezer me njëri tjetrin, në datën 11.08.2004 rreth orës 21.00 në shëtitoren e qytetit të Shijakut tek lokali Bar-Kafe “Euro lloti” në një tavolinë përjashta po rrinin shtetasit Sh. N së bashku me dy shokët e tij F. B e K. B duke pirë nga një birrë. Ndërkohë shikojnë që para lokalit në të cilin ato po qëndronin, parkojnë dy makina të cilat drejtoheshin nga të pandehurit R. K. dhe J. K. Nga njëra nga makinat (tip Audi) zbret i pandehuri R. K, i cili fillon të shajë me fjalë ofenduese në drejtim të shtetasit Sh. N. dhe djemve të xhajës së tij dhe duke u kthyer te makina nxjerr prej andej një automatik. Shtetasi Sh. N. i afrohet të pandehurit R. K me qellim që t’i kape armen, po në këtë moment është afruar dhe shtetasi I. N (vella i Sh) dhe ka arritur t’ia ulë armën të pandehurit R, por i pandehuri R ka filluar të shtijë me breshëri dhe nga kjo është plagosur rende në kembën e djathtë shtetasi I. N. Në këtë moment deshmitari F. B arrin t’ia marrë të pandehurit R. K automatikun duke e hedhur në një lulishte atje pranë. Në kohën që ishin duke u përleshur me njëri tjetrin nga makina tjetër del i pandehuri J. K me pistoletë në dorë, duke ja drejtuar Sh. N, por sipas deshmitarëve pistoletën ben shkrepte boshe dhe me pas ja ka drejtuar dhe I. N. Në këtë moment ka nderhyrë përsëri deshmitari F. B, i cili ja ka ulur dorën J. Pas kësaj të dy të pandehurit janë larguar me makinën e të pandehurit J. K, duke e lënë në vendngjarje makinën e të pandehurit R. K.

Gjykata e shkallës së parë Durres, në perfundim të shqyrtimit gjyqësor, ka deklaruar fajtor të gjykuarin R. K, sipas neneve 76-22 e 278/2 të K.Penal dhe të gjykuarin J. K sipas neneve 84 e 278/2 të K.Penal.

Në dhënien e këtij vendimi, gjykata e shkallës së parë ka shkelur dispozitat procedurale që rregullohen nga neni 372 e vijues i K.Pr.Penale.

Dy të gjykuarit, janë akuzuar dhe derguar për gjykim me akuzën se në bashkepunim me njëri tjetrin kanë tentuar të vrasin shtetasin I. N. Me vendimin perfundimtar, gjykata e rrethit, pasi ka krijuar bindjen se dy të gjykuarit nuk kanë bashkepunuar në kryerjen e veprës penale, të gjykuarin R e ka deklaruar fajtor dhe denuar sipas neneve 76-22 dhe 278/2 të K.Penal, ndërsa të gjykuarin J. K, pa i komunikuar ndonjë akuze të re, e ka deklaruar fajtor dhe denuar për veprën penale të kanosjes në dem të shtetasit Sh. N dhe atë të armembajtjes pa leje. Del qarte se kjo është një akuze e re e cila nuk ka lidhje me veprën penale të vrasjes së mbetur në tentative të shtetasit I. N, akuze për të cilën gjykata, duke mos patur kërkesë nga prokurori,

¹³⁷ Vendim i Gjykatës së Lartë me nr. 610 datë 03.10.2007

duhet te vepronte sipas rregullimeve procedurale te parashikuara nga nenet 373 dhe 374 te K.Pr.Penale. Kjo gjykate, me vendimin perfundimtar ka gabuar edhe duke mos i dhene zgjidhje ligjore akuzes ne ngarkim te te gjykuarit J. K per vepren penale te parashikuar nga neni 76-22 e 25 te K.Penal. Duke qene se nga cmuarja e provave sipas percaktimeve te nenit 152 te K.Pr.Penale, gjykata e rrethit ka formuar bindjen se i gjykuari Juljan nuk eshte autor i kesaj vepre, ne zbatim te kerkesave te nenit 388 te K.Pr.Penale duhet te kishte vendosur ta deklaronte ate te pafajshem per kete akuze.

Në shkëlje te dispozitave procedurale penale ka gjykuar ceshtjen edhe Gjykata Apelit Durrës, mbasi ne kuptim te kerkesave te nenit 428/ç te K.Pr.Penale, kur gjykata e shkalles se pare shkel ne gjykim dispozitat per paraqitjen e akuzave te reja, detyrimi ligjor per gjykatën e apelit eshte qe te prishi kete vendim dhe aktet t'i ktheje per rishqyrtim. Nderkohe rezulton se Gjykata e Apelit Durrës, ne kundërshtim me sa siper, ka zhvilluar gjykimin e ceshtjes duke bere keshtu vendimin e saj te cenueshem. Ajo gjykate, jo vetem ka vazhduar gjykimin e ceshtjes, por mbi te njejtat fakte dhe prova dhe pa perseritur shqyrtimin gjyqesor qofte edhe pjeserisht, ka ndryshuar vendimin e gjykates se rrethit duke i dhene faktit nje tjetër cilesim ligjor.

Veç sa sipër gjykatat, duke e akuzuar te gjykuarin J. K edhe per vepren penale te armembajtjes pa leje, kane vepruar ndesh me Vendimin Unikues nr.1, date 03.02.2006 te Kolegjeve te Bashkuara te Gjykates se Larte lidhur me kete ceshtje. Ne rigjykim, duhet te sqarohet nese pistoletë e perdorur nga J. K ka qene ne gjendje teknike per t'u kategorizuar si arme zjarri ose jo, sqarim ky i domosdoshem per te konkluduar rreth ekzistences ose jo te faktit.

Në lidhje me këtë argumentim të dhënë nga gjykata nuk ndaj të njëjtin mendim. Të dy vëllezërit janë akuzuar nga prokuroria për veprën penale të “Vrasjes me dashje” mbetur në tentativë, në bashkëpunim parashikuar nga neni 76-22 dhe 25 të Kodit Penal. Është e qartë që në gjykim gjykata e shkallës së parë pavarësisht se nuk është shprehur me referencën e duhur ligjore ka ndryshuar cilësimit juridik të veprës penale për të cilën ish-in të akuzuar të dy vëllezërit, duke deklaruar fajtor vetëm njëri prej tyre për veprën penale të “Vrasjes me dashje” ndëkohë të pandehur-in tjetër e kanë deklaruar fajtor për veprën penale të “Kanosjes”.

Pavarësisht se gjykata e shkallës së parë mund të ketë gabuar në zbatimin e duhur të nenit 375 të K. Pr. Penale pasi në vendimin e saj përfundimtar ajo duhet të tregonte bazën ligjore se ku ishte mbështetur për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale si dhe të tregonte arsyet se pse ajo e ndryshonte cilësimit juridik, përsëri ky gabim nuk duhet të përliq aryetimin e Gjykatës së Lartë kur thotë se *duke mos patur kerkese nga prokurori, duhet te vepronte sipas rregullimeve procedurale te parashikuara nga nenet 373 dhe 374 te K.Pr.Penale.*

Veprimet e kundërligjshme të dy të pandehurve janë të konstatuara si të tilla që në fazën e hetimit paraprak nga prokuroria. Për secilin prej veprimeve të kryera prej të pandehurve prokuroria ka ngritur akuza përkatëse duke i cilësuar veprimet e tilla si një rast të bashkëpunimit të tyre në veprën penale të “Vrasjes me dashje”. Në këtë kuptim themi se në gjykim nuk është evidentuar asnjë fakti i ri ashtu sic e kërkon neni 374 i K. Pr. Penale dhe rrjedhimisht as prokurori por edhe as gjykata nuk kanë pasur mundësi objektive për të vepruar sipas parashikimit të nenit 374 të K. Pr. Penal.

Pra jo për mënyrën e zgjidhjes së çështjes penale, por vetëm për pjesën e argumentimit të gjykatës ndaj një mendim të ndryshëm për shkak se referuar rastit të mësipërm mendoj se nuk ka pasur vend për zbatimin e nenit 374 të K. Pr. Penale.

Në vendimin nr. 59/2008 të Gjykatës së Lartë është paraqitur fakti i mëposhtëm¹³⁸:

“Se në datë 18.04.2003, rreth orës 19⁰⁰, në repartin ushtarak nr.4410, në fshatin Drenovë të Rrethit Korçë, i gjykuari O. M, ushtar pranë këtij reparti, mbasi është larguar pa leje nga vendi ky kryente detyrën e rojes, është futur në ambientet e banjës te repartit dhe aty, me armen e zjarrit që kishte me vete, ka qelluar, me puqitje ne gjoks, nje here, viktimen I. P, me detyre pergjegjes i nderreses te rojeve dhe me pas ka dale jashte, duke e lene ate te shtrire pertoke.

Dëshmitarët që kanë shkuar menjëherë drejt vendngjarjes, kanë parë jashtë të pandehurin të shqetësuar, të cilit i kanë marrë armën nga dora. Më pas ata kanë transportuar menjëherë viktimën në spital, ku është konstatuar se kishte vdekur.

Sipas akt ekspertimit mjeko-ligjor te dates 19.04.2003, te kryer nga eksperti E. T, i caktuar nga oficeri i policise gjyqesore, ne mjeker dhe ne majen e hundes se viktimes konstatohen dermishje ne ngjyre te kuqe ne kafe, ndersa nga hunda rridhnin sekrecione hemoragjike te shkumbosura.

Sipas te akt-ekspertimit te kryer po me daten 19.04.2003, ne buzen dhe mjekren e viktimes vihen re ekimoza, ndersa xhaketa eshte e shqyer.

I gjykuari, gjate hetimit, ka pranuar kryerjen e vrasjes se viktimes, duke sqaruar se ne momentin e ngjarjes ka kryer keto veprime: eshte nisur drejt banjes duke patur automatikun ne krahu, jo ne siguresse dhe me fisheke ne goje dhe kur ka arritur te hyrja e banjes, e ka hequr ate nga krahu dhe e ka mbajtur me tyte perpara, ne lartesine e gjoksit te viktimes dhe kur arma ka prekur ne te (gjoksin e viktimes) eshte shkrepur me puqitje. Sipas ketyre shpjegimeve te te pandehurit ne fazen e hetimit paraprak eshte kryer dhe eksperimenti hetimor.

Nisur nga motivi i ngjarjes, rrethanat, si dhe vendi i kryerjes se saj, organi i akuzes e ka akuzuar te pandehurin per kryerjen e vepres penale te vrasjes me dashje te ushtarakut, te parashikuar nga neni 77/1 i K.Penal Ushtarak.

Pasi çështja është gjykuar nga Gjykata e shkalles se pare dhe ajo e Apelit Ushtarak dhe i gjykuari eshte gjendur fajtor dhe denuar sipas nenit 77/1 te K.Penal Ushtarak, Kolegji Penal i Gjykates se Larte, me vendimin nr.397, date 08.06.2005 ka prishur vendimin e Gjykates Ushtarake te Apelit Tirane duke e kthyer çështjen per rishqyrtim ne ate gjykate, me tjeter trup gjykues.

Në përfundim të rigjyimit, Gjykata e Apelit Ushtrak e ka deklaruar fajtor dhe denuar te gjykuarin sipas dispozitave te parashikuara nga nenet 78 dhe 41 te K.P.Ushtarak.

Kolegji Penal i Gjykates se Larte duke konstatuar se ne dhenien e ketij vendimi te Gjykates Ushtarake te Apelit kane ndikuar shkelje procedurale te cilat e bejne ate te pavlefshem çmon se ai duhet te prishet dhe çështja te kthehet per rishqyrtim ne po ate gjykate, me tjeter trup gjykues.

Rezulton se organi i akuzes ne kerkesen per gjykim ka kerkuar gjykimin e te gjykuarit per akuzen e “Vrasjes se ushtarakut te kryer me dashje”, te parashikuar nga neni 77/1 te K.Penal Ushtarak. Gjykata Ushtarake e Apelit, ne vendimin perfundimtar, ka ndryshuar cilesimin ligjor

¹³⁸ Vendim i Gjykatës së Lartë me nr. 59 datë 06.02.2008

persa i perket vePRES penale te siperpermendur, duke e deklaruar fajtor te gjykuarin per vePRES penale te "Vrasjes nga pakujdesia", parashikuar nga neni 78 i K.Penal Ushtarak, si dhe e ka deklaruar fajtor dhe per vePRES penale te "Shkeljes se rregullave te sherbimit te rojes".

Edhe neni 374 te K.Pr.Penale ka parashikuar se dhe kur gjate shqyrtimit gjyqesor del nje fakt i ri i pa permendur ne kerkesen per gjykim, eshte prokurori qe procedon duke terhequr dosjen ose kur kerkon, gjykata mund te lejoje shqyrtimin ne te njejten seance nese jep pelqimin i pandehuri. Ne gjykimin e te pandehurit O. M nuk rezulton qe prokurori te kete kerkuar te terheqe dosjen, apo qe ne te njejten seance te vazhdonte shqyrtimi i kesaj akuze dhe as qe i gjykuari te kete dhene pelqimin per kete akuze te re e megjithate, Gjykata Ushtarake e Apelit e ka deklaruar fajtor dhe denuar te gjykuarin sipas nenit 41 te K.P.Ushtarak.

Një tjetër shkelje procedurale që e bën të cënueshëm vendimin e Gjykates Ushtarake te Apelit Tirane eshte se ajo ka gjykuar ne shkelje te detyrimeve qe rrjedhim nga dispozita e nenit 440 te K.Pr.Penale. Gjate rigjykimit te çeshtjes, nga kjo gjykate nuk jane zbatuar detyrat e lena nga Gjykata e Larte me vendimin e saj nr.397 date 08.06.2005. Akti mjeko-ligjor nr.11, date 19.04.2003 dhe i quajhuri akt ekspertize te dates 19.04.2003, nuk i jane nenshtuar shqyrtimit gjyqesor, si dhe nuk jane pyetur nje sere personash dhe pse pyetja e tyre ka qene detyre konkrete e vendimit te Gjykates se Larte. Ne seancen gjyqesore te dates 8.9.2005, gjykata e apelit ka vendosur te perserise shqyrtimin gjyqesor dhe ne kete kuader, ka kerkuar te thirren dhe pyeten ekspertet Enriko Trebicka, Maksi Trojani e Luan Zholi dhe deshmitaret Roland Beqiri, Mareglen Gora, Bujar Bregu, Arben Janaqi, Argent Mejdani, Emiljano Prifti dhe vete i gjykuari. Por pasi ka realizuar pyetjen e mjekut Maksim Trojani dhe deshmitarin Bujar Bregu, gjykata e apelit ka hequr dore nga kryerja e detyrave te tjera te caktuara me vendimin e Kolegjit Penal te Gjykates se Larte, kryerja e te cilave jo vetem ishte detyrim ligjor qe rrjedh nga permbajtja e nenit 440 te K.Pr.Penale, por dhe me shume rendesi per zgjidhjen e drejte te çeshtjes, pasi faktet e paraqitura ne to mund te kene lidhje me rrethanat e ndodhjes se vePRES penale.

Në këtë rast e vlerësoj të drejtë arsyetimin dhe përfundimin e arritur nga Gjykata e Lartë. Në gjykim në gjykatën e Apelit prokuroria kishte kërkuar deklarimin fajtor të të pandehurit vetëm për veprën penale të "Vrasjes së ushtarakut të kryer me dashje" parashikuar nga neni 77/1 i Kodit Penal Ushtarak dhe jo për veprën penale të "Shkeljes së rregullave të shërbimit të rojes" parashikuar nga neni 41 i K.P.Ushtarak. Pavarësisht se nga aktet ka rezultuar se prokuroria kishte nisur hetimin edhe për veprën penale të parashikuar nga neni 41 i K.P.Ushtarak, në përfundim ajo nuk kishte kërkuar në gjykim deklarimin fajtor të të pandehurit për këtë vepër penale.

Rrjedhimisht gjykata kishte shkelur dispozitat procedurale që bëjnë fjalë për akuzat e reja dhe më konkretisht kishte shkelur parashikimet e nenit 375 të K.Pr.Penale. Gjykata e kishte dënuar të pandehurin edhe për një fakt ndaj të cilit prokuroria nuk kishte paraqitur në përfundim akuzë në gjykim. Për sa kohë fakti i shkeljes së rregullave të shërbimit të rojes nuk ishte një fakti i ri penal pasi sic edhe më lart, fillimisht ky fakt ishte i hetuar nga prokuroria si dhe për sa kohë prokuroria nuk kishte proceduar më tej me përfaqësimin në gjykim të akuzës për faktin e ri penal sipas nenit 374 të K.Pr.Penale, atëherë vendimi i gjykatës për ta deklaruar fajtor të pandehurin edhe një fakt i penal të pa shoqëruar me akuzën konkrete që duhet ti njoftohet prej prokurorit të pandehurit përbën shkelje të nenve 374 dhe 375 të K.Pr.Penale. Si rrjedhim

vendimi i dhënë nga gjykata e Apelit në këtë duhej të prishej dhe çështja penale me të drejtë është dërguar për rigjykim në gjykatën e Apelit.

4.5. Të drejtat e mbrojtjes për të pandehurin në raport me akuzat e reja

Në rastet kur prokuori vepron me një nga mjetet e përmendura më sipër në lidhje me akuzat e reja vështirëson pozitën procedurale të të pandehurit në drejtim të mbrojtjes së tij. Nga momenti i njoftimit zyrtar të akuzës prej prokurorit duke përfshirë edhe njoftimin e kërkesës në seancë paraprake deri në zhvillimin e seancës së parë gjyqësore, i pandehuri normalisht ka në dispozicion kohën e mjaftueshme për të ndërtuar mbrojtjen e tij. Në gjykim i pandehuri është i përgatitur për t'u mbrojtur ndaj akuzës së njoftuar prej prokurorit në seancë paraprake.

Në gjykim mund prokurorin mund të veprojë në disa mënyra si përshebull, të ndryshojë akuzën e parë për shkak se fakti nuk është siç ishte fiksuar në kërkesën për gjykim ose i njofton të pandehurit një akuzë të re që ka lidhje me akuzën e parë, ose procedon me njoftimin e të pandehurit mbi akuzën për një fakt të ri penal. Nryshime të tilla ndodhin edhe në fazën e gjykimit, për shkak të natyrës e karakteristikave që përfaqëson akuza. Kur kemi trajtuar akuzën kemi thënë se ajo mbart si veçori të saj paqëndrueshmërinë dhe elasticitetin, të cilat janë më të dukshme në fazën e hetimeve paraprake. Për këto arsye edhe prokurori në gjykim mund të ndodhet përpara situatave të cilat e detyrojnë atë të veprojë me kontestimet e reja, duke transformuar akuzën fillestare të sjellë prej tij në gjykim.

Në të gjitha këto rrethana të pandehurit i dëmtohen interesat e tij që lidhen me mbrojtjen. E sigurtë është që i pandehuri në gjykim nuk do të mbrohet për akuzën fillestare të sjellë nga prokurori, në rastin më të mirë dhe në rastin më të keq, atij do t'i duhet të sigurojë mbrojtjen e tij në gjykim edhe për akuza të tjera të cilat i bëhen prezent në gjykim. Madje në rastet e *Ndryshimit të akuzës (neni 372 i K.Pr.Penale)* dhe *Akuza për një veprë tjetër (neni 373 i K.Pr.Penale)*, prokurori vepron në “mënyrë automatike”¹³⁹, duke u varur vetëm nga aktiviteti i tij si subjekt që ushtron ndjekjen penale. Në këtë rast prokurorit nuk i nevojitet marrja e pëlqimit prej të pandehurit apo vendimi i gjykatës për të proceduar sipas rasteve të mësipërme.

Situata është më e favorshme për të pandehurin në rastin e parashikuar nga neni 374 i K.Pr.Penale. Në këtë rast prokurori nuk mund të intergrojë faktin e ri penal me gjykimin e veprës penale në të njëjtën seancë gjyqësore, pa marrë më parë pëlqimin e të pandehurit e autorizimin e gjykatës për të proceduar më tej. Në rastin e fundit të parashikuar nga neni 374 i K.Pr.Penale, pozita e të pandehurit është mbrojtur në raport me akuzën për shkak se është i pandehuri ai që vendos nëse dëshiron të procedojë në të njëjtën seancë gjyqësore me integrimin e faktit të ri në raport me veprën penale të sjellë për gjykim.

Pa pëlqimin e të pandehurit prokurori nuk vepron më tej. Për të vijuar më tej, situata mund të vështirësohet për prokurorin kur gjykimi i çështjes penale të nisur, bëhet në mungesë të të pandehurit “*in absentia*”. Me zhvillimin e gjykimit në mungesë të të pandehurit, prokurori e

¹³⁹ Monteleone Andrea, “Modifica dell'imputazione”, “Principio del contraddittorio e nuove contestazioni tra interpretazione funzionale e tutela del diritto di difesa”, gjendet në adresën www.archiviopenale.it

ka të pamundur të procedojë me njoftimin e akuzës për një fakti të ri penal në të njëjtën seancë gjyqësore ku zhvillohet gjykimi i veprës së parë penale. Në situatën e fundit, prokurorit do t'i duhet të procedojë sipas rregullave të zakonshme. Për faktin e ri penal prokurori duhet të nis hetimin si për çdo rast tjetër të zakonshëm.

Të drejtat e të pandehurit në raport me akuzat e reja janë parashikuar nga neni 376 i K.Pr.Penale. Më konkretisht neni 376 i K.Pr.Penale duke përfshirë dhe ndryshimet e reja, që bëjnë fjalë për të drejtat e palëve parashikon se:

- “1. Në rastet e parashikuara nga nenet 372, 373, 374 dhe 375 kryetari i bën të ditur të pandehurit se mund të kërkojë një afat për mbrojtjen. Kur i pandehuri kërkon afat, kryetari ndërpret shqyrtimin gjyqësor për një kohë të përshtatshme, por jo më shumë se dhjetë ditë. Edhe palët e tjera mund të kërkojnë marrjen e provave të reja.*
- 2. Kryetari urdhëron thirrjen e të dëmtuarit, duke respektuar një afat jo më të vogël se pesë ditë.*
- 3. Kur i pandehuri gjykohet në mungesë, sipas neneve 351 dhe 352 të këtij Kodi, prokurori i kërkon gjykatës që akuzat e re të përfshihen në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor dhe që ekstrati i procesverbalit t'i njoftohet të pandehurit. Në këtë rast kryetari ndërpret shqyrtimin gjyqësor dhe cakton një seancë të re, duke respektuar afatet e treguara në paragrafin 1.”*

Sipas parashikimit të mësipërm, me gjithë ndryshimet që mund të pësojë procesi gjyqësor në raport me akuzat, të pandehurit i njihen disa të drejta procedurale që janë në funksion të mbrojtjes së tij. Të drejtat procedurale lidhen me kohëv e nevojshme që gjykata duhet t'i lejojë të pandehurit për përgatitjen e mbrojtjes së tij në raport me akuzat e reja e ndërprerjen e shqyrtimit gjyqësor me qëllim përgatitjen e mbrojtjes.

Pra dispozita e sipërpërmur merr një rëndësi të madhe referuar dhe aspektit kushtetues, pasi në të gjejmë të pasqyruar dy parime të rëndësishme që janë *parimi i kontradiktoritetit dhe parimi i mbrojtjes*.

Kjo do të thotë se fillimisht i pandehuri ka mundësi të kundërshtojë në gjykim kontestimet e reja dhe për të realizuar këtë të drejtë, i pandehuri mund të paraqesë prova të reja të cilat i shërbejnë atij për të kundërshtuar situatën e re të paraqitur nga prokurori në seancë gjyqësore.

Në lidhje me parimin e kontradiktoritetit Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj tashmë të konsoliduar ka interpretuar kuptimin kushtetues të këtij parimi. Kështu në vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 50/2012 në lidhje me interpretimin e këtij parimi gjykata shprehet se¹⁴⁰:

“...Gjykata ka trajtuar në mënyrë të vazhdueshme rëndësinë e respektimit të parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit veçanërisht në gjykimin penal, duke theksuar se këto parime, dhe lidhur ngushtë me to mbrojtja e të pandehurit, e garantuar shprehimisht në nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përbëjnë në vetvete elementet më të qenësishëm e thelbësore të procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues. Gjykata rithekson se parimi i kontradiktoritetit dhe i barazisë së armëve në gjykimin penal kërkon që argumentet e mbrojtjes të paraqiten dhe të dëgjohen njëjloj si ato të prokurorit. Ky

¹⁴⁰ Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 50 datë 01.11.2012

parim presupozon që, secilës palë duhet t'i ofrohen mundësi të arsyeshme për të paraqitur pretendimet për çështjen, në kushte të tilla që të mos e venë në disavantazh me palën tjetër (shih vendimin nr.5, datë 17.02.2003 të Gjykatës Kushtetuese). Për respektimin e këtyre parimeve gjykatat duhet të përmbushin me rigorozitet një sërë detyrimesh, mes të cilave rëndësi të veçantë paraqet, sipas rastit, edhe njoftimi i të pandehurit apo mbrojtësit të tij ligjor për akuzën, ankimin, rekursin, ditën dhe vendin e gjykimit të çështjes etj. Synim kryesor është realizimi i një debati real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, gjë që ndikon pozitivisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e së vërtetës dhe dhënien e drejtësisë nga gjykatat, me objektivitet e paanësi. Këto kërkesa kushtetuese e ligjore janë në funksion të mbrojtjes sa më efektive të të pandehurit, pasi përballë tij qëndron vetë shteti, i përfaqësuar në procesin penal nga prokurori që paraqet dhe mbron akuzën kundër tij. Është detyrë e shtetit që të marrë masat e duhura për të garantuar pjesëmarrjen në procesin penal të personit të akuzuar ose mbrojtësit ligjor, qoftë edhe atij të caktuar kryesisht (shih vendimet nr.23, datë 13.10.2005; nr.24, datë 26.10.2005; nr.16, datë 08.06.2006; nr.13, datë 21.07.2008; nr.19, datë 18.09.2008; nr.10, datë 02.04.2009; nr.16, datë 15.06.2009; nr.25, datë 10.06.2011; nr.4, datë 10.02.2012 të Gjykatës Kushtetuese).

Në lidhje me paraqitjen dhe administrimin e provave në gjykim, në kuptim të parimit të barazisë së armëve, Gjykata mban qëndrimin se provat paraqiten dhe marrin vlerën e tyre në debatin gjyqësor, ku secila palë ka mundësi për të paraqitur argumentet e veta në një pozitë jo më pak të favorshme se pala tjetër (shih vendimet nr.19, datë 18.09.2008; nr.7, datë 27.04.2005; nr.16, datë 27.03.2012 të Gjykatës Kushtetuese). Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se marrja dhe vlerësimi i fakteve dhe i rrethanave, interpretimi i ligjit material dhe procedural dhe aplikimi i tij në çështjet konkrete janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Për sa i përket mënyrës se si janë interpretuar dhe vlerësuar provat nga gjykatat e zakonshme, kjo çështje nuk përbën objekt kontrolli për këtë Gjykatë, sepse ajo mund dhe duhet të investohet kur ndaj një procesi gjyqësor ka pretendime për mënyrat e marrjes së provave, por jo për mënyrën e vlerësimit të tyre. Gjykata ndërhyr vetëm në ato raste kur përmes veprimeve të tyre, gjykatat e zakonshme cenojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Pra, si rregull, është kompetencë e gjykatave të zakonshme të vlerësojnë provat e paraqitura (administruara) në gjykim, ndërsa Gjykatës Kushtetuese i takon të vlerësojë nëse procedurat, në tërësinë e tyre, kanë qenë të drejta, që në rastin e proceseve penale ky vlerësim përfshin edhe respektimin e parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit... ”¹⁴¹.

Pra parimin e kontradiktoritetit e gjejmë të përfshirë në nenin 376 të K.Pr.Penale në pjesën ku kjo dispozitë i njeh të drejtën të pandehurit të paraqesë prova të reja në gjykim, pasi të njihet e të kuptojë qartësisht ndryshimet e reja që kanë ndodhur në procesin penal në drejtim të modifikimit të akuzës apo plotësimit ose shtimit të saj me një akuzë tjetër. Në të njëjtën frymë kjo dispozitë i njeh të pandehurit dhe të drejtën për të përgatitur mbrojtjen. E drejta për të përgatitur mbrojtjen është e lidhur ngushtë me parimin e kontradiktoritetit dhe sidomos në procesin penal ato nuk mund të ndahen nga njëra tjetra.

¹⁴¹ Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 50 datë 1. 11. 2012

Neni 376 i K.Pr.Penale garanton parimin e së drejtës së mbrojtjes së të pandehurit nisur nga fakti se të pandehurit i jepet koha e nevojshme për të përgatitur mbrojtjen duke ndërprerë shqyrtimin gjyqësor.

4.5.1. Të drejtat e të pandehurit në gjykimet alternative në raport me akuzat e reja

Një problem që mund të çenojë të drejtën e mbrojtjes së të pandehurit gjatë gjykimit të akuzave të reja është mos ushtrimi prej tij i disa të drejtave që lidhen me gjykimet alternative, që si qëllim të tyre kanë efektivitetin dhe shpejtësinë e gjykimit nga njëra anë dhe përfitimin nga ana tjetër e disa të drejtave në raport me dënimin për veprën penale që merr i pandehuri si pasojë e arritjes së marrëveshjes që ai bën me organin procedures.

Në Kodin e Procedurës Penale në ndryshimet e reja parashikohen si gjykime alternative gjykimi i drejtpërdrejtë, gjykimi për miratimin e urdhrit penal, gjykimi me marrëveshje si dhe gjykimi i shkurtuar.

Për nevoja të këtij punimi po ndalemi në rastet e Gjykimit me marrëveshje dhe Gjykimit të shkurtuar, pasi në këto gjykime rastet e cënimit të së drejtës së të pandehurit për të kërkuar procedimin në një gjykim alternativ, mund të jetë më i dukshëm e njëkohësisht mund të sjellë pasojë të rënda për të pandehurin jo për faj të tij.

Nevojën për të trajtuar dhe këtë aspekt si pjesë të punimit e kemi marrë nga dy vendime të dhëna nga Gjykata Kushtetuese italiane, e cila ka sanksionuar në vendimet e saj nr. 333/2009¹⁴², nr. 265/1994¹⁴³, antikushtetueshmërinë e nenit 516 të K.Pr.Penale të Italisë për pjesën në të cilën nuk parashikohej e drejta e të pandehurit për t'i kërkuar gjykatës së themelit gjykimin e shkurtuar për rastin kur fakti del ndryshe në gjykim nga ai që ishte përshkuar në kërkesën për gjykim dhe ndryshimi i akuzës i bërë nga prokurori i përkiste faktit që ishte konstatuar si i tillë nga aktet e hetimit paraprak. Në të njëjtën mënyrë Gjykata Kushtetuese e Italisë ndër të tjera është shprehur mbi nenin 516 të K.Pr.Penale, ku në gjykim të pandehurit duhet t'i njihet e drejta nga gjykata për të kërkuar zbatimin e marrëveshjes për caktimin e masës së dënimit sipas nenit 444 të K.Pr.Penale të Italisë.

I nxitur nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese të Italisë mund të serviret një shembull në të cilin shfaqen problemet që ka sistemi ynë procedural, në funksion të cënimit të së drejtës së të pandehurit për të pasur akses në gjykatë në lidhje me përzgjedhjen prej tij të një prej formave të gjykimit alternativ. Të pandehurit jo për fajin e tij, por për “faj” të prokurorit i cënohet e drejta e aksesit në gjykatë për të përfituar prej gjykimit të shkurtuar ose gjykimit me marrëveshje.

Më konkretisht në një rast hipotetik mund të ndodh që një person merret me cilësinë e të pandehurit për veprën penale të “*Vrasjes së punonjësit të policisë së shteti*” mbetur në tentativë parashikuar nga neni 79/b e 22 të Kodit Penal ku parashikohet një dënim me jo më pak se 30 vjet burgim ose burgim të përjetshëm. Gjatë fazës së hetimit paraprak i pandehuri deklaroi se me veprimin e tij nuk ka dashur të vrasë punonjësin e policisë, por ka dashur vetëm ta

¹⁴² Vendim i Gjykatës Kushtetues Italiane nr. 333 datë 14 dhjetor 2009

¹⁴³ Vendim i Gjykatës Kushtetues Italiane nr. 265 datë 30 qershor 1994

kundërshtojë duke përdorur dhunën fizike ndaj punonjësit të policisë që ai të mos kryej detyrën. Gjatë hetimit, si rezultat i dhunës së ushtruar nga i pandehuri, punonjësi i policisë ka pësuar dëmtime në gjymtyrët e sipërme e të poshtme të tij, të cilat futen në kategorinë e plagosjes së lehtë.

Në seancë paraprake gjyqtari konfirmon akuzën e ngritur nga prokurori dhe vendos dërgimin e çështjes për gjykim. Për sa kohë gjatë hetimit nuk arrihet marrëveshja për gjykim mes prokurorit dhe të pandehurit, për shkak akuza e ngritur parashikon një vepër penale që përmban një dënim me burgim mbi 7 vjet, kusht i kërkuar nga neni 406/d paragrafi 2 i K.Pr.Penale të ndryshuar, si dhe për sa kohë i pandehuri nuk mund të kërkojë as gjykim të shkurtuar, pasi në bazë të nenit 402 paragrafi 2 të K.Pr.Penale të ndryshuar, nuk mund të kërkohet gjykim i shkurtuar për veprat penale që parashikojnë dënim me burgim të përjetshëm, çështja penale do të shkojë për gjykim sipas rregullave të gjyqimit të zakonshëm.

Gjatë procesit gjyqësor referuar debatit mbi provat, prokurori bazuar në nenin 372 të K.Pr.Penale ndryshon akuzën ndaj të pandehurit për shkak se fakti në gjykim del ndryshe nga ai që ishte përcaktuar në kërkesën për dërgimin e çështje për gjykim. Akuza e ndryshuar për të pandehurin tashmë është ajo e “*Kundërshtimit të punonjësit të rendit publik*” e kryer në rrethanën cilësuese të ushtrimit të dhunës fizike, parashikuar nga neni 236 paragrafi 2 i K.Penal që përmban një dënim deri në 7 vjet burgim. Në këtë rast me ndryshimin e akuzës prokurori pajtohet me qëndrimin e të pandehurit, i cili e ka bërë të ditur që në hetim se ai me veprimet e dhunës së ushtruar ndaj punonjësit të policisë nuk ka dashur t’ a vrasë, por vetëm t’ a kundërshtoj në ushtrimin e detyrës.

Akuza e ndryshuar në gjykim plotësonte të gjitha kushtet që parashikoheshin nga gjykimet alternative të gjyqimit me marrëveshje dhe gjyqimit të shkurtuar. Të pandehurit në gjykim padrejtësisht i privohet e drejta për të kërkuar procedimin penal sipas gjykimeve alternative.

Në rastin e sipërpërmendur, përgjegjësia për refuzimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar rëndon mbi prokurorinë. Rrjedhimisht nuk do të ishte e drejtë që të pandehurit t’ i refuzohej për shkak të ligjit kërkesa për gjykim alternativ për shkak të “gabimeve” të bëra nga prokurori në fazën e hetimit paraprak, parë kjo në drejtim të hartimit jo në mënyrën e duhur të akteve procedurale apo në drejtim të formulimit jo të saktë të akuzës.

Në këtë rast i pandehuri mund të ndodhej në një situatë të pasigurtë, pasi nga njëra anë ligji i njej atij të drejtën të kërkojë një prej formave të gjykimeve alternative duke hequr dorë nga një sërë të drejtash kushtetuese siç janë marrja e provave, kontradiktoriteti në funksion të përfitimit të uljes së dënimit e nga ana tjetër, kërkesa e tij mund t’ i refuzohet për shkaqe që lidhen me “difektet” e hetimit të kryer nga prokurori¹⁴⁴.

Në këtë mënyrë e drejta që gëzon i pandehuri për të kërkuar gjykim të shkurtuar ose gjykimin me marrëveshje në rrethanat e përmendura më lart, shndërrohet në një mjet jo efektiv.

Nëse i referohemi jurisprudencës së Gjykatës së Lartë e asaj Kushtetuese mbi gjykimin e shkurtuar referuar nenit 404 të K.Pr.Penale që rregullon vendimmarrjen e gjykatës për gjykimin e shkurtuar me gjendjen e akteve procedurale të sjella për gjykim, në vetvete kjo dispozitë në

¹⁴⁴ Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 14 datë 26.03.2012

rastet e përmendura më sipër, përbën një kufizim të ushtrimit efektiv të së drejtës së të pandehurit për të kërkuar gjykim të shkurtuar.

Duke pasur parasysh efektet që sjell gjykimi i shkurtuar përsa i përket ekonomisë gjyqësore dhe veçanërisht masës së dënimit, vlerësohet domosdoshmëria e shmangies së kufizimeve të parashikuara nga neni 404 i K.Pr.Penale mbi të drejtën e gjykimit të shkurtuar, duke hequr pengesat ligjore që refuzojnë këtë lloj gjykimi pa fajin e të pandehurit. Zgjedhja e gjykimit të shkurtuar, si e drejtë procedurale ndikon drejtpërdrejtë në përcaktimin e dënimit, i cili ulet me një të tretën nëse procedohet me gjykim të shkurtuar.

Në këtë rast kemi të bëjmë me një aspekt të së drejtës materiale që zbatohet nëpërmjet të drejtës procedurale mbi avancimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar ose në rastin tjetër për gjykimin me marrëveshje. Në rastet e përmendura më lart, për arsye se gjykimi në shkallë të parë mund të zhvillohet me ritin e zakonshëm të gjykimit për shkak të “gjendjes difektoze” të akteve të sjella nga prokurori, i pandehuri (jo për fajin e tij) nuk përfiton nga ulja e dënimit.

Mohimi i së drejtës për të përfituar ulje dënimi si pasojë e mohimit të një gjykimi alternativ për “defekte” që lidhen me hartimin e akuzës, praktikisht i ka mohuar të pandehurit të drejtën për t’iu drejtuar gjykatës.

E drejta për t’iu drejtuar gjykatës (*aksesi në gjykatë*) është një e drejtë themelore për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 6 i Konventës Evropiane për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut por dhe një e drejtë kushtetuese eparashikuar nga neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë¹⁴⁵.

Në këtë rast mendoj se ka vend të reflektohet mbi përmirësimin e nenit 372 të K.Pr.Penale, duke i dhënë mundësinë të pandehurit që pas ndryshimit të akuzës së bërë nga prokurori në gjykim, t’i njihet e drejta nga gjykata për të kërkuar gjykim me marrëveshje ose gjykimin e shkurtuar për akuzën e ndryshuar.

4.6. Akuzat e reja dhe gjykimi në apel

Një pyetje që mund të shtrohet për diskutim është a mundet prokurori në gjykimin në apel, të procedojë me një nga format e zbatimit të akuzave të reja?

Vlerësoj se çështja është më e thjeshtë po t’i referohemi rasteve të akuzës për një vepër penale tjetër, të parashikuar nga neni 373 i K.Pr.Penale dhe rastit të akuzës për një fakt të ri, të parashikuar nga neni 374 i K. Pr. Penale.

Në gjykimin në apel, pavarësisht faktit nëse gjykimi zhvillohet mbi bazën e ankimit të bërë nga i pandehuri apo nga prokurori, nuk mund të procedohet me njoftimin e akuzës për një vepër penale të lidhur. Arsyeja besoj se lidhet me shkallën në të cilën ndodhet procedimi penal, si dhe me natyrën e gjykimit në apel. Njoftimi i akuzës së re në apel kundrejt të pandehurit për një vepër penale të lidhur me atë që po shqyrohet e vendos të pandehurin në një situatë të vështirë e të pabarabartë procedurale.

¹⁴⁵ Kurushi Klodian, “Abbreviated Trial” Mediterranean Journal of social sciences Vol 7, nr. 3 faqe 235

Së pari, të pandehurit me njoftimin e akuzës për veprën penale të lidhur në gjykatën e apelit, i mohohet një shkallë gjykimi i akuzës së re, për shkak se akuza e re do të shqyrtohet në gjykatën e apelit për herë të parë. Kodi ynë i Procedurës Penale nuk i njeh të drejtën gjykatës së apelit të gjykojë akuzat e sjella për gjykim nga prokurori. Gjykata e apelit shqyrton ankimin e palëve në proces për vendimin e dhënë nga gjykata e shkallës së parë. Njoftimi i akuzës së re në apel prej prokurorit për një vepër penale të lidhur, do të thotë që gjykata e apelit të shprehet në vendimin e saj edhe për akuzën e re, e cila në rast pranimit prej gjykatës së apelit nuk do t'i jepte mundësi të pandehurit të ankimonte në një gjykatë më të lartë fakti vendimin e gjykatës së apelit në lidhje me dënimin për akuzën e shtuar.

Pra nëse procedohet me akuzën për një vepër penale tjetër në gjykatën e apelit, gjykimi i akuzës së shtuar do të jetë vetëm në një shkallë gjykimi dhe të pandehurit do t'i mohohet në këtë mënyrë e drejta për ta ankimuar këtë vendim për çështje fakti.

Nga ana tjetër i pandehuri do të vendosej në një pozitë të pabarabartë në trajtimin e akuzave nga organi procedues. Megjithëse akuzat lidhen me vepra penale që përfshihen në konkurrimin ideal të tyre, ashtu siç e kërkon neni 373 i K.Pr.Penale, për një vepër penale të pandehurit i njihet e drejta e shterimit të plotë të mjeteve të mbrojtjes së tij, ndërsa për veprën tjetër penale që buron nga i njëjti veprim i vetëm kriminal, të pandehurit nuk i njihet e drejta të shterojë të gjitha mjetet e mbrojtjes kur prokurori i njofton akuzën e dytë gjatë gjykimit në apel të çështjes ardhur me ankim nga palët.

E njëjta situatë vlen dhe për rastin e parashikuar nga neni 374 i K.Pr.Penale. Nëse në apel prokurori konstaton një fakt të ri penal që normalisht nuk ka lidhje me veprën penale që shqyrtohet në apel, prokurori për faktin e ri penal vepron ashtu siç duhet të veprojë në një rast të ngjashëm në gjykimin në shkallë të parë. Për faktin e ri penal të konstatuar në apel, prokurori i apelit mbi bazën e akteve të shqyrtuara në gjykatën e apelit, referon në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë, me qëllim regjistrimin e një procedimi të ri penal nga ana e prokurorisë.

Problemi vështirësohet në rastin e ndryshimit të akuzës të parashikuar nga neni 372 i K.Pr.Penale, kur ndryshimi i akuzës kërkon t'a realizojë prokurori pranë gjykatës së apelit. A mundet prokurori i apelit që në zbatim të nenit 372 të K.Pr.Penale të operojë me ndryshimin e akuzës?

Në lidhje me çështjen e mësipërme vetë norma në fjalë nuk ofron parametra juridik me karakter interpretues e për pasojë zgjidhja e saj bëhet në raport me rregullat e përgjithshme të zhvillimit të gjykimit.

Kështu në vendimin nr. 633/2001, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë shprehet se¹⁴⁶:

“Në lidhje me rrethanat e faktit në të cilat është zhvilluar ngjarja dhe për të cilat është deklaruar fajtor e dënuar i pandehuri A.D, për krimin e shpërdorimit të detyrës nga ushtaraku, parashikuar nga neni 70 i Kodit Penal Ushtarak, Gjykata Ushtarake e Apelit, ka pranuar se, ai, duke qenë me detyrën e komandantit të një n/reparti në Repartin e Gadishmërisë, Tiranë, së bashku me efektivin e komanduar prej tij, më 17.05.2001, ka ushtruar kontroll në disa banesa në “Bllokun e Ri”, Selitë (Tiranë), gjatë të cilit, përveç të tjerave, ka marrë edhe një automatik në banesën e shtetasit S.C., pa përpiluar dokumentacionin përkatës që diktohej nga kërkesat e

¹⁴⁶ Vendim i Gjykatës së Lartë nr. 633 datë 14.11.2001

përmbushjes së rregullt të detyrës që ishte duke kryer, gjë që solli si pasojë, humbjen e kësaj arme. Ka pranuar, gjithashtu, se kjo armë i qe dhënë shtetasit S.C. me leje, pasi ai ishte me detyrën e policit në repartin e policisë që ishte ngarkuar me detyrën e ruajtjes së Parkut të Ministrisë së Brendshme.

Në përfundim, duke konsideruar të provuar faktin se ngjarja ka ndodhur në rrethanat e përshkruara më lart, nga ana e Gjykatës Ushtarake të Apelit, është pranuar e drejtë kërkesa e prokurorit që mori pjesë në gjykimin e çështjes në këtë gjykatë, për ndryshimin e akuzës në ngarkim të të pandehurit A, nga neni 55/I, në nenin 70 të Kodit Penal Ushtarak.

Nga shqyrtimi i procesverbalit mbajtur gjatë gjykimin në shkallë të dytë, rezulton se, prokurori që ka marrë pjesë në këtë fazë të gjykimin të kësaj çështjeje, në zbatim të kërkesave të nenit 372 të K.Pr.Penale, në seancën gjyqësore të datës 17.05.2001, ka kërkuar që vepra penale për të cilën akuzohet i pandehuri të cilesohet me paragrafin e parë të nenit 70 të Kodit Penal Ushtarak, kurse në seancën gjyqësore të datës 25.05.2001, e cila është edhe seanca e fundit zhvilluar për gjykimin e kësaj çështjeje, në përfundim të së cilës u dha edhe vendimi përfundimtar, po nga ana e prokurorit, u kërkuar saktësim i akuzës nga paragrafi i parë në paragrafin e dytë të po kësaj dispozite.

Duke shqyrtuar çështjen në tërësi, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, arriti në përfundimin se, ndërsa në lidhje me kërkesën e prokurorit për ndryshimin e akuzës nga neni 55/I në nenin 70/I të Kodit Penal Ushtarak, bërë në seancën gjyqësore datë 17.05.2001, gjykata procedoi në përputhje me kërkesat e pikës 3 të nenit 376 të K.Pr.Penale, pasi akuzën e ndryshuar e përfshin në procesverbalin e kësaj seance dhe i'a komunikoi mbrojtësit që përfaqësonte të pandehurin, i cili gjykohej në mungesë dhe mbas kësaj, ndërpreu shqyrtimin gjyqësor, duke caktuar vazhdimin e gjykimin në një seancë të re, datë 25.05.2001 (brenda afatit 10 ditore që parashikohet në dispozitën e përmendur), në lidhje me pranimin e kërkesës së prokurorit bërë në seancën pasuese, (datë 25.05.2001) për saktësimin e akuzës, gabimisht, ajo procedoi deri në përfundimin e hetimit gjyqësor dhe dhënien e vendimit përfundimtar po brenda kësaj seance.

Ky kolegji çmon se, duke vepruar në këtë mënyrë, gjykata e apelit ka vepruar në kundërshtim me atë çka urdhërohet në pikën 3 të nenit 376 të K.Pr.Penale. Kjo për faktin se, siç del nga vetpërmbajtja e dispozitës së nenit 70 të K.P. Ushtarak, pranimi i kërkesës së re të prokurorit në këtë seancë, efektivisht, solli rëndim të pozitës procedurale të të pandehurit A.D, pasi gjykata duhej të kishte marrë parasysh faktin se, duke pranuar kërkesën për cilësimin e veprës me paragrafin e dytë të kësaj dispozite, nuk bëhet fjalë më për figurën e thjeshtë të krimin të shpërdorimit të detyrës nga ushtaraku, por për figurën e cilësuar të këtij krimi, kërkesë kjo, e cila sigurisht që përbën një akuzë të re në ngarkim të këtij të pandehuri dhe për të cilën, nga ana e Gjykatës së Apelit Ushtarak, duhej të ishin zbatuar përsëri kërkesat e dispozitës procedurale përmendur në paragrafin e mëparshëm të këtij vendimi. Vetëm në këtë mënyrë, këtij të pandehuri, do t'i krijoheshin kushtet e nevojshme për të ushtruar realisht të drejtën e mbrojtjes që i është garantuar në Kushtetutë dhe nga një seri dispozitash të Kodit të Procedurës Penale...”

Mbështetur në argumentin e dhënë nga Gjykata e Lartë rezulton se prokurori i apelit mund të procedojë si prokurori pranë gjykatës së shkallës së parë duke ndryshuar akuzën në apel, si pjesë e ushtrimin të funksionit të tij procedural të ndjekjes penale dhe përfaqësimit të akuzës në gjykim.

Në referim të vendimit të mësipërm rezulton se ndryshimi i akuzës mund të bëhet edhe gjatë gjykimit në apel. Qëndrimi se dhe prokurori i apelit mund të disponojë me ndryshimin e akuzës, krahas praktikës gjyqësore, përkrahet dhe nga një pjesë e doktrinës, e cila shprehet se “*disponimi për ndryshim akuze ishte bërë nga prokurori i apelit ushtarak, ç’ka tregon që disponimi i ndryshimit të akuzës nuk është atribut vetëm i prokurorit të shkallës së parë, por mjafton që të ketë fazë të shqyrtimit gjyqësor, pasi edhe Gjykata e Apelit Ushtarak, duke qënë gjykatë fakti, ka fazë të shqyrtimit gjyqësor, ku përsërit pjesërisht apo tërësisht shqyrtimin gjyqësor e si rrjedhim prokurori pranë kësaj shkalle mund të disponojë me një kërkesë të tillë*¹⁴⁷.

Lidhur me këtë çështje mendoj se Gjykata e Lartë ka trajtuar në mënyrë literale, pa diskutuar në detaje problemet që mund të lindin në rastin e njoftimit të akuzës nga prokurori i apelit.

Përpos shkeljeve të evidentuara, gjykata duhej të vlerësonte raportin e akuzës së komunikuar nga prokurori në apel dhe natyrën e pozicionit të prokurorit të apelit në raport me vendimin përfundimtar të gjyktës së shkallës së parë.

Në kapitujt e mëparshëm trajtuam natyrën e akuzës në fazën e hetimit deri në dhënien e vendimit nga gjykata e shkallës së parë, e cila ishte e paqëndrueshme. Akuza fiton qëndrueshmërinë e saj me vendimin që jep gjykata e shkallës së parë, dhe gjëndja e “ngurtësisë” vazhdon deri në dhënien e vendimit nga gjykata e apelit. Pra thënë më thjeshtë, prokurori i apelit nuk mund të ndryshojë akuzën kur për akuzën është shprehur gjykata e shkallës së parë me vendimin e saj përfundimtar të zgjidhjes së çështjes në themel.

Në këtë kuptim mendoj se prokurori i apelit nuk mund të ndryshojë akuzën gjatë gjykimit në apel, akuzë e cila ka fituar një stabilitet nga ekzistenca e vendimit gjyqësor. Për më tepër objekti i shqyrtimit në gjykatën e apelit është ankimi i prokurorit dhe i të pandehurit mbi vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Nëse do të lejohej prokurori i apelit të ndryshonte akuzën në apel, sipas nenit 372 të K.Pr.Penale atëherë i pandehuri do të vihej përpara një situatë që do t’i reduktonin në minimum të drejtat e mbrojtjes së tij, për shkak se i pandehuri tashmë do të duhej të mbrohej jo vetëm nga vendimi i gjykatës së shkallës së parë i cili sipas tij mund të jetë i padrejtë, por edhe nga ndryshimi i akuzës së bërë nga prokurori në apel.

Nëse do të legjitimonim prokurorin e apelit për të ndryshuar akuzën në apel, atëherë do të duhej të pranohet se ndryshimi i akuzës në apel si veprim procedural “zhvleftëson” vendimin e dhënë nga gjykata e shkallës së parë. Ky përfundim nuk është i vërtetë, pasi vendimi i gjykatës së shkallës së parë mund çënohet vetëm nga një vendim gjyqësor i nxjerrë nga një gjykatë më e lartë kompetente. Vendimi i gjykatës së shkallës së parë “zhvleftëson” akuzën e prokurorit dhe në gjykatën e apelit, si prokurori ashtu dhe i pandehuri, objekt të kundërshtimit të tyre kanë vetëm vendimin e dhënë nga gjykata e shkallës së parë.

¹⁴⁷ Ganaj Françesk. “Akuzat penale në procesin penal dhe garancitë e të pandehurit”, temë e prezantuar si pjesë e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, Mars 2017, faqe 33, që referon në “Disertacion për mbrojtjen e gradës shkencore doktor “*Aplikimi i dënimeve alternative dhe akuzat e reja në procesin penal*”, Admir Belishta, faqe 159 paragrafi 4, Tiranë 2015

Në këtë kuptim mendoj se si në rastet e parashikuara nga nenet 373, 374 të K.Pr.Penale dhe në rastin e parashikuar nga neni 372 i K.Pr.Penale prokurori pranë gjykatës së apelit, nuk mund të procedojë me ndyshimin e akuzës në gjykimin në apel.

4.7. Tërheqja e akuzës prej prokurorit sipas nenit 377 të K.Pr.Penale

Me ushtrimin e ndjekjes penale nga prokurori duhet të kuptojmë jo vetëm fazën e hetimeve paraprake, ku prokurori me regjistrimin e procedimit penal kryen të gjitha veprimet procedurale të lejuara nga ligji procedural por gjithashtu dhe fazën e përfaqësimit të akuzës në gjykim. Pra ndjekja penale për të pandehurin vazhdon prej prokurorit në formën e përfaqësimit të akuzës në gjykim.

Pasqyrimin më të plotë të vazhdimin të ndjekjes penale prej prokurorit ndaj të pandehurit në gjykim e paraqiste neni 377 i K.Pr.Penale përpara ndryshimeve të Ligjit nr.35/2017, sipas të cilit prokurori kishte të drejtë që edhe në fund të shqyrtimit gjyqësor të çështjes në gjykatë, të mund të dispononte, pa u kufizuar nga gjykata me tërheqjen e akuzës¹⁴⁸. Pra në një farë mënyre prokurori kishte “dorë të lirë” për të vendosur mbi fatin e procedimit penal edhe në rastin kur çështja penale ishte drejt përfundimit në gjykimin në shkallë të parë. Në një farë mënyre besoj se një zgjidhje e tillë edhe mund të përlligjej duke i’u referuar mënyrës së organizimit dhe funksionimit të prokurorisë përpara ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016.

Kur prokuroria ishte e organizuar sipas modelit të centralizuar, akuza dhe kërkesa për gjykim e hartuar nga prokurori që ushtronte ndjekjen penale, verifikohesh në shkallë hierarkike nga drejtuesi i tij ose në raste të veçanta nga Prokurori i Përgjithshëm (i cili e kishte deleguar të drejtën e kontrollit tek prokurorët që ushtronin funksionet e tyre në Prokurorinë e Përgjithshme).

Kështu që nëse mund të ekzistonin probleme me hartimin, apo bazueshmërinë e akuzës në fazën e hetimit dhe këto dilema të mbartura nga hetimi, nuk zhdukeshin në gjykim por në të kundërt përforconin dyshimin mbi ekzistencën e veprës penale dhe të pandehurit si autor të saj, prokurorit i jepej mundësia që të tërhiqte akuzën.

Me tërheqjen e akuzës në gjendjen në të cilën ndodheshin aktet e procedimit penal, gjykata nuk mund të jepte vendim fajësie, për shkak të tërheqjes së akuzës. Në këtë rast gjykata vendosej përpara një zgjidhjeje të përcaktuar nga neni 377 i K.Pr.Penale përpara ndryshimeve, që ishte pushimi i çështjes penale ose dhënia e pafajësisë për të pandehurin dhe nëse gjykata çmonte se ajo nuk ishte përpara këtyre dy alternativave, procedonte me kthimin e akteve prokurorit.

Me ndryshimet e reja në Kod është ndryshuar dhe neni 377 i tij, që bën fjalë për kalimin e akteve prokurorit i cili është amenduar si në vijim:

¹⁴⁸ Neni 377 i K.Pr.Penale përpara ndryshimeve me Ligjin 35/2017 që hyn në fuqi më datë 1 gusht 2017, që bën fjalë për “Kalimi i akteve prokurorit” parashikonte se: “1. Kur prokurori e tërheq akuzën dhe në gjendjen që janë provat vërtetohet se i pandehuri nuk ka faj ose del që ekziston një nga rastet e pushimit të çështjes, gjykata vendos pafajësinë e të pandehurit ose pushimin e çështjes. Në rast të kundërt, gjykata vendos kalimin e akteve prokurorit.”

“1. Kur prokurori e tërheq akuzën dhe në gjendjen që janë provat vërtetohet se i pandehuri nuk ka faj ose del që ekziston një nga rastet e pushimit të çështjes, gjykata vendos pafajësinë e të pandehurit ose pushimin e çështjes.”

Fillimisht mund të themi se pa ju referuar përmbajtjes së dispozitës, ekziston një problem mos harmonizimi midis titullit e përmbajtjes së dispozitës.

Titulli i nenit 377 të K.Pr.Penale flet për “Kalimin e akteve prokurorit”, ndërsa përmbajtja e tij nuk parashikon asnjë mundësi që prokurorit t’i kalohen aktet. Me ndryshimet e reja prokurori mund të tërheq akuzën dhe gjykata pas këtij veprimi është e detyruar të vendosë ose pafajësinë e të pandehurit ose të pushojë çështjen penale.

Që të ndodh situata e parashikuar nga neni 377 i K.Pr.Penale do të duhet që prokurori dhe gjykata, të ndajnë të njëjtin përfundim në lidhje me fundin e procedimit penal që duhet të mbyllet me dhënien e pafajësisë së të pandehurit kur vërtetohet se i pandehuri nuk ka faj ose me pushimin e çështjes penale, kur ekziston një nga rastet e pushimit të çështjes penale.

Problemi vështirësohet kur prokurori dhe gjykata nuk ndajnë të njëjtin qëndrim në lidhje me përfundimin e hetimit. Kështu neni 377 i K.Pr.Penale nuk jep asnjë zgjidhje kur prokurori tërheq akuzën ndaj të pandehurit, pasi beson se me provat e shqyrtuara vërtetohet sipas tij se i pandehuri nuk ka faj, ose ekziston një nga rastet e pushimit të çështjes penale, ndërkohë që gjykata vlerëson ndryshe.

Në këtë rast referuar nenit 377 të K.Pr.Penale, pavarësisht se gjykata vlerëson se nuk ndodhet përpara rastit të pushimit të çështjes penale apo dhënies së pafajësisë, për shkak se prokurori ka tërhequr akuzën, do të duhet të jap një vendim kundër bindjes së saj, pasi është e detyruar të zbatojë nenin 377 të K.Pr.Penale.

Në mënyrën sesi është ndërtuar neni 377 i K.Pr.Penale, themi se gjykata “del jashtë natyrës së saj” procedurale, pasi për shkak të rrethanave të parashikuara nga neni 377 i kodit, ajo është e detyruar të vendosë kundër bindjes së saj, duke u shmangur edhe nga zbatimi i parimit të rëndësishëm, të dhënies së drejtësisë.

Nga studimi i disa sistemeve procedurale të vendeve të tjera si Gjermania, Italia, Kroacia, Kosova, Serbia, mund të themi se në asnjërin prej tyre nuk është parashikuar mundësia e tërheqjes së akuzës prej prokurorit pas fazës së fillimit të shqyrtimit gjyqësor të çështjes penale në gjykimin e themelit.

Më konkretisht referuar sistemit italian, të cilin e kemi si model për hartimin e Kodit tonë, si dhe ndryshimeve të fundit me Ligjin nr. 35/2017, rezulton se nuk ekziston asnjë dispozitë procedurale që i jep mundësinë prokurorit të tërheqë akuzën në fund të shqyrtimit gjyqësor të çështjes penale.

Kështu neni 469 i K.Pr.Penale të Italisë parashikon si mundësi pushimin e çështjes penale nga gjyqtari përpara shqyrtimit gjyqësor të saj, për shkaqe që lidhen si me përmbajtjen e hetimit, ashtu edhe për shkaqe që lidhen me parashkrimin e veprës penale, ose kur ekziston një nga rastet që pengon fillimin ose vazhdimin e ndjekjes penale. Gjukata e merr këtë vendim përpara

fillimit të shqyrtimit gjyqësor të çështjes duke dëgjuar në këshillim prokurorin dhe të pandehurin.

Kodi i Procedurës Penale të Kosovës parashikon mundësinë e tërheqjes së aktakuzës prej prokurorit përpara fillimit të shqyrtimit gjyqësor, sipas nenit 292 të tij. Në njëjtën zgjidhje ofron edhe Kodi i Procedurës Penale të Serbisë në nenin 361, sipas të cilit përpara fillimit të shqyrtimit gjyqësor prokurori mund të tërheqë akuzën dhe në këtë rast gjykata vendos ndërprerjen e shqyrtimit gjyqësor të çështjes penale. Edhe neni 380 i Kodit të Procedurës Penale të Kroacisë i njuh mundësinë e tërheqjes së akuzës nga prokurori përpara fillimit të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, me anë të një kërkesë që ai i drejton gjykatës. Gjykata mbi kërkesën e prokurorit vendos mosvazhdimin e mëtejshëm të procedimit penal.

Të njëjtën situatë mbi momentin procedural të vendosjes së pushimit të çështjes penale parashikohet dhe nga neni 174 i K.Pr.Penale të Gjermanisë.

Në të gjitha rastet e përmendura më lart është gjykata, subjekti që vendos për pushimin e çështjes penale përpara fillimit të shqyrtimit gjyqësor kur një veprimi i tillë kërkohet edhe nga prokurori. Në modelin tonë prokurori tërheq akuzën në fund të procesit gjyqësor dhe një veprim i tillë i bërë në fund të gjykimit më duket i papërligjur. Për ta ilustruar mendimin tim po servir një shembull.

Në bazë të nenit 329/a të K.Pr.Penale, të ndryshuar me Ligjin nr. 35/2017 rezulton se në rastet e parashikuara nga kjo dispozitë prokurori nuk mund të pushojë vetë një çështje penale, por ai mund të paraqesë në gjykatë kërkesë për pushimin e çështjes penale. Gjykata nuk kufizohet nga kërkesa e prokurorit për pushimin e çështjes penale, por mund të refuzojë kërkesën e prokurorit për pushimin e çështjes dhe të caktojë një afat brenda të cilit prokurori duhet të kryej veprimet e nevojshme për plotësimin e hetimeve.

Pas kryerjes së këtyre veprimeve, i orientuar dhe nga vendimi i gjykatës prokurori e sjell çështjen për gjykim. Në përfundim të gjykimit pasi janë shqyrtuar të gjitha provat, prokurori tërheq akuzën sipas nenit 377 të K.Pr.Penale duke konfirmuar qëndrimin e tij të mbajtur në përfundim të hetimeve dhe në këtë rast gjykata me përbërje kolegjiale duhet të vendos pushimin e çështjes penale ose pafajësinë për të pandehurin, megjithëse mund të ketë një bindje të ndryshme mbi zgjidhjen e çështjes referuar provave të shqyrtuara.

Në këtë mënyrë i gjithë sistemi i ngritur për kontrollin e hetimeve të prokurorit nga një gjyqtar në seancë paraprake, i cili shoqërohet me dërgimin e çështjes penale në gjyq me vlerësimin e hetimit nga ana e gjyqtarit, zhvleftësohet në fund të gjykimit me aktin e tërheqjes së akuzës nga prokurori sipas nenit 377 të K.Pr.Penale. Rrjedhimisht vendimmarrja e gjyqtarit të seancës paraprake i cili i refuzon kërkesën prokurorit për pushimin e çështjes penale nuk do të sjellë efektin e duhur, për sa kohë në nenin 377 të K.Pr.Penale prokurori mund të vendos vetë mbi fatin e procedimit penal tashmë në gjykim, duke tërhequr akuzën.

Për arsytet e përmendura më sipër mendoj se neni 377 i K.Pr.Penale nuk duhet të ekzistojë për shkak të ndryshimeve të reja që i janë bërë Kodit, ku si rregull ekziston përfshirja e figurës së gjyqtarit të seancës paraprake, i cili kontrollon ligjshmërinë e veprimeve të prokurorit përgjatë hetimeve. Kjo dispozitë procedurale është e panevojshme e do të krijojë probleme në

zbatim, pasi ajo nuk harmonizohet me dispozitat e tjera në kodin e procedurës penale. Rrjedhimisht propozimi në këtë rast është shfuqizimi i nenit 377 të K.Pr.Penale.

KAPITULLI V

NDRYSHIMI I CILESIMIT JURIDIK

5.1. *Prezantimi i përgjithshëm i ndryshimit të cilësimit juridik*

Në Kodin tonë të Procedurës Penale, në Seksionin e katërt të Kreut të dytë janë përfshirë dispozitat që lidhen me *akuzat e reja* në procesin penal. Këto dispozita rregullojnë situata të veçanta juridike, të cilat përfshijnë ushtrimin e ndjekjes penale nga prokurori përgjatë seancës gjyqësore në të cilën është sjellë për gjykim i pandehuri me akuzën përkatëse.

Si rregull prokuroria në përfundim të hetimeve paraprahe, i njofton të pandehurit zyrtarisht akuzën përkatëse për veprën penale konkrete të hetuar dhe paraqet në gjykatë kërkesën për gjykim për akuzën e njoftuar dhe verifikuar në seancë paraprahe. Gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor i pandehuri paraqet argumentet dhe provat që ka në dispozicion në favor të pozitës së tij procedurale në raport me akuzën. Ky proces që ndryshe njihet si debati gjyqësor ndihmon gjykatën që në përfundim të gjykimit të përcaktojë në mënyrë të saktë bazueshmërinë e akuzës mbi provat e shqyrtuara në gjykim e në sintezë të gjykimit, të shpallë edhe vendimin përfundimtar.

Rregulli i përmendur më lart njih edhe disa përjashtime. Mund të ndodhë që fakti i përshkruar nga prokurori në akuzë të dalë ndryshe gjatë gjykimit, apo në gjykim mund të evidentohet një vepër penale e lidhur me atë që është sjellë për gjykim, ose edhe një fakti i ri i cili nuk është përmendur në kërkesën për gjykim. Ndodhur përpara këtyre rasteve i pandehuri nuk është i përgatitur. Në këto raste të pandehurit duhet t'i garantohen të drejtat e një mbrojtjeje efektive përballë ndryshime të papritura të paraqitura nga ana e prokurorisë.

Referuar rastit të mësipërm situata është e qartë nga ana ligjore. Në rast të ndryshimit të akuzës apo komunikimit të një akuze të re në gjykim, të pandehurit i njihet e drejta për të kërkuar në gjykatë një afat kohor të mjaftueshëm me qëllim që ai të përgatitet efektivisht për të realizuar mbrojtjen e tij. Për më tepër dispozitat procedurale që përcaktojnë veprimin e prokurorit në raport me akuzat e reja kanë disa ngjashmëri me njëra tjetrën, ngjashmëri që lidhen me faktin e sjellë për gjykim që transformohet ose pëson ndryshime gjatë debatit gjyqësor dhe reagimin e prokurorit për shkak të situatës së re të krijuar në gjykim.

Pra në përgjithësi fokusi i akuzave të reja në gjykim përqendrohet tek transformimi i faktit penal si rezultat i debatit të zhvilluar në seancë gjyqësore. Si rrjedhojë e ndryshimeve që mund të pësojë fakti penal në gjykim, që është element thelbësor i përfshirë në shkakun e akuzës, normalisht ndryshon dhe elementi i dytë përbërës i akuzës, pra natyra e saj e cila përfaqëson karakteristikat ligjore të përcaktimit juridik të faktit si vepër penale.

Kështu që mund të themi se dispozitat procedurale që lidhen me akuzat e reja, bëjnë të mundur njohjen e lidhjes së ngushtë që ekziston në gjykim midis faktit të transformuar në gjykim si pasojë e debatit gjyqësor dhe reagimit të prokurorit në seancë gjyqësore. Ky reagim i prokurorit mbi faktin e transformuar materializohet në ndryshimin e akuzës, njoftimin e akuzës për një vepër penale të lidhur me atë që po gjykohet, ose njoftimin e akuzës për një fakti të ri penal që nuk është përmendur në kërkesën për gjykim.

Përpos këtyre situatave të krijuara në gjykim Kodi parashikon mundësinë që jo vetëm prokurori por dhe gjykata, në funksion të parimit të dhënies së drejtësisë mund t'i jap faktit të sjellë për gjykim përcaktimin e drejtë ligjor, që normalisht mund të jetë i ndryshëm nga përcaktimi i dhënë prej prokurorit. Vetëm se në këtë rast gjykata nuk ka mundësi ta ndryshojë faktin e sjellë për gjykim, ashtu si kundër e realizon prokurori nëpërmjet akuzave të reja në gjykim. Pra ndryshimi në këtë rast lidhet vetëm me elementin e natyrës së akuzës, sipas të cilës lejohet që jo vetëm prokurori por edhe gjykata mund të ndërhyjë, duke ndryshuar këtë element me vendimin saj. Kështu që gjykata mund t'a përcaktojë ligjërisht ndryshe faktin e sjellë për gjykim nga ana e prokurorit.

Përcaktimi i ndryshëm ligjor i faktit të bërë nga gjykata në vendim, mund të jetë më i lehtë apo më i rëndë. Në këtë rast i pandehuri vihet përpara një vështirësie reale, pasi vendimi i gjykatës i cili mund të ketë rënduar pozitën e tij, mund të jetë i papritur dhe surprizues për të, veçanërisht kur cilësimi ligjor i bërë nga gjykata lidhet me një vepër penale e cila paraqet rrezikshmëri më të lartë shoqërore se ajo që është sjellë për gjykim.

Për këtë arsye, qëllimi i këtij punimi është të analizojë elementët përbërës të ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale të bërë nga gjykata, i vlerësuar në harmoni me garantimin e të drejtave të të pandehurit për të realizuar një mbrojtje efektive ndaj kësaj situate juridike të krijuar me vendimin e gjykatës.

Neni 375 i K.Pr.Penale, i njeh të drejtën gjykatës që në vendimin e saj t'i japë faktit penal të konstatuar gjatë gjykimit një cilësim juridik të ndryshëm nga ai që kishte përcaktuar më parë prokuroria në akuzën e ngritur ndaj të pandehurit e të sjellë për gjykim. Mund të themi se edhe pse me natyrë të kufizuar, cilësimi juridik i faktit të konstatuar në gjykim, nga gjykata në vendimin e saj përfundimtar është shprehje e parimit latin *jura novit curia*¹⁴⁹.

Me ndryshim të cilësimit juridik të veprës penale nga gjykata, do të kuptojmë përcaktimin e saktë ligjor të figurës konkrete të veprës penale të parashikuar nga ligji penal të kryer nga i pandehuri me veprimet apo mosveprimet e tij. Pra cilësimi juridik i veprës penale lidhet ngushtësisht me përcaktimin e drejtë nga pikëpamja juridike të natyrës së veprimeve apo mosveprimeve të realizuara nga një person, veprime të cilat janë të parashikuara nga ligji penal si elementë thelbësorë të vepër penale. Në këtë rast gjykata faktit penal i vendos dispozitën penale konkrete që do të zbatohet ndaj autorit të veprës penale.

Ky veprim i gjykatës lidhet me ushtrimin e së drejtës që ajo ka për të përcaktuar në mënyrë të drejtë cilësimin ligjor të veprës penale, të evidentuar përgjatë gjykimit të çështjes penale.

Më poshtë do të trajtojmë elementët përbërës të ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale nga gjykata.

¹⁴⁹ Gjykata e njeh ligjin.

5.2. Analiza e elementëve të ndryshimit të cilësimit juridik

Elementët e ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale gjenden të përfshira në nenin 375 të K.Pr.Penale. Kjo dispozitë citon shprehimisht se:

“Me vendimin përfundimtar gjykata mund t’i japë faktit një përcaktim të ndryshëm nga ai që ka bërë prokurori ose i dëmtuari akuzues, më të lehtë ose më të rëndë, me kusht që vepra penale të jetë në kompetencën e saj”.

Duke analizuar elementët përbërës të dispozitës së mësipërme konstatohet se kjo dispozitë materializohet në disa elementë që janë: gjykata përcakton cilësimin juridik të veprës penale; fakti penal në cilësimin juridik të gjykatës mbetet i pandryshuar; cilësimi juridik bëhet me vendim përfundimtar të gjykatës dhe gjykata duhet të ketë kompetencë ligjore për ndryshimin e cilësimit juridik;

5.2.1. Gjykata dhe cilësimi juridik i veprës penale

Së pari, subjekti procedural që mund t’i jap faktit një përcaktim ligjor të ndryshëm nga akuza është gjykata. Krahasuar me të drejtën që ka prokurori për të njëjtën çështje, gjykatës në këtë rast i njihet e drejta e përcaktimit përfundimtar të cilësimit të mëparshëm ligjor që prokuroria i ka bërë faktit penal të sjellë për gjykim. Në këtë kuptim gjykata është subjekti procedural që vendos në përfundimisht mbi ligjin që do të zbatohet në çështjen konkrete. Me cilësimin e drejtë ligjor nëpërmjet vendimit, gjykata i jep fund shqyrtimit gjyqësor duke zgjidhur përfundimisht dilemat e problemet që mund të mbart një çështje penale e sjellë për gjykim nga prokuroria.

Nëse nuk do të ekzistonte në Kodin e Procedurës Penale instrumenti i ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale, atëherë gjykata do të kishte në dispozicion vetëm dy alternativa vendimi pra ose vendimi i pafajësisë (përfshirë këtu edhe vendimin për pushimin e çështjes penale) si dhe vendimi i fajësisë sipas përcaktimit të veprës penale të kërkuar nga prokurori. Në sistemet civil law (e drejta kontinentale) pjesë e së cilës është edhe sistemi ynë procedural, gjykatat përgjithësisht marrin një rol aktiv në lidhje me atributin që i ka ngarkuar ligji për t’i dhënë faktit të sjellë për gjykim përcaktimin e drejtë ligjor të pavarur nga ai që i ka bërë prokuroria.

Ndërkohë vendet që bëjnë pjesë në sistemin common law karakterizohen nga një sistem i pastër akuzator. Në varësi të llojit të sistemit, rrjedh si pasojë dhe roli që ka gjykata në proces gjyqësor, nëse ka rol aktiv, pak aktiv apo tërësisht pasiv. Është e rëndësishme të kuptohet roli i gjykatës gjatë procesit penal, sepse pikërisht ndryshimi i cilësimit ligjor të veprës penale tregon për një rol aktiv të saj.

Akuza është instrumenti i parë, në një sistem akuzator që krijon kornizën e një procesi penal. Formulimi i akuzës është i rëndësishëm me qëllim mbrojtjen e të drejtave të të akuzuarit në një gjyq të drejtë, të informohet menjëherë e në detaje mbi natyrën dhe shkakun e akuzës si dhe të ketë kohë të mjaftueshme dhe lehtësi në përgatitjen e mbrojtjes. *Natyra e akuzës* lidhet me cilësimin ligjor të saj, që nënkupton veprën penale të pretenduar dhe formën e përgjegjësisë penale, si dhe *shkaku* i referohet bazës faktuale e përshkrimit të akuzës. Akuza duhet të

përfshijë faktet materiale të cilat mbështesin akuzën, *materiali faktik* duhet të jepet me detaje të mjaftueshme duke informuar të pandehurin në mënyrë të qartë mbi akuzat, duke e lejuar të përgatisë mbrojtjen.

Siç e përmendëm edhe më sipër, cilësimi ligjor i fakteve në mënyrë të pavarur gjen mbështetje në parimin e mirënjohur latin *iura novit curia*, që do të thotë se gjykata e njej ligjin. Gjykata e aplikon këtë parim *ex officio* pa qenë e kufizuar nga argumentat ligjorë të sjella nga palët. Në formën e tij më të përhapur ky parim lejon gjykatën të bazojë vendimin e saj mbi një teori ligjore që nuk ka qenë subjekt i argumentave nga palët. Megjithatë në këndvështrimin e së drejtës së palëve për t'u dëgjuar dhe parimit të kontradiktoritetit, i njohur si në sistemin e *civil law* dhe *common law*, kjo liri veprimi e gjykatës nuk është e pakufizuar.

Në fakt në të dy sistemet, ky parim (*iura novit curia*) aplikohet në mënyra të ndryshme. Tradicionalisht është thënë se ky parim aplikohet në sistemet ligjore të *civil law*, ndërsa në *common law* nuk zbatohet¹⁵⁰.

Iura novit curia aplikohet gjerësisht në gjykatat ndërkombëtare si parim i përgjithshëm. Përsa i përket rregullave procedurale që ndiqen në Gjykatën Penale Ndërkombëtare dhe që lidhen me akuzën, përcaktimi se kur duhet të fillojë një ndjekje penale ndjek parime kontradiktore, që konsistojnë në faktin se prokurori është organi i vetëm që mund të iniciojë një proces gjyqësor duke parashtruar një akuzë, pasi një gjyqtar nuk e ka një kompetencë të tillë. Për më tepër përgjegjësia e fundit përsa i përket përmbajtjes së akuzës i mbetet prokurorit¹⁵¹.

Në sistemin *common law*, theksi vendoset mbi veprën penale, ashtu sikurse është përcaktuar nga prokurori në akuzë. Kjo do të thotë se cilësimi ligjor i bërë nga prokurori është detyrues për gjykatën, mbi të gjitha është kundërt veprës për të cilën është akuzuar dhe i akuzuari ndërton mbrojtjen e tij.

E kundërta ndodh në sistemet *civil law* dhe në ato mikse, ku sjellja, veprimi apo mosveprimi, janë vendimtare e jo cilësimi ligjor i fakteve. Parimi *iura novit curia* aplikohet e si rrjedhim gjykata në këto sisteme nuk është e detyruar që “ti bindet” përcaktimi juridik të veprës penale të bërë nga prokurori.

Për shkak të sistemit procedural të përzgjedhur themi se gjykata në procesin penal ka rol aktiv në lidhje me përcaktimin e duhur ligjor të faktit të sjellë për gjykim. Në këtë kontekst, gjykata në sistemin tonë, nuk ndodhet vetëm përpara dy alternativave vendimmarrëse të cilat i referohen vendimeve të pafajësisë ose të fajësisë së të pandehurit. Gjykata në sistemin tonë, brenda hapësirave të dhëna nga ligji ka mundësinë që përpos vendimeve tradicionale të përmendura më sipër, mund të jap vendime që ndryshojnë cilësimin ligjor të veprës penale të bërë nga prokurori.

¹⁵⁰ Bani Erion, Dardha Luveta, Dervishi Marsela, Gjuzi Adelajda, Goxha Diamela, Hasani Dritan, Mihali Elona, Muçi Emona, “Ndryshimi i cilësimit juridik të veprës penale dhe e drejta për një proces të rregullt ligjor sipas KEDNJ” revista juridike shkencore “Jeta Juridike” botim nr. 2 vitit XII i botimit nga Shkolla e Magjistraturës, Qershor 2012 faqe 51, që referon tek autori Derlén Mattias, “Interpretim shumë gjuhësor i së drejtës së Bashkimit European Monografi Europiane” (2009)

¹⁵¹ Robert Cryer, Prezantim i te drejtës penale dhe procedurës penale ndërkombëtare, botim i viti 2007, Universiteti i Kembrixhit, faqe 373

5.2.2. Fakti në cilësimin juridik mbetet i pandryshuar

Ndryshimi i cilësimit juridik të veprës penale nga gjykata bëhet vetëm në rastet kur ky ndryshim i referohet të njëjtit fakt të sjellë për gjykim nga prokuroria. Fakti të cilit i atribuohet të pandehurit nga prokuroria duhet të mbetet i pandryshuar nga momenti që ka filluar procesi gjyqësor deri në momentin që gjykata është tërhequr për dhënien e vendimin të saj përfundimtar.

Kushti i faktit të pandryshueshëm përbën elementin më të rëndësishëm të instrumentit të ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale. Në aspektin procedural fakt i pandryshueshëm do të thotë pasqyrim i parimit të lidhjes së akuzës me vendimin e gjykatës¹⁵². Në këtë rast gjyqtari e vlerëson ndryshe faktin e sjellë për gjykim, në rastin kur prokurori nuk ka ndërhyrë vetë gjatë gjykimit për të proceduar me ndryshimin e akuzës, apo në rastin kur prokurori gabimisht ka ndryshuar akuzën në gjykim. Në këtë aspekt mund të themi se një pushtet të tillë që i është dhënë gjykatës për të ndryshuar cilësimin juridik të veprës penale përfaqëson një element të sistemit inkuizitor të procedurës penale¹⁵³.

Por çfarë duhet të kuptojmë me shprehjen fakt penal të pandryshueshëm?

Për ti dhënë përgjigje kësaj pyetje duhet fillimisht të trajtojmë termin fakt në procesin penal. Sipas përkufizimit të dhënë nga Dr. Bogdan Šešić, “fakti është ekzistenca objektive reale i ndonjë sendi, dukurie, procesi, ndodhie, ngjarje, cilësie ose raporti i vërtetuar në mënyrë mendore perceptuese¹⁵⁴”. Megjithatë disa fakte në procedurën penale gjykata i vërteton nëpërmjet procesit mendor perceptues të personave të tjerë (dëshmitarët) ose me ndihmën e instrumenteve të ndryshme ligjore, fakti në procedurë penale përfshin dukuri reale në të cilat gjenden kushtet e së drejtës penale materiale për zbatimin e sanksioneve penale nëpërmjet zhvillimit të procedurës penale dhe kryerjes së veprimeve procedurale¹⁵⁵.

Nocioni fakt ka kuptimin e ndonjë ngjarje, ndodhie apo fragmenti të realitetit objektiv. Në këtë rast fakti përfaqëson një ngjarje, ndodhi apo send konkret që është i lidhur në marrëdhënie të shumëfishta me fakte të tjera. Faktet që duhet të vërtetohen në procedurën penale paraqesin thelbin e çështjes penale. Subjektet procedurale kanë për detyrë të angazhohen për vërtetimin e tyre. Prandaj themi se procesi gjyqësor konsiston në vërtetimin e fakteve të nevojshme që shërbejnë për zbatimin e së drejtës. Në këtë kuptim themi se shqyrtimi gjyqësor në procedurën penale shërben për të vërtetuar faktet e nevojshme që lidhen me zbatimin e së drejtës penale (ligjit penal)¹⁵⁶.

Fakti i pandryshueshëm do të thotë i njëjti fakt që është sjellë për gjykim nga prokurori, i cili duhet të vërtetohet në shqyrtim gjyqësor nëpërmjet zbatimit të dispozitave të procedurës penale. I njëjti fakt do të thotë vërtetim në gjykim të të njëjtave veprime të kryera nga i njëjti person, i përgjegjshëm përpara ligjit, me të cilat ka cenuar apo dëmtuar të njëjtat vlera apo

¹⁵² Conso Giovanni, Grevi Vittorio., “Compiendo di Procedura Penale” Seconda edizione, CEDAM 2003, faqe 710

¹⁵³ Conso Giovanni, Grevi Vittorio., “Compiendo di Procedura Penale” Seconda edizione, CEDAM 2003, po aty

¹⁵⁴ Dr. Sahiti Ejup, “E drejta e procedurës penale”, Universiteti i Prishtinës 2005, faqe 133

¹⁵⁵ Dr. Sahiti Ejup po aty

¹⁵⁶ Dr. Sahiti Ejup po aty

benefite juridike të mbrojtura posaçërisht nga ligji penal, që janë realizuar në të njëjtën kohë, që si rezultat do të sjellë zbatimin e ligjit penal. Këto konstatime të cilat lidhen me faktin penal nuk duhet të jenë të ndryshme në vlerësimin e prokurorisë dhe gjykatës. Me termin “fakti i njëjti” duhet të kuptohet jo vetëm që ai në përgjithësi të rezultojë i njëjtën, por duhet që edhe elementet thelbësorë të faktit penal të cilët konfigurojnë edhe veprën penale të parashikuar nga ligji penal duhet të jenë të njëjta.

Për ta konkretizuar se çfarë duhet të kuptojmë me të njëjtin fakt të sjellë për gjykim nga prokurori përmendim vendimin nr.472 datë 13.09.2006 të dhënë nga Gjykata e Lartë, ku më konkretisht citohet se:

“...Më datë 09.04.2000, në orët e para të mëngjesit, në afërsi të fshatit Gërrec të Vlorës, tre persona te armatosur me armë zjarri dhe të maskuar kanë vjedhur pasagjeret e një furgoni dhe të një autobuzi, të cilët kanë përshkruar karakteristikat e autorëve të vjedhjes, pa mundur t'i identifikojnë ato.

Gjatë hetimeve ka rezultuar se personat e armatosur dhe të maskuar kanë dalë në këmbë në rrugën e fshatit Gjorm të Vlorës, ku kanë ndaluar automjetin e drejtuar nga dëshmitari A. A, të cilit i kanë kërkuar t'i çonte në fshatin Kotë po të rrethit Vlorë. Ky dëshmitar ka mundur të identifikojë vetëm njërin prej tyre, shtetasin T.S, i cili nuk ka mundur të merret në pyetje nga organi i akuzës, pasi 9 ditë pas ngjarjes është vrarë.

Pasi kanë zbritur në fshatin Kotë, personat e armatosur dhe të maskuar kanë zënë pritë në vendin e quajtur “Qafa e Koroveshit” dhe rreth orës 06⁰⁰ kur aty ka kaluar furgoni i parë me pasagjerë i drejtuar nga dëshmitari V.R, ata i kanë dalë përpara duke e detyruar të ndalojë dhe nën kërcenimin e armëve ju kanë marrë sende me vlerë dhe paratë. Më pas, ata kanë urdhëruar drejtuesin e mjetit të largohet me shpejtësi, për të ndaluar autobuzin me pasagjerë që po vinte drejt tyre. Përsëri ata kanë detyruar pasagjerët të zbresin poshtë të cilëve u kanë marrë paratë dhe sendet me vlerë, por kur kanë hasur në rezistencën e shoferit të autobusit për të dorëzuar shumën 210.000 lekë që kishte me vete për të zhdoganuar autobuzin, njëri nga personat e armatosur i ka qëlluar atij pranë këmbëve për ta trembur dhe pasi ja kanë marrë dhe atij të hollat, i kanë detyruar pasagjerët të hipin në autobus dhe të largohen. Njëkohësisht personat e armatosur janë larguar në këmbë në drejtim të fshatit Amonicë dhe rrugës, rreth 200 m larg vendit të ngjarjes kanë hedhur armët dhe maskat, si dhe një aparat fotografik që i kishin marrë një pasagjeri...

Në përfundim të hetimeve, organi i akuzës i ka kërkuar gjykates gjykimin e të pandehurve M. N. dhe G. S. për akuzën e vjedhjes me armë në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 140 dhe 25 i K.Penal.

Gjykata e Apelit Vlorë duke vepruar në kundërshtim me parashikimet e nenit 373 të K.Pr.Penale, në përfundim të gjyimit i ka deklaruar fajtor dhe dënuar dy të pandehurit jo vetëm për akuzën e paraqitur nga organi i prokurorisë, por edhe sipas nenit 278 (armëmbajtjes pa leje) të K.Penal.

Në vështrim të kërkesave të nenit 373 të K.Pr.Penale, kur gjatë shqyrtimit gjyqësor del një vepër tjetër që ka lidhje me atë që gjykohet dhe që nuk është përmendur në kërkesën për gjykim, është prokurori ai që i komunikon të pandehurit veprën tjetër penale. Në çështjen objekt

gjykimi, nga procesverbalet e seancave gjyqësore rezulton se deri në diskutimin përfundimtar, nga ana e prokurorit nuk i është komunikuar të pandehurve ndonjë akuzë për veprën penale të armë mbajtjes pa leje ndërkohë që Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin përfundimtar i ka deklaruar fajtor dhe dënuar të dy të pandehurit për një vepër tjetër penale e cila nuk është përmenduar në kërkesën për gjykim dhe as i është komunikuar të pandehurve nga prokurori gjatë gjyqimit.

Në kuptim të përmbajtjes së nenit 375 të K.Pr.Penale, me vendimin përfundimtar, gjykatës i lind e drejta t'i japë faktit një përcaktim të ndryshëm nga ai që i ka bërë prokurori, pamvarësisht nëse kualifikimi i ri është për një vepër më të rëndë por kurrësi nuk ka të drejtë që të deklarojë të pandehurin fajtor për akuza të pa komunikuar nga prokurori. Gjykata është organi i cili realizon dhënien e drejtësisë duke mos qenë vetë palë në procesin penal.

Në këto rrethana, vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë është rrjedhojë e mosrespektimit të rregullave procedurale që lidhen me paraqitjen e akuzave të reja, dhe si i tillë duhet të priset...¹⁵⁷.

Për ta ilustruar më tej se çfarë duhet të kuptojmë me të njëjtin fakt të sjellë për gjykim nga prokurori, po paraqesim më poshtë vendimin e Gjykatës së Apelit "Për Krimet e Rënda" nr. 40 datë 31.05.2017 i cili në lidhje me përkufizimin e faktit të njëjtë penal shprehet se:

"...Në kërkesën për gjykim të organit të prokurorisë, fakti penal në ngarkim të të pandehurit konsiston në kërkimin prej tij një ditë para ngjarjes të një shume prej 80 000 euro nga kallëzuesi H. në këmbim të dhënies së një vendimi civil në favor të tij, në të cilën kallëzuesi ishte në pozitën procedurale të palës së paditur. Fakti i mësipërm i pretenduar nga organi i prokurorisë ka qenë edhe objekt shqyrtimi gjyqësor në këtë procedim penal. Gjatë shqyrtimit gjyqësor debati midis organit të prokurorisë dhe të pandehurit është zhvilluar rreth këtij mekanizmi të pretenduar nga organi i akuzës sipas të cilit është konsumuar nga i pandehuri fakti penal në ngarkim të tij. Edhe në konkluzione organi i prokurorisë ka kërkuar deklarinimin fajtor të të pandehurit për kryerjen prej tij të veprës penale në mekanizmin e mësipërm të ngjarjes.

Gjykata e shkallës së parë "Për Krimet e Rënda" Tiranë me vendimin e saj përfundimtar ka arritur në përfundimin se fakti penal në ngarkim të të pandehurit i parashtuar nga prokurori për kërkimin e shumës prej 80 000 euro nuk mbështetet në prova të plota duke hedhur poshtë pretendimet e organit të prokurorisë për konsumimin e veprës penale nga ana e tij në rrethanat e mësipërme të faktit.

Pavarësisht këtij përfundimi të arritur, Gjykata e shkallës së parë, e ka gjetur fajtor të pandehurin për të njëjtën vepër penale të akuzuar nga prokuroria por duke pranuar kryerjen e saj dhe për rrjedhojë pranimin e faktit penal ndryshe nga ç'është përshkruar në kërkesën për gjykim, duke konkluduar se i pandehuri nuk vërtetohet ti ketë kërkuar shumën prej 80 000 euro kallëzuesit por kërkimi konsiston në një shumë prej 1 000 000 lekë të reja, kërkim i cili është bërë në një marrëveshje të mëparshme midis të pandehurit nga njëra anë si dhe kallëzuesit dhe avokatit mbrojtës nga ana tjetër.

Në rrethanat e mësipërme kolegji penal i gjykatës së apelit çmon se duke marrë në konsideratë përfundimin e arritur nga gjykata e shkallës së parë, fakti penal i pranuar prej saj

¹⁵⁷ Vendim i Gjykatës së Lartë nr. 472 datë 13.09.2006

në gjykim është i ndryshëm nga fakti penal i pretenduar nga organi i akuzës si në kërkesën për gjykim ashtu edhe gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor dhe në konkluzionet përfundimtare të tij. Që fakti penal gjatë shqyrtimit gjyqësor rezultoi i ndryshëm nga ç`është përshkruar në kërkesën për gjykim del qartë edhe nga apeli i paraqitur nga organi i prokurorisë ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë me të cilin kërkohet ndryshimi i pjesshëm i vendimit nr. 1 datë2016 duke përfshirë në faktin penal edhe faktin e kërimit të shumës 80 000 euro nga i pandehuri...

Përfundimet e arritura nga gjykata e shkallës së parë vlerësohen në shkelje të parashikimeve të nenit 376 të K. Pr. Penale, pasi nga ana e gjykatës së shkallës së parë nuk janë respektuar të drejtat për të kërkuar afat për mbrojtjen e tij në kushtet sipas nenit 372 të K.Pr.Penale fakti penal ka rezultuar ndryshe nga ç`është përshkruar në kërkesën për gjykim...

Në ndryshim nga ç`është mbrojtur gjatë gjykimit i pandehuri është gjendur fajtor për rrethana fakti të cilat kanë rezultuar vetëm pas shqyrtimit gjyqësor të çështjes duke mos pasur mundësi të mbrohet për rrethanat e faktit për të cilat është gjendur fajtor nga gjykata pasi siç thamë më lart, nga ana e gjykatës nuk i është dhënë mundësia të njihet dhe për rrjedhojë të realizojë gjatë gjykimit në shkallë të parë një mbrojtje efektive për rrethana të ndryshme të faktit penal.

Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda duke konstatuar se në gjykimin e të pandehurit janë shkelur dispozitat për paraqitjen e akuzave të reja siç parashikohet në nenin 376 të K.Pr.Penale në lidhje me nenin 372 të tij, arrin në përfundimin se duhet të prishet vendimi i gjykatës së shkallës së parë Për Krimet e Rënda Tiranë, pasi janë shkelur dispozitat për paraqitjen e akuzave të reja dhe në mbështetje të nenit 429/1 të K.Pr.Penale urdhërohet dërgimi i akteve për gjykim një kolegji tjetër të Gjykatës së shkallës së parë "Për Krimet e Rënda" Tiranë..."

Në dy shembujt e mësipërm vlerësojmë se në mënyrë indirekte të dy gjykatat në evidentimin e shkeljeve të gjetura nga vendimet e dhëna prej gjykatave më të ulëta, kanë interpretuar parimin procedural të identifikimit të një raporti që duhet të ekzistojë midis akuzës së sjellë për gjykim dhe vendimit të gjykatës. Akuza dhe vendimi i gjykatës duhet të qëndrojnë të lidhura me njëra tjetrën vetëm në elementin e faktit të sjellë për gjykim. Fakti i sjellë për gjykim duhet të jetë i njëjtë me faktin e konstatuar nga gjykata në vendimin e saj.

5.2.3. Cilësimi juridik dhe vendimi i gjykatës

Ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale përpara ndryshimeve të Kodit të Procedurës Penale me Ligjin nr. 35/2017, gjykata mund ta japë vetëm në vendimin e saj përfundimtar. Në një pikë tjetër të këtij punimi do të pasqyrojmë dhe ndryshimet e fundit të Kodit që lidhen me cilësimin juridik të veprës penale të bërë nga gjykata, me një vendim të ndryshëm nga ai përfundimtar.

Gjykata është e detyruar nga ligji që t'i japë faktit të sjellë për gjykim dhe të konstatuar si të tillë gjatë debatit, përcaktimin e duhur juridik. Një veprim të tillë me natyrë procedurale gjykata mund ta ushtrojë vetëm në fund të gjykimit, pasi të ketë dëgjuar dhe konkluzionet e fundit të palëve në proces.

Cilësimi juridik që gjykata i bën faktit në vendimin e saj përfundimtar mund të jetë më i lehtë ose më i rëndë se cilësimi ligjor që prokuroria i ka bërë këtij fakti në formulimin e akuzës të sjellë për gjykim. Pra gjykata në cilësimin juridik që i bën veprës penale nuk qëndron e lidhur me përcaktimin ligjor që ka bërë prokurori.

Çështja që mund të ngrihet për diskutim lidhet me pyetjen se, përse duhet që gjykata të ndryshojë cilësimin juridik të veprës penale kur fakti penal i sjellë për gjykim në vlerësimin e gjykatës mbetet i njëjtë?

Në përgjigje të pyetjes së mësipërme mund të themi se ekzistojnë disa shkaqe ligjore të cilat i japin mundësinë gjykatës që të njëjtit fakt penal të ardhur për gjykim, mund t'i japë një vlerësim të ndryshëm ligjor nga ai që i ka dhënë më parë prokurori. Këto raste lidhen në përgjithësi me situatën e *konkurrimit imagjinar (apo fiktiv) të veprave penale*, të njohur dhe trajtuar nga doktrina e së drejtës penale.

Më konkretisht në doktrinën penale njihet instituti i *konkurrimit imagjinar (apo fiktiv) i veprave penale*. Konkurrim imagjinar (fiktiv) të veprave penale kemi në rastet kur një vepër penale e kryer, ka në përbërje të saj disa elementë të rëndësishëm, të cilët nuk parashikohen vetëm nga një dispozitë e vetme penale por nga disa dispozita penale. Në një vlerësim paraprak duket sikur disa dispozita penale mund të zbatohen në këtë rast, prandaj në terminologji alternative themi që në këtë rast kemi konkurrim dispozitash penale¹⁵⁸. Në të vërtetë nga të gjitha dispozitat penale vetëm njëra prej tyre do të zbatohet për faktin penal të pandryshuar, të cilit i përgjigjet një vepër penale dhe normalisht autori duhet të dënohet vetëm një herë.

Rasti i konkurrimit imagjinar të veprave penale është rasti më i zakonshëm i ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale e për ilustrim mund ta shoqërojmë me një shembull.

Një person duke qëlluar me armë zjarri me breshëri, me dashje në të njëjtën kohë vret një punonjës policie në detyrë dhe një qytetar që ndodhej aty pranë. Referuar Kodit Penal shqiptar për këtë rast konkurrojnë fiktivisht disa dispozita penale që mund të zbatohen ndaj autorit të veprës penale. Më konkretisht *Vrasja me dashje e punonjësit të policisë së rendit publik* parashikohet si vepër penale nga neni 79/b i Kodit Penal, *Vrasja me dashje* parashikohet si vepër penale nga neni 76 i Kodit Penal dhe *Vrasja me dashje kundër dy ose më shumë personave* parashikohet si vepër penale nga neni 79 pika (dh) i Kodit Penal.

Në një vlerësim paraprak mund të themi se në shembullin e mësipërm, sipas Kodit Penal shqiptar ndodhemi përpara konkurrimit imagjinar të veprave penale, pasi ndaj autorit mund të diskutohet zbatimi i dispozitave penale për *Vrasjen me dashje të punonjësit të policisë së rendit publik* dhe *Vrasjen me dashje* ndaj qytetarit që u ndodh aty pranë, ose të zbatohet dispozita penale e *Vrasjes me dashje kundër dy ose më shumë personave*. Ndër këto dy alternativa ligjore i takon gjykatës të vendosë përfundimisht se cila dispozitë penale duhet të zbatohet. Në rast se prokurori në formulimin e akuzës ndaj autorit të vrasjeve ka përzgjedhur zbatimin e dispozitës së gabuar penale, atëherë gjykata në vendimin e saj përfundimtar duhet të ndryshojë cilësimin juridik të veprës penale të bërë më parë gabimisht prej prokurorit.

¹⁵⁸ Mëngjesi Sokol, "Bazat e doktrinës të së drejtës penale", Tiranë 2016

Pra referuar doktrinës penale mbi *konkurrimin imagjinar (fiktiv) të veprave penale*, mund të themi se ky institut i së drejtës penale shërben si shkak ligjor që përligj nevojën e ndërhyrjes së gjykatës në rikualifikimin juridik të veprës penale të sjellë për gjykim më parë nga prokuroria. Kështu që parashikimi ligjor i ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale nga gjykata është i nevojshëm si shprehje e zbatimit të parimit të ligjshmërisë dhe të drejtësisë në caktimin e fajësisë së autorit dhe dënimit të tij¹⁵⁹.

Rastin e konkurrimin imagjinar të veprave penale e gjejmë të përshkruar në shumë vendime gjyqësore që kanë ndryshuar cilësimin juridik të veprës penale të sjellë për gjykim nga prokurori.

Më poshtë po paraqesim disa shembuj:

Kështu në vendimin nr. 415/2008 të Gjykatës së Lartë pasqyrohen faktet e mëposhtme¹⁶⁰:

“...Nga shqyrtimi gjyqësor ka rezultuar e provuar se më datë 28.09.2005, nga ana e shërbimeve të policisë gjyqësore të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Vlorë, është ushtruar kontroll në banesën e të gjykuarit A. K, në fshatin Kaninë të rrethit Vlorë, ku janë gjetur dhe sekuestruar dymbëdhjetë thasë me thurje plastike dhe kater çarçafe të mbushur me bimë jeshile të pa presuar, me peshe 96 kg. Shtate nga thaset e lartpërmendur janë gjetur në dhomen e gjumit të të gjykuarit, e cila ndodhej në krahun e djathtë të banesës, kurse sasia tjetër në dhomen e gjumit të shtetasës V. K, nëna e të gjykuarit, e cila jeton në një banesë me këtë të fundit.

*Sipas aktit të ekspertimit kimik nr. 3551, datë 17.11.2005, ka rezultuar se materiali bimor gjetur dhe sekuestruar në banesën e të gjykuarit është mariuane, produkt i bimes *canabis sativa* L, që sipas ligjit nr.7975, datë 26.07.1995 dhe ligjit nr.9272, datë 09.09.2004 “Per barnat narkotike”, tabela e parë, lista 4, klasifikohen në kategorinë e barnave narkotike.*

Nga aktet që i janë nënshtruar shqyrtimit gjyqësor ka rezultuar gjithashtu se, ka qenë pikërisht i gjykuari A. K. personi që ka hapur derën e shtëpisë në momentin që kanë shkuar forcat e policisë për kontroll. Pasi është pyetur nëse kishte sende të kundraligjshme në shtëpi, dhe i gjykuari është përgjigjur negativisht, është proceduar me kontrollin e banesës së tij, dhe fillimisht është kontrolluar dhoma e gjumit të tij, ku dhe janë gjetur shtate thasë me lende narkotike.

Gjate gjykimit prokurori, në referim të nenit 372 të K.Pr.Penale, ndryshoi akuzën në ngarkim të të gjykuarit A. K. nga vepra penale e “prodhimit dhe shitjes së narkotikeve”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal, në veprën penale të “veprimeve që pengojnë zbulimin e se vertetes”, parashikuar nga neni 301 i Kodit Penal.

Gjykata, bazuar në nenin 375 të K.Pr.Penale, ndryshoi cilësimin juridik të veprës penale për të gjykuarin A. nga vepra penale e “veprimeve që pengojnë zbulimin e se vertetes”, parashikuar nga neni 301 i Kodit Penal, në veprën penale të “prodhimit dhe shitjes së narkotikeve”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal.

¹⁵⁹ Kurushi Klodian, Skënderaj Klodjan “Legal Qualification of the offence”, Academic Journal of Interdisciplinary Studies, Vol. 5, No. 2, July 2016 faqe 117

¹⁶⁰ Vendim i Gjykatës së Lartë nr. 415 datë 24. 09. 2008

Pretendimi i ngritur nga i gjykuari dhe mbrojta e tij se, në këtë rast, gjykata ka marrë kompetencat e prokurorit, duke u kthyer në organin akuzues, nuk është i drejtë dhe i bazuar në ligj, pasi gjykata nuk ka formuluar akuzë të re dhe as ka ndryshuar atë, siç pretendohet, por mbi bazën e fakteve të nënshtruara shqyrtimit gjyqësor ka bërë cilësimin e duhur ligjor të veprës, duke i dhënë faktit një përcaktim tjetër, të ndryshëm nga prokurori, e drejtë e cila është sanksionuar në nenin 375 të K.Pr.Penale.

Ky qëndrim i gjykatës së faktit dhe asaj të apelit gjendet në përputhje dhe me konkluzionet e arritura nga Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj nr.50, date 30.07.1999, në të cilin arsyetohet se kuptimi në këtë mënyrë i përmbajtjes së nenit 375 të K.Pr.Penale i shërben dhënies së drejtësisë nga ana e gjykatës, pasi në të kundërt ajo do të vepronte në kundërshtim me provat dhe me ligjin.

Nisur sa sipër, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, çmon se pretendimet e ngritura në rekurs nga i gjykuari A. K., dhe mbrojtësi i tij nuk janë të bazuara në ligj e për rrjedhojë, vendimi nr.401, datë 07.11.2006 i Gjykatës së Apelit Vlorë gjendet i bazuar në ligj e në prova dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi...”

Një rast tjetër ku mund të evidentohet veprimi gjykatës për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale është rasti i identifikimit në gjykim të veprës penale vazhduese. Në praktikë ka ndodhur që një person të akuzohet nga prokuroria disa herë për kryerjen e së njëjtës veprë penale, duke dëmtuar apo cënuar të njëjtën marrëdhënie shoqërore. Në këto raste veprimet e kryera nga autori i saj janë hallka përbërëse të një zinxhiri, i cili i pasqyron këto veprime si pjesë integrale të një veprimi të vetëm për të arritur një qëllim kriminal të mendur prej autorit të saj. Për sa kohë këto veprime janë të lidhura ngushtë më njëra – tjetrën për shkak të të njëjtit mendim unik kriminal, këto veprime nuk mund të përbëjnë vepra penale më vete, por ato duhet të cilësohen si veprime të integruara në veprën penale vazhduese.

Kështu një person nuk mund të përgjigjet penalisht për të gjitha veprimet serike të kryera prej tij në funksion të arritjes së një qëllimi të vetëm kriminal, por ai do të përgjigjet për një veprë penale të vetme që është vepra penale vazhduese.

Gjykata e Shkallës së Parë Për Krimet e Rënda Tiranë, në një rast konkret¹⁶¹, mbi ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale të sjellë për gjykim, duke u mbështetur në natyrën e veprës penale vazhduese është shprehur se:

“...I pandehuri ka konsumuar veprën penale të “Shtrëngimit me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë” parashikuar nga neni 109/b/1 i Kodit Penal. Ai nëpërmjet kësaj veprë penale ka përfituar nga i dëmtuari në disa raste shuma parash në lekë dhe euro si dhe dy aparate celulari në mënyrë të padrejtë.

I pandehuri e ka njohur të dëmtuarin dhe nëpërmjet komunikimeve elektronike nga “Facebook” me një profil me emrin incognito “InaAgolli” dhe më pas “Ina Bori Agolli” ka arritur ti marrë të dëmtuarit disa foto nudo të dërguara nga ky i fundit në adresën e hapur nga i pandehuri. Më pas nëpërmjet komunikimeve kërcënuese se fotot e siguruara ai do t`ja bënte

¹⁶¹ Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë “Për Krimet e Rënda” Tiranë nr. 94 datë 28.07.2015

publike shoqërisë së të dëmtuarit, i pandehuri i ka kërkuar në pesë raste viktimës së tij që të paguante në shkëmbim të mos publikimit të fotove.

Nëpërmjet kërcënimeve me anë të komunikimeve elektronike dhe pa u identifikuar nga i dëmtuari, i pandehuri ka arritur të marrë të dëmtuarit 10 000 lekë, një aparat celulari të markës Samsung Galaxy S3, një aparat celulari të markës Iphone 4S. Me të njëjtën mënyrë ai i ka kërkuar të dëmtuarit shumën e 30 000 lekë të cilën nuk ka arritur ta marrë prej tij si dhe në fund ai i ka marrë të dëmtuarit shumën e 200 eurove, shumë e cila i është sekuestruar të pandehurit nga policia gjyqësore e cila e kishte nën vëzhgim të pandehurin pas bashkëpunimit që i dëmtuari kishte realizuar me policinë gjyqësore.

Në të gjitha rastet i pandehuri ka përdorur të njëjtën mënyrë për të përfituar pasuri prej të dëmtuarit duke e shantazhuar nëpërmjet publikimi të katër fotove nudo që i pandehuri e kishte përfitur prej të dëmtuarit nga komunikimi elektronik me të. Të gjitha sendet e kërkuara i dëmtuari i ka dorëzuar në vende të ndryshme të qytetit të Bajram Currit sipas porosive të dhëna nga i pandehuri pa e njohur personin që i përfitoi sendet në mënyrë të paligjshme.

Në tre rastet e para që lidhen me dorëzimin e shumës së parave dhe të dy aparateve të celularit i dëmtuari është treguar i bindur ndaj kërkesave të të pandehurit nga frika e publikimit të fotove.

Në rastin e katërt që ka ndodhur në muajin dhjetor të vitit 2014 për shumën 30 000 lekë të kërkuar nga i pandehuri, i dëmtuari ka refuzuar ta paguajë. Më pas i pandehuri për shkak se i dëmtuari i kishte bërë bllok komunikimeve që vinin nga profili "Ina Bori Agolli" u ka dërguar njoftimeve nëpërmjet të njëjtit profil shokëve të të dëmtuarit që janë shtetasit B. dhe E. Këtyre personave i pandehuri u ka njoftuar se ata duhet të lajmëronin shokun e tyre, të dëmtuarin M. që të komunikonte me të pandehurin, në rast të kundërt ai do të bënte publike fotot e tij. Pasi u lajmërua prej shokëve të tij i dëmtuari komunikoi me të pandehurin për rastin e fundit.

Në rastin e pestë që lidhet me komunikimet elektronike të datave 22. 01. 2015 e në vijim i pandehuri i ka kërkuar të dëmtuarit që ky i fundit ti sigurojë një sasi prej 500 gram hashash. Meqenëse i dëmtuari nuk pranoi ta kryente këtë veprim pasi ai nuk kishte lidhje me lëndët narkotike, i pandehuri i kërkoi të dëmtuarit shumën 200 euro me të cilën i pandehuri do të siguronte vetë lëndën narkotike.

Më datë 13. 02. 2015 i pandehuri është kapur në flagrancë nga policia gjyqësore në qytetin e Bajram Currit menjëherë sapo ai kishte marrë shumën prej 200 eurosh të vendosura në një zarf të cilin më parë e kishte vendosur në një kontenier i dëmtuari i porositur prej të pandehurit.

Vetë i pandehuri i konfirmon në deklarinimin e tij të pesta rastet ku ai i ka kërkuar dhe ka marrë në katër herë pasuri nga i dëmtuari në mënyrë të padrejtë.

Gjykata vlerëson se pavarësisht se i pandehuri ka përfituar pasuri në katër raste nga i dëmtuari duke e shtrënguar atë për të dhënë padrejtësisht pasuri në pesë raste, ai nuk duhet të përgjigjet penalisht për çdo rast të konsumuar prej tij. Në çështjen konkrete gjykata vlerëson se i pandehuri nuk duhet të mbajë përgjegjësi penale aq herë sa i pandehuri ka konsumuar veprimet kriminale ndaj të dëmtuarit me qëllim përfitimi material.

Në këtë rast gjykata vlerëson se i pandehuri ka konsumuar një krim të vetëm që është vepra penale vazhduese e “Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë” parashikuar nga neni 109/b/1 i Kodit Penal. Në këtë mënyrë gjykata bazuar në nenin 375 të Kodit të Procedurës Penale do të ndryshojë cilësimin juridik të veprës penale të sjellë për gjykim nga prokuroria duke e cilësuar veprën penale të “Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë” parashikuar nga neni 109/b/1 i Kodit Penal si një vepër të vetme penale të kryer nga i pandehuri.

Të pesë rastet e përmendura më lart mbi bazën e provave që u parashtruan gjatë arsyetimit të vendimit nuk qendrojnë të shpëputura nga njëra – tjetra. Këto raste përbëjnë vepra penale, por ato nuk mund të qendrojnë të pavarura nga njëra – tjetra. Veprat penale të kryera brenda një afati kohor relativisht të shkurtër nga vetëm një i pandehur dhe ndaj të njëjtit person, me anë të të njëjtit mekanizëm kërcënimi (përhapja e të njëjtave fotove nudo në të gjitha raste) me të njëjtin qëllim kriminal që ishte përfitimi pa të drejtë të pasurive të të dëmtuarit, janë të lidhura ngushtë me njëra – tjetrën.

Të gjitha rastet kriminale të evidentuara më lart mbartin të njëjta karakteristika dhe janë të vendosura në një lidhje logjike ndërmjet tyre.

Elementet e përbashkëta të secilës vepër penale të kryer nga i pandehuri po i paraqesim më poshtë:

Së pari në gjykim janë evidentuar kryerja e disa veprave penale të njëjta që parashikohen nga neni 109/b/1 i Kodit Penal që është vepra penale e “Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë”. Në pesë raste të shtrëngimit me anë të dhunës psikike (kërcënimit) i pandehuri ka përfitur nga i dëmtuari në katër raste pasuri në mënyrë të padrejtë. Mënyra e kërcënimit të realizuar nga i pandehuri është e njëjtë në të pestë rastet. Ai ka përdorur si mjet për kërcënimin e të dëmtuarit publikimin e katër fotove nudo që i pandehuri i ka marrë prej të dëmtuarit nëpërmjet Facebook.

Së dyti të gjitha veprat penale po ti veçojmë nga njëra – tjetra janë kryer nga i njëjti person që është i pandehuri D. Gj. Në të gjitha rastet i pandehuri ka qenë personi i vetëm që ka shtrënguar të dëmtuarin me anë të dhunës psikike për dhënie pasurie.

Së treti të gjitha vepra penale janë kryer ndaj të njëjtit person, që është i dëmtuari M. M. I pandehuri kërcënimet me anë të komunikimeve elektronike ja ka drejtuar të dëmtuarit në adresën e Facebookut që kishte hapur ky i fundit. Si rrjedhim i dëmtuari në katër raste ka qenë i detyruar që ti jap pasuritë e tij që ishin kërkuar prej të pandehurit.

Së katërti midis veprave penale ekziston një vazhdimësi lidhje e shtrirë në një kohë të shkurtër. Të gjitha veprat penale të njëjta janë pjesë e të njëjtit qëllim kriminal që manifestoi i pandehuri. Nëpërmjet këtyre veprave penale i pandehuri ka përfitur pasuri prej të dëmtuarit. Kështu që veprat penale kanë qenë pjesë e të njëjtit plan kriminal të krijuar nga i pandehuri. Plani kriminal i të pandehurit ka qenë zhvatja (përfitimi i padrejtë) e shtrirë në kohë e pasurisë së të dëmtuarit me anë të shtrëngimit nëpërmjet dhunës psikike.

Së pesti të gjitha veprat penale të kryera nga i pandehuri janë kryer me dashje dhe me qëllim përfitimi material.

Pas evidentimit të elementeve të përbashkëta të të gjitha veprave penale gjykata vlerëson se veprat penale të kryera nga i pandehuri janë pjesë përbërëse e veprës penale vazhduese të “Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë” parashikuar nga neni 109/b/1 i Kodit Penal. Në këtë rast për efekt të konstruktit juridike dhe lidhjes organike që kanë veprat me njëra – tjetrën këto vepra do të konsiderohen si një vepër penale e vetme vazhduese e kryer nga i pandehuri...”

Rast tjetër i ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale lidhet me përcaktimin e drejtë ligjor të disa rrethanave cilësuese në të cilat është kryer vepra penale. Identifikimi i këtyre rrethanave si pjesë përbërëse të veprës penale i japin një përcaktim ligjor e vlerë tjetër kualifikimit të veprës penale. Rrethanat duhet të jenë pjese e fakti penal të hetuar nga prokuroria dhe si rrjedhojë ato duhet të jenë pjesë e shqyrtimit gjyqësor.

Kodi ynë penal parashikon një sërë rrethanash cilësuese që i rrisin rrezikshmërinë shoqërore veprës penale të kryer. Si rrethana cilësuese mund të përmendim rrethanat e kryerjes së veprës penale në bashkëpunim, më shumë se një herë, kundër dy ose më shumë personave, ose kur shoqërohet me përdorimin e dhunës, ose ka shkaktuar pasoja të rënda etj.

Nëse vepra penale është kryer në prani të rrethanave cilësuese të përmendura më lart dhe këto rrethana janë evidentuar gjatë hetimit dhe në gjykim, gjykata mund të ndryshojë cilësimin juridik të veprës penale duke i përfshirë rrethanat cilësuese, si pjesë integrale e veprës penale nëse prokurori nuk i përmend këto rrethana në akuzën e tij. Rasti më tipik që ndeshet në praktikën tonë gjyqësore është rasti i përfshirjes së rrethanës cilësuese të bashkëpunimit, si pjesë përbërëse e veprës penale në cilësimin juridik që gjykata i bën veprës penale, kur kjo rrethanë nuk është pjese e akuzës së prokurorit.

Për këtë rast vlen të përmendim Vendimin Unifikues të Gjykatës së Lartë nr. 4/2011, i cili për institutin e bashkëpunimit në veprën penale dhe evidentimit të saj si rrethanë cilësuese shprehet se¹⁶²:

“...E njëjta logjike të çon në përfundimin se, edhe në rastet kur njëri nga bashkëpunëtorët është i panjohur, ndodhemi në kushtet e veprës penale të kryer në bashkëpunim, pasi personi në gjykim përgjigjet për veprimet apo mosveprimet në shkallën e kryer nga ai vetë. Mosnjohja e karakteristikave personale të bashkëpunëtorit të panjohur nuk shmang ekzistencën e bashkëpunimit dhe nuk e bën të paaplikueshme dispozitën e pjesës së përgjithshme të Kodit Penal. Në çdo rast, eventualisht karakteristikat personale të bashkëpunëtorit të panjohur do ishin shkak për përjashtimin e tij nga përgjegjësia penale, por nuk ndikojnë në cilësimin juridik dhe përcaktimin e përgjegjësisë për personin në gjykim.

Në të njëjtën linjë arsyetimi Kolegjet e Bashkuara çmojnë se edhe në rastet kur për shkak të mosidentifikimit nga ana e organit të akuzës nuk ka filluar procedim penal ndaj ndonjë personi tjetër, ose për të njëjtin shkak a ndonjë shkak të ndryshëm çështja nuk është veçuar, përsëri vepra do të cilësohet e kryer në bashkëpunim dhe personi në gjykim do të përgjigjet për veprimet apo mosveprimet e kryera nga ai vetë, me kusht që të provohet dhe vërtetohet ekzistenca e kushteve të përgjithshme të bashkëpunimit.

¹⁶² Vendim unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 4 datë 15.04.2011

Për gjithë sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin unifikues se: kur nga pikëpamja e anës objektive provohet se vepra penale është kryer nga dy ose më shumë persona, vepra do të konsiderohet e kryer në bashkëpunim. Kjo si për rastet kur nuk identifikohen bashkëpunëtorët, ashtu edhe për rastet kur bashkëpunëtori nuk ka përgjegjësi penale për shkak të paaftësisë apo moshës për përgjegjësi penale. Cilësitë e veçanta që shtojnë, pakësojnë apo përjashtojnë dënimin merren parasysh vetëm për bashkëpunëtorin tek i cili ato ekzistojnë...”.

Ndërkohë në një vendim tjetër të Gjykatës së Lartë evidenohej rëndësia e rrethanave të tjera cilësuese që duhet të merren parasysh nga gjykata, pasi këto rrethana ndikojnë në cilësimin e drejtë ligjor të veprës penale. Më konkretisht në vendimin nr. 644/2007 Gjykata e Lartë shprehet se¹⁶³:

“...Bazuar në sa më sipër, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, çmon se vendimi i Gjykatës së Apelit Korçë që ka deklaruar fajtorë të gjykuarën O.C., për veprën penale të vrasjes me dashje, parashikuar nga neni 76 të K.Penal, është rezultat i zbatimit të drejtë të ligjit penal, fakt që nuk është kontestuar as nga pjesmarrësit në proces.

Gjykata e Apelit Korçë, pasi i ka bërë një kronologji të detajuar ngjarjes së ndodhur, pas shqyrtimit në tërësi të provave, duke zbatuar drejtë kërkesat e nenit 152 të K.Pr.Penale për çmuarjen e tyre, sipas bindjes së formuar, me të drejtë ka bërë ndryshimin e cilësimit ligjor të veprës nga vrasje me paramendim, parashikuar nga neni 78/1 i K.Penal, në vrasje me dashje, parashikuar nga neni 76 të K.Penal. Por gjykata e apelit, ndonëse ka bërë ndryshimin e kualifikimit ligjor të veprës nga vrasje me paramendim në vrasje me dashje ka lënë po të njëjtën masë dënimi të dhënë nga gjykata e shkallës së parë për veprën penale të vrasjes me paramendim.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë çmon se, përderisa gjykata e apelit ka bërë ndryshimin e kualifikimit ligjor të veprës penale, në vartësi me këtë kualifikim duhet të merrte parasysh dhe të vlerësonte më drejtë edhe kërkesat e nenit 47 të K.Penal, shkallën e fajit, rrezikshmërinë shoqërore të veprës dhe të autores, moshën e saj të re, qëndrimin pendues, etj., ndaj për këtë pjesë, ky vendim duhet ndryshuar, duke i dhënë një masë më të lehtë dënimi.

Edhe përsa i përket kualifikimit ligjor të veprës penale të “Mbajtjes pa leje të armëve luftarake”, parashikuar nga neni 278/4 të K.Penal, Kolegji Penal konstaton se si gjykata e shkallës së parë dhe Gjykata e Apelit Korçë, kanë pranuar një kualifikim të gabuar ligjor të kësaj vepre. Kualifikimi ligjor sipas paragrafit të 4-të të nenit 278 të K.Penal, për këtë vepër duhet të bëhej vetëm kur, mbajtja e armëve është në sasi të mëdha, kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë, ose ka sjellur pasoja të rënda, siç shprehet në mënyrë të qartë dispozita e mësipërme ligjore. Në rastin në shqyrtim asnjëri nga këto kritere që përcakton ky paragraf i kësaj dispozite nuk ekziston. Jo vetëm kuptimi i ligjit, por as praktika gjyqësore në rastet e vrasjes me dashje të kësaj natyre, mbajtjen pa leje të armëve luftarake nuk e ka kualifikuar sipas paragrafit të 4-të të nenit 278 të K.Penal.

Duhet theksuar se në fazën e hetimeve paraprake, të gjykuarës i është komunikuar nga ana e prokurorit vetëm akuzat e “mbajtjes pa leje të armëve luftarake” të parashikuar nga paragrafi i dytë i nenit 278 të K.Penal dhe jo ajo e parashikuar nga paragrafi i 4-të i kësaj dispozite,

¹⁶³ Vendim i Gjykatës së Lartë nr. 644 datë 17.10.2007

çfarë pasqyrohet qartë nga të gjitha aktet procedurale të kësaj faze, si proces-verbali i pyetjes së O. C. me cilësinë e të pandehurës, kërkesa për mase sigurimi, vendimi për kryerjen e ekspertimit dhe së fundi edhe në aktin perfundimtar të prokurorit siç është kërkesa për gjykim e paraqitur përpara gjykatës. Por meqënëse gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit e kanë trajtuar këtë akuzë si vepër penale të parashikuar nga neni 278/4 të K.Penal, ndonëse nuk ekziston asnjë vendim i ndërmjetëm apo perfundimtar që në bazë të nenit 375 të K.Pr.Penale të jetë bërë ndryshimi i kualifikimit ligjor të kësaj veprë, pra përderisa të dy shkallët e gjykimit e kanë deklaruar fajtores dhe e kanë dënuar të gjykuarën O. C. për këtë vepër (neni 278/4 të K.Penal), Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në zbatim të nenit 375 të K.Pr.Penale, e bën vetë ndryshimin e kualifikimit ligjor të veprës penale të “mbajtjes pa leje të armëve luftarake” nga paragrafi i 4-te në paragrafin e dytë të nenit 278 të K.Penal. Për rrjedhojë edhe për këtë pjesë vendimi i Gjykatës së Apelit Korçë duhet të ndyshohet, duke i caktuar edhe një masë dënimi në përshtatje me këtë kualifikim ligjor...”

Ndryshimi i cilësimit juridik të veprës penale është i lidhur edhe me ndryshimin e ligjit penal në kohën e gjykimit të autorit të saj nga gjykata. Ndryshimi i ligjit penal në gjykimin e një çështje penale mund të sjellë dhe ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale, nëse ndryshimi i ri e parashikon faktin penal të sjellë për gjykim si vepër penale dhe me ndryshimin e ri ai është më favorizues për t’u zbatuar ndaj të pandehurit.

Gjykata e Lartë në vendimin e saj nr. 432/2003 në lidhje me ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale për shkak të zbatimit të ligjit më favorizues ndaj të pandehurit shprehet se¹⁶⁴:

“...Kolegji Penal është i mendimit se kërkimi i prokurorit në gjykimin e bërë në gjykatën e apelit për aplikimin e nenit 79 germa "dh" të K.Penal, si dispozitë më favorizuese për të gjykuarin nuk është e bazuar, sepse neni 78 i K.Penal që ka qënë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale nga i gjykuari, parashikonte si masë dënimi nga 15 deri në 25 dhe kur kishte rrethana rënduese edhe burgim të përjetshëm, ndërsa neni 79 germa "dh" e K.Penal ka si masë dënimi jo më pak se 20 vjet burgim ose burgim të përjetshëm. Për të përcaktuar se cila është dispozita penale më e favorshme për të gjykuarin, vlerësohet dispozitivi i nenit përkatës duke u bërë krahasimi i minimumit dhe maksimumit të dënimit si dhe të dënimeve alternative të parashikuara nga secila dispozitë, që në rastin në shqyrtim del qartë se neni 79, germa "dh" ka minimum dhe maksimum të tillë që e bën që ajo të jetë dispozitë më e rëndë se neni 78 i Kodit Penal që ka qënë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale nga ana e të gjykuarit...”

5.2.4. Kompetenca lëndore dhe kompetenca funksionale

Kompetencën lëndore dhe funksionale e kemi trajtuar në kapitullin e akuzave të reja dhe më konkretisht në rastin kur prokurori paraqet në gjykim një akuzë që ka lidhje me veprën penale që po gjykohet. Të njëjtat rregulla ndiqen edhe nga gjykata, kur ndodhet përpara situatës së ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale, ndryshim i cili duhet të shoqërohet me dërgimin e çështjes penale në gjykatën kompetente, për shkak të lëndës ose për shkak të funksionit të saj.

¹⁶⁴ Vendim i Gjykatës së Lartë nr. 432 datë 16.07.2003

Përcaktimi i kompetencës në ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale nga gjykata, merr rëndësi të veçantë për shkak se kompetenca është një element i rëndësishëm procedural e kushtetues në funksion të procesit të rregullt ligjor. Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj në disa raste ka theksuar rëndësinë e përcaktimit të kompetencës lëndore dhe funksionale në funksion të zbatimit të një procesi të rregullt ligjor. Në vendimin e saj nr. 11/2009 në lidhje me përcaktimin e drejtë të kompetencës për gjykimin e një çështje Gjykata Kushtetuese shpreh¹⁶⁵:

“...Kërkuesi pretendon se është gjykuar nga gjykatat e krimeve të rënda për veprën penale të vrasjes kundër disa personave mbetur në tentativë, kur duhej të gjykohej nga gjykatat e zakonshme të rretheve gjyqësore dhe, si rrjedhojë, i është cënuar e drejta kushtetuese për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës e të nenit 6 të Konventës Europiane “Mbi Liritë dhe të Drejtat Themelore të Njeriut”.

Në lidhje me këtë aspekt, Gjykata gjen me vend që të ritheksojë, se shprehja “gjykatë ... e caktuar me ligj” në nenin 42/2 të Kushtetutës mbulon jo vetëm bazën ligjore për vetë ekzistencën e gjykatës, por edhe kompozimin e trupit gjykues të ngarkuar për shqyrtimin e çdo çështje konkrete (Vendimi nr.14, datë 17.04.2007 i Gjykatës Kushtetuese). Vetë kompetenca lëndore e gjykatës është e lidhur ngushtë me kompozimin e trupit gjykues të ngarkuar për shqyrtimin e çdo çështje konkrete. Në këtë kontekst, fjala “ligj”, sipas nenit 42 të Kushtetutës, përfshin edhe legjislacionin për krijimin dhe kompetencën e gjykatave, ku kompetenca për gjykimin e çështjeve penale ka të bëjë me rrethin e akuzave, shqyrtimi i të cilave është atribut i gjykatave të llojeve dhe niveleve të ndryshme.

Në përputhje me sa më sipër, Gjykata vlerëson se, nëse një gjykatë nuk ka juridiksion/kompetencë për të gjykuar të pandehurin në përputhje me dispozitat që zbatohen sipas legjislacionit përkatës, ajo nuk është “e krijuar me ligj” sipas kuptimit të nenit 42/2 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të Konventës Europiane...”

Në këto vendime Gjykata Kushtetuese ka përcaktuar se shprehja “gjykatë e krijuar me ligj”, mbulon si bazën ligjore për vetë ekzistencën e gjykatës (kompetenca lëndore), por edhe kompozimin e trupit gjykues për shqyrtimin e çdo çështje konkrete.

Nëse do t’i referohemi kompetencës sipas kuptimit që i është dhënë nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese, themi se komponent i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor është përcaktimi i saktë në një gjykim i kompetencës lëndore dhe funksionale nga gjykata për të proceduar me zgjidhjen e një çështje të sjellë për gjykim.

Siç e kemi përmendur edhe më lart neni 75/a i K.Pr.Penale ka përcaktuar një kategori veprash penale të cilat paraqesin rrezikshmëri të lartë shoqërore për t’u gjykuar nga Gjykata “Për Krimet e Rënda”. Ndarja e veprave penale si lëndë për t’u gjykuar nga gjykata të ndryshme të shkallëve të para është përcaktuar në Kodin e Procedurës Penale mbi bazën e një kriteri ligjor të parashikuar shprehimisht nga neni 75/a i K.Pr.Penale. Në përzgjedhjen e kompetencës lëndore, legjislatori ka marrë parasysh jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese që në disa vendime të cilat do t’i përmendim edhe më poshtë ka përcaktuar elementët e procesit të rregullt ligjor në funksion të kriterit të kompetencës. Në këtë mënyrë legjislatori për shkak të lëndës me të cilën operojnë gjykatat e shkallëve të para në Shqipëri ka bërë një

¹⁶⁵ Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 11 datë 23. 04. 2009; Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 14 datë 17. 04.2007

ndarje të çështjeve penale që duhet të gjykohen nga gjykatat e shkallëve të para dhe çështjeve penale që duhet të gjykohen nga gjykata e shkallës së parë “Për Krimet e Rënda”.¹⁶⁶

Si vepron gjykata në rastin kur konstaton se ndryshimi i cilësimit juridik të veprës penale i përket si kompetencë lëndore një gjykatë tjetër?

Në lidhje me këtë rast mund t’i referohemi praktikës gjyqësore vendase. Më konkretisht Gjykata e Lartë është shprehur se¹⁶⁷:

“...Përcaktimi i drejtë i kompetencës ka rëndësi rregullatore, pasi lidhet dhe me konceptin e procesit të rregullt ligjor sipas nenit 6 të KEDNJ-së, duke shmangur konfliktin midis gjykatave të ndryshme dhe gjykimin dy herë për të njëjtën vepër penale. Ky konflikt mund të evidentohet si ndërmjet gjykatave të së njëjtit nivel, ashtu dhe me një gjykatë të një niveli më të lartë.

Kolegji Penal vlerëson se në rastin objekt shqyrtimi konflikti i krijuar midis Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe Gjykatës së Krimeve të Rënda duhet të trajtohet si një konflikt midis dy gjykatave në shkallë hierarkike të ndryshme dhe jo paralele. Ky diferencim përcaktohet në bazë të natyrës së veprave penale që shqyrtohen nga gjykata e krimeve të rënda, të cilat janë me një rrezikshmëri shoqërore më të lartë për sa i përket rëndësisë së faktit dhe marrëdhënies juridike që mbrohet dhe që shprehet dhe në përcaktimin e kompetencës lëndore me një grup veprash penale të përcaktuara qartë në nenin 75 të K.Pr.Penale¹⁶⁸.

Kompetenca lëndore përcaktohet para së gjithash nga akuzat e ngritura nga prokurori ndaj të pandehurit, e cila përzgjedh në mënyrë automatike sipas dispozitave procedurale penale edhe gjykatën e cila në bazë të ligjit duhet ta gjykojë çështjen. ...Referuar vendit ku pretendohet se është kryer vepra penale çështja është në kompetencë tokësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.... Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vlerëson se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër nuk ka zbatuar drejt nenin 375 të K.Pr.Penale¹⁶⁹ për sa i përket shpalljes së vendimit të moskompetencës, ndërkohë që ishte tërhequr në dhomë këshillimi për të marrë vendimin përfundimtar.

... Gjithashtu është theksuar se një nga kushtet është që këtë ndryshim mund t’a bëjë kur kjo është në kompetencë të saj. Në rast se akuzat e reja nuk është në kompetencë të gjykatës, duke e lidhur me nenin 85 të K.Pr.Penale, aktet i dërgohen gjykatës kompetente.

Gjykata Kushtetuese në vendimin e sipërcituar ka trajtuar dhe momentet procedurale kur konstatohet nga ana e gjykatës moskompetenca dhe mënyra e reagimit prej saj në varësi të

¹⁶⁶ Ndryshimet e fundit të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale suprimojnë Gjykatën e Krimeve të Rënda dhe në vend të saj krijohet Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar e cila në kompetencën e saj lëndore gjykon veprat penale kundër korrupsionit, krimit të organizuar, si dhe të gjitha akuzat penale kundër zyrtarëve të lartë të përcaktuara shprehimisht nga neni 75/a pikat “a”, “b”, “c”, “ç” i Kodit të Procedurës Penale që hyn në fuqi më datë 1 gusht 2017

¹⁶⁷ Vendim i Gjykatës së Lartë nr. 00 – 2011 – 1106 datë 27.12.2011

¹⁶⁸ “Gjykata e Krimeve të Rënda gjykon krimet e parashikuara nga nenet 73, 74, 75, 79, shkronjat “c” dhe “ç”, 109, 109/b, 110/a, 111, 114/b, 128/b, 219, 220, 221, 230, 230/a, 230/b, 231, 232, 233, 234, 234/a, 234/b, 278/a, 282/a, 283/a, 284/a, 287/a, 333, 333/a e 334 të Kodit Penal, duke përfshirë edhe rastet kur ato janë kryer nga të miturit.”

¹⁶⁹ “Me vendimin përfundimtar gjykata mund t’i japë faktit një përcaktim të ndryshëm nga ai që ka bërë prokurori ose i dëmtuari akuzues, më të lehtë ose më të rëndë, me kusht që vepra penale të jetë në kompetencën e saj.”

fazës së gjykimit, duke ndarë në dy momente: a) gjatë hetimit gjyqësor dhe b) mbas mbylljes së shqyrtimit gjyqësor kur është tërhequr për vendim.

...Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në kushtet kur i është shtruar për zgjidhje konflikti i kompetencës midis dy gjykatave mbas kundërshtimit nga ana e gjykatës së Krimeve të Rënda, vendosi të analizoje edhe shkaqet e parashtruara në vendimin e moskompetencës për sa i përket pretendimit në lidhje me kualifikimin ligjor të faktit penal për sa i përket bashkëpunimit, si element i kryerjes së veprës penale nga bashkëpunim i thjeshtë në format e veçanta të bashkëpunimit si grup i strukturuar kriminal. Përcaktimi i drejtë i gjykatës kompetente ka rëndësi sepse i hap rrugë një procesi të rregullt ligjor nga një gjykatë e caktuar me ligj me pasojë pavlefshmëri të procesit dhe të vendimit. Në rast se vendimi jepet nga gjykata jo kompetente, pavaresisht se si është zgjidhur çështja, i hap rrugën një procesi të pavlefshëm i cili në rast se kundërshtohet nga palët mund të shpallet i pavlefshëm në bazë të nenit 86 të K.Pr.Penale.

Ky qëndrim në lidhje me respektimin nga gjykata të kompetencës dhe të pasojave në procesin penal është analizuar dhe në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese (vendimi nr.11, datë 23.04.2009). Në këtë vendim shprehet se: "...detyrimi i respektimit nga gjyqtari të kufirit të kompetencës është ndër të tjera parakusht për të mos lejuar që shumë gjyqtarë të ushtrojnë të njëjtin pushtet me vendime për një fakt të caktuar, duke cënuar parimin kushtetues të ligjshmërisë apo të gjykimit të një personi dy herë për të njëjtën vepër (ne bis in idem), të parashikuar përkatësisht në nenet 4/1 dhe 34 të Kushtetutës. Prandaj, për çdo rast dhe çështje të mundshme, ligji ka parashikuar një gjykatë kompetente për të gjykuar".

Kolegji Penal vlerëson se, duke arritur në këtë konkluzion për ndryshimin e formës së bashkëpunimit, Gjykata e Shkallës së Parë Shkodër ka vepruar në kundërshtim me funksionin që ajo ka si organ që jep drejtësi dhe duke marrë atributet që ka prokurori si organi që ngre akuzë. Ndryshe nga sa pretendon kjo gjykatë se faktit penal i ka dhënë një kualifikim tjetër ligjor sipas nenit 375 të K.Pr.Penale, vendimin e moskompetencës e ka ngritur në bazë të një akuze të re të ngritur prej saj. Kështu, përveç akuzës së ngritur nga prokurori për veprën penale të kultivimit të lëndëve narkotike të kryer në bashkëpunim sipas nenit 284/2 dhe 3 të Kodit Penal, gjykata i ka akuzuar dhe për veprën penale të krijimit të grupit të strukturuar kriminal, të parashikuar nga neni 333/a të Kodit Penal. Gjykata nuk ka pasur parasysh në vendim kur ka ndryshuar formën e bashkëpunimit përcaktimin e nenit 28/5 të Kodit Penal, i cili e klasifikon krijimin dhe pjesëmarrjen në një grup të strukturuar kriminal si vepër penale dhe dënimin sipas parashikimit në pjesën e posaçme të Kodit Penal.

Kolegji Penal vlerëson se e drejta që i është dhënë trupit gjykues për të verifikuar kryesisht kompetencën lëndore nuk duhet të përdoret në mënyrë abuzive duke investuar një gjykatë tjetër, çka dëmton përfundimin e procesit penal brenda një afati të arsyeshëm dhe duke rrezikuar ligjshmërinë e procesit. Vendimi për shpalljen e moskompetencës është alogjik, pasi nuk bazohet në asnjë prej provave të cilat janë shqyrtuar gjatë gjykimit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka arritur në konkluzionin alogjik se 52 fermerë, të cilët në këtë proces janë si të pandehur në kuadër të veprimtarisë së tyre prodhuese në mënyrë të hapur, ditën për diell kanë vepruar si grup i strukturuar kriminal (formë e veprimtarisë kriminale të kriminit të organizuar), duke sfiduar shtetin. Gjykata është bazuar në prova të njëanshme si dhe pretendimet e prokurorit pa vënë në diskutim provat në tërësi dhe pretendimet e të pandehurve në lidhje me

faktin nëse kemi të bëjmë me lëndë narkotike të llojit *canabis sativa* të ndaluar nga ligji apo kërç industrial, dijeninë e tyre, etj.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër duke ngritur një akuzë tjetër në vendimin e saj të moskompetencës ka vepruar jashtë kufijve të së drejtës, duke i dhënë atributet që ka prokurori sipas nenit 24/1 të K.Pr.Penale. Në kushtet kur vendimi nr.44, datë 27.01.2011 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër për shpalljen e moskompetencës nuk është i mbështetur në ligj, duhet të priset dhe çështja duhet të dërgohet pranë kësaj gjykate për vazhdimin e mëtejshëm të gjykimit, me të njëjtin trup gjykues...”

Edhe për kompetencën funksionale e cila lidhet me numrin e gjyqtarëve si pjesë përbërëse e trupit gjykues për të gjykuar çështje penale konkrete, duhet të veprohet me kujdesin e duhur për shkak të respektimit të procesit të rregullt ligjor. Kompetenca funksionale që përcakton numrin e gjyqtarëve që nevojiten për gjykimin e një çështje penale është parashikuar nga neni 13 i K.Pr.Penale.

Me ndryshimet e fundit të Kodit me Ligjin nr. 35/2017, në nenin 13 paragrafi 3 të Kodit është përcaktuar se gjykohen me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë veprat penale të cilat parashikojnë një dënim jo më pak se 10 vjet burgim.

Rregullat e ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale nga gjykata kur konstaton se për veprën e re penale të cilës i është ndryshuar cilësimi juridik duhet të gjykohet nga një trup gjykues me kompetencën e duhur funksionale, janë të njëjta me ato që parashikohen për kompetencën ligjore të përmendur më sipër. Kështu nëse një gjyqtar konstaton gjatë gjykimit se ndryshimi i cilësimit juridik lidhet me një veprë penale e cila duhet të gjykohet me tre gjyqtarë, nuk mund të bëjë vetë ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale për shkak të kriterit kufizues që është parashikuar nga neni 375 i K.Pr.Penale. Në këtë situatë gjyqtari duhet të shpallë moskompetencën funksionale të parashikuar nga neni 13 i K.Pr.Penale dhe çështjen penale në gjykim duhet ta dërgojë në gjykatën kompetente të përbërë me trup gjykues prej tre gjyqtarësh.

5.3. Cilësimi juridik i veprës penale sipas ndryshimeve në Kodin e Procedurës Penale

Ndryshimet e fundit në Kodin e Procedurës Penale të kryera me Ligjin nr. 35/2017 kanë prekur dhe nenin 375. Formulimi i nenit 375 të K. Pr. Penale është ndryshuar si më poshtë:

“1. Me vendimin përfundimtar gjykata mund t’i japë faktit një përcaktim të ndryshëm nga ai që ka bërë prokurori ose i dëmtuari akuzues, më të lehtë ose më të rëndë, me kusht që vepra penale të jetë në kompetencën e saj.

2. Kur në përfundim të shqyrtimit gjyqësor gjykata vlerëson se fakti për të cilin akuzohet i pandehuri mund të ketë cilësim juridik më të rëndë se ai që ka bërë prokurori ose viktima akuzuese, njofton palët mbi këtë mundësi dhe u jep kohën e nevojshme për t’u mbrojtur. Palët kanë të drejtë të paraqesin prova të reja.

3. Kur gjykimi zhvillohet në mungesë të të pandehurit, sipas nenit 352, të këtij Kodi, gjykata zbaton rregullat e përcaktuara në paragrafët 1 dhe 2 të tij.”

Pjesa më e rëndësishme e ndryshimit që ka pësuar neni 375 i K.Pr.Penale ka të bëjë me paragrafin e dytë të dispozitës objekt referimi që lidhet me mundësinë e ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale nga gjykata në përfundim të shqyrtimit gjyqësor.

Sipas ndryshimeve të reja, nëse cilësimi juridik i veprës penale i bërë nga gjykata është më i rëndë se ai që ka bërë prokurori ose viktimi akuzuese, gjykata nuk merr vendim përfundimtar, por njofton palët mbi mundësinë e këtij ndryshimi duke u dhënë kohën e nevojshme për t'u mbrojtur. Ndryshimet e reja në nenin 375 të K.Pr.Penale na risjellin edhe një herë në vëmendje, të njëjtën dispozitë përbërëse në miratimin e Kodit të Procedurës Penale në vitin 1995. Fillimisht neni 375 i K.Pr.Penale ka qenë formuluar si në vijim:

“1. Gjykata mund t'i japë faktit një përcaktim juridik, të ndryshëm nga ai që ka bërë prokurori, me kusht që vepra penale të jetë në kompetencën e saj, duke vënë në dijeni palët.”

Përmbajtja e kësaj dispozite kaloi dhe kontrollin kushtetues për shkak të dyshimeve të ngritura në lidhje me paragjykimin (njëanshmërinë) e çështjes penale nga gjykata, në rastin e vënies në dijeni të palëve mbi ndryshimin e cilësimit juridik të faktit penal nga vetë gjykata, përpara dhënies së vendimit përfundimtar.

Kështu Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 50/1999 është shprehur mbi përputhshmërinë e nenit 375 të K.Pr.Penale të përmendur më sipër, në raport me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Për pjesën e njoftimit të palëve mbi ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale nga gjykata përpara se ajo të shprehet me vendim përfundimtar, Gjykata Kushtetuese në këtë pikë është shprehur se¹⁷⁰:

“...Gjykata, duke i dhënë faktit një përcaktim juridik të ndryshëm nga ai i prokurorit, mund të bëjë që cilësimi i ri të jetë një vepër penale më e lehtë ose më e rëndë. Në rastin e fundit nuk do të thotë se rëndohet pozita e të pandehurit. Rëndimi i pozitës trajtohet në raport me shkallën më të lartë të gjykimin. Kur gjykata bën cilësimin e drejtë ligjor të veprës, pavarësisht nga karakteri i saj më i rëndë, ajo ka bërë një zbatim të drejtë të ligjit dhe duke vënë në dijeni palët u krijon atyre mundësinë për t'u ankuar ndaj vendimit.

Për zbatimin e nenit 375 të Kodit të Procedurës Penale, kërkohen edhe kushte të tjera. Njëri nga kushtet është që gjykata këtë ndryshim mund ta bëjë kur vepra penale është në kompetencën e saj. Në rast se vepra penale nuk është në kompetencë të gjykatës, ajo nuk mund ta bëjë ndryshimin por ia dërgon çështjen organit kompetent. Kushti tjetër është që për ndryshimin të verë në dijeni palët. Kur gjykata bën ndryshimin gjatë seancës me vendim të ndërmjetëm, ua komunikon atë palëve. Por në rast se gjykata konstaton se duhet bërë ndryshimi i cilësimit juridik të veprës pas mbylljes së shqyrtimit gjyqësor kur është tërhequr për vendim, atëhere duhet të riçelë seancën dhe të vejë në dijeni palët, dhe të dëgjojë edhe pretendimet e tyre. Kështu ajo garanton të drejtën e mbrojtjes dhe të akuzës së prokurorit. Zbatimi në këtë mënyrë i kërkesave të nenit 375 të Kodit të Procedurës Penale, është një garanci për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, duke e vënë gjykatën në rolin që i takon për dhënien e drejtësisë. Prandaj, neni 375 i Kodit të Procedurës Penale jo vetëm që nuk vjen në kundërshtim me nenin 148 të Kushtetutës, por është në përputhje edhe me parimet e tjera kushtetuese të zhvillimit të një gjykimi të drejtë nga një gjykatë e paanshme...”

¹⁷⁰ Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 50 datë 30.07.1999

Në këtë vendim të Gjykatës Kushtetuese vihen re dy parime të rëndësishme në funksion të procesit të rregullt ligjor, që janë *e drejta e mbrojtjes dhe zhvillimi i një gjykimi të drejtë nga një gjykatë e paanshme*. Pra vënia në dijeni e palëve nga gjykata paraprakisht mbi ndryshimin e cilësimit juridik të faktit penal të sjellë për gjykim edhe në rastin kur ky ndryshim mund të rëndojë pozitën e të pandehurit, nuk është shkelje e parimit të pavarësisë dhe paanshmërisë së gjykatës kur ajo kryen këtë veprim. Gjykata Kushtetuese në këtë vendim gjyqësor shkon edhe më tej në argumentimin e saj, duke nënvizuar se vënia në dijeni nga gjykata për të pandehurin me vendim të ndërmjetëm mbi ndryshimin e cilësimit juridik të fakti penal edhe në rëndim të pozitës së tij është në përputhje me parimin e së drejtës së mbrojtjes. Pasi të vihet në dijeni me ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale, i pandehuri ka mundësi që të përgatisë mbrojtjen e tij përpara të njëjtës gjykatë edhe për ndryshimin e cilësimit juridik të bërë nga gjykata.

Më vonë me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002 neni 375 i K.Pr.Penale u ndryshua si në vijim:

“Me vendimin përfundimtar gjykata mund t’i japë faktit një përcaktim të ndryshëm nga ai që ka bërë prokurori ose i dëmtuari akuzues, më të lehtë ose më të rëndë, me kusht që vepra penale të jetë në kompetencën e saj.”

Sipas këtij ndryshimi gjykata me vendimin e saj përfundimtar mund t’i jap faktit një cilësim të ndryshëm juridik edhe duke rënduar pozitën e të pandehurit, pa njoftuar palët paraprakisht për këtë ndryshim. Ky ndryshim ishte i dukshëm në raport me mënyrën sesi duhet të vepronte gjykata për të ndryshuar cilësimin juridik të veprës penale.

Në pamje të parë duket se ndryshimi i dytë i nenit 375 të K.Pr.Penale është më cilësor, pasi gjykata në këtë rast qëndron mbi palët, nuk përfshihet në shfaqen e mendimit të saj mbi përfundimin e procesit penal paraprakisht, por mendimin e saj mbi zgjidhjen e çështjes penale gjykata e jep me vendimin e saj përfundimtar.

Në mënyrë indirekte kjo dispozitë procedurale është verifikuar edhe nga GJEDNJ-ja, mbi një ankim që i është drejtuar kësaj gjykate nga një i dënuar nga autoritetet gjyqësore shqiptare.

Më konkretisht një rast i gjykuar nga gjykatat shqiptare është shqyrtuar në Gjykatën e Strasburgut mbi bazën e ankimeve të paraqitura nga disa të dënuar.¹⁷¹ Ndër të tjera aplikuesit në Gjykatën e Strasburgut u ankuan edhe për shkeljen e së drejtës së mbrojtjes sipas nenit 6 të Konventës, për shkak të rikualifikimit të veprës penale të bërë nga gjykata e shkallës së parë në vendimin e saj përfundimtar duke u mbështetur në nenin 375 të Kodit tonë të Procedurës Penale.

Në lidhje me ndryshimin e cilësimit juridik të bërë nga gjykata e shkallës së parë, Gjykata e Strasburgut në vendimin e saj, arsyetoi se gjatë vlerësimit të drejtësisë së ushtruar në tërësinë e të gjitha procedurave, riklasifikimi i një krimi nuk përbën shkelje të së drejtës së mbrojtjes, nëse i pandehuri pas këtij veprimi të bërë nga gjykata ka pasur mjaftueshëm mundësi të mbrojë veten. Në këtë rast ankuesi e kundërshtoi riklasifikimin e veprës penale në Gjykatën e Apelit, gjykatë e cila ka kompetencë ligjore për të shqyrtuar ankimin mbi bazën e faktit e të ligjit penal të zbatuar. Në vlerësimin e Gjykatës së Strasburgut ankuesi pati kohën dhe lehtësirat e duhura për të përgatitur mbrojtjen e tij ndaj riformulimit të veprës penale të bërë nga gjykata e shkallës

¹⁷¹ EHRC – Case of Haxhia v. Albania Applications no. 29861/03

së parë. Në fakt ankuesi paraqiti ankimin e tij *inter alia* në Gjykatën e Apelit, si pjesë të cënimit të së drejtës së mbrojtjes së tij për riklasifikimin e veprës penale.¹⁷²

Pra neni 375 i K.Pr.Penale e ka kaluar testin e kontrollit të përputhshmërisë në raport me parimin e ushtrimit të një mbrojtjeje efektive nga i pandehuri në një proces penal, kur mundësinë për të përgatitur mbrojtjen mbi ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale i pandehuri e ushtron në Gjykatën e Apelit.

Më konkretisht për këtë pjesë GJEDNJ u shpreh se¹⁷³:

“...Gjatë vlerësimit të drejtësisë së ushtruar në tërësinë e procedurave penale gjykata pranoi se riklasifikimi i një krimi nuk shkel të drejtat e mbrojtjes nëse i pandehuri ka pasur mjaftueshëm mundësi të mbrojë veten e tij gjatë procedurave të rishqyrtimit (Dallos v Hungari, Sipavičius kundër Lituanisë). Në çështjen konkrete ankuesi e kundërshtoi dënimin e tij dhe riklasifikimin përpara gjykatës së Apelit, gjykatë e cila është kompetente për t’u marrë me këtë çështje...

Prandaj gjykata vlerëson se duke pasur parasysh faktet e çështjes veçanërisht materialet e paraqitura së fundmi nga prokurori në procesin gjyqësor siç parashtrohet edhe në vendimin e Gjykatës së Rrethit, nuk mund të thuhet se ankuesi nuk mund ta studionte riklasifikimin e akuzës penale kundër tij. Ankuesi pati kohën dhe lehtësirat e duhura për të përgatitur mbrojtjen e tij ndaj akuzës së riformuluar dhe në fakt ai e paraqiti përpara gjykatës së Apelit mbrojtjen e tij për akuzën e riformuluar. Në këtë këndvështrim kjo çështje dallon nga çështja Pelissier dhe Sassi ku gjykata e Kasacionit nuk rishqyrtoi “maturinë” e Gjykatës së Apelit në riklasifikimin e akuzës.

Pra neni 375 i K.Pr.Penale përpara ndryshimit të fundit mund të krijonte probleme me të drejtën e mbrojtjes së të pandehurit, nëse shqyrtimi gjyqësor fillon e mbaron në gjykatën e shkallës së parë dhe ndryshimi i cilësimit juridik të veprës penale bëhet me vendimin përfundimtar nga gjykata. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për gjykatën e apelit, pasi ndryshimi i cilësimit juridik të veprës penale mund të bëhet edhe në gjykatën e apelit e cila me vendim përfundimtar mund t’i jap faktit një cilësim të ndryshëm juridik duke rënduar pozitën e të pandehurit. Rëndimi i pozitës procedurale të të pandehurit në gjykatën e apelit për shkak të ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale të bërë nga kjo gjykatë në vendimin e saj përfundimtar, mund të krijojë probleme që lidhen me procesin e rregullt ligjor për shkak se i pandehuri pas vendimit rëndues që merr nga gjykata e apelit nuk ka mundësi reale për të paraqitur prova në ankimin e tij në një gjykatë më të lartë. Kujtojmë këtu se Gjykata e Lartë është një gjykatë që shqyrton ankimet vetëm për shkelje të ligjit e si e tillë ajo nuk merr në shqyrtim prova të kërkuara nga palët.

Në çështjen *Pélissier and Sassi v. France* GJEDNJ-ja thekson procedurën që duhet të ndjekë një gjykatë në rastin e ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale, me qëllim që të pandehurit të mos i cënohet e drejta për t’u informuar mbi natyrën dhe shkakun e akuzës si dhe

¹⁷² EHRC – Case of Haxhia v. Albania Applications no. 29861/03

¹⁷³ EHRC – Case of Haxhia v. Albania po aty.

e drejta për të pasur kohën dhe lehtësirat e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e tij. Në lidhje me këtë moment GJEDNJ-ja është shprehur se¹⁷⁴:

“...gjkata në përputhje me rrethanat vlerëson se në përdorimin e së drejtës së gjykatës për të riklasifikuar faktet e cila pa asnjë mëdyshje është pjesë e ushtrimit të juridiksionit të saj, Gjykata e Apelit të Aix – en – Provence duhet ti kishte ofruar aplikantëve mundësinë e ushtrimit të mbrojtjes së tyre për ndryshimin cilësimit të veprës penale në mënyrë praktike dhe efektive në kohën e duhur. Nuk rezulton asnjë shpjegim nga kjo çështje se pse psh seanca nuk u shty për argumente të mëtejshme, ose pse aplikantëve nuk u është kërkuar të parashtronjë me shkrim pretendimet e tyre gjatë kohës që çështja ishte në gjykim në gjykatën e apelit.

Në të kundërt të kësaj të përmendur më lart, materiali përpara gjykatës informon se aplikuesve nuk u është dhënë mundësia të përgatisin mbrojtjen e tyre për akuzat e reja. Vetëm në vendimin e dhënë nga Gjykata e Apelit ata mësuan për rikualifikimin e fakteve. Thjesht kjo ishte tepër vonë për aplikuesit.

Për sa më sipër gjykata konkludon se e drejta e aplikuesve për tu informuar në detaje për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër tyre dhe e drejta e tyre për të pasur kohën dhe lehtësinë për të përgatitur mbrojtjen e tyre janë të cënuara. Rrjedhimisht ka shkelje të paragrafit 3 (a) dhe (b) të nenit 6 të Konventës e marrë së bashku me paragrafin e 1 të këtij neni e cila parashikon gjykimin e drejtë...”.

Më tej jurisprudenca e GJEDNJ-së mbi rikualifikimin e veprës penale nga gjykata dhe rregullat që duhet të ndiqen prej saj në mënyrë që të mos cënohen të drejtat e të pandehurit në lidhje me informimin në detaje të akuzës dhe e drejta e mbrojtjes ndaj këtij ndryshimi është konsoliduar edhe në çështje të tjera të ngjashme. Në këto vendime GJEDNJ-ja shprehet se *“informacioni që lidhet me akuzën duke përfshirë edhe karakteristika ligjore të saj, të cilat gjykata mund t’i adoptojë si pjesë e vendimmarrjes së saj, duhet t’i bëhen të njohur të pandehurit përpara gjykimit të akuzës (siç mund të jetë rasti i seancës paraprake) ose së fundmi përgjatë fazës së shqyrtimit gjyqësor”*¹⁷⁵.

Në këtë kuptim një referim i përgjithshëm në seancë mbi mundësinë e gjykatës për të arritur në përfundim të ndryshëm nga prokurori përse i përket kualifikimit të një vepre penale është qartësisht e pamjaftueshme.¹⁷⁶ Pra në rastin e riklasifikimit të faktit penal nga gjykata gjatë gjykimit, të pandehurit duhet t’i ofrohet prej saj mundësia e ushtrimit të së drejtës së mbrojtjes në mënyrë praktike dhe efektive duke i dhënë të pandehurit dhe një afat të caktuar kohor për të përgatitur mbrojtjen¹⁷⁷.

Në rikualifikimin e një vepre penale sipas GJEDNJ-së, vlerësohet si veprim i mjaftueshëm për t’u parashikuar nga i pandehuri nëse gjykata në rikualifikim i referohet një elementi i cili është i lidhur me akuzën dhe i evidentuar si i tillë gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes penale¹⁷⁸.

¹⁷⁴ EHRC - Case of Pélissier and Sassi v. France, Application no. 25444/94, 25 March 1999

¹⁷⁵ Guide on Article 6 “Right to a fair trial”, Counsel of Europe 2014, available for download at www.echr.coe.int

¹⁷⁶ EHRC case I. H and Others v. Austria

¹⁷⁷ EHRC case Block v. Hungary

¹⁷⁸ EHRC case of De Salvador Torres v. Spain, case of Sadak and others v. Turkey, case of Juha Nuutinen v. Finland

Edhe një herë sjellim në vëmendje se defektet mbi njoftimin për rikualifikimin e akuzës sipas GJEDNJ-së mund të riparohen në Gjykatën e Apelit, nëse i pandehuri ka pasur mundësinë të apelojë vendimin e dhënë nga gjykata në një gjykatë më të lartë, duke ushtruar të drejtën e tij të mbrojtjes në respekt të riformulimit të akuzës dhe të kundërshtojë dënimin e dhënë, si për kualifikimin e veprës penale ashtu edhe për faktin penal¹⁷⁹.

Mendoj se jurisprudenca e GJEDNJ-së mbi rikualifikimin nga gjykata, të veprës penale të sjellë për gjykim nga prokurori ka ndikuar në lidhje me ndryshimin (e kryer me Ligjin nr. 35/2017) e nenit 375 të K.Pr.Penale.

Sipas ndryshimeve të fundit, gjykata në përfundim të gjykimit duhet të njoftojë të pandehurin për mundësinë e ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale me qëllim që t'i jepet koha e nevojshme për të përgatitur mbrojtjen mbi ndryshimin e cilësimit të njoftuar prej gjykatës.

Në këtë aspekt vlerësoj se ndryshimi i nenit 375 të K.Pr.Penale, na rikujton formulimin origjinal të kësaj dispozite dhe është në përputhje me standardet e kërkuara nga GJEDNJ-ja për të garantuar procesin e rregullt ligjor. Në këtë kuptim mund të themi se ndryshimet e reja në nenin 375 të K.Pr.Penale përafrohen me standardin e përdorur dhe nga Kodi i Procedurës Penale të Gjermanisë¹⁸⁰.

5.3.1. Ndryshimi i cilësimit juridik në gjykimin në apel

Trajtimin e ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale në gjykatën e apelit apo edhe në Gjykatën e Lartë e vlerësova si pjesë të rëndësishme të punimit duke ju referuar një rasti praktik, i cili ka ngritur disa probleme procedurale që parashtrohen në këtë pikë të punimit.

Më konkretisht Gjykata e Apelit “Për Krimet e Rënda” në vendimin nr. 88/2016¹⁸¹, është shprehur se:

“...I pandehuri B. N është gjykuar fillimisht nga Gjykata e shkallës së parë “Për Krimet e Rënda” Tiranë për akuza e sjella për gjykim të “Trafikimit të narkotikëve” në bashkëpunim mbetur në tentativë sipas neneve 283/a/2 – 22 të Kodit Penal dhe për akuzën e “Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe municionit” sipas nenit 278/2 të Kodit Penal.

Gjykata e shkallës së parë “Për Krimet e Rënda” Tiranë me vendimin e saj përfundimtar me nr. 54 datë 22. 04. 2016 ka vendosur: Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit B. N për veprën penale të “Trafikimit të narkotikëve” në bashkëpunim mbetur në tentativë sipas neneve 283/a/2 e 22 të Kodit Penal për shkak se nuk provohet se i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Deklarimin fajtor të të pandehurit B. N për veprën penale të “Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe municionit” sipas nenit 278/2 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 2 vjet e 9 nëntë muaj burgim.

¹⁷⁹ EHRC case of Zhupnik v.Ukraine

¹⁸⁰ Neni 265 i Kodit të Procedurës Penale Gjermane

¹⁸¹ Vendim i Gjykatës së Apelit “Për Krimet e Rënda” Tiranë nr. 88 datë 13.09.2016

Gjykata e apelit e shqyrtoi këtë çështje penale mbi ankimin e prokurorit i cili kishte kërkuar ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë duke e deklaruar të pandehurin fajtor edhe për veprën penale të "Trafikimit të narkotikëve" në bashkëpunim mbetur në tentativë sipas neneve 283/a/2 e 22 të Kodit Penal dhe dënimit të tij me 12 vjet burgim dhe në bashkim të dënimeve sipas nenit 55 të K. Penal dënimit përfundimtar të të pandehurit me 13 vjet burgim.

...Gjykata e apelit Për Krimet e Rënda në analizë të provave të shqyrtuara dhe të verifikuara në këtë proces çmon të drejtë apelin e paraqitur nga prokurori në lidhje me fajësinë e të pandehurit për veprën penale të Trafikimit të narkotikëve në bashkëpunim në formën e eksportimit të sasisë prej 1530, 45 gram heroinë sekuestruar në automjetin e drejtuar nga bashkë i pandehuri N. Sh. në qytetin e Fierit. Në ndryshim nga prokurori në vlerësimin e provave të marra në këtë proces penal ky kolegji vlerëson se në rastin konkret bashkëpunimi mes të pandehurve të përfshirë në këtë aktivitet kriminal është në formën e grupit të strukturuar kriminal për arsye që do i analizojmë më poshtë.

Në lidhje me formën e bashkëpunimit në ndryshim nga prokurori që e ka cilësuar trafikimin e narkotikëve si të kryer në bashkëpunim ky kolegji konform nenit 375 të K.Pr.Penale arrin në konkluzionin se bashkëpunimi mes të pandehurve në këtë procedim penal është në formën e grupit të strukturuar kriminal...

Në lidhje me ndryshimin e cilësimit juridik të faktit penal të atribuuar të pandehurit gjatë këtij gjykimi në apel ky kolegji vlerëson dhe mori në analizë respektimin e dy parimeve të rëndësishme të procesit penal "iuria novit curia" krahas "Reformatio in peius". Ky kolegji vlerëson se duhet theksuar fakti që apelues është prokurori i cili kundërshton vendimin e gjykatës së shkallës së parë në pjesën ku është disponuar pafajësia e të pandehurit për trafikimin e narkotikëve. Në këto kushte në zbatim të nenit 425/2 gërma "a" të K. Pr. Penale si dhe në zbatim të parimit iura novit curia gjykata e apelit ka detyrimin të jap faktit të atribuuar të pandehurit cilësimin e duhur ligjor edhe në lidhje me formën e veçantë të bashkëpunimit.

Elementi i dytë që duhet të theksohet në rastin konkret është fakti se gjykimi në shkallë të parë është zhvilluar sipas procedurës së gjykimin të zakonshëm fakt që nënkupton se provat janë debatuar dhe vlerësuar në një proces kontradiktore duke i dhënë mundësi të pandehurit të përgatis mbrojtjen dhe të kundërshtojë çdo provë dhe akt në ngarkim të tij. Sa më larg vlerësohet me rëndësi nga gjykata në funksion të garantimit të të drejtave kushtetuese e procedurale të të pandehurit rrjedhojë e logjikës është konkluzioni se në këtë rast nuk është rënduar pozita e të pandehurit në raport me akuzën e atribuuar dhe realizimin e një mbrojtje efektive prej tij..."

Çështjet që paraqesin probleme në raport me cilësimin juridik të veprës penale që i bën gjykata apelit lidhen me dy pika kryesore: Së pari, a mundet gjykata e apelit të rëndojë pozitën e të pandehurit më tepër sesa është kërkuar prej prokurorit në ankimin që ka paraqitur kundër vendimit të dhënë nga gjykata e shkallës së parë? Së dyti, a mundet gjykata e apelit t'i rëndojë më tepër pozitën të pandehurit duke e cilësuar veprën penale të kryer në bashkëpunim në një nga format e veçanta të bashkëpunimit të parashikuar nga neni 28 i Kodit Penal?

Në lidhje me çështjen e parë zgjidhjen e problemit duhet ta shohim në përfundimet e arritura më lart për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale. Fillimisht mund të themi me siguri se gjykata e apelit mund t'i rëndojë pozitën të pandehurit kur apelues i këtij vendimi është prokurori. Rëndimi i pozitës së të pandehurit në gjykimin në apel nuk krijon probleme juridike,

kur ky rëndim pozite është në nivelin e apelit të kërkuar nga prokurori. Duke ju referuar rastit konkret, nëse gjykata do të cilësonte veprën penale të trafikimit të narkotikëve në bashkëpunim, mbetur në tentativë ashtu si kundër është kërkuar nga prokurori në ankim, vendimi i gjykatës nuk do të paraqiste asnjë problem nga pikëpamja e garancisë që i ofrohet të pandehurit për të përgatitur mbrojtjen e tij. Në këtë rast i pandehuri nuk vihet përpara një vendimi “surprizë” të gjykatës së apelit.

Përkundrazi, i pandehuri ka pasur mundësinë të parashikojë si alternativë vendimi në gjykatën e apelit edhe vendimin i cili do të mbështeste ankimin e bërë nga prokurori. Në këtë rast në apel, të pandehurit i janë dhënë mundësitë që ai të njihet në detaje me përmbajtjen e ankimit të prokurorit si dhe i është dhënë koha e lehtësirave e nevojshme që përpara gjykimin në apel i pandehuri të përgatisë mbrojtjen e tij. Në rastin konkret i pandehuri është njohur me apelin e prokurorit, i cili kishte kërkuar ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë duke e deklaruar fajtor atë për veprën penale të trafikimit të narkotikëve në bashkëpunim, mbetur në tentativë. Kështu që në seancë gjyqësore në gjykatën e apelit i pandehuri është i përgatitur për mbrojtjen e tij në raport me ankimin e prokurorit.

Në këtë pikë i pandehuri nuk mund të mbrohet nga parimi “*Reformatio in peius*” në gjykatën e apelit.

Sipas vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë nr. 2/2009 me parimin *reformatio in peius*¹⁸² duhet të kuptojmë situatën e përcaktuar si më poshtë:

“...Kolegjet e Bashkuara megjithëse konstatojnë që në në Kodin e Procedurës Penale, vetëm në pikën 3 të dispozitës së nenit 425 të tij, është sanksionuar shprehimisht me ligj parimi i mosrëndimit të pozitës (që, gjykata nuk mund të caktojë një dënim më të rëndë, të zbatojë një masë sigurimi më të rëndë, t’i japë pafajësisë një shkak më pak të favorshëm nga ai i vendimit të apeluar, kur apeluar është vetëm i pandehuri), edhe pse nuk gjëndet, në formë të shprehur qartë (eksplicite), arritën në përfundimin sipas të cilit, parimi i mosrëndimit të pozitës së të pandehurit duhet të gjejë zbatim në të gjitha shkallët e gjykimin të çështjes (d.m.th. edhe gjatë gjykimin dhe rigjykimin të saj në Gjykatën e Lartë, apo gjatë rigjykimin në gjykatën e shkallës së parë)...”.

Referuar rastit të përmendur më sipër themi se dhe në përputhje me vendimin e mësipërm unifikues i pandehuri nuk mund të mbrohet me parimin *reformatio in peius* për shkak se ankimi në këtë rast është paraqitur nga prokurori. Kështu që i pandehuri është mbrojtur në kufijtë e parashikueshmërisë së ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale materializuar në mbrojtjen ndaj veprës penale të *Trafikimit të narkotikëve* në bashkëpunim, mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 283/a/2 e 22 të Kodit Penal.

Por Gjykata e Apelit në vendimin e saj përfundimtar rëndoi më tepër pozitën procedurale të të pandehurit, pasi ajo gjykatë dënoi për një veprë penale më të rëndë se ajo e kërkuar nga prokurori, siç ishte vepra penale e *Trafikimit të narkotikëve* kryer në formën e grupit të strukturuar kriminal, mbetur në tentativë e parashikuar nga neni 283/a/1/22 e 334 të Kodit Penal. Vendimi i dhënë nga Gjykata e apelit ishte një vendim përfundimtar, menjëherë i

¹⁸² Vendim unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 2 datë 06.02.2009

ekzekutueshëm duke i rënduar pozitën të pandehurit e si i tillë ishte një vendimi “surprizë” i paparashikueshëm për të pandehurin.

Në këtë rast të pandehurit i janë mohuar në apel dy të drejta thelbësore të tij në funksion të një procesi të rregullt ligjor, që janë e drejta për t’u njoftuar në detaje paraprakisht në gjykatë për mundësinë e ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale e që për më tepër i rëndon pozitën procedurale më shumë sesa ajo e kërkuar nga prokurori dhe e drejta për t’i krijuar lehtësitë e nevojshme që i pandehuri të përgatisë mbrojtjen mbi ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale.

Pikërisht në një rast të ngjashëm Gjykata e Apelit të Aix – en – Provence në Francë, në çështjen *Pélissier and Sassi v. Francë*, kishte vepruar gabimisht në të njëjtën mënyrë ashtu siç veproi Gjykata e Apelit “Për Krimet e Rënda” në rastin tonë.

Pra edhe në rastin e rikualifikimit të faktit penal nga gjykata gjatë gjykimit, të pandehurit duhet t’i ofrohet prej saj, mundësia e ushtrimit të së drejtës së mbrojtjes në mënyrë praktike dhe efektive duke i dhënë të pandehurit një afat të caktuar kohor për të përgatitur mbrojtjen¹⁸³.

E vetmja zgjidhje që i mbetet Gjykatës së Apelit “Për Krimet e Rënda” duke i’u referuar kuadrit ligjor përpara ndryshimeve aktuale të nenit 375 të K.Pr.Penale, ishte të pranonte ankimin e prokurorit dhe t’i rëndonte pozitën procedurale të pandehurit deri në kufirin e parashikuar nga ankimi i prokurorit.

Në nenin 375 të K.Pr.Penale, përpara ndryshimeve me Ligjin nr. 35/2017, Gjykata e Apelit e kishte të pamundur të rëndonte pozitën e të pandehurit me vendim përfundimtar përtej kërkesës për rëndimin e pozitës së të pandehurit prej prokurorit. Sipas nenit 375 të K.Pr.Penale përpara ndryshimeve, gjykata mund të ndryshonte cilësimin juridik të veprës penale edhe duke e rënduar pozitën e të pandehurit me vendim përfundimtar.

Kështu që parimi *iura novit curia* në gjykatën e Apelit ushtrohej në mënyrë të kufizuar, pasi kur bëhej fjalë për rëndimin e pozitës së të pandehurit, gjykata e apelit referuar jurisprudencës së GJEDNJ-së, mund të rëndonte pozitën e tij deri në kufirin e kërkuar nga prokurori në ankim. Më tej gjykata e apelit nuk mund të rëndonte pozitën e të pandehurit në vendimin e saj përfundimtar që rikualifikonte faktin penal.

Në ndryshimet e reja të nenit 375 të K.Pr.Penale mendoj se gjykata e apelit ka mundësi të zbatojë parimin *iura novit curia*, pa kufizimet e përmendura më sipër. Kjo gjykatë mund të rikualifikojë faktin penal përpara dhënies së vendimit përfundimtar dhe këtë ndryshim duhet t’ja njoftojë palëve në gjykim, me qëllim që ata të përgatisin mbrojtjen e tyre. Kështu përpara dhënies së vendimit përfundimtar, duke i njoftuar palët për mundësinë e ndryshimit të cilësimit juridik të faktit penal, gjykata vepron në përputhje me nenin 6 paragrafët 1 e 3 të KEDNJ-së pasi me këtë njoftim për mundësinë e rëndimit të pozitës procedurale, gjykata i jep kohën e nevojshme të pandehurit për të paraqitur prova si dhe për të realizuar mbrojtjen e tij dhe në drejtim të mundësisë së ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale.

¹⁸³ EHRC case Block v. Hungary

Në lidhje me çështjen e dytë vlerësoj se ndoshta për gjykatën e apelit i vetmi kufizim i saj për të zbatuar parimin *iura novit cura* është kufizimi që lidhet me cilësimin e bashkëpunimit në një veprë penale, si formë të veçantë bashkëpunimi nga ato që parashikohen në nenin 28 të Kodit Penal¹⁸⁴, e kur forma e veçantë e bashkëpunimit nuk është pjesë përbërëse e akuzës së hartuar nga prokurori.

Duke ju referuar rastit konkret përtej argumenteve të përmendur më sipër, Gjykata e Apelit “Për Krimet e Rënda” nuk mund të ndryshojë cilësimin juridik të një veprë penale si të kryer në formën e bashkëpunimit të veçantë, të parashikuar nga neni 28 i Kodit Penal, nëse ky bashkëpunim i veçantë nuk është cilësuar si i tillë më parë nga prokuroria në kërkesën për dërgimin e çështjes për gjykim.

Format e veçanta të bashkëpunimit kanë një specifikë në krahasim me bashkëpunimin e zakonshëm që në disa vepra penale është parashikuar dhe si rrethanë cilësuese. Në format e veçanta të bashkëpunimit, të pandehurit procedohen jo vetëm për veprën penale konkrete që mund të jetë kryer në një prej formave të veçanta të bashkëpunimit, por edhe për veprën penale të krijimit ose pjesëmarrjes së tyre në këtë bashkëpunim. Më konkretisht për dy nga format e veçanta të bashkëpunimit që janë bashkëpunimi në formën e organizatës kriminale apo të grupit të strukturuar kriminal, bashkëpunëtorët si rregull mbajnë përgjegjësi penale edhe për krijimin apo pjesëmarrjen në organizatë kriminale apo grup të strukturuar kriminal¹⁸⁵.

Pra Kodi ynë Penal inkriminon përgatitjen si fazë të veprimtarisë kriminale, si vepra të veçanta penale që i referohen bashkimit të autorëve në organizatë kriminale apo grup të strukturuar kriminal me qëllim kryerjen e veprave penale të tjera të parashikuar nga Kodi Penal. Kështu që në hipotezën e kryerjes së një veprë penale nga disa persona në kuadër të organizatës kriminale apo grupit të strukturuar kriminal, këta persona duhet të përgjigjen penalisht jo vetëm për kryerjen e veprës penale konkrete, duke i shtuar si dënim edhe sanksionin e parashikuar nga

¹⁸⁴ Neni 28 i Kodit Penal për format e veçanta të bashkëpunimit parashikon se: “1. Organizata kriminale është forma më e lartë e bashkëpunimit, në të cilën bëjnë pjesë tre ose më shumë persona dhe që dallohet nga shkalla e veçantë e organizimit, strukturimit, qëndrueshmërisë, kohëzgjatjes, si dhe nga qëllimi për kryerjen e një a më shumë veprave penale, për të realizuar përfitime materiale dhe jomateriale. 2. Organizata terroriste është një formë e veçantë e organizatës kriminale, e përbërë nga dy ose më shumë persona, që kanë një bashkëpunim të qëndrueshëm në kohë, me synim kryerjen e veprave me qëllime terroriste. 3. Banda e armatosur është një formë e veçantë bashkëpunimi që, duke zotëruar armë, municione luftarake dhe mjete të tjera të nevojshme, synon kryerjen e veprave penale, të parashikuara në krerët V, VI dhe VII të pjesës së posaçme të këtij Kodi. 4. Grupi i strukturuar kriminal është formë e veçantë bashkëpunimi, në të cilin bëjnë pjesë tre ose më shumë persona, për kryerjen e një a më shumë veprave penale, për të realizuar përfitime materiale dhe jomateriale. Grupi i strukturuar kriminal për kryerjen e një veprë penale nuk formohet rastësisht e nuk është e nevojshme të dallohet për anëtarësi të qëndrueshme, ndarje detyrash, organizim dhe strukturim të zhvilluar. 5. Krijimi dhe pjesëmarrja në një organizatë kriminale, organizatë terroriste, bandë të armatosur ose grup të strukturuar kriminal cilësohen si vepra penale dhe dënohen sipas parashikimeve të pjesës së posaçme të këtij Kodi ose të dispozitave të tjera penale të veçanta. 6. Anëtarët e organizatës kriminale, të organizatës terroriste, bandës së armatosur ose grupit të strukturuar kriminal janë përgjegjës për të gjitha veprat penale, të kryera prej tyre, në përmbushjen e qëllimeve të veprimtarisë së tyre kriminale. 7. Pjesëtari i organizatës kriminale, organizatës terroriste, bandës së armatosur ose i grupit të strukturuar kriminal, përfiton përjashtimin nga dënimi ose uljen e tij, kur jep ndihmesë, që gjykohet vendimtare për njohjen e veprimtarisë së tyre, të bashkëpunëtorëve të tjerë, pasurive të zotëruara drejtpërdrejt ose jo prej tyre, si dhe për veprimtaritë hetimore, që zhvillohen ndaj organizatave kriminale, organizatave terroriste, bandave të armatosura dhe grupeve të strukturuar kriminale.”

¹⁸⁵ Neni 333 dhe 333/a i Kodit Penal.

neni 334 i Kodit Penal¹⁸⁶, por edhe për veprën penale të krijimit apo pjesëmarrjes në organizatën kriminale apo grupin e strukturuar kriminal.

Vepra penale e krijimit apo pjesëmarrjes në organizatë kriminale apo grup të strukturuar kriminal është një veprë penale më vete, e parashikuar nga neni 333 dhe 333/a i Kodit Penal dhe si e tillë ajo qëndron e pavarur prej veprave penale të kryera nga organizata kriminale apo grupi i strukturuar kriminal, që në këtë rast marrin cilësinë e një entiteti apo bashkimi që vepron në mënyrë të koordinuar për të kryer veprën ose veprat penale.

Nëse i kthehem rastit në gjykim vërejmë se gjykata e apelit e ka dënuar të pandehurin për veprën penale të *Trafikimit të narkotikëve* mbetur në tentativa, në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga neni 283/a/1, 22 e 334 të Kodit Penal.

Në këtë rast ndryshe nga sa argumenton kjo gjykatë se faktit penal i ka dhënë një kualifikim tjetër ligjor sipas nenit 375 të K.Pr.Penale, vendimin e ndryshimit të cilësimit juridik e ka hartuar në bazë të një akuze të re, të ngritur prej saj. Vërejmë se në arsyetimin e vendimit gjykata i referohet nenit 28/4 të Kodit Penal kur flet për anëtarësinë e grupit kriminal, që sipas nenit 333/a të Kodit Penal kjo cilësi anëtarësie është e dënueshme në mënyrë të veçantë.

Kështu, përveç akuzës së ngritur nga prokurori për veprën penale të trafikimit të lëndëve narkotike, të kryer në bashkëpunim mbetur në tentativa, sipas nenit 283/a/2 e 22 të Kodit Penal, gjykata realisht e ka akuzuar e dhe dënuar të pandehurin edhe për veprën penale të krijimit të grupit të strukturuar kriminal, të parashikuar nga neni 333/a të Kodit Penal.

Gjykata nuk ka pasur parasysh në vendim kur ka ndryshuar formën e bashkëpunimit, përcaktimin e nenit 28/5 të Kodit Penal, i cili e klasifikon krijimin dhe pjesëmarrjen në një grup të strukturuar kriminal si veprë penale dhe dënimin sipas parashikimit në pjesën e posaçme të Kodit Penal.

Kështu që gjykata e ka të pamundur të ndryshojë cilësimin juridik të veprës penale të kryer në bashkëpunim duke rënduar pozitën e të pandehurit me cilësimin e bashkëpunimit në një prej formave të saj të organizatës kriminale apo grupit të strukturuar kriminal.

Për këto arsye duke i dhënë përgjigje pyetjes së dytë të ngritur për vendimin e Gjykatës së Apelit “Për Krime të Rënda” Tiranë, mendojmë se ajo gjykatë ka gabuar në ndryshimin e cilësimit juridik mbi përcaktimin e formës së bashkëpunimit duke ndryshuar atë, nga bashkëpunim i thjeshtë në bashkëpunim në kuadër të grupit të strukturuar kriminal. Në këtë cilësim të ri, gjykata i ka atribuar të pandehurit një fakt të ri penal që është pjesëmarrja në grup të strukturuar kriminal, fakt penal i cili nuk ishte pjesë e kërkesës për gjykimin e çështjes penale nga ana e prokurorit.

¹⁸⁶ Neni 334 i Kodit Penal parashikon se: “1. Kryerja e veprave penale nga pjesëtarë të organizatës kriminale dhe të grupit të strukturuar kriminal dënohet sipas dispozitave penale përkatëse, duke i shtuar dënimin për veprën penale të kryer edhe pesë vjet burgim, si dhe gjobën në masën një të tretën, por pa kaluar kufirin maksimal të dënimin me burgim. 2. Kur dispozita përkatëse referuese përmban dënim me burgim apo me burgim të përjetshëm, dënohet me njëzet e pesë vjet burgim ose me burgim të përjetshëm. 3. Kur dispozita përkatëse referuese përmban vetëm dënim me burgim të përjetshëm, dënohet me burgim të përjetshëm”.

KAPITULLI VI

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

6.1. Përfundime

Sistemi ynë procedural lejon ndërtimin e akuzës prej prokurorisë në fazën e hetimeve paraprake duke mos përcaktuar me saktësi kohën se kur duhet të kryhet ky veprim procedural. Pavarësisht se Kodi i Procedurës Penale nuk përcakton kohën se kur hartohet e njoftohet akuzë, në të përcaktohen kushtet e përgjithshme me plotësimin e të cilave prokurori njofton akuzën të pandehurit.

Më konkretisht kushti i përgjithshëm në fazën e hetimit paraprak lidhet me mbledhjen e të dhënave të mjaftueshme për të marrë një person në cilësinë e të pandehurit. Volumi i të dhënave të mjaftueshme që nxisin prokurorin për t'i njoftuar akuzën konkrete të pandehurit vlerësohet vetëm nga prokurori, si subjekti i ngarkuar prej ligjit për të ushtruar ndjekjen penale, pjesë e së cilës natyrisht është dhe njoftimi i akuzës të pandehurit.

Për sa kohë hartimi i akuzës dhe njoftimi i saj nga prokurori është një proces që lidhet me mjaftueshmërinë e të dhënave të mbledhura në fazën e hetimit paraprak, mund të themi se në vetvete akuzë e njoftuar prej prokurorit në bazë të nenit 34 të Kodit të Procedurës Penale është normalisht e përkohëshme, pra nuk është e qëndrueshme në momentin e parë të njoftimit tek i pandehuri.

Përkohëshmëria e akuzës si njoftim i parë që prokurori i bën të pandehurit, lidhet me një vlerësim relativ që prokurori kryen mbi të dhënat e mjaftueshme të mbledhura në fazën e hetimeve paraprake. Themi se prokurori në njoftimin e parë të akuzës kundrejt të pandehurit bazohet në një vlerësim relativ, për shkak se hartimin fillestar të akuzës ai e bazon në të dhënat e grumbulluara deri në një moment të caktuar të hetimit.

Sigurisht që hetimi nuk përfundon me njoftimin e akuzës kundrejt të pandehurit. Për këtë rast sistemi ynë procedural i ka dhënë një hapësirë të mjaftueshme prokurorit që të njoftojë akuzën në fillim, në vijim ose në fund të hetimeve paraprake. Kjo hapësirë e mjaftueshme mbi njoftimin e akuzës lidhet me vlerësimin relativ të prokurorit mbi të dhënat e mjaftueshme që ka mbledhur përgjatë hetimeve paraprake.

Gjithashtu prokurori nuk mbetet peng i akuzës së parë njoftuar të pandehurit gjatë hetimeve. Nëse prokurori ka njoftuar akuzën të pandehurit për kryerjen prej tij të një vepre penale gjatë hetimit pa shkuar në përfundim të tij, mund të mbledhë të dhëna të tjera shtesë, në funksion të hetimit, të cilat mund të ndryshojnë situatën e parë të njoftimit të akuzës. Në këtë rast prokurori ka të drejtë, duke u bazuar dhe në të dhënat e reja, të ndryshojë ose plotësojë akuzën, duke rënduar ose lehtësuar pozitën procedurale të të pandehurit në varësi të natyrës së të dhënave të reja të grumbulluara gjatë hetimeve.

Kështu që në fazën e hetimit paraprak mund të flasim për “akuzën provizore” që hartohet prej prokurorit e paqartësuar plotësisht. Akuzë është njëkohësisht edhe e ndryshueshme ose elastike për shkak të varësisë së saj prej të dhënave që i shtohen hetimit të nisur prej prokurorit.

Ndryshimi i elementëve të akuzës sjell dhe ndryshimin e saj dhe për rrjedhojë ky ndryshim do të reflektohet në sjelljen e mëtejshme të prokurorit por dhe të pandehurit, si dy subjekte procedurale që janë të lidhur pashmangshmërisht me akuzën.

Nëpërmjet akuzës i pandehuri duhet të njoftohet në mënyrë të qartë e të plotë për dy elementët thelbësorë të saj, që janë shkaku i akuzës dhe natyra e akuzës.

Shkaku i akuzës është elementi që përcakton veprimin e dyshuar të kryer prej të pandehurit mbi të cilin është mbështetur akuza e ngritur prej prokurorisë. Kur i referohemi veprimit kemi parasysh të gjithë elementët materiale që përcaktojnë faktin penal që dyshohet se është realizuar nga i pandehuri. Pra shkaku i akuzës lidhet me veprimet ose mosveprimet konkrete të kryera prej të pandehurit, të cilat formojnë figurën konkrete të veprës penale të kryer prej të pandehurit.

Natyra e akuzës është elementi që përcakton karakteristikat ligjore që i jepet veprimit të të pandehurit sipas dispozitës apo dispozitave konkrete të Kodit Penal. Pra natyra e akuzës lidhet me përcaktueshmërinë e veprimit ose mosveprimit konkret të të pandehurit, si vepër penale që është parashikuar nga Kodi Penal ose nga ligje të tjera penale.

Elementët e akuzës i parashtrohen të pandehurit në aktin e njoftimit të akuzës nëpërmjet të dhënave të grumbulluara nga prokurori deri në atë fazë të hetimit paraprak, të cilat janë të vlerësuara si të mjaftueshme për të arritur në përfundimin mbi natyrën e veprës penale dhe autorin e saj. Njoftimi i akuzës me akt të shkruar pasqyron përfundimin paraprak të arritur prej prokurorit se vepra penale është kryer dhe se autori i saj është personi të cilit i bëhet ky njoftim.

Përpilimi i aktit për marrjen e personit në cilësinë e të pandehurit dhe njohja e tij detyrimisht e në mënyrë të hollësishme me shkakun dhe natyrën e akuzës që prokuroria ka arritur të grumbullojë kundër tij, ka lidhje me të drejtën e personit për t'u mbrojtur. Për këtë arsye veprimi i njoftimit të akuzës me akt të shkruar duke përfshirë në të, gjithë elementët e akuzës është i një rëndësie të veçantë. Mos respektimi i këtyre kërkesave nga prokuroria përbën shkak për cënimin e së drejtës së mbrojtjes për të pandehurin.

Në ndryshimet e reja në Kodin e Procedurës Penale është parashikuar një model i ri i prokurorit, në mënyrën e organizimit dhe funksionit të tij si organ kushtetues por njëkohësisht ka ndryshuar dhe mënyra e ushtrimit prej tij të ndjekjes penale dhe përfaqësimit të akuzës në gjykim. Me Ligjin nr. 76/2016 Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i janë bërë disa ndryshime të cilat kanë përfshirë edhe Prokurorinë si institucion kushtetues.

Në ndryshimet e reja kushtetuese me Ligjin nr. 76/2016, rezulton se funksionet dhe organizimi kushtetues i prokurorit si subjekt procedural i ushtrimit të ndjekjes penale dhe përfaqësimit të akuzës në emër të shtetit në gjykim, kanë ndryshuar. Me këto ndryshime prokuroria nuk vepron më si organ i centralizuar, por është organ i pavarur që respekton pavarësinë e brendshme të prokurorëve mbi hetimin e ndjekjen penale, sipas ligjit.

Kjo do të thotë se në ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimit të akuzës në gjykim si funksion kushtetues, prokurori nuk është i varur e nuk kontrollohet nga eprori për çështjen penale për të cilën është nisur një hetim. Në ushtrimin e funksionit të njoftimit të akuzës prokurori i hetimit është i pavarur prej drejtuesit të prokurorisë apo edhe më tej prej Prokurorit të Përgjithshëm.

Pra me ndryshimet e reja kushtetuese mund të themi se këto ndryshime kanë decentralizuar funksionin e prokurorit në ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimit të akuzës në gjykim.

Këto ndryshime Kushtetuese padyshim që kanë reflektuar edhe në ndryshimet që pësoi Kodi i Procedurës Penale.

Modeli i zgjedhur në Kodin e Procedurës Penale të ndryshuar, që pasqyron ndryshimin kushtetues të funksionimit të prokurorisë, si subjekt procedural është një model që i përngjason sistemit inkuizitor të procesit penal. Sipas këtij modeli të ri të zgjedhur, në ndryshimet e reja prokurori vërtet nuk kontrollohet në mënyrë vertikale prej prokurorit të tij, por tashmë kontrolli i hetimit dhe akuzës së ngritur për hetimin e kryer do të realizohet nga një subjekt i ri procedural që është Gjyqtari i Seancës Paraprake.

Në ndryshimet e reja në Kodin tonë të Procedurës Penale është përfshirë edhe Gjyqtari i Seancës Paraprake, i cili në bazë të ligjit kontrollon hetimin dhe akuzën e ngritur nga prokurori përpara se çështja penale e hetuar të shkojë për gjykim. Mund të themi se edhe në këtë rast modeli i përzgjedhur në Kodin tonë të Procedurës Penale mbi mënyrën sesi do të funksionojë gjyqtari i seancës paraprake e çfarë “pushteti” do të ushtrojë ai ndaj përfundimit të hetimeve dhe akuzës së ngritur prej prokurorit, përngjason me modelin italian të gjyqtarit të seancës paraprake.

Sipas ndryshimeve të reja Gjyqtari i Seancës Paraprake zhvillon seancë gjyqësore me dyer të mbyllura, në prani të detyrueshme të prokurorit dhe mbrojtësit të të pandehurit, me qëllim kontrollin e hetimeve të përfunduara nga prokurori përpara se çështja penale e hetuar të dërgohet për gjykim. Pra në seancën paraprake gjyqtari i vetëm, në prani të palëve zhvillon seancë gjyqësore me qëllim verifikimin paraprakisht të kërkesës për gjykim, përpara se çështja penale të dërgohet për gjykim.

Verifikimi dhe kontrolli që kryen gjyqtari i vetëm është paraprak e jo i hollësishëm. Verifikimi i kërkesës për gjykim të sjellë nga prokurori bazohet në dy drejtime kryesore që janë, verifikimi i rezultateve të hetimit nëse ato janë ose jo të plota, si dhe verifikimi i akuzës së ngritur nga prokurori nëse ajo është e qartë dhe e saktë.

Në seancë paraprake parashikohet për herë të parë mundësia e modifikimit të akuzës, shtimit të një akuze prej prokurorit që ka lidhje me atë që ai ka hetuar, si dhe rasti i njoftimit të të pandehuri për akuzën në lidhje me një fakt të ri penal. Të gjitha këto raste do të ndeshen në mënyrë më të “sofistikuar” gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes penale në themel.

Në seancë paraprake gjatë verifikimit të faktit penal të hetuar, në parashtrimin që prokurori në prani të të pandehurit i paraqet gjyqtarit, mund të rezultojë se akuza e ngritur paraprakisht prej prokurorit nuk i përgjigjet faktit penal të hetuar dhe konstatuar në seancën paraprake, ose referuar faktit të hetuar, akuza e ngritur në hetim nuk “mbulon” të gjithë faktin penal të hetuar dhe është e nevojshme shtimi i një akuzë të re mbi faktin penal të hetuar, ose mund të rezultojë në seancë përftimi i të dhënave të reja të pa hetuara nga prokurori, të cilat pasqyrojnë ekzistencën e një fakti të ri penal ndaj të cilit duhet të nisë ndjekja penale.

Në të gjitha këto raste Gjyqtari i Seancës Paraprake ka për detyrë të lejojë prokurorin të kryejë veprimet e duhura procedurale në mënyrë që hetimi ndaj të pandehurit të jetë i plotë dhe

të mos krijojë probleme procedurale në gjykimin në themel të çështjes penale. Në këto raste të përmendura më sipër, vetë gjyqtari nuk rregullon akuzën, nuk shton akuzën për veprën penale të re apo faktin e ri penal që është konstatuar në seancë paraprake si produkt i një verifikimi të bërë nga gjyqtari të bërë në këtë seancë. I vetmi funksion i gjyqtarit është konstatimi i situatës së re, të ndryshme nga ajo që është përcaktuar më parë prej prokurorit në hetim duke lejuar prokurorin të veprojë në përmbushje të funksioneve të tij procedurale dhe kushtetuese, për të saktësuar qartë dhe drejt kontestimet e reja të verifikuara në seancë paraprake.

Në rastin kur hetimi i kryer nga prokurori është i plotë në drejtim të mbledhjes së provave dhe përcaktimit të faktit penal por në vlerësimin e gjyqtarit të seancës paraprake cilësimi juridik i faktit prej prokurorit është i gabuar, gjyqtari i vetëm në seancë paraprake nuk e ndryshon dot këtë cilësim. Kjo për shkak se në fazën e hetimit paraprak, pjesë e së cilës është dhe seanca paraprake, prokurori gëzon të drejtën kushtetuese të hartimit të akuzës që përfshin mundësinë e prokurorit për të përcaktuar ligjin penal konkret që i përgjigjet faktit penal të hetuar prej tij. Në këtë rast të fundit gjyqtari ka vetëm një mundësi, kthimin e akteve prokurorit.

Ndryshimi i akuzave në seancë paraprake është instrument në të cilin si prokurori ashtu dhe gjyqtari ndërveprojnë referuar kryesisht akteve të sjella për gjykim nga prokurori. Pra vendimi për të ndryshuar akuzën, shtuar një akuzë të re për një vepër penale që ka lidhje me atë që është sjellë për gjykim, njoftuar një akuzë për një fakt të ri penal të papërmendur në kërkesën për gjykim, bazohet në aktet procedurale të mbledhura gjatë fazës së hetimit paraprak.

Rrjedhimisht dhe vendimi i ndryshimit të akuzës në këtë rast është “i pjesshëm”, pasi bazohet vetëm në aktet e prokurorit. Qëllimi i vendosjes së modelit të ndryshimit të akuzës, në seancë paraprake lidhet me verifikimin e akuzës nga një gjyqtar përpara se çështja e dërguar për gjykim nga prokurori t’i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor në themel nga trupi gjykues. Pra në këtë rast gjyqtari i seancës paraprake funksionon si hallkë kontrolli në verifikimin e cilësisë së hetimit të kryer nga prokuroria dhe akuzës së ngritur prej tij, referuar faktit penal të hetuar. Pas këtij verifikimi dosja penale shkon në gjykim, më e plotë dhe redukton problemet që mund të lindin në gjykim me akuzën e hartuar prej prokurorit.

Ndryshimi i akuzës në seancë paraprake nuk zëvendëson kapitullin e akuzave të reja. Në gjykimin e çështjes penale në themel, akuzat e reja si model lejojnë prokurorin të ndryshojë akuzën, të shtojë një akuzë për një vepër penale të re, apo një akuzë për një fakt të ri penal gjatë shqyrtimit gjyqësor. Një veprim i tillë prej prokurorit në gjykim është produkt që normalisht nxirret nga debati gjyqësor i provave të shqyrtuara. Rrjedhimisht në këtë rast, akuzat e reja të shfaqura në gjykim janë më të qëndrueshme e më të plota, për shkak se ato mbështeten në debatin e provave të shqyrtuara.

Për këtë arsye mund të themi se ndryshimi i akuzave në seancë paraprake, nuk zëvendëson akuzat e reja në gjykim.

Akuza “gjenerike ose e papërcaktuar” është akuza e formuluar nga prokurori, i cili ka pasqyruar në mënyrë mekanike gërmën e dipozitës penale inkriminuese, pa e azhurnuar këtë dispozitë me elementët konstituiv të faktit penal konkret të verifikuar gjatë hetimit. Në këtë rast mund të themi se të gjithë elementët përbërës të faktit penal janë evidentuar përgjatë hetimit, vetëm se këto elemente nuk janë pasqyruar nga prokurori me përpikmërinë e duhur.

Akuza gjenerike nuk është një institut i së drejtës procedurale penale. Ajo është produkt i praktikës gjyqësore që lidhet me sjelljen dhe veprimin e prokurorit në hartimin e akuzës dhe paraqitjen e saj për gjykim. Në akuzën gjenerike hetimi është i plotë. Aktet të cilat pasqyrojnë veprimet e kryera nga i pandehuri janë evidentuar në mënyrë të qartë, por ajo që e bën të paplotë akuzën, është mos saktësimi prej prokurorit i elementëve konkrete të veprimit të kryer nga i pandehuri në akuzën e atribuar. Në akuzën gjenerike prokurori mjaftohet me përshkrimin e dispozitës penale që inkriminon veprimin e të pandehurit.

Raste të tilla në praktikën tonë gjyqësore janë të evidentuara dhe në përballjen me një akuzë gjenerike i pandehuri mund të ketë humbur në disa raste të drejtën e tij për të kërkuar gjykim të shkurtuar. Një arsye më shumë për të përkrahur seancën paraprake, lidhet me fenomenin praktik të “akuzës gjenerike” e cila besoj se do të reduktohet ndjeshëm për shkak të verifikimit e trajtimit të saj në seancë paraprake.

Ndjekja penale që prokurori ushtron ndaj të pandehurit në gjykim, sjell së paku dy detyrime për gjykatën.

Së pari, mbi ndjekjen penale gjykata është e detyruar të vendos me vendim përfundimtar mbi faktin penal të përcaktuar qartë e të fiksuar nga prokurori në përmbajtjen e akuzës që gjen pasqyrim në kërkesën për gjykim të sjellë prej tij. Pra gjykata nuk mund t’i shmanget detyrimit për t’u shprehur me vendim mbi akuzën e sjellë për gjykim prej prokurorit, si shprehje e ndjekjes penale që prokurori ushtron në gjykim ndaj të pandehurit.

Së dyti gjykatës i ndalohet e drejta për të vendosur me vendim mbi një fakt penal të ndryshëm nga ai i përcaktuar prej prokurorit në përmbajtjen e akuzës së njoftuar të pandehurit.

Për sa kohë ushtrimi i ndjekjes penale prej prokurorit vazhdon edhe përgjatë fazës së shqyrtimit gjyqësor, atëherë me të drejtë mund të themi se prokurori në funksionin e tij kushtetues e procedural të ushtrimit të ndjekjes penale, mund të veprojë në gjykim dhe me paraqitjen e akuzave e të reja për të pandehurin, të ushtrojë në gjykim ndjekjen penale ndaj të pandehurit për një fakt të ri penal të zbuluar prej tij gjatë gjykimit, apo dhe të ndryshojë akuzën e sjellë për gjykim ndaj të pandehurit për të njëjtin fakt.

Të gjitha këto veprime prokurori në gjykim i ushtron në funksion të ndjekjes penale si një detyrim kushtetues dhe procedural. Pra ndryshimi i akuzës, akuza për një vepër tjetër penale apo akuza për një fakt të ri, janë forma të ushtrimit të ndjekjes penale të prokurorit në gjykim, të cilat gjejnë rregullim në institutin e akuzave të reja të parashikuar nga nenet 372 deri 377 të Kodit të Procedurës Penale.

Nëse nuk do të ekzitonin rregullat mbi akuzat e reja, atëherë situata të cilat parashikojnë këto dispozita procedurale mund të vendosin gjithë procedimin penal në vështirësi. Në këtë rast prokurorit do t’i duhet të procedonte sipas rregullimit të zakonshëm për çdo situatë të re të lindur në gjykim që ka lidhje me akuzat e reja. Pra nëse nuk do të ekzitone kapitulli i akuzave të reja prokurori do të regjistronte një procedimin të ri penal për akuzën që ka lidhje me atë që gjykohet, për akuzën që lidhet me faktin e ri penal, apo për rastin e ndryshimit të akuzës. Në këtë situatë të fundit, gjithë procedimi penal i sjellë për gjykim nga prokurori do të pësonte një “regres”, në kuptimin e kthimit mbrapa edhe një herë në fazën e hetimit të tij.

Kështu që kapitulli i akuzave të reja ofron stabilitet dhe siguri juridike për të pandehurin. Dhe në rastet e marrjes e vlerësimit të ndryshëm të të dhënave që lidhen me procedimin penal në gjykim, i pandehuri nuk rrezikon që çështja e tij penale në gjykim të kthehet dhe një herë në fazën e hetimit paraprak për shkak të ndryshimit të të dhënave të përfuara gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Instituti i akuzave të reja në Kodin e Procedurës Penale nuk rregullon vetëm veprimtarinë e prokurorit në gjykim në funksion të ushtrimit prej tij të ndjekjes penale që lidhet me situata të reja që kanë dalë gjatë gjykimit të çështjes penale në drejtim të akuzës së ngritur apo edhe në drejtim të hetimit të përfunduar. Instituti i akuzave të reja rregullon sjelljen e të pandehurit, duke i ofruar të drejta procedurale të mjaftueshme për të realizuar e garantuar një mbrojtje efektive në drejtim të situatës së re të krijuar në gjykim.

Njëkohësisht për sa kohë nëpërmjet akuzave të reja ligji i ofron mundësinë prokurorit të ndryshojë akuzën në gjykim, si shprehje e ushtrimit të ndjekjes penale ndaj të pandehurit, pa u kufizuar në shkallën e procedimit penal, edhe gjykatës ligji i krijon mundësinë që faktit penal të hetuar për të cilin është ngritur një akuzë, t'i përcaktojë cilësimin e duhur ligjor në funksion të maksimës latine “gjykata e njeh ligjin”.

Pra instituti i akuzave të reja që si promotor të saj në gjykim, ka në fillim prokurorin për shkak të ushtrimit të ndjekjes penale, lejon edhe subjektet e tjera procedurale të realizojnë të drejtat e tyre si aspekt i respektimit të parimit të procesit të rregullt ligjor. Të pandehurit në këtë rast i ofrohen të njëjtat garanci që ka dhe në fazën e hetimit paraprak. Garancia kryesore në këtë rast është vënia në dispozicion nga ana e gjykatës për të përgatitur mbrojtjen e tij si dhe situatën e re ligjore të krijuar me ndryshimin e akuzës, mbi njoftimin në gjykim të akuzës për një veprë penale të re apo fakti të ri penal, për të cilat i pandehuri vihet në dijeni vetëm gjatë gjykimit.

Fakti penal është i lidhur ngushtësisht me elementët të cilat identifikojnë qartësisht veprimet e autorit të veprës penale, arsyet se përse ka kryer veprën penale, si dhe pasojat e ardhura nga vepra penale. Në kuptim të nenit 372 të K.Pr.Penale fakti penal nuk ndryshon në thelb në gjykim. Në gjykim në raport me debatin e zhvilluar mbi provat, ndryshon vlerësimi i prokurorit mbi disa elementë të faktit penal që mund të jenë të përfuara në gjykim, të cilat e lejojnë prokurorin të jap një vlerësim të ndryshëm të faktit penal në rapor me faktin e përcaktuar në kërkesën e dërgimit të çështjes në gjykim.

Bazuar në nenin 372 të K.Pr.Penale, ndryshimi i akuzës në gjykim është atribut ekskluziv i prokurorit, si shprehje e ushtrimit të ndjekjes penale që ai i bën veprës penale. Në këtë kuptim prokurori nuk kufizohet nga gjykata apo pozita e të pandehurit për të ndryshuar akuzën në gjykim. Prokurori e ndryshon akuzën pa kërkesë drejtuar gjykatës dhe ndryshimi i akuzës i njoftohet të pandehurit në seancë gjyqësore, pa respektuar ndonjë formalitet të veçantë, pasi dhe ligji nuk shprehet mbi formën e njoftimit të ndryshimit të akuzës në gjykim.

Nëse i pandehuri gjykohet në mungesë atëherë njoftimi i ndryshimit të akuzës duhet të bëhet në formë shkresore. Me ndryshimin e akuzës gjykata është e detyruar t'i lërë kohën e nevojshme të pandehurit për të përgatitur mbrojtjen e tij për këtë ndryshim, si dhe të lejojë të pandehurin të paraqesë prova të reja, në funksion të garantimit të së drejtës së mbrojtjes.

Në lidhje me kompetencën e gjykatës mbi shqyrtimin e ndryshimit të akuzës është propozuar që neni 372 i K.Pr.Penale të ndryshojë duke ndjekur të njëjtin standard që parashikon neni 373 i K.Pr.Penale në përcaktimin e kompetencës.

Akuza për një veprë penale tjetër gjen pasqyrim në analizën e bërë për të gjithë elementët e saj. Vepër tjetër penale do të thotë që në procesin gjyqësor kur prokurori vepron me njoftimin e saj tek i pandehuri, fakti penal është identifikuar qartësisht dhe fakti penal nuk është fakti ri i cili konstatohet vetëm gjatë procesit gjyqësor. Fakti penal nuk ka nevojë t'i nënshtrohet hetimit paraprak, pasi ai plotëson të gjitha kushtet për t'u identifikuar si vepër penale.

Midis fakti penal dhe veprës penale në kuptimin e kërkuar nga nenet 373 e 374 të K.Pr.Penale ekziston një ndryshim thelbësor që lidhet me identifikimin e ngjarjes kriminale të ndodhur. Ndërsa fakti i ndodhur në përgjithësi ka nevojë t'i nënshtrohet hetimit paraprak me qëllim mbledhjen e të dhënave të nevojshme për të konkluduar në ekzistencën ose jo të veprës penale, elementëve përbërës të saj, autorin ose autorët pjesëmarrës në kryerjen e veprës penale, në rastin e veprës penale të dalë në gjykim, themi se hetimi paraprak është i kryer dhe janë mbledhur gjithë të dhënat e nevojshme që identifikojnë faktin penal në një vepër penale konkrete.

Hetimi është i kryer për shkak se vepra tjetër penale është e lidhur ngushtësisht me veprën e parë penale për të cilën është sjellë për gjykim i pandehuri. Vepra e parë penale i është nënshtuar hetimit paraprak dhe elementët e saj janë mbledhur e vlerësuar si të tilla prej prokurorit në përfundim të hetimeve. Si rrjedhim për shkak të lidhjes së ngushtë që duhet të ekzistojë midis veprës penale të hetuar dhe asaj të dalë në gjykim, elementët thelbësorë të veprës penale të hetuar janë elementë përbërës dhe të veprës tjetër penale të konstatuar në gjykim. Kështu që dhe vepra penale tjetër e konstatuar në gjykim nuk është një vepër penale e re, pasi elementët përbërës të saj janë mbledhur gjatë fazës së hetimeve paraprake e si rrjedhim këto elementë janë të njohura për prokurorin dhe të pandehurin përpara fillimit të shqyrtimit gjyqësor të çështjes.

Pra kur ligjvënësi i referohet shprehjes “*vepër tjetër penale*” ka patur parasysh situatën në të cilën fakti penal që referon te vepra tjetër penale, i është nënshtuar hetimit paraprak dhe në gjykim elementët thelbësorë të veprës tjetër penale nuk janë elemente të reja të panjohura si për prokurorin ashtu edhe për të pandehurin. Kjo për shkak se këto element përbërës të veprës tjetër penale janë mbledhur kryesisht në fazën e hetimit paraprak, në funksion të hetimit të veprës së parë penale. Kështu që akuza për një vepër tjetër penale në gjykim, nuk duhet kuptuar si akuzë për një vepër të re penale, por duhet kuptuar si akuzë për një vepër tjetër penale të hetuar që në fazën e hetimit paraprak kur janë mbledhur të dhënat për hetimin e veprës së parë penale që është sjellë për gjykim.

Akuza për një vepër tjetër penale i jep mundësinë prokurorit të procedojë në gjykim me atribuimin ndaj të pandehurit të një veprë tjetër penale, pa qenë nevoja që prokurori për veprën penale tjetër të nis hetimin nga e para. Vepra penale tjetër e evidentuar në gjykim, nuk ka nevojë për hetim të ri, pasi hetimi për këtë vepër penale është kryer nga prokurora në të njëjtën kohë e bashkërisht me hetimin e veprës penale që prokurori ka sjellë fillimisht për gjykim.

Në rastin e akuzës për një veprë tjetër penale në gjykim, i pandehuri tashmë ndodhet në një situatë tjetër që realisht i rëndon pozitën procedurale. Me atribumin e akuzës për një veprë tjetër penale në gjykim, i pandehuri duhet të përgjigjet së paku për dy vepra penale të dyshuara si të kryera prej tij. Ai duhet të përgjigjet për veprën e parë penale që është sjellë për gjykim nga prokurori, si dhe për veprën tjetër penale, të cilën prokurori ja njofton të pandehurit në seancë gjyqësore të gjykimit të veprës së parë penale. Pra të pandehurit në gjykim i shtohet edhe një veprë tjetër penale.

Neni 373 i K.Pr.Penale parashikon situatën kur i pandehuri dyshohet se ka kryer dy ose më shumë vepra penale dhe këto vepra penale duhet t'i nënshtrohen gjykimit brenda një procesi gjyqësor.

Rastet kur një person kryen dy ose më shumë vepra penale, janë raste që trajtohen nga teoria e së drejtës penale, për shkak se secila nga veprat penale përmban një dënim të parashikuar si të tillë nga ligji penal dhe si rrjedhim ligji penal i ka dhënë si zgjidhje të vetme kësaj situate duke parashikuar një dispozitë të përgjithshme penale që parashikon rastet kur dhe si duhet të zbatohen dispozitat penale mbi bashkimin e dënimeve kur autori duhet të përgjigjet penalisht për kryerjen e dy ose më shumë veprave penale.

Në ndryshim nga neni 374 i K.Pr.Penale, neni 373 i tij parashikon rastet e konkurrimit ideal të veprave penale ose rastin e veprës penale vazhduese. Kështu që lidhja midis akuzës për një veprë penale të lidhur me atë që gjykohet është lidhja që ekziston midis veprave penale të kryera me një veprim të vetëm ose lidhja që ekziston midis veprimeve serike, të cilat janë pjesë integrale e të njëjtit mendim unik kriminal.

Ndërkohë në rastin e parashikuar nga neni 374 i K.Pr.Penale ndodhemi përpara situatës së konkurrimit real të veprave penale. Ajo se çfarë i lidh veprat penale në konkurrimin real të tyre është kyerja e tyre nga një autor. Pra lidhja në këtë rast qëndron për shkak të subjektit që kryen veprën penale. Duke ju referuar subjektit, neni 374 i K.Pr.Penale parashikon mundësinë e gjykimit në të njëjtin proces gjyqësor të akuzës së sjellë për gjykim nga prokurori dhe akuzës që i njoftohet të pandehurit në gjykim për faktin e ri penal të zbuluar përgjatë debatit gjyqësor.

Në këtë rast në ndryshim nga situatat e tjera, prokurori nuk gëzon të drejtën ekskluzive për të proceduar pa kufizim në të njëjtën seancë gjyqësore me njoftimin e akuzës për faktin e ri penal.

Për të proceduar me akuzën për faktin e ri penal në të njëjtin proces gjyqësor, prokurorit do t'i duhet të marrë pëlqimin e të pandehurit dhe njëkohësisht dhe lejen e gjykatës. Qëndrimet e ndryshme në seancë të të pandehurit ose të gjykatës mund të sjellin ndërprerjen e procedimit penal për faktin e ri të konstatuar në gjykim. Në hipotezën e fundit, prokurori për faktin e ri penal duhet të veprojë sipas rregullave të zakonshme.

Nga momenti i hyrjes në fuqi të Kodit të Procedurës Penale dhe deri në kohën e përfundimit të këtij punimi neni 375 të K.Pr.Penale që bën fjalë për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale i janë bërë tre ndryshime të rëndësishme. Kjo tregon dhe një herë për vëmendjen që duhet t'i kushtojë gjykata respektimit të të drejtave të pandehurit, kur ajo vlerëson se duhet të procedojë me ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale.

Të gjitha ndryshimet që i janë bërë nenit 375 kanë kaluar testin e respektimit të të drejtave të të pandehurit në raport me procesin e rregullt ligjor. Në këtë aspekt është shprehur dhe Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj nr. 50/1999 si dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së në çështjen Haxhiaj kundër Shqipërisë.

GJEDNJ-ja ka sanksionuar se informacioni që lidhet me akuzën, duke përfshirë dhe karakteristikat ligjore të saj, të cilat gjykata mund t'i adoptojë si pjesë e vendimmarrjes së saj, duhet t'i bëhen të njohur të pandehurit përpara gjykimit të akuzës (siç mund të jetë rasti i seancës paraprake) ose së fundmi përgjatë fazës së shqyrtimit gjyqësor.

Në këtë kuptim një referim i përgjithshëm në seancë, mbi mundësinë që gjykata mund të arrijë në një përfundim të ndryshëm nga prokurori përpara i përket kualifikimit të një veprë penale është qartësisht e pamjaftueshme. Pra në rastin e riklasifikimit të faktit penal nga gjykata gjatë gjykimit, të pandehurit duhet t'i ofrohet prej saj mundësia e ushtrimit të së drejtës së mbrojtjes në mënyrë praktike dhe efektive, duke i dhënë të pandehurit një afat të caktuar kohor për të përgatitur mbrojtjen.

Në rikualifikimin e një veprë penale sipas GJEDNJ-së, vlerësohet si veprim i mjaftueshëm për t'u parashikuar nga i pandehuri nëse gjykata në rikualifikim i referohet një elementi i cili është i lidhur me akuzën dhe i evidentuar si i tillë gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes penale. Defektet në njoftimin për rikualifikimin e akuzës sipas GJEDNJ-së, mund të riparohen në Gjykatën e Apelit, nëse i pandehuri ka pasur mundësinë të apelojë vendimin e dhënë nga gjykata në një gjykatë më të lartë, duke ushtruar të drejtën e tij të mbrojtjes në respekt të riformulimit të akuzës e të kundërshtojë dënimin e dhënë, si për kualifikimin e veprës penale, ashtu dhe për faktin penal.

Jurisprudenca e GJEDNJ-së mbi rikualifikimin prej gjykatës të veprës penale të sjellë për gjykim, kanë ndikuar në ndryshimin e nenit 375 të K.Pr.Penale me ligjin nr. 35/2017. Sipas këtyre ndryshimeve gjykata, në përfundim të gjykimit duhet të njoftojë të pandehurin për mundësinë e ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale, me qëllim që t'i jepet koha e nevojshme për të përgatitur mbrojtjen mbi ndryshimin e cilësimit të njoftuar prej gjykatës. Në këtë aspekt vlerësoj se ndryshimi i nenit 375 të K.Pr.Penale i cili na rikujton formulimin origjinal të kësaj dispozite në kodin në fuqi, është në përputhje me standardet e kërkuara nga GJEDNJ-ja për të siguruar një proces të rregullt ligjor.

Në këtë aspekt, ndryshimet e reja në nenin 375 të K.Pr.Penale përafrojnë jo vetëm me standardin e ofruar nga GJEDNJ-ja por ngjasojnë dhe me modelet e tjera të përzgjedhura nga shtete të tjera evropiane, siç është rasti i Kodit të Procedurës Penale të Gjermanisë.

6.2. Rekomandime

Në përfundim të këtij punimi pasqyrohen dhe disa rekomandime të cilat mund të vlejnjë në përmirësimin e legjislacionit procedural penal në lidhje me akuzat e reja.

1. Propozimi për ndryshimin e nenit 79/1 gërma "b" në Kodin e Procedurës Penale si më poshtë:

“1. Organi procedues mund të vendos bashkimin e procedimeve:

... b) kur një person akuzohet për disa vepra penale të kryera me një veprim apo mosveprim të vetëm, ose me disa veprime a mosveprime të kryera prej tij për arritjen e qëllim të vetëm kriminal.”

2. Propozimi për ndryshimin e nenit 332/d pika 1 i K.Pr.Penale

“1.Kur gjatë seancës paraprake fakti del ndryshe nga ç’është përshkruar në kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq, rezulton një vepër tjetër penale, sipas shkronjës “b”, të paragrafit 1, të nenit 79, apo del një rrethanë rënduese që nuk është përmendur, prokurori ndryshon akuzën, shton veprën penale të re ose rrethanën rënduese dhe ia komunikon të pandehurit të pranishëm. Kur i pandehuri nuk është i pranishëm, akuza e re i komunikohet mbrojtësit të tij, të cilit i jepen jo më shumë se 10 ditë kohë për të komunikuar me të pandehurin.”

3. Propozim për ndryshimin e nenit 372 të K.Pr.Penale

“1.Kur gjatë shqyrtimit gjyqësor fakti del ndryshe nga ç’është përshkruar në kërkesën për gjykim dhe gjykimi i tij nuk është në kompetencën e një gjykate më të lartë, prokurori ndryshon akuzën dhe procedon me akuzën përkatëse.

2.Kur gjatë shqyrtimit gjyqësor prokurori ndryshon akuzën dhe janë rastet që gjykata mund të procedojë me gjykimin me marrëveshje apo gjykimin e shkurtuar, i pandehuri pas njoftimit të ndryshimit të akuzës ka të drejtë të kërkojë zbatimin e këtyre formave të posaçme të gjyqimit të përmendura më lart në këtë paragraf. Kur i pandehuri gjykohet në mungesë, këtë të drejtë e ka edhe mbrojtësi i zgjedhur prej tij, me kusht që kjo e drejtë ti jetë autorizuar shprehimisht nga i pandehuri.”

4. Propozim për rregullimin e fjalisë së parë të nenit 374 të K.Pr.Penale si në vijim:

“Fakti i ri penal i zbuluar në gjykim

Përtej rasteve të parashikuara nga neni 373 i Kodit të Procedurës Penale, prokurori procedon në format e zakonshme nëse gjatë shqyrtimit gjyqësor në ngarkim të të pandehurit zbulohet një fakt i ri i papërmendur në kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq, për të cilin duhet proceduar kryesisht.”

5. Propozim për shfuqizimin e nenit 377 të Kodit të Procedurës Penale.

Shfuqizimin e nenit 377 të K. Pr. Penale

BIBLIOGRAFIA

- Belishta Admir, Disertacion për mbrojtjen e gradës shkencore doctor “*Aplikimi i dënimeve alternative dhe akuzat e reja në procesin penal*”, Tiranë 2015”.
- Bani Erion, Dardha Luveta, Dervishi Marsela, Gjuzi Adelajda, Goxha Diamela, Hasani Dritan, Mihali Elona, Muçi Emona, “Ndryshimi i cilësimit juridik të veprës penale dhe e drejta për një proces të rregullt ligjor sipas KEDNJ”, Revista “Jeta Juridike” nr 2, qershor 2012
- Conso Giovanni, Grevi Vittorio “Compendio di Procedura Penale” seconda edizione “CEDAM 2003
- Counsel of Europe - Guide on Article 6 “Right to a fair trial”, 2014, available for download at www.echr.coe.int
- Cryer Robert, “Prezantim i te drejtës penale dhe procedurës penale ndërkombëtare”, botim i viti 2007, Universiteti i Kembrixhit
- Derlén Mattias, “Interpretim shumë gjuhësor i së drejtës së Bashkimit European Monografi Europiane” (2009).
- Frashëri Marsida “Akuzat e reja sipas legjislacionit tonë procedural në fuqi“, botuar në “Mbi disa çështje të së drejtës procedurale penale”, Botim i Shkollës së Magjistraturës nr. 1, viti 2010.
- Gaito Alfredo, “La Prova Penale” UTET.
- Ganaj Françesk, “Akuzat penale në procesin penal dhe garancitë e të pandehurit” temë e prezantuar si pjesë e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, Mars 2017.
- Gazeli Kosta, “Vështrim historik – krahasues për akuzat e reja në legjislacionin Procedural penal shqiptar”, Shkrim i botuar në Revistën shkencore “Justiniani i Parë” botuar në Tiranë më datë 20 prill 2011.
- Islami Halim, Hoxha Artan, Panda Ilir, “Komentari i Kodit të Procedurës Penale” Tiranë 2010 ribotim, botimet “Morava”.
- Kaçupi Skënder., “E drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme”, “Cikël leksionesh, Universiteti Tiranë, Fakulteti i Drejtësisë”.
- Kambovksi Vllado, “E Drejta Penale Pjesa e Përgjithshme”, Shtëpia Botuese “FURKAM ISM” Shkup 2007.
- Kurushi Klodian, “Abbreviated Trial” Mediterranean Journal of social sciences Vol 7, nr. 3.
- Kurushi Klodian, Skënderaj Klodjan “Legal Qualification of the offence”, Academic Journal of Interdisciplinary Studies, Vol. 5, No. 2, July 2016.
- Material i marrë nga Konkursi i zhvilluar në ambientet e Gjykatës së shkallës së parë “Për Krimet e Rënda” Tiranë, organizuar nga Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, mbajtur më datë 10 maj 2013.
- Mercone M, “Diritto processuale penale“, XI Edizione, “Edizioni Giuridiche Simone” 2003.
- Mëngjesi Sokol, “Bazat e doktrinës së të drejtës penale”, “Botimet Morava” Tiranë 2016.
- Monteleone Andrea, Modifica dell’imputazione “Principio del contraddittorio e nuove contestazioni: tra interpretazione funzionale e tutela del diritto di difesa, gjendet edhe në www.archiviopenale.it/2013/06/2013monteleone_ultima.pdf.

- Paolo Tonini “Lineamenti di diritto processuale penale” Giufre Editore, Torino 2012.
- Perrotta Giulio, “La genericità dell’imputazione”, 17 maggio 2012 gjendet në <https://www.diritto.it/la-genericita-dell-imputazione>.
- Sahiti Ejup “E drejta e Procedurës Penale” Prishtinë 2005.
- Salihu Ismet., “E drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme”, Prishtinë, tetor 2014.
- Skënderaj Klodjan, “Gjykimet e posaçme dhe rëndësia e tyre në procesin penal”, Disertacion “Për mbrojtjen e gradës shkencore Doktor” Tiranë 2014

LEGJISLACION

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, miratuar me Ligjin nr. 8417 datë 21.10.1998, ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016
- Ligj nr. 8137 datë 31.07.1996 “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”
- Ligj Nr. 1650 datë 30 Mars 1953 “Kodi i Procedurës Penale të Republikës Popullore të Shqipërisë
- Ligj nr. 6069 datë 25.12.1979 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”
- Ligj nr. 7905 datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”
- Ligj nr. 8813 datë 13.06.2002 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905 datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i ndryshuar”.
- Ligj nr. 35 datë 30.03.2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905 datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i ndryshuar”.
- Ligj nr. 7895 date 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar
- Kodi Procedurës Penale i Italisë, 2011
- Kodi Penal i Italisë, 2011.
- Kodi Procedurës Penale i Gjermanisë, 2014.
- Kodi Procedurës Penale i Kosovës, 2012.
- Kodi Procedurës Penale i Kroacisë, 2009.
- Kodi Procedurës Penale i Serbisë 2011.
- Kodi Procedurës Penale i Estonisë 2017.
- Kodi Procedurës Penale i Letonisë 2010.
- Kodi Procedurës Penale i Hollandës 2012.
- Kodi Procedurës Penale i Francës 2000.
- Rregullat Federale të Procedures Penale, USA Washington 2010.
- Instrumentet statutoire për Anglinë dhe Uellsin në Procedurën Penale 2011.

VENDIME TË GJYKATËS SË LARTË

- Vendim Unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 3 datë 27.09.2002
- Vendim Unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 2 datë 06.02.2009
- Vendim Unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 4 datë 15.04.2011
- Vendim i Kolegjit Penal i Gjykatës së Lartë nr. 5 datë 12.12.2008
- Vendim i Kolegjit Penal i Gjykatës së Lartë nr. 36 datë 25.12.2009
- Vendim i Kolegjit Penal i Gjykatës së Lartë nr. 636 datë 25.11.2009
- Vendim i Kolegjit Penal i Gjykatës së Lartë nr. 618 datë 10.12.2003
- Vendim i Kolegjit Penal i Gjykatës së Lartë nr. 610 datë 03.10.2007
- Vendim i Kolegjit Penal i Gjykatës së Lartë nr. 59 datë 06.02.2008
- Vendim i Kolegjit Penal i Gjykatës së Lartë nr. 633 datë 14.11.2001
- Vendim i Kolegjit Penal i Gjykatës së Lartë nr. 472 datë 13.09.2006
- Vendim i Kolegjit Penal i Gjykatës së Lartë nr. 415 datë 24.09.2008
- Vendim i Kolegjit Penal i Gjykatës së Lartë nr. 64 datë 17.10.2007
- Vendim i Kolegjit Penal i Gjykatës së Lartë nr. 432 datë 16.07.2003
- Vendim i Kolegjit Penal i Gjykatës së Lartë nr. 00-2011-1106 datë 27.12.2011

VENDIME TË GJYKATËS KUSHTETUESE

- Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 24 datë 30.04.2012
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 4 datë 10.02.2012
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 47 datë 01.04.2015
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 50 datë 01.11.2012
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 23 datë 13.10.2005
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 24 datë 26.10.2005
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 16 datë 08.06.2006
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 13 datë 21.07.2008
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 19 datë 18.09.2008
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 10 datë 02.04.2009
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 16 datë 15.06.2009
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 25 datë 10.06.2011
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 14 datë 26.03.2012
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 11 datë 23.04.2009
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 14 datë 17.04.2002
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 50 datë 30.07.1999

VENDIME TË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË

- Vendim i Gjykatës së shkallës së parë “Për Krimet e Rënda” Tiranë nr. 62 datë 15.02.2014
- Vendim i Gjykatës së shkallës së parë “Për Krimet e Rënda” Tiranë nr. 71 datë 19.05.2016
- Vendim i Gjykatës së shkallës së parë “Për Krimet e Rënda” Tiranë nr. 01 datë 08.01.2007
- Vendim i Gjykatës së shkallës së parë “Për Krimet e Rënda” Tiranë nr. 11 datë 22.01.2015
- Vendim i Gjykatës së shkallës së parë “Për Krimet e Rënda” Tiranë nr. 136 datë 25.11.2014
- Vendim i Gjykatës së shkallës së parë “Për Krimet e Rënda” Tiranë nr. 25 datë 09.07.2010
- Vendim i Gjykatës së shkallës së parë “Për Krimet e Rënda” Tiranë nr. 94 datë 28.07.2015
- Vendim i Gjykatës së shkallës së parë Sarandë nr. 84 datë 18.04.2004
- Vendim i Gjykatës së shkallës së parë Vlorë nr. 76 datë 24.02.2010

VENDIME TË GJYKATËS SË APELIT

- Vendim i Gjykatës së Apelit “Për Krimet e Rënda” Tiranë nr. 88 datë 13.09.2016

VENDIME TË GJYKATËS EVROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT

- Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, çështja Matoccia kundër Italisë, nr. 23969/94, datë 25 korrik 2000
- Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, çështja Haxhia kundër Shqipërisë, nr. 29861/03, datë 8 tetor 2013
- Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, çështja Pélissier dhe Sassi kundër Francës, nr. 25444/94, datë 25 mars 1999
- Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, çështja Matoccia kundër Italisë, nr. 23969/94, datë 25 korrik 2000
- Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, çështja I. H. dhe të tjerë kundër Austrisë, nr. 42780/98, datë 25 prill 2006

- Gjykata Evropian e të Drejtave të Njeriut, çështja Block kundër Hungarisë, nr. 56282/09, datë 25 janar 2011
- Gjykata Evropian e të Drejtave të Njeriut, çështja De Salvator Torres kundër Spanjës, nr. 21525/93, datë 24 tetor 1996
- Gjykata Evropian e të Drejtave të Njeriut, çështja Sadak dhe të tjerë kundër Turqisë, nr. 29900/96, 29901/96, 29902/96, 29903/96, datë 17 korrik 2001
- Gjykata Evropian e të Drejtave të Njeriut, çështja Juha Nuutinen kundër Finlandës, nr. 45830/99, datë 24 prill 2007
- Gjykata Evropian e të Drejtave të Njeriut, çështja Zhupnik kundër Ukrainës, nr. 20792/05, datë 9 dhjetor 2010

VENDIME TË GJYKATËS SË KASACIONIT TË ITALISË (Corte di Cassazione)

- Sezioni Unite della Corte di Cassazione, vendim n. 5307 datë 01.02.2008
- Corte Cassazione penale Sezione VI, vendim n. 6251 datë 22 mars 2000
- Corte Cassazione penale Sezione III, vendim n. 5072 datë 17 mars 1998
- Corte Cassazione penale Sezione II, vendim n. 6584 datë 16 dhjetor 2003
- Corte Cassazione penale Sezione VI, vendim n. 10125 datë 22 mars 2000
- Corte Cassazione penale Sezione IV, vendim n. 30255 datë 12 korrik 2013

VENDIME TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË ITALISË (Corte Costituzionale)

- Corte Costituzionale, Vendim n. 333 datë 14 dhjetor 2009
- Corte Costituzionale, Vendim n. 265 datë 30 qershor 1994